


**Dr. Nuhi Veselaj**

**KONTRIBUTI I ASDRENIT  
NË FORMIMIN E GJUHËS LETRARE  
KOMBËTARE SHQIPE**

**(rishikim magjistrature)**



/Autografi i prof. A. Kostallari/

**Prishtinë, 2014**



## PASQYRA E LËNDËS

### KONTRIBUTI I ASDRENIT NË FORMIMIN E GJUHËS LETRARE KOMBËTARE SHQIPE

Parathënie

HYRJE

#### I. RILINDJA SHQIPTARE - USHQIM IDEOR DHE BURIM PRAKTIK GJUHËSOR I VEPRËS SË ASDRENIT

1. Kushtet shoqërore-ekonomike të kohës
2. Rreth tipareve të platformës gjuhësore të rilindësve që i përqafoi Asdreni

#### II. KONCEPTI I ASDRENIT MBI GJUHËN DHE FUNKSIONIN E SAJ

(1) Gjuha si mjet dhe armë për ekzistencë dhe zgjim kombëtar në periudhën para shpalljes së Pavarësisë

1. Koncepti i funksionit të gjuhës që nga paraqitjet e para të autorit

2. Çështja e alfabetit, gjuha letrare dhe diferencimi stilistik

(2) Periudha e Pavarësisë, zgjerimi i konceptit mbi gjuhën dhe të rolit të saj

1) Asdreni rreth gjuhës së Naimit dhe artikulli "Robëria dhe liria"

2) Rreth artikullit "Disa vërejtje përmi –Ë–në"

a) Konstatim hyrës

b) Rrëth përmbajtjes së artikullit

c) Sqarime të nevojshme

1. Rreth dy rregullave tash të pavlera

2. Vërejtje e konstatime me vlerë

3) Koncepti i Asdrenit rreth funksionimit të gjuhës në dy veprat e fundit të tij.

a) Nga "Psalme murgu"

b) Nga "Kambana e Krujës"

a. Nga "Republika shqiptare"

b. Nga "Trashëgim"

c. Nga "Unë flamuri po ju flas"

Sipërfundim

#### III. DISA VEÇORI DREJTSHKRIMORE-FONETIKE E GRAMATIKORE NË VEPRAT E ASDRENIT

1) Rreth disa veçorive fonetike

A) Alternimi i zanoreve

a) A-ja

b) I-ja

c) U-ja

ç) E-ja

Shënim.-

d) Ë-ja

B) Dyzanoret

a) Dyzanorshi IE

b) Dyzanorshi UE/UA

c) Dyzanorshi YE

ç) Fenomeni i shënimit –Ë të E-së së diftongut

C) Këmbimi i konsonanteve

1. C/S,C/X,C/Ç

2. G/K, G/GJ

3. H/zero

4. LL/L

5. R/RR

6. S/Z/X

7. SH/S/ZH

8 Ç/ SH

Shënim.-

9. Th/F/T

10. B/P

Ç) Grupet konsonantike dhe shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme

1. Veçori e përgjithshme

2. Asimilimi a reflektimi i grupeve konsonantike

## (II) VEÇORI MORFOLOGJIKE

(1) EMRI

1. Gjinia

a) Gjinia asnjënjëse

b) Gjinia mashkullore

c) Gjinia femërore

2. Shumësi dhe shquarsia e emrave

a) Shumësi me mbaresën –A

1) Gjinia mashkullore

2) Gjinia femërore

b) Shumësi me mbaresën –Ë

1) Gjinia mashkullore

2) Gjinia femërore

c) Shumësi me mbaresën –Ë

1) Gjinia mashkullore,

2) Gjinia femërore

Shënim.-

ç) Shumësi me mbaresën -O

d) Shumësi me mbaresën –ËR

dh) Shumësi me mbaresën –RA

e) Shumësi me mbaresën -NJ/J

- 3) Konstatime lidhur me rasat
- a) Emërorja
  - b) Gjinorja
  - c) Kallëzorja
  - ç) Rasa vendore
  - d) Rrjedhorja pa parafjalë

(2) FOLJA

- 1. Aoristi
- 2. Foljet më –NJ/J
- 3. Foljet me i ose o të theksuar përforcuar me J

IV. RRETH PËRZIJIMIT TË TË GJUHËS SË ASDRENIT ME  
GEGIZMA/TOSKIZMA

Konstatim paraprak

1) Disa nga gegizmat /toskiymat në veprat e Asdrenit

- 1. Nga Rreze dielli
- 2. Nga Ëndrra e lotë
- 3. Nga Psalme murgu
- 4) Nga Kambana e Krujës

2) Numri dhe trajtëshkrimi i paskajores me +pjesore sipas veprave të Asdrenit

Sqarim paraprak

a) Titujt e poezive dhe shembujt me paskajore me +pjesore, sipas veprave

- 1) RD
- 2) ËL
- 3) PM
- 4) KK

b) Pasqyra e numrit të paskajoreve me +pjesore sipas tipit të pjesoreve

c) Venerime rreth pasqyrës së mësipërme

Sqarim.-

Sipërfundim

V. DISA VEÇORI FJALËFORMUESE E LEKSIKORE NGA GJUHA E VEPRËS  
POETIKE TË ASDRENIT

A. PARASHTESIMI

- 1. Parashtesa Ç- (-SH/-ZH)
- 2. Parashtesa M-
- 3. Parashtesa N-
- 4. Parashtesa PA-
- 5. Parashtesa PËR
- 6. Parashtesa STËR
- 7. Parashtesa të tjera

B. PRAPASHTESIMI

- 1. Prapashtesa -AK(-ARAK)

2. Prapashtesa -AR, TAR
3. Prapashtesa -I, (-RI/-NI), -SI
  - a) Prapashtesa -I (-RI)
 

Tabela e numrit të emrave me -I
  - b) Prapashtesa -SI
 

Tabela e e numrit të emrave me -SI
4. Prapashtesa -IM
5. Prapashtesa -JE
6. Prapashtesa -ESË
7. Prapashtesa -(Ë)S
8. Prapashtesa -OR, -TOR, -SOR
9. Prapashtesa -OSH
10. Prapashtesa -(I)SHT, ISHTE? ISHTË
11. Prapashtesa -SHËM
12. Ca mbiemra tejfoljorë
 

Pasqyra e numrit të fjalëve me prapashtesa
13. Krijimi i disa foljeve me prapashtesën -O(J)

### C. KOMPOZIMI

Tabela e numrit të kompozitave prej veprës në vepër

### VI .DISA NGA VEÇORITË LEKSIKO-STILISTIKE TË GJUHËS SË VEPRAVE TË ASDRENIT

- 1) Dialektorja edhe kombëtarja në veprën poetike të Asdrenit
- 2) Fjalë të huaja dhe ndërkombëtarizma
- 3) Denduria e përdorimit të disa fjalëve dhe krijimi a sjellja e fjalëve të reja
 

Tabela e numrit të dendurisë së përdorimit të disa fjalëve
- 4) Konstatime rreth prekjes së së fjalëve për shkak rimimi
- 5) Fjalorth i disa fjalëve të karakterit inspirues

### PËRFUNDIMI

Literatura

## PARATHËNIE

Temën e magistraturës *Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe* ma propozoi Prof. Androkli Kostallari (mars 1973) në pajtim me prof. Ali Hadrin, që ishte atëherë dekan i Fakultetit Filozofik të Prishtinës dhe që të dy ishin në dijeni se në atë kohë isha i suspenduar (pezulluar) nga puna si i papërshtatshëm politikisht për pushtetin serb të kohës, ndërkaq si student pasuniversitar i kisha dhënë të gjitha provimet, andaj këtë temë ma kishin rezervuar (Shih autografin e prof. Kostallarit në ballinë), ngase e dinin se lëvizjen për hulumtime terreni ose në arkiva etj. e kisha të kufizuar. Kuptohet, temën e ofruar, edhe pse me njëfarë droje, e pranova me kënaqësi. Me kënaqësi se tema m'u duk e përkapshme, pasi veprat e Asdrenit që të katër përmbledhjet, tashmë i kishim të botuara te ne nga NGB Rilindja (1971) nën përkujdesjen e prof. Rexhep Qosjes, material i parë ky i grumbulluar për studim që tashmë e kisha në dorë dhe pothuaj tëtërin e kisha të lexuar paraprakisht dhe njëherazi isha i interesuar studimisht të kontribuojë pikërisht në fushën në mes të letërsisë dhe gjuhës, pasi deri atëherë, kisha bërë njëfarë emri në fushë të letërsisë (4 përmbledhje poezi e prozë pjesërisht të botuara), por edhe sa i përket gjuhësisë nuk isha aq mbrapa. Për dëshmi, i kisha ndjekur ligjeratat bashkë me pasuniversitarët nga kjo degë, andaj tema më pështatej, por në anën tjetër kisha njëfarë droje, sepse lidhur me këtë fushë kërkimore më mungonte përvoja dhe se kisha parasysh një konstatim të prof. Rexhep Qosjes, i cili duke u arsyetuar pse ai nuk e kishte bërë përgatitjen kritike të veprave të Asdrenit qe shprehur: "*një njeri i vetëm që do të dëshironte të bënte përgatitjen kritike të veprave të tij (Asdrenit) i ka të gjitha gjasat të humbet në atë pyll*", d.m.th. në pyllin e gjuhës asdreniane (Shih te Kambana e Krujës, shënim - f. 214) Megjithatë, tema ime kishte të bënte me një mënyrë tjetër vëzhgimore të atij pylli. Kishte të bëjë, rreth kontributit të Asdrenit për gjuhën në përgjithësi dhe me letrarishten e sotme në veçanti.

Sidoqoftë, nën aso kushtesh, pa humbur kohë iu përvësua rileximit, duke vënë në pah veçoritë gjuhësore të veprimtarisë së poetit. I rilexova me vëmendje fill e fund të katër përmbledhjet, duke nxjerrë shënime mbi bazë të *skicës ideore orientuese*, të cilën, ç'është e vërteta, ma diktoi pak a shumë prof. A. Kostallari, të cilën, si me thënë, e kishte pasur të parapërgatitur. Sidoqoftë, brenda një kohe të arsyeshme unë e përgatita temën, madje i shtova edhe kapituj të ri asaj skice-ideore për të treguar sadopak se kisha njëfarë aftësie për t'u ballafaquar me tema të kësaj natyre. Pas një kohe dorëshkrimit ia paraqita për shikim prof. Latif Mulakut, i cili sapo ishte emëruar si udhëheqës shkencor, të cilit në mënyrë të veçantë i jam mirënjohës, jo vetëm për kurajo e ndonjë vërejtje, por edhe për ndihmesën e nevojshme administrativo-procedurale që ma dha kështu pas ripunimit dhe dhënies së formës përfundimtare të temës ai u pajtua me parashtrësën drejtuar Këshillin Mësimor-shkencor, për caktimin e Komisionit për mbrojtjen e temës.

Ndërkohë, para se të mbrohej punimi si temë magistrature, rastisi që në Prishtinë të vinin prof. Koço Bihiku dhe prof. Jorgo Bullo, të cilëve u pata ofruar punimin shoqërisht. Pas leximit, profesorët e nderuar më fort më përgëzuan se ma bënë ndonjë vërejtje, Dhe së këndejmi puna ime e vlerësuar pozitivisht edhe nga Këshilli Mësimor-shkencor sipas referatit të prof. Latif Mulakut dhe më **03.04.1980**, tema me titull **Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe** si punim magistrature u mbrojt para Komisionit në këtë përbërje: **Akad. prof. Idriz Ajeti** (kryetar), **Akad. prof. Besim Bokshi** e

**prof. Rexhep Ismajli** (anëtarë) dhe **prof. Latif Mulaku** (mentor).

Kështu, edhe pse nuk isha plotësisht i kënaqur me punën time, rezervë që e bart edhe sot, sepse nuk m'u dha mundësia as atëherë as më vonë objektivisht e materialisht që të konsultoja dosjen në arkivat përkatës qoftë në Tiranë, Bukurisht etj., ose të bëja hulumtime plus siç ëndërroja, *ngase veç tjerash* kisha dëshirë që gjuhën e Asdrenit ta krahasoja me atë të Gj. Fishtes, që më mbeti vetëm dëshirë e porealizuar deri në dotët e sotme, pasi tash për këtë punë nuk po më lejojnë preokupimet e tjera dhe mosha, megjithatë ky punim po del si libër më vete, para lexuesve, duke lënë vend për vërejtje dhe përplotësime.

Në të vërtetë, pasi veprat e botimit të parë të Asdrenit (1971) me disa shënime të mëpastajme plotësuese më janë djegur gjatë Luftës, tashti u rishikua teksti i kopjes së punimit, të cilit, përveç lëndës nga botimi II i veprave të Asdrenit, botim i *NGB Rilindja*, Prishtinë 1987 u shtuan edhe të dhëna të reja që ndërkohë i ndeshëm të publikuara në masmedia dhe internet, madje u plotësua me kapitull të ri lidhur me gegizmat (paskajoren) në veprat e Asdrenit, por nuk e pashë të arsyeshme me i verifikue të dhënat statistikore nga tabelat përkatëse të kapitujve të fundit, por sidoqoftë, tekstin e përforcuar të këtij punimi me disa përplotësime e quaj bazë që mund t'u shërbejë studiuesve për punime të tjera edhe më serioze që duhet t'i bëhen gjuhës së veprës së Asdrenit, ngase, vërtet, vepra e tij meriton studime edhe më të thelluara, sidomos për disa pika të veçanta të specifikuara, përveç atyre nga fusha e letërsisë, por edhe nga ajo e gjuhësisë që këtu vetëm sa u prekën prej nesh.

Sidoqoftë, tashti presim vlerësimin e vërtetë nga lexuesi i nderuar. Megjithatë, edhe pse kemi të bëjmë me punim tim të parë shkruar në fushën e gjuhësisë, ne kemi bindjen se që lexuesi nuk do të zhgënjehet me përmbajtjen e tij, i cili edhe nuk u ndryshua shumë metodologjikisht nga version i parë, ngase patëm për qëllim ta ruajmë sadokudo karakterin e tij dokumentues, i hartuar që atëherë, në vitet '70 të shekullit XX, si tekst disertacioni për titullin: *magjistër i shkencave filologjike*.



## H Y R J E

Studimi i zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe paraqitet si një kompleks në vete. Por për t'iu qasur vështrimit të këtij procesi si një nga format mjaft praktike, të kapshme dhe frytdhënëse është edhe studimi i gjuhës së shkrimtarëve të veçantë në krahasim me normëzimin e sotëm. Natyrisht kontributi konkret i shkrimtarit në fushën e formimit të gjuhës letrare përkufizohet sipas fazës së caktuar historike, por edhe me jehonën që mund të ketë lënë ajo gjuhë në atë periudhë dhe etapat vijuese. Pikërisht, duke hetuar peshën e veprës artistike me fuqinë e jehonës së fjalës së tyre në kohë-hapësirën përkatëse të gjuhës globale kombëtare shqipe, mund të konstatojmë në këtë përjasje edhe kontributin e secilit shkrimtar veç e veç në formimin e gjuhës sonë letrare kombëtare. Nëse e krahasojmë gjuhën shqipe me një godinë të madhe e të bukur të ngritur trashëgimisht si dhuratë hyjnore, dhe të gjuhës letrare me elementet e gjuhës globale nga mbarë masat ose të folmet popullore në rrjedhë e sipër si nevojë e gjallimit, atëherë me siguri veprat e shkrimtarëve do t'i dallonim si pjesë të shtyllave a si qoshe të suvatuara me mjeshtri që bashkë me fasadimet me nerv ia shtojnë bukurinë arkitekturale nga pamja e jashtme, por njëherazi edhe nga përbrenda i shtojnë jetëgjatësi përmbajtësore asaj godine hyjnore. Asgjë nuk duhet nënvlerësuar në atë objekt madhështor shejtnor, sidomos, kur kemi për bazë gjuhën shqipe si dhuratë që e gëzuan e lëruan dhe na e lanë trashëgim të parët tanë që nga parahistoria, mirëpo shkrimtarët patriotë, sidomos nga epoka përkatëse historike do të zënin vendin më të merituar, pikërisht me sforcimin bazor arkitekturale dhe zbulimin fasador me elemente gjuhësore poetike, elemente këto që shërbyen si armaturim ndërlihdës përforcues. Sigurisht, të gjithë e dimë se në këtë kontekst respektimi qëndrojnë jo vetëm veprat e shkrimtarëve tanë të vjetër pararilindës, por edhe ata anonim, para e pas tyre, pastaj për lavdi të shumfishtë kanë lënë gjurmë edhe veprimtarët rilindës dhe sidomos tash krijuesit bashkëkohorët, më fort joanonimë. Sidoqoftë, në këtë kontekst kur kemi parasysh veprimin e Asdrenit respektimi qëndron dinjitetshëm në dy etapa zhvillimore (rilindje e pavarësi) kur u dallua ai si në fushën e atdhetarisë ashtu edhe në atë të krijimtarisë letrare. Shikuar në përgjithsi, nuk thuhet beft, *që popullin shqiptar e bënë ose e rilindën si komb shkrimtarët, me gjuhën dhe veprimtarinë e tyre*, pa marrë parasysh konfesionet ose shtresat shoqërore e politike – ideologjike që patën. Gjithsesi edhe sot e mot roli i gjuhës së shkrimtarëve në këtë drejtim do të jetë i dallueshëm. Në të vërtetë, edhe pse me formimin e shteteve, gjuha zyrtare administrative stilistikisht del e përshkallëzuar në shumë sfera të jetës reale, ndërsa stili i gjuhës poetike të shkrimtarit duket se del në simargjinë, e specifikuar më tepër në botën e ndjesive, megjithatë edhe ajo gjuhë në kuadër të formëzimit gjuhësor e kombëtar e ka vendin vet të pazëvendësueshëm. Së këtejmi, vepra e Asdrenit, vëzhguar nga aspekti historik bën pjesë në ato dy etapa. atë të Rilindjes Kombëtare dhe atë të Pavarësisë, etapa shumë të rëndësishme të formimit dhe konsolidimit të kombit dhe shtetësisë shqiptare. Shikuar nga fillimishtja ndoshta për periudhën e parë vepra e tij nuk është më dalluesja, ngase ajo nuk mund të krahasohet me kontributin e veprave të Naimit, Kristoforidhit, të Samiut, Gj. Fishtes, Prennushit, Gurakuqit, Mjedës etj., mirëpo edhe ajo (gjuha e veprave të Asdrenit) si vazhduese dhe ndërlihdëse e hallkave Rilindje/Pavarësi (romatizëm/realizëm) ka rëndësinë e

vet të padiskutueshme. Është fakt i pamohueshëm se gjuha e shkrimtarit është një sintezë ose maja më e lartë e përfaqësimit të gjuhës së atij populli në fazën e caktuar historike. Ajo edhe pse nuk është e tëra, është hallkë ndërflidhëse e dinjitetshme e asaj gjuhe, kur dihet se shkrimtari i mire me koloritin që i jep atij ligjërimi e pasuron dhe e ëmbëson atë gjuhë me shprehje metaforike, metonimike, simbole etj. Është e vërtetë se letërisa e rilindësve tanë shënoi kalimin nga letërsia shqipe me përmbajtje kryesisht fetare e didaskalike në letërsinë e mirëfilltë kombëtare (romantike/realiste), duke shënuar jo vetëm ngritje artistike, por edhe përmbajtje të angazhuar kombëtarisht, për të ndikuar kështu edhe në nervin gjuhësor të individëve, por edhe për të shërbyer si shtysë mbi bazën e gjuhës sonë letrare komunikuese të masave.

Së këtejmi, në këtë rrafsh, përveç veprimtarive të tjera, ngase shkrimtarët tanë u dalluan edhe në fusha të tjera, duke arritur të zënë edhe pozita të caktuara shoqërore-politike ose u dalluan edhe edhe si autorë librash nga fusha përkatëse shkencore e pedagogjiko-shkolllore, publicistike etj., megjithatë në këtë kontekst krimtaria letrare artistike e ruajti, si me thënë, vendin e vet të nderit dhe lidhur me këtë shtrohet detyrë që të konstatohet sa është e mundshme se cilat fjalë a shprehje konkrete i zgjodhi, i solli apo edhe i krijoi vetë shkrimtari në kuadër të mikro e makro strukturave të gjuhës, duke e shkrirë talentin e vet për të shprehur sa më mire mendimet e ndjesitë e veta. Madje, cilat nga ato fjalë mbesin si veçori e stilit individual si dhe sa të tilla me forcën e autoritetit estetiko-ideor të tij futën ose priren të futen në rrjedhën e gjuhës letrare kombëtare dhe në çfarë niveli. Prandaj, gjithsesi vlen të konstatohet realisht edhe ndikimi i gjuhës së veprës së Asdrenit në formimin e begatimin e gjuhë sonë në përgjithësi dhe të shqipes letrare në veçanti, qoftë ajo mbi bazë gegnishte atëherë, qoftë edhe ajo mbi bazë toskërishte, përkatësisht të standardit të sotëm.

Ç'është e vërteta, deri më tash Asdreni me të të drejtë është vlerësuar si shkrimtar i madh, publicist e poet i dalluar dhe duke qenë i tillë, sigurisht edhe ai me shkrimtarët e kohës së tij pati ndërndikim gjuhësisht e tematikisht dhe kështu kontribuan së bashku në përdorimin dhe për zhvillimin e gjuhës së shkollës dhe jo vetëm të saj. S'do mend se gjatë kohës së Asdrenit dhe më vonë do të jetë konsultuar vepra e tij nga bashkëvepruesit, por sa pati ndikim tek pasardhësit gjuha e veprës së Asdrenit dhe sa pati ndikim pikërisht në fazën formëzimit të ideve ose edhe konkretisht rreth normëzimit gjuhës sonë të sotme letrare kombëtare, jo krejtësisht mbi bazë njëdialektore, por *me përzijim* (sajim i Asdrenit), me disa elemente toskërishte/gegërishte, do të përpiqemi ta shndërisim sadopak këtu, ngase ky objektiv është edhe qëllimi i këtij punimi. Ç'është vërteta, ne në këtë punim jemi përpjekur të gjejmë sa ishte e mundur pikat afruese të gjuhës së Asdrenit, jo vetëm me letrarishten e sotme, por edhe me atë të ish shqipes letrare mbi bazë të gegnishtes, por edhe të cek edhe pikat dalluese dhe sa ia kemi arritur këtij qëllimi le të vlerësohet nga profesionistët dhe nga lexuesi i nderuar.

Është konstatim i drejtë se edhe Asdreni, si shkrimtarët e tjerë të dalluar, të dalë nga gjiri i Rilindjes sonë Kombëtare, luftoi dhe punoi për "gjuhën letrare shqipe, për mësimin e lëvrimin e lirë të saj, për njësimin e pastrimin e saj" (A. Kostallari, ref në KD, SF 1/73, andaj nisur nga ky fakt po përmendim kalimthi mendimet e dy intelektualëve tanë të dëgjuar rreth kësaj dukurie:

**Së pari**, si e vlerësonte që në atë epokë gjuhën e shkrimtarit (gjuhëtarit) prof Aleksandër Xhuvanit (Shih A. Xhuvani, *Çështje të fjalorit të gjuhës shqipe*, SL II, Tiranë 1972, 115-125), i cili për atë periudhë shquhej më fort si gjuhëtar-standardolog mbi bazë të

gegnishtes:

*Gjuha e shkrimtarëve të dalluar merret si "gjedhë" për formimin e gjuhës letrare, gjë që na jep për të kuptuar se gjuha e shkrimtarit përgjithësisht ishte ose duhet të ishte gjuhë e zgjedhur përfaqësuese e dalë në mbështje të gjuhës së popullit, e cila njëherazi kishte dhe e ka ndikimin e vet të gjithë folësit e asaj gjuhe.*

**Së dyti**, edhe prof. Dhimitër Shuteriqi (nismëtar në detyrë i standardit mbi bazë të toskërishtes), duke apeluar që të studiohet gjuha e shkrimtarëve të veçantë vlerësonte me të drejtë se:

*"Si përpunues të sintaksit e të stilit, si zgjedhës të shijes e fjalëve e të lokucionit, si krijues fjalësh e nuancash kuptimore, shkrimtarët kanë qenë në ballë të punës për gjuhën tonë letrare të përbashkët. Ende njihet pak e aspak, ende pak a aspak studiohet e përgjithësohet kjo ndihmesë nga shkenca jonë mbi gjuhën." (Shih Shkrimtarët dhe drejtshkrimi, SF 1/73) f. 171.)*

Prandaj shikuar nga ky aspekt studimi i gjuhës së veprave konkrete të shkrimtarëve, fjalë kjo me të cilën në ato faza konkrete kuptoheshin edhe me konceptin e vetë gjuhëtarit, andaj në këtë kompleks del si detyrë e shkencës sonë, për të nxjerrë në sheh kontributin ideor e gjuhësor të Asdrenit, andaj përpjekja jonë në këtë drejtim besoj se arsyeton vetveten.

Asdreni ishte i vetëdijshëm për rolin shumëdimensional që ka gjuha si ligjërim dhe njëherazi edhe për përgjegjësinë që ka vetë krjuesi letrar lidhur me të, prandaj, siç mësojmë edhe nga fjalët e tij, ai vazhdimisht bëri përpjekje që të furnizohej sa më mire me këtë armë kryesore të shkrimtarit, me të cilën vë në qarkullim idetë, mendimet dhe emocionet e veta dhe me to komunikon me lexuesit dhe e bën të pavdekshëm emrin me veprën e vet të sukseshme. Thuhet me të drejtë se poeti Asdren pati një jetë relativisht të gjatë letrare, gati dyzetvjeçare, dhe ishte në marrëdhënie bashkëveprimi me një shumicë shkrimtarësh e publicistësh të kohës, të cilët, bashkë me të, i dhanë kahen e tonin, në një farë dore, zhvillimit konvergjent të shoqërisë së atëhershme shqiptare gjuhësisht, politikisht dhe kulturisht. Dhe gjatë kësaj periudhe, sidomos gjatë tri dekadave të para të shekullit XX ai punoi e ndikoi intensivisht, jo vetëm me veprimtari e shkrime publike, por edhe më fort me vargjet e veta, me të cilat pasqyroi fatin historik të botës shqiptare, qoftë me tablo romantike, qoftë me ato realiste. Së këtejmi, në gjuhën e veprës së tij si ndërlidhëse e hallkave të zingjirit të formimit të gjuhës sonë letrare ndeshim elemente nga gjuha naimjane dhe e rilindësve të tjerë dhe të bashkëkohësve të tij, nga të cilët thithi dallueshëm nektarin poetik letrar që e mori, qoftë nga mësuesit e tij, qoftë nga bashkëkohësit, ashtu siç vepruan edhe A. Z.Çajupi, Gj. Fishta, F. Konica, H. Mosi, R. Siliqi, N. Mjeda, L. Gurakuqi etj. etj. edhe po me këtë nektar gjuhësor e letrar do ta kultivohet vazhdimisht edhe gjatë periudhës së Pavarësisë do të përshëndet fundi LDB-së dhe kështu edhe Asdreni para se të ikte në amshim la në prehërin e brezit të ri një tufë margaritari kulturor, gjuhësor e letrar që do të mbetet si një visar të respektuar përjetësisht në historinë tonë kulturore, gjuhësore e letrare.

Si fakt për ndërndikimin dhe ndërveprimin edhe të krijuesve letrarë po përmendim vlerësimin që i bëri atëherë veprën së dytë *Ëndra e lote* të Asdrenit poeti shkodran e gjithkombëtar me fame Atë Gjergj Fishta, te *Hylli i dritës*, nr. 8, 1914:

*...një vepër me dinjitet, që e pasunoi, letërsinë shqipe me poezi të përshkueme nga një*

*flad i ambël freskie dhe hijeshie fort të kandëshme... Mas mendimit tem, ky libër tfaq ma së miri shka ka të hieshëm në vetvedi djalekti i Tosknis.*

Sidoqë të jetë, bosht orientimi në punimin tone, patëm jo vetëm *skicën ideore orientuese*, por edhe të dhëna nga punimet e Prof.Kostallarit dhe të tjerëve lidhur me formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, që janë cekur si literaturë apo në referencat përkatëse të këtij punimi.

Në mënyrë të veçantë ishin të mirëpritura për ne shkrimet që pata mundësi t'i kisha në dorë, siç janë ato të Dhimitër Shuteriqit, Dhimitër Fullanit, Rexhep Qosjes, Jup Kastratit, Vehbi Balës, Koço Bihikut etj., edhe pse në shkrimet e tyre nuk është rrahur shtruar çështja ashtu siç kërkohet në temën tone. Në mënyrë të veçantë do të veçoja konstatimet që i bën gjuhës së Asdrenit prof. Dhimitër Shuteriqi në *Historinë e letërsisë shqipe I*, ku përmend disa neologjizma të Asdrenit, edhe pse ato, sipas tij, nuk mbeten të gjitha të inkorporuara në shqipen e sotme letrare kombëtare, siç janë disa: shkodranizma, korçarizma, adaptimi shumëtrajtash i infinitivit, përzierjet dialektore, ndonjëra nga fjalët e huaja, rrjedhorja pa parafjalë si dhe ndonjë ndikim nga fjalori poetik i Lazgushit, dhe pothuajse, të gjitha këto çështje janë prekur në një fare mase në kapitujt e fundit të këtij punimi, për të cilat edhe kemi shprehur vlerësimn tonë.

Përveç konstatimeve të prof. Dh. Shuteriqit përmendim edhe punimin e Jup Kastratit, *Disa konsiderata mbi gjuhën e Asdrenit*, ku përmend edhe mendimet e Asdrenit si kontribut, lidhur me ortografinë si dhe për gjuhën letrare shqipe. Gjithashtu për t'u kuptuar drejt dhe për t'u vlerësuar si duhet kontributi i Asdrenit nga aspekti gjuhësor patëm parasysht konceptin e drejtë se "gjuha me lidhjet e saj të zhvillimit mund të kuptohet vetëm atëherë kur studiohet në lidhje të ngushtë me historinë e popullit që është krijuar dhe bartës i saj". Pra duke u bazuar në këtë kontekst ne u përpoqëm të marrim në konsideratë të gjitha rrethanat e përkapshme me ndikim. Ndërkohë shkrimtari e studiuesi Sabri Hamiti (*Fjala*, 15 qershor 1975, f. 7) ka shprehur një konstatim jo pa interes pikërisht për gjuhën e poetit në fjalë:

*Poezia e Asdrenit është shumë më e realizuar poetikisht se vjershat e Naimit mbi gjuhën... Asdreni e njuh gjuhën si trashëgimi dhe përvojë të bartur nëpër kohë pandërprerje – si gjuhë të njohjes...(me) lashtësinë, bashkëhohësinë dhe me atë që vjen...*

Pra, nga kjo kuptojmë se Asdreni ka ecur mbarë edhe gjuhësisht e artistikisht në raport me vorbullsinë kohore shoqërore që përjetonte.

Sido që të jetë, me gjiithë ndihmën që mora nga studiuesit e qëmtuesit e sipërcekur, më është dashur që vijën e realizimit të kësaj teme në të shumtën e rasteve ta piketoja e ta hapja vetë. Mirëpo, tash së voni na u dha një rast i mire. Konsultuam punim-kumtesën, pothuaj të vetme të specifikuar nga fusha e gjuhësisë, shkruar nga **prof. Emil Lafe** me titull **Asdreni për gjuhën dhe gjuha e Asdrenit** (*Gjuha jonë*, nr. 3-4, 2002), për të cilin kemi respekt të veçantë, ngase aty profesori i nderuar me kompetencë analizon konceptin e Asdrenit për gjuhën dhe gjuhën e tij, ku veç tjerash etj.) bën mire që e nxjerr në sipërfaqe bashkë me mbi 20 konstatime, si veçori të gjuhës së Asdrenit që nuk përkojnë me standardin e sotëm, edhe fjalë-termin e Asdrenit, sajësë të Asdrenit: **përzijim**, fjalë kjo të cilën Asdreni, në të vërtetë e përdor edhe në një vend tjetër, duke e shënuar fillimisht si titull **Përzijim sendesh** në sinonimi me fjalën **Të përziëra** për poezinë që e boton nën titullin **Stinat** (Shih: **Psalmë murgu** -Shënime f. 333). Sidoqoftë, prof. E. Lafe, duke e përmendur 3 herë në atë kumtesë këtë sajësë të qëlluar të Asdrenit, pothuaj, e legalizon atë si term që i përshtatet natyrës së punës së

Asdrenit, ngase kemi të bëjmë me tiparin dallues të gjuhës ndërdialektore të Asdrenit. Mirëpo, ndoshta, përmasat e një kumtese nuk e lejuan profesorin e nderuar, që të zgjatet e thellohet edhe më shumë, pikërisht rreth këtij *përzijimi* të gjuhës toskërishte/gegnishte të Asdrenit edhe me paskajore me + pjesore (gege) që është një ndër *përzijimet* më karakteristike të gjuhës së Asdrenit. Po kjo nuk i ul vlerën aspak punimit të profesor E. Lafe, konstatimet e të cilit ishin tejet të mirëseardhura për rrumbullaksim e punimin tonë, sepse prej tij jo vetëm paten e kanë çfarë të mësojnë lexuesit, por mësova edhe vetë, qoftë nga të shprehurit e tij profesional, qoftë nga përzgjedhja e pikave përkatëse. Autori i kumtesës veç tjerash përmend, siç u cek, në nja 20 pika pikërisht si fakte të atij *përzijimi*, të cilat për kohën drejtshkrimisht nuk ishin të qortueshme, por që sot janë në dis-harmoni me normëzimin e shqipes së sotme letrare. Ne, këtë material qoftë si veçori fonetike, qoftë gramatikore e kemi shfrytëzuar në vendin përkatës gjatë analizës sonë, andaj e falenderojmë profesorin për këtë ndihmesë.

Sido që të jetë, në këtë punim veç tjerash gjatë shtjellimit të veprës së Asdrenit jemi përpjekur, veç hollësive të tjera të vemë në pah bashkë me veçoritë gjuhësore të Asdrenit edhe paksa *kontributin historiko-shoqëror, atë teoriko-letrar dhe sidomos kontributin gjuhësor-stilistik të veprës shkrimore të tij*, segmente këto që u trajtuan në këta pesë kapituj:

1. Rilindja shqiptare – ushqim ideor e burim praktik gjuhësor i veprës së Asdrenit;
2. Koncepti i Asdrenit mbi gjuhën dhe funksionin e saj;
3. Veçoritë më karakteristike drejtshkrimore në veprën poetike të Asdrenit;
4. Rreth përzijimit të toskërishtes së Asdrenit me gegizma dhe anasjelltas dhe
5. Disa veçori fjalëformuese në veprën poetike të Asdrenit.

Së fundi, u përmblodhën shkurtimisht fare rezultatet ose konkluzionet e përgjithshme dhe të veçanta **Rreth kontributit të Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe.**



## **I. RILINDJA SHQIPTARE - USHQIM IDEOR DHE BURIM PRAKTIK GJUHËSOR I VEPRËS SË ASDRENT**

Për të vlerësuar kontributin e Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe është e nevojshme që paraprakisht të dihen rrethanat nën të cilat u rrit, u formua dhe veproi ai, duke pasur pikëmbështetje, së pari, kushtet ekonomiko-shoqërore dhe ato historiko-politike e kulturore të kohës dhe së dyti, tiparet që i përqafoi Asdreni prej platformës gjuhësore të rilindësve tanë.

### **1. Kushtet shoqërore ekonomike të kohës**

Na është i njohur fakti se fundi i shekullit XVII dhe, pothuajse tërë shekulli XVIII, si dhe fillimi i shekullit XIX, ishte shekulli i zgjimit të popujve në përgjithësi, madje edhe në Turqinë osmane si dhe në vendet e tjera, sidomos europiane kishte depërtuar sadokudo jo vetëm idejisht revolucioni tekniko-shkencor si dhe ai ekonomik, bashkë me rryma të ndryshme shoqërore-politike. Sidomos në këtë kontekst Revolucioni Borgjez Frances (1789), pati jehonë epokale. Atëherë, qitën krye ose u përhapen dhe u identifikuan një varg rrymash e lëvizjesh filozofike, letrare-artistike dhe aq më tepër iluministe kombëtare në Europë e më gjerë. Është periudha, kur zunë të identifikohen kombet, madje si rrjedhojë edhe të formohen shtete kombëtare. Po në këtë periudhë zejtaria me elemente tekniko-teknologjike kishte marrë hov të jashtëzakonshëm në krahasim me periudhat e mëparshme. Lidhjet tregtare kishin hapur mundësi të reja, duke zgjeruar gjithnjë e më tepër rrjetin tregtar. Rrugët për fitime ishin hapur, sidomos në vendet ku kishte filluar të lulëzonte ekonomia, jo vetëm ajo manifakturale, por edhe ajo kapitaliste, ku aplikoheshin normat e reja dhe shfrytëzoheshin mjetet teknike dhe krahët e punës mbi bazë të këtyre normave.

Në Europë e në përgjithësi, u përhap ose u sfocua ideja e iluminizmit, e gërshetuar edhe me ato të romantizmit. Kështu romantizmi te shqiptarët si rrymë e drejtim në këtë kohë nuk pati jehonë vetëm në shkrime, por edhe në aspektin psiko-sociologjik rreth zgjimit kombëtar, sidomos kjo vërehet gjithnjë e më shumë te intelektualët përparimtarë shqiptarë, të cilët shfaqen respekt ndaj gjuhës së tyre amtare. Në të vërtetë, interesimi për popullin shqiptar dhe ekzotikën e vendit të tyre u bë edhe si temë e kohës në disa qarqe të caktuara europiane. Është koha, kur një varg romantikësh paksa aventurierë, si Bajroni, e të tjerë, kishin prekur me këmbë, kishin parë me sy dhe kishin shprehur me shkrime okzotikën e viseve shqiptare. U shfaq dhe u intensifikua edhe interesimi për gjendjen dhe studimin e gjuhës shqipe. Dhe të gjitha këto ndihmonin dhe nxitnin edhe riidentifikimin e kombit e të entitetit të shqiptarsisë, edhe pse ende kombi shqiptar nuk njihej zyrtarisht, jo vetëm nga Turqia, po as nga shtetet e tjera të mëdha europiane, sepse edhe vetë shqiptarët në masë të madhe ende ishin të zgjuar jo sa duhej kombëtarisht, ngase i kishin të mbuluar sytë e mendjes me tymin e zi të robërisë osmane të ndihmuar me injorancën e me propagandën e klerikëve të feve e ideologjive të huaja. Ndërkohë, u përftuan disa intelektualë shqiptarë, të cilët arriten nivele të larta diturie e zgjimi sipas frymës europiane dhe si rrjedhojë filluan të mblidhnin visarin gjuhësor të popullit

shqiptar, por edhe të mbillnin e selitnin masivizimin e idesë së zgjimit kombëtar për dashuri ndaj gjuhës shqipe. Çështë e vërteta, kishte edhe shqiptarë pasivë në trojet e veta, por kur mërgonin si krahë pune në vendet ku "fitohet" bukë më lehtë, si në Egjipt, Amerikë, Stamboll dhe në thellësi të qyteve tjera të Turqisë dhe sidomos në metropolet europiane e amerikane, atje transformoheshin si atdhetarë të vërtetë. Po kështu ndodhi edhe me jo pak shqiptarë kryesisht nga Jugu i Shqipërisë që kishin migruar në Rumani. Atje, në Rumani, disa individë, bashkë edhe me disa familje që pretendonin se kishin prejardhje vllahe (arumune), por pa përjashtuar gërshetimin thrako-iliro-shqiptar, kishin bërë emër. Aty, madje kishte familje të tilla shqiptare që më herët kishin prosperuar shumë, siç ishte edhe familja e Gjikasjve. Ndërkohë, aty nga gjysma e shekullit XIX ndodhen edhe ngjarje të tilla shoqërore politike, kur u intensifikuan luftat e popujve për çlirim në baza kombëtare, pra, edhe në vendet e Ballkanit. Madje disa shtete fituan autonomi ose u mvetësuan nga zgjedha e Perandorisë Osmane. U bënë të pavarura ose autonome të ndihmuara kryesisht nga Rusia cariste e nga disa shtete europiane, të cilat ishin në armiqësi historike e konfesionale me Turqinë. Kështu pati ndodhur me Rumaninë. Po në këtë kontekst ndërkohë fituan identifikim kryesisht vendet ortodokse si Greqia, Mali i Zi, Serbia, Bullgaria, të cilat që në fillim e në vijim të ndërsyera sidomos nga Rusia cariste haptas e me dredhi shprehnin oreks për gllabërimin e tokave shqiptare që mbeten nën ombrellën e shkriftë të Stambollit. Kjo u intensifikua sidomos pas Paqes së Shën Stefanit (mars 1878) kur Turqia si humbëse e Luftës me Rusinë, si peng për paqe lëshinte pe dhe ofronte territore satelitëve të Rosisë, nga viset e Rumelisë (Ballkanit), të banuara me shqiptarë. Një zgjerim i tillë i pushtetit, përkatësisht i influencës së Rosisë preku interesat e shteteve europiane, të cilat ndërhynë, andaj si rrjedhojë u organizua Kongresi i Berlinit, i cili paksa do ta frenonte Rusinë rreth këtij gllabërimi, megjithatë ashtu-kështu disa territore shqiptare mbeten të pushtuara e disa të tjera u vunë në rrezik potencial si mall kusuritjeje në mes të shteteve të huaja dhe Turqisë. Në këtë kohë populli shqiptar i prirë nga intelektualë atdhedashës, duke shfrytëzuar rrethanat edhe me njëfarë pëlqimi të Portës së Naltë, bëri rezistencë të organizuar me formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (qershor 1878). Në të vërtetë, kjo Lidhje me elemente jo vetëm të synuara shteti, por edhe me diçka më shumë, zgjati vetëm 3 vjet, deri në vitin 1881, kur ajo rezistencë e organizuar në shkallë kombëtare u shua me zjarr e hekur nga Turqia. Pikërisht në këtë kohë, Asdreni ishte 9 vjeçar. Sigurisht, edhe pse si nxënës i shkollës greke mund ta kishte ndjerë, dëgjuar e shijuar paksa jehonën e ndjenjës së zgjimit kombëtar arbëror, e cila sadokudo dukej në lëvizjen e masave për ruajtjes e identitetit shqiptar dhe këtë ndjenjë rezistence e afrimi ndërkonfesionor gjithsesi do ta bartë me vete e do ta shtojë e formëztojë më tej, pas 4 vjetësh, në Rumani, ku qe i detyruar të emigronte në moshën 13 vjeçare. Atje, në Rumani, njëherë provoi si qymyrshi, por fati i ndihmoi, gjeti punë në një dyqan ëmbëlsiqesh. Aty, për 3 vjet punë do të bëhet edhe vetë mjeshtër ëmbëtar. Po, veç kësaj ushtroi dhe punë të tjera, por arsimimit nuk iu nda. Përveç shkollës së N. Naços, atje, edhe pse në gjuhën rumune, kreu shkollën e mesme, ku e perfeksionoi greqishten e rumanishten, por e mësoi edhe frëngjishten, por, si duket, mori baza edhe për gjuhë të tjera si gjermanisht e italisht, nga të cilat më vonë me sukses do të bëjë adaptime vjershash. Një kohë vazhdoi mësimet në fakultetin e shkencave politike, të cilin nuk e kreu po për shkaqe ekonomike e të tjera, por ky, në të vërtetë kreu tashti një shkollë tjetër shumë me vlerë që do ta bëjë të pavdekshëm në botën shqiptare. Kreu **shkollën e shqiptarisë**, duke u mbrumosur kështu me idetë e Rilindjes sonë kombëtare. Dhe, si me thënë, u bë student e studiuës i



zellshëm i veprave të rilindësve tanë, sidomos i veprave lirike-bukolike e atdhetare të Naim Frashërit, rrugën e të cilit do ta vazhdojë me sukses, por aq më tepër mësoi nga burime të tjera me ç'rast e përvetësoi shqipen e dy koineve kryesore: toskërishte e gegnishte, të cilën do ta dëshmojë që në shkrimwet e para.

Në të vërtetë, Asdreni, dorë të mbarë për gjuhën shqipe pati marrë pikërisht pasi kreu shkollën e natës, të organizuar prej atdhetarit të madh të asaj kohe **Nikolla Naço**, i cili qe aktiv në shoqatën **Dituria**, të cilën e pati formuar Jani Vreto, si degë të asaj të Stambollit, pastaj vetë ky botoi gazetën **Shqiptari**, ku e punësoi Asdrenin, si përkthyes-redaktor të pjesës në gjuhës shqipe. Aty, Asdreni (Aleks Stavri Drenova), fitoi shumë intelektualisht e gjuhësisht. Po aty iu dha mundësia të njëhej e shoqërohej edhe me shumë shokë ideali, bashkëmendimtarë të lëvizjes panshqiptare. Madje në Shoqatën **Dija**, u lidh me një grup atdhetarësh shqiptarë të afirmuar, si: *Mihal Grameno, Ibrahim Temo, Thoma Avrami, Jashar Erbara, Kristo Luarasi, Dërvish Hima e Jan M. Lehova*, që të gjithë këta, secili në kaçikun e vet, në rrugën kombëtare bënë emër për lavdi që përmenden në historinë e kombit tonë. Edhe Asdreni, përveç aktiviteteve të tjera, pati hapur një shkollë për fëmijë të punëtorëve shqiptarë në Konstancë, por ai më tepër u dallua në fushën e krijimtarisë publicistike e sidomos poetike. Në këtë kontekst do të njëhej si vazhdues i frymës së Rilindjes sonë Kombëtare. Po cilat ishin ato tipare të kësaj rilindjeje që i përqafoi dhe i sendërzoi Asdreni në veprat e tij do t'i cekim tash fill në nëntitullin vijues, por gjithsesi do t'i faktojmë konkretisht gjatë shtjellimit analitik të veprës shkrimore të Asdrenit në krerët vijues të këtij punimi.

## 2. Rreth tipareve të platformës gjuhësore të rilindësve tanë që i përqafoi Asdreni

Nuk është e tepërt të riceket e vërteta se rilindësit tanë, edhe pse ishin nën robërinë osmane, idenë e Atdheut e kishin të perceptuar drejt. Atdhe quhej **Shqipëria**, trolli ku jetonin dhe flisnin gjuhën e tyre popullsia iliro-arbnore që tash e quanin veten **shqiptarë**, të cilët identifikoheshin edhe territorialisht: **Qysh prej Tivari deri në Prevezë (V. Pasha)**, ku të parët e tyre, dembabadem kishin gjalluar në “**fushat e gjera e malet e larta**”, ku në ato **Bjeshkët e shqiptaris**”, “**natyra i pëpoq**” dhe ku i njëhte edhe “**guri i thatë**” (Naimi, Fishta Mjeda, Çajupi). Pra, kështu konceptisht ishin kristalizuar të gjitha trojet ku banonin shqiptarët nga Doklea deri te Gjiri i Artës, të cilat për t'i bashkuar e mvetësuar lypsej punuar shumë dhe për t'ia arritur qëllimit lypsej Platformë e përgjithshme e përcaktuar dhe brenda saj patjetër si punë e parë imponohej mbështetja në kultivimin e gjuhës shqipe. Po cilat ishin ato tipare kryesore themelore të asaj *platforme në lëmin gjuhësor*, do të përpiqemi t'i përmbledhim më poshtë:

- 1) Rilindësit kërkonin që të flitej e të shkruhej shqip dhe vetëm shqip, pa barbarizma, duke respektuar njëhërëpërnjëherë *gjuhën e përzier* (Sami Frashëri) d.m.th. të jenë të lira të gjitha të folmet e gjuhës globale shqipe në kuadër të dy dialekteve, atbotë, si të thuash, të dalluara, edhe pse jo aq të koenizuara: geqe e toske.
- 2) Tradita shkrimore (gjuha e shkrimtarëve të vjetër) të respektohej sa më shumë, por pa lënë anash trajtat e të folmeve përkatëse. Nuk prishte punë, sipas tyre, që gjuha të jetë *e përzier* me trajta të llojllojshme sinonimike shqipe, qoftë edhe për të njëjtin nocion,

por gjithsesi duke pasur tendencë afrimi në konkurrencë lojale drejt një gjuhë të përbashkët që e ardhmja do ta formëzojë, por duke pasur si koncept parimin mesin e artit urbano-gjeografik (vija Shkumbin me qendër Elbasanin) që ndërlidhte këto dy sikoine.

- 3) Në shkrime e biseda të rrahen dhe të glorifikohen edhe mite siç ishin edhe temat historike, pellazge, ilire, dardane dhe sidomos të spikatej epoka skëndërbejane.
- 4) Në shkrime të trajtoheshin tema nga jeta fshatare e baritore, të natyrës shqiptare për të nxjerrë në dritë terminologjinë përkatëse. Dhe kështu, duke shfrytëzuar folklorin dhe të folmet rilindësit tanë, në të vërtetë, edhe futën në përdorim shumë fjalë të gurrës popullore dhe në këtë mënyrë ndihmohej ngjallja e leksikut të lëmenjve përkatës nga gurra e të folmeve popullore. Me një fjalë, edhe u ringjallën nga ata shumë fjalë, trajta fjalësh, lokucione e frazeologji popullore, madje u bë ripërrirja e disa fjalëve, të cilat u shkundën nga pluhuri i harresës.
- 5) Nga rilindësit u thurën vargje si tekste këngësh popullore sipas frymës së këngëve shqipe të trashëguara, por edhe sipas zhanreve të gjuhëve të huaja të zhvilluara dhe kështu u pasurua shkrimi shqip me tema e forma përkatëse sipas modeleve të gjuhëve të zhvilluara të kohës.
- 6) Rilindësit i vunë vetes për detyrë të qërojnë gjuhën, sidomos nga barabarizmat turke, edhe ato greke, madje edhe disa terma të huaj (ndërkombëtarizma) i kalkëzuan, duke krijuar kështu fjalë të reja sipas natyrës së gjuhës shqipe, në përputhje me ligjësitë e brendshme të saj. Edhe pse nuk ishte përpjekje jo e pambarë, të gjitha ato *kalkëzime* ose terma *të krijuar prej tyre* nuk mbeten të qëndrueshëm në letrarishten e mëvonshme të zyrtarizuar, përkatësisht në stilin funksional përkatës sipas degëve a disiplinave të caktuara shkencore.
- 7) Në shkrimet e rilindësve tanë nuk mbeten pa u fshikulluar edhe disa vese të pakëndshme të popullit tone, sidomos: tradhëtia, naiviteti, shpirti rob në shërbim të të huajve etj.
- 8) Nuk u la anash pa u prekur e neutralizuar, sa ishte e mundur, as fanatizmi fetar, pastaj drejtpërdrejt ose ironikisht në satira kritikoheheshin edhe veset e të këqijat e shoqërisë shqiptare të asaj kohe, por që një punë e tillë u vazhdua edhe në periudhën e Pavarësisë. Ndërkohë u kritikua deri edhe funksionimi jo normal i organizmave të shtetit shqiptar. Sidomos u kamxhikosën: mospuna, mosshkollimi në gjuhën amtare, padrejtësia ndaj vegjëlisë, jo vetëm nga bejlerët e vjetër, por edhe prej *beglerëve të rinj*, me një fjalë, viheshin në thumb edhe pushtetarët për qeverisje jot ë mirë.

Në të vërtetë, shumë kërkesa e kritika të rilindësve me vlerë universale, për mos me thënë: që të gjitha, mbeten aktuale edhe në periudhën vijuese të Pavarësisë, madje janë aktuale edhe sot.

Po tashti shtrohet pyetja, ato veçori të rilindësve të sapocekura, a vërehen apo si i ndeshim të zbatuara në veprat e Asdrenit, në veçanti në dy veprat e para, që i takojnë kësaj etape, do të përpiqemi t'i zbardhim gjatë analizës sonë. Mirëpo, pasi tema jonë nuk ka të bëjë aq me tiparet të rilindësve tanë, po ka të bëjë konkretisht lidhur me kontributin e Asdrenit në formimin e shqipes letrare kombëtare, ne, gjithsesi do të ndalemi për aq sa e kemi të mundur të konstatojmë rreth zbatimit të veçorive të sipërcekura në gjuhën e veprave të Asdrenit. Dhe për të arritur te objektivi i temës sonë paraprakisht do t'i themi ca fjalë më në hollësi rreth

formëzimit të tij gjuhësor.

Konstatohet fillimisht se Asdreni nuk nxitoi së ekspozuari sa më parë me shkrime. Ai këtë e bëri vetëm pasi u brumos dhe u pajis intelektualisht e gjuhësisht në mënyrë mjaft solide, qoftë me dije të përgjithshme, qoftë edhe me mësimin e përvetësimin e gjuhës shqipe të të dy koineve. Kështu në moshën 30 vjeçare filloi, së pari, me ndonjë artikull gazetaresk ose me ndonjë poezi. Dhe pikërisht këtë pjekuri intelektuale e gjuhësore e dëshmojnë shkrimet ose poezitë e tij të para të sukseshme që filluan të botoheshin në shtypin e kohës, si vjersha *Mallkim*, e botuar te *Albania* e F.Konicës, por aq më tepër me paraqitjen e përmbledhjes së vjershave të frymëzuara me titull **Rreze dielli**, e cila pa dritën e shtypit më 1904. Pas kësaj, Asdreni vazhdoi gjithnjë e më me sukses me shkrime publicistike dhe sidomos me krijime të tjera, kryesisht të angazhuara, didaktike e letrare poetike, të cilat i kurorëzoi me veprën tjetër edhe më frymëzuese me titull **Ëndrra e lotë**, e cila u botua pikërisht, në vitin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (1912), vepër kjo që, mund të quhet si një dhuratë që Asdreni i paraprinte kësaj **Shpalljeje**, me të cilën në të vërtetë, nderonte letërsinë shqipe, nderonte kombin e gjuhën shqipe, nderonte dhe personalitetin e vet, ngase këto poezi shërbyen si perla të poezisë shqiptare për kohën, siç ishte edhe poezia **Betim mbi flamur** e cila u bë hymni ynë kombëtar. Në të vërtetë, kjo poezi e shkruar e përpunuar me njëfarë adaptimi më parë (1908), por që botuar më 2 prill 1912 në Sofje, d.m.th. 7 muaj, para se të bëhej shpallja e **Pavarësisë** në Vlorë, më 28 Nëntor 1912. Kështu Asdreni sidomos me këto dy vepra, por edhe me veprimtari të tjera, i siguroi vetes vend nderi në historinë e popullit tone si rilindës në përgjithësi dhe në veçanti në fushën e poetikës shqipe.

Vetë paraqitja e tij e suksesshme me shkrime në moshën 30-vjeçare parakupton, pra, siç u tha, formimin e tij gjuhësor, andaj dhe fillet e formimit të tij gjuhësor i hetojmë po në fazën e fundit të Rilindjes sonë, fille këto që do t'i shpjerë të tufëzuara edhe në etapën Pavarësisë, kur ajo gjuhë pasurohet vazhdimisht, duke u specifikuar jo vetëm nga tema të ndryshme shoqërore që trajton, por edhe nga gjuha e profiluar vetëm për ndonjë temë të veçantë, siç janë tekstet që u komponuar këngë e u shfrytëzuan si recital. E veçanta e stilit të tij gjuhësor del se ai, sidomos në kohë të fundit nuk glorifikonte në krijime të veta më gjuhën e shqiptarët si shkrimtar i stilit romantik, por e pasqyronte në raste realitetin e hidhur shoqëror të atyre periudhave që po kalonte shoqëria shqiptare dhe kështu e shprehu mjaft fuqishëm atë realitet me disa satira të tij të paarrtshme nga të tjerët, ngase ky atë hidhërim e përjetonte me shpirt si njeri e si poet.

Në të vërtetë, Asdreni që në vjershat e para preku kurbetin, të cilin, siç e thamë, e përjetoi në palcën e shpirtit të tij që në moshë të njomë. Ky nuk e mohonte Bukureshtin, qytet ky, i cili pranoi shumë mërgimtarë shqiptarë edhe vetë atë, të cilët i "ushqente" dinjëtetshëm,, por Asdreni mallkon fatin se aty ata mërgimtarë mbetnin përgjithmonë, andaj poeti me keqardhje mallkon lumin e Bukureshtit Dumbovicën, ngase, siç thotë ai:

se ujën tënd kush e pi  
më s'shef as fëmij as shtëpi!...

dhe përfundon:

se sa herë ty të kujton  
s'mund të ikin e të mallkon!

Mirëpo, disa nga ata mërgimtarë që s'u kthyen më në vendlindje, në atë vend arritën edhe njëfarë karriere tregtare e politike, madje ndonjëri nga ata kishte mundësi të shërbente edhe si punëdhënës. Ndër ta pati edhe bankierë, të cilët joshnin me ndonjë ndihmë të lehtë mërgimtarët e rinj dhe njëherazi dikush prej tyre i prekur nga ndjenjat rilindëse ndihmonte edhe çështjen shqiptare. Një fat të tillë ngulitjeje e pati, pra, edhe Asdreni, i cili në atë qytet, shkoi, jo për të studiuar a për t'u arsimuar si poet, mendimtar e patriot, siç do të na dalë, por thjesht fillimisht shkoi si qymyrxhi e çirak për të fituar kafshatën e gojës.

Por, sido që të jetë, Asdreni, duke marrë me vete, gjuhën shqipe, edhe pse të shkriftë, jo vetëm nuk do ta harrojë atë, vendlindjen e atdheun, por do ta përsosë gjuhën, jo vetëm si mjet komunikimi, në bisedë të përditshme së bashku me shumë bashkatdhetarë të tij, por edhe për më shumë. Njëherazi, duke qenë nxënës shembullor kryesisht i veprave të poetëve, gazetarëve e publicistëve tanë rilindës, të cilat merrnin e jepnin jetë pikërisht në klubet e shoqëritë e shqiptarëve në mërgim, siç ishte edhe Bukureshti, ai do ta dojë edhe më shumë gjuhën e vendlindjes, Atdheun. Kështu Asdreni duke u brumosur me ndjenja e dije atdhetare do të bëhet edhe vetë një ndër njohësit e mire të kësaj gjuhe, në rritje e sipër, madje duke arritur të jetë edhe mësues i saj. Së këndejmi, si shumë mërgimtarë edhe ky në shkollën e mërgimit mësuan, fituan dhe u mishëruan edhe një botëkuptim të ri ndaj jetës, fituan një shpirt më të lirë, zgjeruan horizontin e vëzhgimit mendor etj. Kështu përlindi tek ta një ndërdije e re, jo vetëm për çlirim nga zaptuesit turq, por edhe për luftën klasore kundër shfrytëzimit të egër feudalo-borgjez. Ide të tilla, siç do të shohim, i ndeshim të gërshetuara në veprat e tij. Asdreni, në të vërtetë, përqafoi rrugën e drejtë, ku ky jo vetëm nuk u lëkund në vallen e lëvizjes për çlirim kombëtar, por u thithmua edhe nga ideja demokratike e përparimtare e kohës. Ai dinte për luftën garibaldiane në Itali, për lëvizjen për pavarësi në Rumani e vende të tjera të Ballkanit. Me një fjalë, kishte pëqafuar si ide e praktikë moto-parullën e revocionarëve të Revolucionit francez (1789): "*liberte, egalite, fraternite*," (liri, barazi, vëllazëri).

Kështu Asdreni me kohë mori erë aksionisti për goditje e thyerje shpatash pikërisht nën ndikimin e atyre rrymave luftarake përparimtare Këtë e dëshmon duke u inkuadruar me plot qenien e vet në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, madje edhe më me bindje dhe përkushtim për realizimin jo vetëm të mëvetësisë së Shqipërisë, por edhe për lirinë kombëtare e njerëzore të popullit shqiptar, kauzë kjo, për të cilën do të veprojë gjatë tërë jetës së tij si poet dhe si patriot.

Ç'është e vërteta, edhe pse Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shua me gjak, siç u tha, veprat e rilindësve tanë nuk u shuan dot, përkundrazi ato u shumuan, u përhapën edhe më me jehonë të bardhë propagandistike anembanë trojeve shqiptare, jo vetëm në diasporë e mërgatë, por edhe brenda trojeve të atdheut të robëruar. U përhapën qoftë me gojë, qoftë me publikime publicistike, qoftë, e aq më tepër, edhe me këngë popullore e me krijimtari letrare poetike, por thjesht edhe me vepra shkencore gjuhësore, siç ishin gramatikat e autorëve: K. Kristoforidhi, Sami Frashëri e Pashkë Vasa, të cilat nuk ishin prodhime të rastit po ishin prova që pasqyronin pjekurinë e platformës së rilindësve tanë, ngase dihej deviza: **Pa dije e zhvillim shkencor nuk ka mëvetësi e liri të vërtetë kombëtare**. Shkrimet e tilla, sidomos veprat poetike e programatike gjithnjë e më tepër gjetën mbështetje e jetë në masat e gjera dhe hap pas hapi u bënë ushqim shpirtëror pothuaj i të gjitha shtresave të shoqërisë shqiptare që jetonin dhe jetojnë edhe sot bashkë me shpresën që një ditë do të realizohej aspirata e dëshiruar rilindëse

kombëtare: **Bashkimi i tokave shqiptare në një Shqipëri unike, së paku, pa vijë të zezë kufindarëse.** Aktivitete më të gjalla, atëherë, u përformuan sidomos në kolonitë shqiptare, ku si qendër ndërlidhëse shërbente pikërisht kolonia e Bukureshtit. Atje, në Bukuresht, deri në prag të pavarësisë, frekuentonin lirshëm të gjithë veprimtarët më në zë të çështjes kombëtare. Mërgimtarët e atëhershëm si edhe të sotmit e kishin të gjallë idenë e bashkimit, e cila gërshetohej siç gërshëtohet në njëfarë dore edhe sot edhe me nostalgji e trimëri dhe me shkrirje pasurie, por sidoqoftë, vërejmë se edhe për Asdrenin puna rreth kulturës gjuhësore e kujdesit ndaj saj, shtohet, rritej, madhohej e pasurohej vazhdimisht. Asdrenin e gëzonin dhe e frymëzonin pa masë faktet që edhe në atdhe nuk ishin të pakta rezistencat me armë kundër dhunës të pushtetit të huaj, andaj i frymëzuar nga ngjarjet e tilla thurte vargje në përkrahje të veprave të tilla. Në atë kohë Turqia osmane nuk ishte e zonja të ruante interesat vitale as të shtetit të vet e mjerisht aq më pak të ruante pa coptuar tokat e banuara me shqiptarë ose t'u jepte bile njëfarë autonomie, qoftë edhe nën ombrellën e vet, dhe kështu të shpëtonte nga ndarja tërësinë gjeografike e një populli me përkatësi të njëjtë etnike e gjuhësore.

Veprat e tilla ashtu si edhe ajo e Asdrenit lindën nën kushte jo aq të volitshme, sepse masat shqiptare sa i përket dritës së shkollimit ende mrizonin unshëm nën terrin e analfabetizmit, të injorancës dhe të fanatizmit fetar, faktorë këta, që gjithnjë frenonin e tërhiqnin mbrapa, duke i mbajtur masat në amulli. Kështu këtë amulli shfrytëzonin politikat e huaja, duke i lënë të tillët në shërbim të pushtuesit, duke u përgatitur që të tillët t'i gllabëronin vetë, megjithatë veprat e rilindësve tanë nëndheshëm lëviznin dhe si rrjedhojë patën jehonë shumë pozitive. Ishte ajo periudhë, kur intelektualët shqiptarë edhe brenda pushtetit turk, si me thënë, rrezikonin gjithçka individuale, duke e vënë tërë mundin e fuqinë e tyre në të mirë të zgjimit kombëtar në trojet shqiptare. Ishte kohë, kur intelektualë e patriotë të të gjitha shtresave dhe konfesioneve nuk e ndalnin veprimtarinë, edhe pse jetonin nën kanosjen e përndjekjeve të pandërpera turke e të reaksionit vendës, por edhe të intrigave dhe represaljeve të shovinistëve e sidomos të fanarit grek në jug dhe popave sllavë (rusë, serbë e bullgarë) në veri, të cilët kishin liri veprimi ndër ortodoksët shqiptarë, e drejtë kjo e lejuar ndërkombëtarisht që në Kongresin e Berlinit. Madje edhe disa shtete europiane, siç është cekur më përpara, ndihmonin apetitet imperialiste greke e sllavo-ortodokse, të cilët donin ta pushtonin trojet shqiptare, pikërisht në kohën kur ai popull sapo kishte filluar të ushqente puplat e veta shqiptarë me rrezet e dëshirës për të fluturuar në qiellin e autonomisë ose të pavarësisë së vet, sapo kishte filluar të thithte e të ngrohej shpirtërisht me ajrin e pastër të historisë së vet në ato kohë plot shtrëngata, kur kishte aq dëshirë si etnitet për të shijuar i lire freskinë e qiellit dhe të trollit të vet dhe të hapte krahët për përqaftim drejt lirisë, drejt fluturimit në qiellin e vet në kuadër të kontinentit të popujve të lirë europianë.

Dhe, ç'është e vërteta, përkundër pengesave të shumta, vepra e rilindësve, mund të thuhet se u kurorëzua me sukses, ngase u shumuan përkrahësit e mëvetësisë, sidomos në kohën e Asdrenit të ri të burruar, por edhe në saje të atyre që pasuan rrugën e tyre në kohën e rritës së bijve dhe bijave të shqipes. Dhe pikërisht këtu, qëndron rëndësia dhe merita e vijuesve të tyre, të bashkëlufëtareve të Asdrenit me shokë, të cilët mësuan nga të parët dhe me përkushtim vazhduan punën e tyre, duke vepruar me guxim kundër ndasisë që vinte nga injoranca dhe fanatizmi fetar, realitete këto që mjerisht janë të pranishme me plot paqartësi dhe sot. Andaj në trojet e veta e kudoqofshin shqiptarët toskë e gegë, muslimanë e të krishterë edhe sot s' duhet

të harrojnë shqiptarët jo vetëm krahasimin që bën Atë Gjergj Fishta se në **Shqipni**:

Atje lejnë toskë e gegë  
Si dy rreze n'flakë të nji dielli,  
Si dy rrfe që shkojnë tue djegë  
Kur shkrep reja nalt prej Qielli.

Por edhe krahasimin që bën Asdreni jugorëve e veriorëve të lemëve, të cilët të përforcuar:

**si dy lisa rritur në një djellë** ose gjallojnë **si dy lisa pranë ngjitur**

ose siç thuhet në një version tjetër *Toskë e Gegë* qëndrojnë aq të ndërlidhur si dy faqe të një **lire faqengjitur**, asnjëra **faqe e lirës** pa tjetrën s'ka vlerë. Pra, pikërisht, në rrethanat e tilla me edukim rilindësish, u rrit dhe u formua edhe Asdreni, i cili mori frymën e parë në gjiun e Rilindjes sonë kombëtare, ku lurtoi krahët e vet që të fluturonte në hapësirën e krijimtarisë së tij në fushën e poetikës patriotike e satirike. Suksesi i tij qëndronte në faktin se ai nuk mbeti vetëm në dëshirë, por bëri përpjekje me gjithë mend që patjetër ta mësojë e përvetësojë gjuhën shqipe, e cila ishte pikëmbështetje kryesore prej kah nisej çdo shkrimtar e patriot i kohës së tij, premisë, kjo që vlen edhe për sot e për nesër për të gjithë shqiptarët, kudo qofshin ata.

Në të vërtetë, kjo ishte rruga e veprimit që u stoliste tiparet rilindësve tanë dhe Asdrenit si pinjoll të asaj lëvizjeje, e cila pati edhe zhgënjime, por fatlumnisht edhe suksese të admirueshme, siç edhe veprat e pavdekshme atdhetarie e arti edhe në fushën e krijimtarisë letrare, të cilat e dhe sot frymëzojnë brezat, siç është edhe vepra e Asdrenit.

## II. KONCEPTI I ASDRENIT PËR GJUHËN DHE FUNKSIONIN E SAJ

E kemi të njohur qëndrimin e K. Kristoforidhit dhe kontributin e tij lidhur me çështjen e shqipes letrare të njësuar duke i përdorur paralel të dy dialektet, qoftë në tekste lutjesh, qoftë në tregimin *Gjahu i malësorëve*, i cili të njëjtën fjalë të shqipes e ofronte në të shkruar në trajta të ndryshme dialektore, si të themi, me prirje përgjithësimi, pa përcëmuar asnjërën trajtë. Gjithashtu e kemi të njohur edhe rekomandimin si zgjidhje që jepte Sami Frashëri, kur shprehej se: "*edhe të gjithë dialektat do të gjendenë të gjitha të bashkuara e të përzierat*". (Shih *Letra* e S. Frashërit, dërguar De Radës, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë 1972, f. 273.) Me një gjuhë të tillë që shkruar edhe *Kanonizma* e Shoqërisë së Shkronjave Shqip të Stambollit (1879). Edhe Faik Konica, nuk e quante të mjaftueshme njohjen e toskërishtes, prandaj kërkonte që patjetër të mësohej e të përdorej edhe gegërishtja dhe kështu në konkurrencë fjalësh e trajtash në një gjuhë "*të përzier*" shqipe të fitojnë vlerat ose trajtat përkatëse mbizotëruese të fjalës e të formave që e meritonin dhe në këtë mënyrë të nxiret fituese (si normë) trajta përkatëse. Po kjo ide përzierjeje jo vetëm u përfaqëua pa rezervë si rekomandim nga Asdreni, por ky u përpoq ta zbatonte që në fillim të shkrimeve të tij dhe e vazhdoi pa ndërprerë jo vetëm gjatë etapes së parë, por edhe gjatë etapave të tjera, deri në fund të krijtarisë së tij.

Ç'është e drejta, Asdreni, edhe pse nuk u muar me studimin e mbledhjen e folklorit ose të leksikut të shqipes, interesimi për gjuhën popullore, këngët popullore si dhe për gjuhën e leksikun e veprave të publikuara të shkrimtarëve të të dy dialekteve nuk i mungoi. Kështu, Asdreni përthithi fjalë e shprehje nga të gjitha të folmet ose nga të dyja koinetë kryesore toske e gege dhe pa ngurrim trajtat e ndryshme, madje edhe të së njëjtës fjalë i fuste në veprën e vet poetike. Në të vërtetë, Asdreni, siç na ka ndodhur edhe ne e shumë të tjerëve, s'mund të ikte nga fjalë-porositë magjepse e vetkuptuar e Naim Frashërit:

Se njerëztë gjith vdesin  
po jeta s'mbetet e shkretë  
**Gjuha, mëmëdheu** mbesin  
Të patundura përjetë.

Prandaj Asdreni si dhe të gjithë idealistët e respektuan denjësisht këtë devizë, edhe pse e dinin se për **gjuhën** dhe **mëmëdhenë** (kombin) duhej punuar e luftuar papra, deri në sakrificat jete, andaj edhe idetë e tij lidhur me këtë ky i shihte të zbatueshme, duke gjetur frymëzim e mbështetje, pikërisht në dashuri e ideal si në vargjet e Naim Frashërit, ngase, siç e thotë Asdreni vetë:

*Gjithë në kohë të tij (d.m.th. të Naimit - shënimi im) pamë një sërë burrash idealistë që ushqeheshin po me ato mendime të bashkëta e të kulluara si të Naimit, nga të cilët nuk di në trashëguam edhe na të sotmit atë shkëndijë zjarri edhe atë flakërim të dashurisë së kombit e të gjuhës sonë ...* " Shih: Naim Frashëri si idealist shqiptar, rib. *Kambana e Krujës* 1971, f. 196-197.)

Po në këtë artikull, ku **kombin** dhe **gjuhën** pothuajse i njëzon me **atdheun**, rikuton me nderim

rilindësit më të dalluar duke u dhënë secilit veç e veç dhe epitete të qëndrueshme, si p.sh.:

*Naimi, idealist shqiptar, Samiu, dijetar, Abdyli, diplomat, Vaso Pasha - Shkodrani, këngëtori i mjerimeve tona, Konstantin Kristoforidhi, i ati i gjuhësisë sonë, Johani Vretua, atdhetar i flakët e përkthenjës i disa veprave, i rrepti e i flakti Nikollë Naçua, ndërsejës i idesë shqiptare në Rumani, Efthim Mitkua, autor i Mbletës Shqipëtare dhe udhëheqës i shqiptarëve të Misirit, Anastas Kullorioti, guximtar e atdhetar si dhe P. Kupitari në Greqi, Girillamo De Rada poeti ndjesëhollë, Anselmo Lorecchio gazetar shumë vjeçar, shkrimtari (gjuhtari) Dh. Kamarda në Itali...*

Dhe kjo është dëshmia më e mirë e thënë nga goja e pendës së Asdrenit, me të cilën pasqyron formimin e tij intelektual si njohës i doajenëve të Rilindjes sonë Kombëtare, por njëharazi dëshmon për autorin si njohës sa i përket gjuhës së veprave së tyre, sepse ai me siguri do t'i ketë njohur edhe gjuhën e veprimtarinë e adhuruesve të vet dhe pastaj për ta do të japë kaq vlerësime të qëlluara. Duke sh kruar për Naimin në një vend tjetër Asdreni konstaton "*se edhe aq të tjerë veteranë, të cilët ishin në lidhje mendimesh e dëshirash, të ushqyer të gjithë me një ideal*", prandaj është e kuptueshme që Asdreni do të ketë qenë i ndikuar jo vetëm nga shkrimet e një personi po edhe *i të tjerëve veteranë*. Dhe kështu ai e formoi qëndrimin e vet teorik e praktik pragmatik gjuhësor, gjithsesi edhe sa i përket bazave të gjuhës letrare, që janë: drejtshkrimi, gramatika, leksiku, fjalëformimi dhe shprehjet ideo-artistike.

Me fjalë të tjera, Asdreni, veteranët tanë rilindës nuk i kishte vetëm mësues ideali shqiptarësie, por edhe mësues gjuhe, historie dhe si shembëlltyra veprimi. Së këtejmi, ai me të gjitha mjetet dhe enegjinë vazhdoi veprimtarinë për zgjimin kombëtar të bashkatdhetarëve, veç tjerash edhe me anë të gjuhës publicistike e asaj poetike. Pra, kuptohet se Asdreni vazhdoi ecejaket e tij në frymën e idesë së veprës së vithkuqarit Naum Veçilharxhi, nga i cili nuk u shtrua vetëm çështja e mësimit të gjuhës amtare, por edhe ideja, që në rrethana të caktuara, edhe të huajt (siç thotë ai) duhet *ta mësojnë* gjuhën shqipe. Jo vetëm Naumi, që shtroi në plan të parë mësimin e gjuhës amtare, duke e formuluar drejt kërkesën e rilindësve, po ashtu u shprehën edhe Zef Jubanin e Hasan Tahsini, i cili botërisht (në Stamboll) kërkonte mësimin e shqipes, sepse *një popull nuk mund të dalë nga robëria pa e punuar dhe pa e mësuar gjuhën vet*. Edhe nga anëtarët firmëtarë të **Shoqatës së shkronjave shqip e Stambollit** që shprehur shumë qartë kjo ide, sidomos me anë të **KANONIZMËS** së asaj Shoqërie, ku pos tjerash përmendet dëmi që u shkaktonte shqiptarëve shkollimi jo shqip po në gjuhë të huaja, andaj shihet "**e madhe nevojë**", siç ngulmohet në atë Rregullore, që edhe shqiptarët "**të shkruajnë gjuhën dhe të kenë shkronjat e të këndojnë ndë gjuhët e tyre**". Andaj grupi përkatës, me Sami Frashërin në krye, hartuan alfabetin e gjuhës shqipe, Dhe po në këtë Kanonizmë shtrohej kërkesë, që të botoheshin gazeta e revista me këtë alfabet, madje kërkohet të hapeshin shkolla në gjuhën shqipe. Dhe në nenin 14 parashikohet që **Shoqëria e shkronjave shqipe:**

*"të zgjanohet kudo ku ka Shqiptarë, të cilët ... kanë me bërë (shoqata) degë më vet-he, por do të quhen degë të kësaj shoqënie"*.

Ç'është e drejta, koncepti i Asdrenit mbi gjuhën dhe funksionin e saj del jo vetëm nga vargjet e tij kushtuar gjuhës, por edhe në artikuj të veçantë publicistikë me të cilët rrahte probleme të caktuara të gjuhës shqipe.

Këtë rast e shohim të arsyeshme të themi dy fjalë për artikullin: "**Qe ku e që kur**



**emëri Shqipëtar?**, botuar në gazetën **Toska**, Minia, Egjipt (1901), ku autori e pranon me rezerve tezën e G. Majerit se emri shqiptar vjen në biçim të foljes latine *excipio* (*excipere exceptus*) (**marr vesh, me marrë vesh, kuptoj.**) dhe së andejmi shqip **skjiponj!!**. (t. *shqip-onj*, g. *shqyp-oj*). Asdreni, edhe pse rrëfëhet se “*për këtë çështje nuk është i thellë*”, megjithatë i duket se një shpjegim i tillë nuk është i sigurt, ndërkaq shpjegimi i mëhershëm sipas etimologjisë popullore që prek në gojëdhënë lidhur me shqipen (shqiponjën) e *Burrit* (*Pirros*) *me krahët e saj* (ushtarë shqiptarë), i duket më i mbështetur dhe më joshës *shqiptarisht*, shpjegim ky që në vërtetë pati përhapje, para se Asdreni ta marrë në *mbrojtje* prejardhjen e kësaj fjale, sipas të cilit:

*fjala shqiptar është bërë prej shqipes, zogut të bekuar të Hyjt q'i faleshin prindërit të vjetër tanë...*

Në të vërtetë, Asdreni nuk e mohon faktin se shqiptarët jashtë Shqipërisë veten nuk e quajnë shqiptarë po *arbër*, e nga të huajtë quhen *albanë, arvanitas, arnaut* etj, por kjo nuk e zbeh mendimarsyetimin e tij, sepse ai aludon se emri *shqiptar* do të ketë qenë më i hershëm në gojën e shqipfolësve se emri *arbër* etj., por ishte pasivizuar nën ndikimin e të huajve dhe që ndërkohë shqipfolësit e trojeve të sotme që tash e quajnë veten *shqiptarë* e kanë rikthyer atë emër të lashtënisë. Asdreni, siç u parapëremnd, si të gjithë rilindësit tanë etnonimin *shqiptar* e ndërlihd me legjenden e sipërme të sapocekur rreth *Pirros* (*Burrit*) dhe e shpjegon në bazë të *antikofjalëtorie-s*, siç e quan ai etimologjinë dhe vazhdon:

*...Duket kthjellët si drita e ditës se populli i tërë kët emër e përqafoi, se tingëllonte bukur në veshën e saj më tepër kur dinin se ç'kuptim ka kjo fjalë,*

d.m.th., fjala **shqiptar**, e cila sipas tij, nënkupton konceptin: **burr guximtar, trim i madh luftëtar** - ndër njerëz, ashtu, si **shqipja** a **shqiponja** që dallohet si mbretëreshë ndaj shpendëve të tjerë të maleve, prandaj:

*Edhe ne Shqiptarët, do ta mbajmë e duhet ta nderojmë këtë emër, që të jetojë e të jetë sa kohë do të shkëlqejnë dielli e hëna në qiell.*

Pra, për ne, si dhe për studiues të gjuhës së Asdrenit bie në sy fakti shumë i rëndësishëm, jo shpjegimi ose asrsyetimi *etimologjik* që bën ai, po për vetë gjuhën e stilin që përdor ai, për mënyrën e të shprehurit shqip të tij, shumë rrjedhshëm, lehtë dhe qartë, madje edhe për faktin e kthellimit ose motivimit të kësaj fjale sipas etimologjisë popullore nga *\*shkkip shqipe a \*shkjyp shqype* ose *\*skjiponj* apo *shqypoj*, në kuptimin: si gjuhë e **shqipeve** (shqiponjave!). Me fjalë të tjera, edhe nga ky artikull duket mirëfilli se ai kishte punuar jo pak në zotërimin dhe pasurimin e shqipes së tij, prandaj edhe dukeshin të gjitha premiset, për të përparuar mendësia e tij edhe më në aspektin gjuhësor, gjë që vërtet, u dëshmuua me krjimtarinë e tij mendimore e poetike në vazhdim.

Asdreni nga gjuha që e përsosi me shokë e shoqëri shqiptare si dhe nga leximi i literatures shqipe që ofrohej në atë kohë, formëzoi konceptin për gjuhën të cilën:

së pari e kuptoi dhe e shfrytëzoi si armë për ekzistencën dhe zgjimin kombëtar,

së dyti, kontribuoi rreth problemit të vendosjes së alfabetit të shqipes dhe rreth diferencimit të gjuhës sipas stileve funksionale të gjuhës gjatë rritës së saj, si *normëzim situator*, si *gjuhë poetike me liri vjershërimi* dhe si *gjuhë shkrimi* me trajta të normëzuara,

së treti, arriti të konceptojë si duhet gjuhën letrare shqipe **të njëjshme** dhe kjo të arrihet: **me përzijim** (*përzijim - sajësë e tij*), kuptohet, pa lënë jashtë vlerat e të dy koineve,

veriore e jugore dhe shtroi kështu detyra para lexuesve, shtetarëve për kujdesin që duhet ta kenë ndaj gjuhës zyrtare (standarde), poetëve ndaj gjuhës poetike dhe qytetarëve ndaj gjuhës amtare, kujdes ky që imponohet krahas zgjerimit të nevojave brenda shoqërisë shqiptare si dhe në raport me gjuhët e huaja. Për të gjitha këto veçori konceptore si dhe ndonjë tjetër që i ndeshim gjatë rritës suksesive në shkrimet e tij do të bëjmë fjalë në vijim, duke ndarë veprim-mendimet e shfaqura shkrimisht të autorit në dy periudha:

(I). Periudha para shpalljes së Pavarësisë dhe

(II). Periudha e Pavarësisë.

Prandaj në vijim gjatë analizës përkatëse do të njihemi paksa më konkretisht me konceptet e sapocekura më sipër të Asdrenit lidhur me gjuhën e funksionet e saj.

## (I) Gjuha si mjet dhe armë për ekzistencë dhe zgjim kombëtare në periudhën para shpalljes së Pavarësisë .

### 1. Koncepti i funksionit të gjuhës që nga paraqitjet e para të autorit

Siç është cekur më sipër, që në moshën 30 vjeçare, pas artikullit rreth prejardhjes së etnonimit **shqiptar** (1902) Asdreni, boton në revistën ALBANIA të Faik Konicës artikullin *MBI OXHAKËSINË*, ku shpreh ide demokratike duke e favorizuar "vegjëlënë", si shtyllë të kombit, prej gjirit të të cilit duhet të dalë parësia, përkatësisht të dalin atdhetarët. Po këtë vit (1902) shkroi një skeç me titull *BASHKIMI*, dialog në mes të një muslimani dhe të një krishteri, që të dy shqiptarë të stërvuajtur, të cilët nëpërmjet dialogut, siç del nga teksti, arrijnë të kuptojnë se të këqijat u vinin nga të mosmësuarit në gjuhën e tyre, andaj edhe nuk e kishin pasur të qartë se "*çdo me thënë atdhe*", dhe kjo ishte arsyeja që ishin bërë "*kleçkë e lodra e të huajve ...* Po të kishin mësuar shqip jo vetëm këta, por do të kishin *kuptuar tërë shqiptarët këtë punë, ç'do me thënë gjuhë edhe atdhesi*, (dhe atëherë shqiptarisht) *oh sa do të kishim qenë përpara*!"...siç e kuptuan tashti këta dhe përfundojnë duke shqiptuar njëzëshëm të dy bashkë:

Pra, ne gjë nuk kërkojmë,  
përveç gjuhën të mësojmë  
se ajo na sjell dashuri  
si dhe të madhe trimëri.

Kështu, te gjuha Asdreni, sheh pikëmbështetjen parësore dhe për trimëri. Sikurse rilindësit para tij edhe ky kapet fort për faktin gjuhësor, duke i dhënë vendin e merituar gjuhës "*si një veçorie qenësore të kombit tonë*" dhe kështu duke përdorur mirë këtë armë të pazëvendësueshme për zgjimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar, ai bashkohet me shokët e tij të idealit drejt synimit të bashkimit kombëtar, pa dallim krahine, ideje a feje.

Asdreni lidhur me gjuhën dhe problemet rreth saj në mënyrë edhe më konkrete do të sqarohet në "PARATHËNIEN" e veprës së tij të parë RREZE DIELLI, shkruar më 1903 dhe botuar më 1904, prej kah mund të nxjerrim të dhëna me interes për temën tone të këtij kapitulli. Që në fillim të parathënies prek çështjen e shkrimit të gjuhës shqipe në formë antonimi:

**"të shkruash gjuhën shqipe s'është punë e rëndë dhe as e lehtë, - duke theksuar se - me mundim, me përpjekje dhe me durim mund të mësohet edhe shqipja që të dalë me fytyrë siç janë gjuhët tjera"**

dhe për këtë gjen rast e rrëfhet:

*"me mos ditur si të gjenjë mirë e mirë çdo fjalë për të dëftyer, e më tepër vjershat ku gjuha duhet të rjedhë si ar i kulluar, fare të paktën si argjent, t'i ngjasë atij mburimit që mburon i kulluar..."*

dhe nga ky të rrëfyer kuptojmë se Asdreni që atëherë bën diferencimin stilistik të gjuhës "**për të dëftyer**" dhe për gjuhën "**e vjershës**", e cila në radhë të parë ka qëllim estetik. Mirëpo kjo çështje do të vërehet më shtruar në përmbledhjen e veprës së dytë të tij, ku do të jetësohet edhe më me sukses ky synim në disa poezi, përfshirë në atë vepër e në të tjera që i shkroi më vonë. Në vazhdim të këtij shkrimi Asdreni u shfaq mirënjohje e nderim ndaj paraardhësve:

*"burrave qi me ndjenjat e tyre të çelura për atdhenë dhe për gjuhën u përpoqën e na lanë miaft shenja se Shqipëria rron".*

Pastaj duke u hedhur në polemikë me grekët e grekomanët dhe armiqtë e shqipes përgjithësisht shprehet se asnjëra gjuhë nuk duhet të nënçmohet dhe se kultivimi i gjuhës shqipe nuk shkon në dëm të asnjërës gjuhë tjetër se "*shkurt ne duam të mirën tonë dhe jo të ligën e tjetër*".

Asdreni pati qëndrim të drejtë dhe largpamës dhe sa i përket çështjes së alfabetit, ai po në këtë parathënie arsyeton pse për botimin e kësaj vepre zgjodhi alfabetin e akademisë "**Bashkimi**" (të Shkodrës), alfabetin e thjeshtë latin, duke hequr dorë nga alfabeti i Stambollit, i cili pati marrë vizën po në Bukuresht me botimin e veprave më të rëndësishme të syrit të mendjes së veprimtarisë letrare të Rilindjes sonë: veprat e vëllezërve Frashëri e të tjerëve, Po në këtë parathënie ai sqaron pse nuk e përdori as alfabetin e Nikollë Naços, në gazetën e të cilit kishte marrë dorë përvoje dhe të cilin si njeri e patriot e çmonte shumë. Në fund të parathënies Asdreni thotë:

*"Këto vjersha, që të gjitha janë të thjeshta bërë prej zemrës më sa më ndihu fuqia e mendjes dhe gjuha ... pastaj sa për gjuhën më ç'gjendje është, (këndonjësit) e dinë fort mirë."*

Pra, sa i përket zhvillimit të gjuhës Asdreni nuk ishte i kënaqur dhe apelon për mësimin e për zhvillimin e saj dhe këtë temë, pothuaj si kult të shenjtëruar, e prek, siç do të shohim në vijim, edhe në nja 10 vjersha, po në këtë vëllim. Që në fillim, të ciklit *Atdhesie* prin vjersha Këshillë. Pas saj vjen vjersha kushtuar Gjin Alandro-Kastriotit me titull "TINGËLLIM", ku bie në sy se për Asdrenin çështja e gjuhës lidhet domosdo me të qenët apo të mosqenët e Shqipërisë. Së këtejmi, po kjo ide e tij edhe më qartë shprehet në vjershën SHQIPTAR I VËRTETË. Sipas autorit, **Shqiptar dhe Atdhetar** është ai që e do, për të lufton dhe që e çmon për jetë **gjuhën shqipe**, të cilën e mëson dhe njëherazi, di ta ruajë me kujdes nga propaganda e huaj, sepse atbotë të huajt e armiqtë kërkonin vërbimin e shqiptarëve, kërkonin që shqiptarët mos të mësojnë në gjuhën e vet. Dhe kështu mjaft fuqishëm e përfundon porosinë:

Hapni sytë mirë,  
Mos rini nd'errësirë;  
Se gjuhën kur të shohin  
Shqiptarët se mësojnë  
E shkruajnë 'edh' e flasin  
Tër' armiqt do t'pëlcasin!

Në vjershën *Grekomantë* edhe më tej e rrah këtë çështje, duke u hedhur në sulm kundër armiqve të gjuhës shqipe, ku mjerisht gjendeshin edhe disa shqiptarëve *injorantë* e të bastarduar, të cilët edhe e përçmonin gjuhën e vet duke thënë se:

"Oh shqipja është për barinjtë,  
S'është gjuhë që të kuptohesh,  
Nuk e marrin vesh as arinjtë  
Dhe Shqipen kur e flet çnderohesh."

Dhe për t'u mbrojtur nga një kompleks i tillë që ishte bërë njëfarë simode e ndonjë pjestari të klasës sunduese ose të ndonjë injoranti të kohës dhe për t'u dhënë zemër skeptikëve poeti thekson:

Shqipja shkruhet mirë e këndohet  
Po duhen njerëz me vullnesë.

Edhe në vjershën *Girillamo de Radës*, duke i shprehur meritë të madhit De Radë që dha për çështjen e gjuhës e të atdheut thotë:

U përpoqe me gjithë dëshirë  
të na dëftesh si është më mirë  
Ç'do me thënë **gjuhë** dhe **atdhe**  
dhe sa vlerë kanë ato për ne.

Kundër armikut të shqipes poeti më me grushtin top sulet në vjershën MALLËKIM. Aty njëherë i drejtohet shqipes duke e hymnizuar atë e pastaj u drejtohet shqiptarëve me porosinë që ta flasin dhe ta shkruajnë "*të qëruar*", përndryshe "*qofshin të mallkuar*", se kjo gjuhë është e shenjtë dhe se është e bukur sa s'ka shembëll në botë. Dhe kështu fton "besimtarët" shqiptarë muslimanë e ortodoksë (të krishtenë) të dalin në rrugën e drejtë dhe mos të ngelin në rrugën e "gënjeshtrove", ndërkaq për devijuesit e tillë ose kundër disa servilëve, "bartës të kultures", që të tillët u shërbenin të huajve, s'përmbahet dot, andaj kundër tyre poeti reagon me mallkim:

Pse nxini ditët me Greqishten,  
Me Turçen e Arabishten?  
Mësoni shqipen të ndrituar  
Në mos qofshi të mallkuar!

Edhe duke vazhduar gjithnjë thirrjen për mësimin e shqipes në vjershën LUTIE DHE MALLËKIM poeti paraqet një tablo të realitetit të hidhur të kohës:

Shqipja thonë, na prish fenë  
Shkurt, të flasësh nuk të lënë,  
Po Greqishten e lëvdojnë  
Dhe me turçen të gjykojnë!

Dhe në vazhdim poeti përsërit kërkesë-porosinë me ngulm që gjuha shqipe jo vetëm s'bën të mohohet, por ajo duhet të mësohet e të kultivohet dhe këtë e kërkon nga të gjithë bashkatdhetarët, të të gjitha shtresave shoqërore në vjershën PUNONI PA PRERË (bërë për Qarkun Shpresa):

Malësorë e fusharakë,  
Qytetarë e fshatarakë  
Këndoni me zë të naltë  
Këtë gjuhë q' është si mjaltë ...

Ju mjeshtër e tregtarë,  
Punëtorë e ushtetarë,  
Kudo qofshi e më çdo çip  
Shkruani, flisni vetëm shqip.

Duke vazhduar me të rrahurit e kësaj teme në vjershën NAIM BEJ FRASHERIT, të cilin e krahasoj me një si yll që ndrit ose si një lule që stolis e erëson:

Ashtu edhe Naimi ndriti  
Mi qiellin e Shqipërisë,  
Erësirën ia ngriti  
**Gjuhës edhe kombësisë.**

Pra, Naimi që ai Ylli ose idhulli i hyjnueshëm me forcën e të cilit u braktisën retë e zeza nga *qielli i gjuhës* dhe *i kombësisë* dhe se këtij idhulli duhet t'i ngjajë çdo "**shqiptar i vërtetë**", ngase ai (Naimi) gjuhën e ngjalli e i dha jetë "duke punuar" për të, prandaj rrugën e Naimit duhet ndjekur të gjithë shqiptarët *e vërtetë*. Dhe përnjëmend Asdreni po atë rrugë të vjershërimit si Naimi e ndoqi me përkushtim. Edhe ky gjuhës i vë vendin e merituar si veçori të pare karakteristike kombëtare, madje ajo duhet të shërbejë si mjet e armë për afrimi në mes të shqiptarëve pa dallim feje, si armë për bashkimin e tyre për të shporrur shtypjen e robërinë. Jo vetëm kaq, po gjuha shqipe duhet të përdoret për të demaskuar jo vetëm pseudointelektualët e injorantët vendës, po edhe propaganduesit e huaj.

Ç'është e vërteta, kur kemi parasysh gjuhën e poetit në këtë vepër mund të themi se Asdreni ka ecje përpara, megjithatë nuk ikën fort larg nga suazat e gjuhës poetike të pararendësve të tij, gjë që në veprat e tjera këtë dhunti hyjnore: gjuhën shqipe për shqiptarët do ta kurorëzojë edhe më mire me mendime si dhe me krijime të reja me ecje përpara, sidomos në fushën e fjalës poetike. Ndërkaq, kur është fjala tek alfabeti, siç u tha më sipër, Asdreni pati qëndrim të drejtë konvergjent, mirëpo kësaj çështjeje do t'i qaset më vonë duke marrë pjesë

aktive në polemikën që zhvillohej në revista të ndryshme, për këtë më në hollësi në nëntitullin vijues.

## 2. Çështja e alfabetit të përbashkët, koncepti rreth gjuhës letrare dhe avancimi në difencimin stilistik

Në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX, çështja e alfabetit unik për shqiptarët nga shqiptarët u shtrua edhe më fuqishëm se përpara dhe u bë vërtet çështje e ngutshme, ngase procesi i zgjimit kombëtar nuk ishte tash në fazën e lindjes, por në atë të rritës dhe që shkonte drejt pjekurisë, ngase tashme edhe publikimet në shqip kishin marrë përzgjerime më të mëdha hapësinore se në të kaluarën edhe brenda trojeve të të dy arealeve të shqipes. Vetë koha tregoi se alfabeti i Stambollit, me gjithë meritën që kishte, ishte jopraktik, sepse paraqiteshin vështirësi për sigurimin e teknikës së shkrimit, si jashtë si brendë Shqipërisë, mirëpo edhe alfabetat që lindën pas tij, nuk ishin aq unikë, dalloheshin edhe pse pretendonin të ishin mbi bazë thjesht latine. Në të vërtetë, alfabeti i Bashkimit të Shkodrës, që u përmend më sipër, mbi bazë latine kishte edhe mbështetje historike, sidomos në Gegëni (Shkodër) e në ndër arbëreshët e Italisë, kujto veprat e shkrimtarëve të vjetër gegë pararilindës si dhe ata arbëreshë të Italisë, andaj edhe teknikisht alfabeti i tillë ishte më i lehtë për t'u gjetur, adaptuar e zbatuar. Në të vërtetë, alfabeti mbi bazë latine pati adhurues e përdorues më të shumtë si në Veri (Shkodër), por edhe në diasporën perëndimore, mirëpo edhe këto alfabete të shqipes mbi bazë *thjesht* latine paraqiteshin shumë variantesh, kishte dallime lidhur me shkronjë-tingujt e shqipes që nuk i kishte latinishtja. Është e vërtetë se lidhur me çështjen e alfabetit u bë polemikë në fletushka të ndryshme e sidomos në revistën ALBANIA të Faik Konicës. Në atë polemikë u inkuadrua edhe Asdreni, madje tri vjet para Kongresit të Manastirit (1908), ai botoi në këtë revistë artikullin me titull "**Çështja e alfabetit**" (1905), për të cilin do të bëjmë fjalë në vijim.

Vlera e këtij artikulli qëndron në faktin se pikërisht këtu Asdreni paraqet qëndrimin e tij ndaj problemit të alfabetit unik për gjuhën shqipe. Ai që në fillim cek se çështja e shkrimit të shqipes po shkon mirë dhe se "tërë shkronjëtorët janë gati për këtë bashkim", bashkim të cilin e sheh në alfabetin e Bashkimit. Veç tjerash në favor të alfabetit të tillë konstaton se edhe ALBANIA e ka pranuar atë alfabet, vetëm e vetëm për hir të konvergencës dhe Asdreni lidhur me këtë mendon se të gjithë do ta pranojnë po këtë alfabet, të cilin e pati parazgjedhur një vit më parë, kur e pati botuar veprën "RREZE DIELLI" (1904). Në vijim të artikullit Asdreni jep për të kuptuar se për këtë çështje ishte interesuar më herët dhe se posedonte një parapërgatitje solide rreth kësaj teme. Përmend se dinte për alfabetin e P. Bogdanit, të Frëngut të Bardhë, të Hahnit, të kohës së Ali Pashë Tepelenës, përmend atë të Naum Veqilharxhit, të Mirko Boçarit (me letra greqisht), të Kulluriotit, të Kamaradës, të Dorsës, të De Radës, të Sqiroit, të Mitkos, të Vasil Dhimitër Rusit (që shtypi më 1878 të parin libër në Bukuresht), alfabetin e N. Naços, të Jovan Lazarit, të Mjedës si dhe natyrisht edhe atë të Stambollit dhe nxjerr përfundimin që "**me pak mirëdashje nga ana e të gjithëve të mbarohet kjo punë aq e lehtë po shumë e rëndë për ne**", të miratohet alfabeti i **AKADEMISË BASHKIMI të Shkodrës**. Mirëpo kjo përzgjedhje, sipas tij, duhet të bëhet me marrëveshje.

Asdreni e çmonte lart alfabetin e Stambollit, si të themi, të vetmin rival serioz ndaj alfabetit të Bashkimit. Kishte vlerësim realist. **Abetarin e Stambollit** e quan "**agim për tërë**

**shqiptarët"**, mirëpo, meqë "**koha shkonte, vjetët rridhnin**"... ndërsa "*letrat e Stambollit nuk gjendeshin në çdo anë, ku mund të shtypej një ditar a një libër, atëherë u ndje nevoja që të shtypen me letra latine*". Asdreni, duke konstatuar se alfabeti latin pati përhapje më të gjerë nëpër qendrat e Evropës, thekson:

*"gjersa më në fund fillohet në Shkodrë një shoqëri për përparimin e letrëturës Shqipe, e cila i solli dhe i sjell mjaft shërbim atdheut. Botoj disa libra me vlerë dhe po shtyp përpara me një alfabet të vjetër të Gegënisë me një këmbim vetëm të disa letrave a shenja të veçanta që kishte, dhe, i cili sot për sot kam shpresë se ka për të mbetur si i përgjithshëm".*

Kështu Asdreni, siç u tha më sipër përkrahu alfabetin me të cilin botoi veprën e tij të parë, alfabet ky, të cilin edhe e propagandoi, duke kërkuar masivizimin e tij. Në këtë mënyrë Asdreni dha kontribut rreth një alfabeti unik, disa vjet përpara se të vendosej *alfabeti i ri i Kongresit të Manastirit*, i cili me pak ndryshime ishte po ai i Bashkimit, apo ishte nën vazhden e autoritetit të tij me atributin *thjesht latin*. Ç'është e vërteta, Asdreni as që e pranon plotësisht pa vërejtje alfabetin e Bashkimit, por nga ai e merr dhe e përqafon vetëm parimin *thjesht latin* si bazë. Ja, si shprehej ai lidhur me këtë:

*"Vërtet alfabeti i Bashkimit nuk është i mbaruar se edhe unë që jam anëtar i tij nuk më pëlqen që shoh letrën X për Z etj... Po mendimi ynë është që të merret një **abe i thjeshtë latin** prej të gjithëve, edhe me kohë ndërrimet mund të bëhen pa ndonjë vështirë..."*

Kështu, Asdreni, me intuitë të hollë, parashikoi alfabetin e njësishtëm të gjuhës shqipe. Analiza e tij nuk ishte e njëanshme dhe së këtejmi kontributi i tij në këtë pikë nuk duhet heshtur. Gjithsesi, lidhur me këtë duhet të përplotësohet dija ose të thuhet e vërteta se bashkë me autoritetin e alfabetit të *Bashkimit* në Kongresin e Manastirit që edhe autoriteti i Asdrenit i shfaqur paraprakisht me shkrime teorike të tij, aq më tepër, duke e përdorur praktikisht atë alfabet në veprat e veta, dhe njëherazi duke kërkuar që të vendosej si alfabet I vetëm edhe për shqipen e përbashkët letrare, Sidoqoftë, pra, në fund të këtij artikulli Asdreni shpreh mendimin dhe mbi gjuhën letrare shqipe:

*"Kam uzdajë se pas të vendosurit e një abetari të përgjithëshëm, mbetet edhe ndjehet nevoj' t'i jipet një drejtim edhe gjuhës **duke i bashkuar që të dy dialektet Tosk e Geg**, i cili **përzijim** me pakë mundim ng'an'e shkronjëtorëvet **do t'i japë një fytyrim gjuhës si ç'janë fytyruar tërë gjuhërat, duk' i dhënë funt shkrimit të gjuhës dhe aqë të rrahuravet mëndjen midis nesh.**"*

Një teori e tillë pohuese, siç shprehu Asdreni në analizën e mësipërme, që shtruar nga Sami Frashëri, mandej që e cekur nga F. Konica, Luigj Gurakuqi, A. Xhuvani e më vonë edhe nga autorë të tjerë, si I.D. Sheperi "*Genishte e Toskëzuar ose Toskërishte e Gegëzuar*". Ndoshta të tjerët mund të kenë ndërruar mendimet në nuanca, duke anuar drejt dialektit të vet, kurse Asdreni drejtimit të tillë përbashkues **duke i bashkuar që të dy dialektet Tosk e Geg** që e kishte praktikuar në veprën e tij të parë, pothuajse i ndejti besnik, por duke e aplikuar në poezitë e veta edhe në periudhën e Pavarësisë "**përzijimit ndërdialektor**. Kuptohet, ai gjithsesi në bazë pati dialektin e jugut, toskërishten, nga e cila nuk hoqi dorë, por atë koine e

përdori me *përzijim*, d.m.th. me fytyrë drejt gegërishtes, duke parapëlqyer sidomos trajtat që i mendonte si më të përbashkëta ose që i nevojiteshin për ndonjë arsye, qoftë edhe për rimim.

Më 1907 Asdreni shkroi një prozë poetike apo një ese politik me titull “**Një çap përpara**”, ku bën fjalë për çështjen shqiptare dhe me të drejtë vë re se zgjimi kombëtar kishte marrë rrugë të mbarë dhe priteshin “**ditë të bardha me padurim**”. Këtu në këtë prozë poetike vërejmë se çështja e gjuhës nuk përmendet fare, por tash përmendet **flamuri shqiptar**, me të cilin tani simbolizohet edhe vetë kombi edhe gjuha. Është viti kur e shkroi dhe e botoi edhe poezinë **Betim mbi flamur**, himni i ardhshëm i shtetit dhe kombit shqiptar. Dhe me të vërtetë, ngjarjet e vitit 1908, fitorja e Turqve të Rij, (Hyryeti etj.), kur zbriten nga malet herojtë e çetave të para patriotike *me flamuj në dorë*, i cili edhe do të valojë për një kohë i lire, por jo zyrtarisht, do ta gëzojnë pa masë edhe Asdrenin. Pikërisht këtë atmosferë poeti do ta përjetësojë me vargje shumë të ngrohta atdhedashurie, ngase në vizionin e tij tash shihte lindjen e “**Shqipërisë së Shqiptarëve**”, organikisht të jetësuar me flamurin e me gjuhë shqipe, megjithatë, lidhur me këtë shpreh edhe rezerve të ligjshme. Është e vërtetë, se patriotët shqiptarë shfrytëzuan revolucionin xhonturk (hyrijet) dhe, dhe si me thënë, po ato ditë me nxit organizuan një varg aksionesh kulturore, por si ngjarje me rëndësi shumë të madhe të atij viti, për zhvillimin e kulturës shqiptare ishte: organizimi i **Kongresit të Manastirit (1908)**, i cili u mbajt për të vendosur alfabetin e vetëm të shqipes, ashtu siç pati parashikuar edhe poeti ynë. Në këtë Kongres nuk qe i ftuar Asdreni, por fryma e tij ishte e pranishme, madje siç i shkroi një pjesëmarrës, kongresistët kënduan këngën e tij “**Ardhi dita**”.

Siç dihet Kongresi (Komisioni përkatës), për të zbutur kundërshtitë lidhur me tri alfabetet që u shtruan aty: **Alfabeti i Stambollit, Alfabeti i Shoqnisë Bashkimi të Shkodrës dhe Alfabeti i Shoqnisë Agimi të Shkodrës**, miratoi dy alfabete: atë të Stambollit me ndonjë përmirësim dhe një të ri, i cili i ngjante alfabetit të Bashkimit, por kishte disa ndryshime. Rekomandohej që të dy alfabetet të mësoheshin në shkolla etj, duke i lënë kohës që të zgjedhte njërin prej tyre. Asdreni nuk reagoi në fillim kundër vendimit të Kongresit të Manastirit për alfabetin “binjak”, siç do të quajë ai më vonë, por kur filluan të ngejnë krye divergjenca dhe filluan spekulimet lidhur me alfabetin, sidomos kundër alfabetit latin nga ana e disa të quajturve *reformatorë*, të shtyrë nga fanatizmi fetar dhe politika e huaj, ngase dolën njerëz që tashti propagandonin alfabetin arabo-turk, atë grek, qirilicë etj., atëherë Asdreni nuk përmbahet dot dhe më 1910 botoi artikullin me titull “**ALFABETI NJË ÇËSHTJE PA FUNT**”. Në këtë artikull, ai hedhet menjëherë në polemikë kundër provokatorëve dhe burimin e provokimeve e gjen te ndjenja e tyre e dobët njerëzore, intelektuale e kombëtare, ngase njerëzit e tillë ishin të verbuar nga fanatizmi dhe gjithsesi intelektualisht e kombëtarisht ishin të papjekur dhe se ky fanatizëm ishte bërë, siç thotë Asdreni “*sëmundje që na prish, nuk na bashkon e na fik, si thotë Gega*” dhe autori s’përmbahet, merr guxim dhe mjaft ashpër e sulmon Kongresin e Manastirit, sepse:

*“fajin më të madh s’e ka përveç se Kongresi i Manastirit që vendosi një alfabet binjak që nuk pati vullnetin e hekurt që të mbarojë e ti japë funt e kjo quhet edhe dobësi, po e sollli punën ashtu e u bë shkak që të na flasin e të na përflasin si Grekomenët si Turkomenët”.*

Asdreni si dhe më parë ishte që çështja e alfabetit ta vendoset nga **gjuhëtarë e dijetarë**



kompetentë, sepse vetëm ata kanë tagër shkencor, sipas "*nomit të gjuhësisë e të diturisë*" dhe jo ata që nuk kanë cilësi, *kualitete për një gjë të këtyllë pune*.

Në këtë situatë Asdreni nuk përmbahet për pa u deklaruar edhe një herë për alfabetin latin, për alfabetin që e kemi sot. Nuk dijmë për ndonjë tjetër person autoritativ, që të ketë sulmuar kështu haptas alfabetin binjak të Kongresit të Manastirit, duke kërkuar me forcë që të përdoret vetëm alfabeti që e kemi sot. Asdreni, lidhur me këtë, jo vetëm mbështet, po më duket se ia kalon alergjisë së Faik Konicës, i cili vendimet e tilla i quante, veç tjerash *punë barijsh....*, d.m.th. i diskualifikonte kompetencën profesionale të hartuesve.

Siç dihet alfabeti i ri i Kongresit të Manastirit, alfabeti i sotëm si i vetëm u përkrah edhe nga Kongresi II i Manastirit, por si me thënë u vendos dhe u përhap apo u mishërua ashtu në mënyrë të heshtur, jo me ndonjë vendim institucional, duke e flakur jashtë pa kurrfarë konfrontimi përdorimi i "binjakut", që kishte elemente të shkronjave greke, e sllave, popuj këta që me politikën e tyre mbillnin neveri e shkaktonin rezistencë të gjithë "shqiptarët e vërtetë", prandaj në këtë drejtim roli i Asdrenit duhet të vlerësohet si një kontribut pozitiv.

Është interesant se në këtë fazë nga Asdreni nuk është prekur fare gjuha si gjuhë në aspektin propagandistik, sepse poeti, siç shprehet në "**Mendime të kohës**" (1911) e ndjen flakën e kryengritjes "**për përlindjen kombëtare në Shqipëri të Veriut (...)**". Kështu Asdreni e ndjen veten të bashkuar me luftëtarët "**me heroë. trima luftëtarë dhe me ato gra trimëresha**" dhe atyre u bashkohet me fuqinë e penës, të mendjes e të gojës, që në këtë mënyrë do t'u jepte zemër luftëtarëve që ta goditnin e ta shpurnin armikun nga trojet shqiptare. Sidoqoftë, ai përkrahu luftën e tyre me vargje, me ndihma financiare, me këngë patriotike, të cilat vërtet u bënë hite që jo vetëm këndoheshin edhe nga vetë luftëtarët, por që u masivizuan në popull, duke u mësuar në shkolla etj., të cilat madje edhe sot kanë prani, sidomos në raste solemnitetesh dhe kështu gjallojnë sot dhe si të tilla do të mbesin trashëgim ndër breza.

Qëndrimi kritik i Asdrenit ndaj ngjarjeve të kohës dhe të vetë gjendjes së gjuhës e të letërsisë del i shprehur edhe në parathënien e veprës së dytë: **ËNDRRA E LOTË** (1912), që mban titullin **Dy fjalë përpara**. Ku autori me gjakftohësi, por gojaplot mëshon dhe meson se nuk mjafton vetëm të hidhesh në "fushë të luftës", por duhet menduar për veprim të vërtetë kulturor, punë kjo që me frytet e veta do t'u shërbejë "**gjeneratave të paskëtajshme**". Kjo na jep për të kuptuar se edhe pse i ekzaltuar nga situata e luftës ai në këtë vepër botoi poezi mjaft me kriter artistik, sepse ishte i vetëdijshëm për rolin që ka shkrimi i kulturuar e sidomos poezia (kënga) në situata të tilla të ndieshme. Kështu ai ndër të parët, me sa dime, flet për angazhimin e letërsisë dhe mbi rolin shoqëror të saj, madje ndoshta edhe fetishizon, kur thotë "**se shkrimi ka vlerën më të madhe për një veprim të tillë**". Ai madje ndoshta nxiton paksa në konstatimin vijues kur shton se:

**"Është një fakt i pamohuar se letërsia ka veprimin e saj përmbi shtetin shoqëror e politik të një kombi, se ajo është fryma që e ngjall edhe bruma që gahet për të ushqyer e përtëritur mendarisht..."**

Analitikanët, zakonisht thonë se platforma politike nuk arrihet vetëm me poezinë, me letërsinë, siç thotë poeti, mirëpo, megjithatë, pajtohem edhe ne se poezia (kënga) ka specifikën e vet dhe roli i saj është shumë i rëndësishëm dhe ai rol assesi s'bën të mohohet, mirëpo është e vërtetë se letërsia nuk mund të bartë ose ta zëvendësojë në tërësi krejt faktorin:

*luftë e armatosur për liri*, madje as lëndën e të gjitha shkencave politiko-propagandistike, ekonomike, përkatësisht nuk mund ta bartë tërë propagandën përkatëse politike e ushtarake në luftën e organizuar për liri. Por është, gjithashtu e vërtetë se poezia, duke paraqitur realitetin objektiv gërshetuar me atë subjektive kalon kufijt e botëkuptimeve të ngushta të individëve dhe e pasqyron jetën gjithsesi më gjerësisht se ndonjë rrëfim i thatë fejtano-propagandistik i kohës. Ndërkaq, nëse me termin *letërsi* nënkuptohet i përfshirë tërë kompleksi programatik gjuhësor që ka të bëjë me lëvizjen gjegjëse, atëherë kritika ndaj Asdrenit për fetishizim të letërsisë duhet të zbutet paksa, gjithsesi në dobi të mendimit asdrenian.

Po në këtë situatë Asdreni nuk e lë pa e përmendur edhe gjuhën letrare, e cila, sipas tij, si çështje kombëtare, siç është, edhe sot, në kohën tone, kërkon zgjidhje ose imponohet sipas radhës fill pasi të mbushet dëshira e politikës dhe e letërsisë, d.m.th. pas ndonjë turbulence, zakonisht pas fitimit të luftës, d.m.th pas ndryshimeve të mëdha shoqërore-politike etj. Ja, si shprehet Asdreni:

*"Dihet se më çdo komp fillimi i çdo lëvizjeje të shoqërisë është bërë duke vajtur dora dorës letrësia me politikën; se duke shtyrë njëra tjetrën mbushen dëshirat e të dy palëve, edhe pastaj si mbarohen ato që ishin për t'u bërë, merr secila udhën e saj veçan - po për ne, këto d.m.th. përparimi i çështjes kombëtare si dhe çvillimi i një gjuhe letrare e kanë rrugën të shtruar jo me lule po me gjemba..."*

Kështu Asdreni ishte i vetëdijshëm se çështja e gjuhës letrare për shqiptarët paraqiste vështirësi të mëdha dhe këshillon "*prej ato (gjemba e pengesa) që do të shkelësh e mos ua ndjesh thumbin...!*"

Dhe me të vërtetë, shpallja e Pavarësisë (1912), Komisia letrare e Shkodrës (1917), Etapa e Pavarësisë dhe konsolidimi i shtetit shqiptar, që pasoi, edhe pse me territor të cunguar, 1920-1944), imponoi një gjuhë letrare zyrtare, mbi bazë të gegnishtes (elbanishtes me përmirësime) por ajo nuk mund të quhej e unifikuar plotësisht. sepse i mungonin tri bazat themelore mbështetëse dokumentuese të elaboruara me kompetencë dhe pastaj të miratuara institucionalisht, siç janë: **drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori normative përshkrues**. Sidoqoftë, për atë kohë del mjaft i pjekur konstatimi i Asdrenit, i cili lidhur me këtë njësim ose për konceptin e gjuhës zyrtare, shprehet kështu:

*"tash shqiptarët janë në një tjetër shtet ndjenjash kombëtare, dhe se këto ndjenja janë duke u shtuar e duke përparuar, ashtu edhe gjuha bashkë me letërsinë kanë marrë atë sulm që bën çdo gjë që është në rritje e sipër."*

Mirëpo duhet të kuptojmë se gjatë hovit të rritjes së vullshme paraqiten edhe vështirësitë të cilat pengojnë shumë, qofshin ato vështirësi me rrënjë nga e kaluara e trashëguar heterogjene, qoftë nga armiqtë e vjetër të brendshëm e të jashtëm, qoftë nga armiqtë e rinj apo mungesa e kuadrove profesionale e politike si dhe vështirësi të tjera të natyrshme që sjell vetë koha. Kështu Asdreni nuk e shihte vetëm problemin ndërdialektor ose brendadialektor për letrarishten e *njëjshme* shqipe, por ai shihte edhe problemin ndërshqiptarë lidhur me ndasinë fetare e zonale, e cila shfrytëzohej ose fryhej me sherr edhe nga të huajt në dëm të unitetit të shqiptarëve. Pra, Asdrenin veç tjerash e shqetësonte edhe çështje e fesë dhe e ndasive zonale te

shqiptarët. Ky, po këtë problem e përmend disa here, duke qëndruar në pozicione të pranueshme. Ai, duke pasur parasysh interesin e shenjtë kombëtar shpjegon se ndjenjat fetare të kohës së kaluar (!) nuk i kishin sjellë asnjë të mire, por vetëm të këqija e ndasi popullit tonë, e tash, sipas tij, **ajo ndjenjë fetare** duhet zëvendësuar me një ndjenjë tjetër *edhe më të fortë, edhe më motivuese* që është: **ndjenja kombëtare**. Asdreni, ka bindjen se *dashuria a besimi i madh për gjuhën e kombin shqiptar i neutralizon bindjet e fanatizmit ekstrem fetar që ishte dhe është i dëmshëm për kombin tone e gjuhën e tij*. Me fjalë të tjera, besimi fetar, pa mohuar besimtarët dinjitozë, si me thënë, duhet të mbetet nën hijen e besimit ndaj atdheut, kombit e gjuhës shqipe dhe kjo aspak nuk e përçmon fenë e askujt. Sepse ndjenja kombëtare e zgjuar shqiptare, gjeti mbështetje jo fenë që ndan e nuk e bashkon, po gjeti "**shkopin magjik të Qirques**" e që ky shkop është **gjuha, gjuha shqipe, shkrimi i saj**, armë kjo që bashkon të gjithë shqiptarë besimtarë pa ndërhyrë në formëzimin e tyre fetar, **shkop magjik ky**, i cili u mungonte të parëve tanë të cilët luftuan shumë për të drejta e liri, por mundi u shkante kot sepse u mungonte pikërisht **shqipja e kultivuar** që bashkon ose u mungonte **arma e pendës, "shkrimi i gjuhës së tyre**, i cili u dëfton sot shqiptarëve **rrugën e vërtetë**, sepse:

*"gjuha është ajo që e çquan njeriun nga ngjamësit që e rrethojnë një komp të veçantë, ajo gjuhë që duke u folur dhe duke u shkruar mirë, zëri i saj bën që të buçasin malet, të ushtojnë pyllët, të murmurisin mburimet, të ligjërojnë zogjtë, të tunden fiset, e të ngjallen të vdekurit".*

Pra, *gjuha shqipe* është shenjë e parë themelore e kombit shqiptar, dhe në atë kompleks, *gjuha poetike* është për të hymnizuar malet, pyjet, burimet, zogjtë, që të tunden fiset, me një fjalë të ngjallet kombi, atdheu dhe të ringjallen të vdekurit – pra të bëhet e pavdekshme historia.

Jo vetëm kaq, po kësaj teme Asdreni do t'i përkushtohet edhe me poezi, kushtuar gjuhës, ku specifiteti i gjuhës poetike shprehet në mënyrë edhe më të thelluar. Në vazhdim të këtij artikullit Asdreni përmend qartë edhe rolin e gjuhës për zhvillimin e shkencës, siç e cek edhe në një vend tjetër: *"në çdo degë diturie e mjeshtërie"*. Gjithashtu, sipas tij, gjuha kultivohet edhe me adaptimin (përkthim e shqipërim) nga gjuhët e huaja si një gjë fort pozitive, sepse një punë e tillë sjell dobi të shumëfishtë, qoftë sa i përket lëndës së trajtuar, ideve, formave të shprehjes si dhe pasurimit të gjuhës për fitimin e përvojës në stile të ndryshme funksionale. Kështu, në prag të pavarësisë Asdreni, siç u cek më sipër, shtroi të dhëna të rëndësishme që i përkasin veprimtarisë gjuhësore. Edhe pse asnjë poezi nuk ia kushtoi veçan gjuhës shqipe, kemi raste kur kalimthi po në vargje përmend funksionin e gjuhës e rolin e saj. P.sh. në poezinë *Krerëve tradhëtarë*, u tërheq vërejtjen:

Ju njohim cilët jeni, s'është nevojë  
T'u hapet libri i veprave të bëra,  
Se populli i përmend pa pra gojë më gojë  
Me kut i mat, me syt' i sheh të tëra.

Pra, jo vetëm të mirat, por edhe punët e liga nuk harrohen dot nga populli, *i cili i zbulon me gojë*, kështuqë syrit të popullit nuk i shpëton as e mira, as e keqja, sepse veprat fliten e përfliten dhe kështu e vërteta nxjerr sheshit, si tradhëtarët ashtu edhe atdhetarët.

Vërejmë, gjithashtu se pas shpalljes së *Kushtetutës* nga Turqit e Rinj (1908) Asdreni në vend të termave *gjuhë, atdhesi, përlindje, atdhetarizëm (shqiptarë të vërtetë)* e fjalë të tjera të

ngjashme, siç u cek më sipër, e përthekon me fjalën **FLAMUR**, simbol ky në të cilin përfshihen pothuajse të gjitha ato tipare që shpreheshin me termat e sipërpërmendur, koncepte këto që në gjuhën e Asdrenit shpjegohet kështu:

Besa jonë është flamuri  
Shenj'i lartë, yll për ne,  
Themel kombit që i vuri;  
Duk u lindur ditë e re.

Pra edhe këtu hetojmë se flamuri del me funksione të shumëfishta, ndër të tjera simbolizon themelin e kombit, cilësi kjo që më pare si parësore i mvishej gjuhës.

Edhe në vjershën **KËNGA E BASHKIMIT** indirekt përmenden shqiptarët e viseve të Shqipërisë që edhe pse dallohen nga të folmet, janë vëllezër të një kombi:

Gegë e Toskë vllazën jemi  
Të dy bashkë një emër kemi  
Dhe një fat në këtë botë  
Shqyptarë jemi, fjala thotë.

dhe vazhdon

Prej një nënë jemi lerë  
Mysliman' e të kristerë  
Në një diell jemi rritur  
**Si dy lisa pranë ngjitur.**  
.....  
Prej Viose gjer te Drini  
Mos na ndajë dot Shkumbini...  
Posi vllazën na të rrojmë  
Dhe Shqypninë ta forcojmë.

Edhe këtu, simbolizohen dialektet kryesore të shqipes të cilat duhet të shërbenin si mjet afrimi e jo ndarjeje për shqiptarët, sepse vetëm kështu *forcohet Shypnia*.

Në periudhën pas shpalljes së Hyrijetit 1908 ose **lirisë**, siç thotë Asdreni, nuk është aktuale më, sipas tij, as hymnizimi i gjuhës shqipe, ngase tash anembanë vendit u hapen shkolla dhe mësohej shqipja, por tash është e rëndësishme mësim-ushtimi ose të kuptuarit e luftës politike, ngase paraqiten forma të tjera të shtypjes dhe duheshin edhe forma të reja të luftës, andaj duhet shumë përpjekje për të ruajtur dhe shfrytëzuar: **lirinë e fituar për gjuhën e shkollën shqipe** (me ligj). Kështu këtë çështje e shpreh me ironi Asdreni në vjershën **KOSHTUTA**:

Ndë gjuhë tënde folë e shkruaj shumë  
Për qiell, për yj, për dhenë sa të duash,  
Por të tjera mos zgjat, të ruash

Se gërshtët thonë, dhe ... ndë lumë!

Kjo e dhënë, si më sipër është pasqyrë e hidhur e kohës, e shprehur paksa me ironi. Është fakt i njohur se lirinë që ta "dhuron: zaptuesi, kurr nuk është *liri e mjaftueshme*, e drejtë kjo formale që nuk kënaq fare. Ajo liri është e drejtë gjysmake, që në mjaft raste e kemi përjetuar edhe ne, ngase nuk është liri e tërësishme vetëm e drejta të shkruajsh në gjuhën tënde. Poeti, kërkon liri të vërtetë: liri shoqërore, kombëtare, kërkon gjuhë zyrtare shqipe(!).

Asdreni, në vjershën TË FALA, kushtuar Kongresit të Elbasanit, ku u shqyrtuan edhe çështje me rëndësi si dhe për kulturën shqiptare në përgjithësi, ku u vendos deri edhe për shkollën për mësues dhe ku rekomandohet që si *gjuha letrare* të jetë në bazë të *elbasanishtes* (dialekti i Shqipërisë së Mesme) që Asdreni e kishte ide të ravijëzuar më parë. Është interesant se këtë rast nuk e përmend këtë rekomandim, por përshëndet veprimtarët, du8kem I emnuar dy kosovarët: Hasan Prishtina e Nexhip Draga, duke lumnuar veprën e tyre burmore, për shkollën shqipe për mësues:

U lumtë burrave të Shqipërisë  
U lumtë atdhetarëve të shtrenjtë  
Themel me nder q'i vunë kombësisë  
Që mbushnë një detyrë sot të shenjtë.

Si provë se Asdreni e mbështeste që më parë në parim si ide të shenjtë shkollën normale dhe gjuhën e Kristiforidhit si zgjidhje gjuhe të stilit ndërbashkuese, pra, mbi bazë elbasanishte më së miri, siç e kuptojmë ne, dëshmojnë këto dy vargje të cilat jo rastësisht i pati vënë në ballinën e veprës së tij të parë *Reze djelli*:

S' ka punë *m' e shenjtnumun për atdhen'* kur lufton,  
Si dhe *për t'lulëzumun gjuhën* që kuvendon.

Sidoqoftë, këto ishin disa nga konstatimet lidhur me konceptin e Asdrenit mbi gjuhën, funksionin dhe kulturën gjuhësore të shprehura në etapën para Pavarësisë, por që është shumë e rëndësishme dhe me interes të dihet e të njihet kjo e vërtetë, sepse këto konstatime në njëfarë mënyre përplotësohen në etapën vijuese të Pavarësisë siç do të shohin në nëntitullin vijues, edhe pse tashti rrethanat kishin ndryshuar: Shqipëria ishte Mosvarme.

## (II). Periudha e Pavarësisë, zgjerimi i konceptit mbi gjuhën dhe rolit të saj

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë u bë më 28 Nëntor 1912 nën kushte tejet të pavolitshme për shqiptarët, madje dihen përpëlitjet e shtetit shqiptar dhe fati i tokave shqiptare para dhe kur plasën luftat ballkanike dhe Lufta I Botërore e deri në mbarim të kësaj lufte dhe më pastaj. Asdreni dhe në këtë periudhë do të shkruajë ndonjë poezi, që do ta botojë më vonë apo do t'i mbetet dorëshkrim.

Dihe se në Periudhën e Pavarësisë imperativi për gjuhë letrare (administratë) jo vetëm ishte edhe më i madh se përpara, por ishte një domosdojë, sepse gjuha në shtetin e shpallur shqiptar që nga viti 1912, nuk i kishte barrierat e mëparshme, por tash kishte pengesa rreth konsolidimit të organeve të pushtetit shqiptar dhe gjuhën e tij zyrtare, e cila nuk ishte aspak e lehtë, magjithatë fatbardhësisht u fillua me **shqipen zyrtare** që me shpalljen e pavarësisë dhe

të Qeverisë së parë nga Ismail Qemali.

Ndërkaq edhe pse kjo periudhë e luftës ishte e disfavorshme, ngase Shqipëria ishte e okupuar nga ushtritë e huaja, megjithatë, siç dihet, nga forcat përparimtare shqiptare të papënguar ose edhe të ndihmuara nga pushteti austrohungarez më 1916-1919, i cili shqiptarëve u lejonte flamurin, shkollën dhe administratën shqipe, u shfrytëzua rasti dhe në Shkodër u mbajt **Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës**, e cila trajtoi çështjen e gjuhës letrare-administrative shqipe, vendimet e të cilës qenë prezente në rrjedhat e mëtejshme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe mbi baza të shëndosha konvergjente, duke i dhënë krahun gegërishtes, por pa e përçmuar asnjë rast toskërishten. Në mbledhjen e parë të kësaj Komisie u miratua propozimi i Luigj Gurakuqi) dhe jo vetëm i tij, që kishte të bënte me gjuhë letrare (tash edhe zyrtare):

**"Sot për sot të merret dialekti i Elbasanit, por gjithnjë tue vështruam me gjetë forma të mesme me përmirësime për me futun në gjuhë të përbashkueme"...**

Rekomandim që përputhej me idenë e formëzuar që në Kongresin e Elbasanit 1909 , por tash ky parim-rekomandim fuqizohet ose implementohet dhe në "RREGULLAT MBI ORTOGRAFINË E GJUHËS SË SHKRUAR" (1917) të miratuar nga kjo Komisi, ku që në paragrafin e parë thuhet:

**"Si themel i ortografisë do të merret dialekti i Elbasanit me disa ndryshime".**

Kështu çështja e bazës së gjuhës së përbashkët për bashkimin kombëtar ishte zgjidhur në parim, pothuaj gati ashtu siç ishte orientuar edhe në periudhën e Rilindjes ose ishte kuptuar sadopak edhe nga Asdreni, mirëpo edhe pse emnohej elbasanishtja (e folmja Shqipërisë së Mesme), megjithatë, edhe tash lejoheshin zgjidhje me karakter kompromisi. Në formulimet e Komisionit pati edhe asosh kontradiktore ose jo aq të fiksuara qartë. P.sh. në paragrafinë 3. anëtarët e komisionit tregoheshin shumë duerlirë:

*" Komisia letrare sot për sot e sheh me arsye që këto parime mos të ndiqen fjalë për fjalë, e të metat që do të ketë kjo mënyrë ortografije, j'a lën kohës së ardhshme e shpreson se zhdrivillimi i gjuhës ka për të gjetë vetë udhën e mesme". (Shih: Lajmet e Komisionit Letrare Shqipe në Shkodër, nr. 1 kallënduer 1918, botuar në Vjenë.)*

Dihe se në Kongresin e Lushnjës (1920) u përkrahën vendimet e Komisionit Letrare të Shkodrës, duke u shtuar edhe disa terma, por pa u shtuar rregulla të reja, mirëpo në vazhden e kohës jo fort larg pati edhe reagime kundër atyre vendimeve, madje, siç thuhet, edhe nga ndonjëri nga "misët", që ishte anëtar i atij komisioni. Me fjalë të tjera çështja e normëzimit mbeti temë; e hapur në raportin ndër-dialektor, edhe pse kishte mjaft afri në burimet gramatikore, qoftë të botuara mbi bazë të gegërishtes si normë zyrtare, qoftë të asaj mbi bazë të toskërishtes, gjithsesi si normë jo e qortueshme.

Ndër shkrimet e Asdrenit në këtë periudhë 1912-1920, dallohen këto dy krijime letrare: *Shqipëria (1914)* dhe *Burri i Dheut 1920*, ku gjuha e poezive vazhdonte me ndjekë po atë rrugën e tij të mesme "me përzijime" që ishte praktikuar në dy veprat e para, sepse Asdreni pikërisht këtë mënyrë e shihte si zgjidhjen më të mirë dhe të sigurt për sforcimin e bashkimin kombëtar dhe për njëzimin e gjuhës letrare kombëtare. Por për këtë çështje në këtë kohë Asdreni nuk u ndal në ndonjë shqyrtim të gjerë teorik, por nga puna e tij praktike, mund të

shihet qartë se ai ndjek jo pasukses rrugën e vet “*me përzijime*”, natyrisht duke qëndruar tash më fort mbi bazë të dialektit të vet. Ndërkaq, për vendosjen përfundimtare të kësaj çështjeje, Asdreni mendonte, si më parë, që kjo çështje mbetet për t’u zgjidhur me kompetencë nga faktorët gjuhësorë.

Dihet se pushteti me ligjet unike kushtëzoi kiearki ashtu lidhur me përdorimin e gjuhës në administratë, gjuhë kjo që do t’i përshtatej asaj kiearkie organizmash shtetërorë. Pra, tashti gjuha shqipe patjetër duhet të shërbente në praktikë, sigurisht edhe si gjuhë e përbashkët administrative, zyrtare shtetërore, ngase, sidomos pas vitit 1920, u hapën zyre e përfaqësi për nevojat e brendshme e të jashtme të shtetit shqiptar. Kështu, si të thuash, u imponua domosdo një mjet i tillë për nevojat e një aparati të tërë shtetëror, edhe pse të përdëshiruar gjithshqiptar.

Sipas asaj që vërejtëm, edhe pse Asdreni, nuk shprehet aq qartë, koncepti i Asdrenit rreth njësimi të shqipes letrare në funksion letrar në këtë fazë 1920-1944) më tepër del jo mbi bazë të gegnishtes (*elbaskanishtes me disa përmirësime*), por pikërisht **mbi bazë të toskërishtes me disa përplotësime të gegërishtes, ku paskajorja dhe pjesorja e gegnishtes nuk del e harruar në gjuhën e tij**, koncept ky që do të dale i shprehur shkencërisht nga **Ilia Dilo Sheperi**, i cili për gjuhën e përbashkët letrare kishte devizën: **Gegnishte e Toskëzuar ose Toskërishte e Gegëzuar**, e cila kuptohet nga titulli i veprës së tij: **Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskërishtes**” (Korçë, 1927), ku ai përparësi i jepte toskërishtes, mirëpo pa përjashtuar vlerat e gegnishtes, siç ishte paskajorja me + pjesore e vlera të tjera.

Sidoqoftë, nuk dime sa do të jetë ndikuar edhe nga vepra e Asdrenit I. Dilo Sheperi, dhe sa Asdreni në këtë periudhë nga vepra e atij idealisti e shkencëtari e atdhetari të madh. Sidoqoftë, siç do ta shohim në vijim, Asdreni anon më tepër sipas variantit të dytë, *Toskërishte e Gegëuar*. Siç do të shohim konstatimi ynë del i mbështetur apo jo, do të kuptohet më mire pasi të analizojmë konceptin e Adrenit për gjuhën e funksionin e saj së pari, në dy tre artikuj , si me thënë teorikë: së pari, artikullin lidhur me gjuhën e Naimit (1925) dhe artikullin *Robëria dhe Liria*, së dyti artikullin thjesht gjuhësor: **Disa vërejtje për mbi Ë-në** (1930) dhe së treti, rreth koncepteve të tij për gjuhën dhe funksionin e saj shprehur në dy veprat e fundit poetike të tij: **Psalmë murgu** (1930) dhe **Kambana e Krujës** (1971)

### 1) Asdreni për gjuhën e Naimit dhe rreth artikullit *Robëria dhe liria*

Në këtë periudhë vlen të përmendet se si shprehet Asdreni në artikullin kushtuar Naimit (më 1925), ku pos tjerash, veç atyre që siç e pamë në citime më parë, konstaton se:

**"Naimi për ne ka për të mbetur prapë fytyra më e shkëlqyer se bëri gjë të rëndë për një gjuhë të palëruar".**

Meqë ndonjë insert, siç u tha, nga ky artikull e kemi cekur më përpara, këtu po spikasim atë që nënkuptohet se Asdreni si poet nuk i ikën gjuhës së koinesë së Naimit me shokë (toskërishtes), edhe pse ishte shprehur më parë për përzijim si me thënë të *barabartë* të dy dialekteve, ngase faktikisht realiteti do ta ketë bindur që ai të anojë nga toskërishtja, por pa përjashtuar fjalë e trajta të gegërishtes sipas nevojës, përkatësisht pa përjashtuar specifikime më të nduarnduarta stilistike e semantike.

Pra, pa u larguar nga gjuha bazë e Naimit lidhur me problemet politike dhe të tjera të asaj kohe Asdreni si publicist do të shprehë mendimet e tij në artikullin **ROBËRIA DHE**

LIRIA shkruar më 1930, në të cilin veç tjerash cek një plagë gangrenëse të shqiptarëve që e shqetësonte shumë e ajo ishte përçarja ose mosmarrëveshjet ndërshqiptare jo vetëm politike, sepse, siç e thotë ai:

*"Përçarja u bë një sëmundje endemike duke prurë dëmet dhe rreziket ata më të mëdhenjtë për vendin".*

Dhe pastaj kujton të kaluarën jo aq me pompozitet siç bënte më përpara, por në mënyrë më reale, duke tërhequr vërejtjen se ndjenja kombëtare te shqiptarët nuk bënë të lëmeket as brenda Shqipërisë Londineze dhe as në viset shqiptare jashtë saj (siç duam kuptojnë ne). Me fjalë të tjera nuk duhet pasur dobësi trimërie, siç kishte paqsur edhe më përpara te disa individë me emër që hezitonin ose u bishtonin punëve të mëdha e me rrezik për kauza atdhetare, ngase siç thotë poeti::

*Nuk mundim të mohojmë se një shkëndijë kombësisje here-herë në rasi të ndryshme nukë shkrepse në zemrat e disave, ... u mungonte kuximi për vepra madhështore, për një përballje të padrejtësive shekullore,,...(andaj rikujton se) Lidhja e Prizrenit është një shembull...*

Sido që të ketë dashur të thotë Asdreni ai këtë rast i kujton personat pozitivë historikë, të cilët me vullnetin e çelniktë të tyre bënë që të tejkaloheshin pengesat në të kaluarën, duke aluduar që edhe tashti si në Lidhjen e Prizrenit duhet ndjekur rruga e zgjidhjes së të gjitha problemeve, pa marrë parasysh sakrificat. Prandaj, edhe mosmarrëveshjet rreth gjuhës, atdheut (kombit të ndarë) duhen zgjidhur edhe me trimëri.

## **2) Rreth artikullit *Disa vërejtje përmi Ë-në***

Për qëndrimin e tij lidhur me gjuhën e shkrimit dhe funksionet e saj, para se t'i drejtohem veprës së tij të tretë PSALME MURGU, e cila u botua më 1930, dhe veprës së katërt *Kambana e Krujës*, e cila i mbeti dorëshkrim, po e marrim në trajtim përmbajtjen e punimit të tij, si të themi, thjesht teorik nga fusha e gramatikës ose praktika gjuhësore, me titull: "**Disa vërejtje përmi Ë-në**", botuar në gazetën *Shqipëria e re* rubrikën *Çështje gjuhe*, nr. 4 f. 25 (1930), ku autori rrah problemin më të ndjeshëm ortografik të gjuhës shqipe, jo vetëm të asaj kohe, por edhe të kohës sonë. Çështja ka të bëjë me drejtshkrimin, përkatësisht *përdorimin e shpërdorimin* e shkronjës **Ë**, siç thotë autori, andaj. ky artikull, zgjon interes:

së pari, për pasqyrimin dhe qëndrimin konkret të Asdrenit rreth çështjeve të hapura gjuhësore në fushën e morfologjisë e të kulturës së gjuhës të asaj periudhe dhe

së dyti, për mënyrën e të shprehurit të përmbajtjes dhe të stilit, ngase që atbotë rrah problemin më të ndërliqshëm, i cili, siç u tha, ende është aktual ose qëndron hapur si problem i drejtshkrimit të shqipes standarde.

### **a) Konstatim hyrës**

Konstatojmë se pak kush e di se Asdreni e ka rrahur këtë çështje mjaft profesionale që në vitin 1930, sepse nga studiuesit e kësaj teme, nuk përmendet pothuajse fare kontributi i



Asdrenit për këtë pikë, edhe pse këtë temë ai e kishte rrahur me tendencë mjaft pragmatike **40 vjet** para Kongresit të Drejtshkrimit (1972), ku prof. A. Kostallari e trajton po këtë temë, me ndarje shembujsh në 14 etalone, ose e trajtoi **84 vjet** para se Këshilli Ndërkademiak ta rishqyrtojë këtë çështje aktualisht.

### **b) Rreth përmbajtjes së artikullit**

Përmbajtjen e artikullit të Adrenit po e parafrazojmë me pak fjalë, duke e ilustruar me ndonjë shprehje a shembull nga origjinali.

Që në fillim Asdreni na bën me dije se edhe ky “*si mjaft të tjerë u heq vërrejtjen shkrimtarëve tanë për mi përdorimin dhe shpërdorimin e Ë-së që po bëhet në shkrimin e gjuhës sonë*” dhe menjëherë sqaron se nuk e ka fjalën për *gjuhën e folur*, sepse “*fjalimin*” folësi mund ta përdorojë *simbas andjes, si i vjen më mire*, madje nuk e ka të bëjë as për *gjuhën poetike*, por e ka fjalën veçan për *gjuhën e shkrimit*, sepse sipas tij “*në shkrim ndryshon puna krejt, sepse tani duhet respektuar norma nga pikëpamja e fonetikës, e hijeshiës si edhe estetikës së gjuhës. Dhe pasi kërkon mirëkuptim për vërejtjet e tilla, ngase supozon se tërheqja e vëmendjes (kritika) mund të jetë edhe jo aq me kripë, ngase për individët e caktuar kripa mund t’u djegë varrët e hapura, po sidoqoftë kritika si ilaç duhet të shërbejë për t’u vënë fre çthurjeve ... në fushë të shkrimit të gjuhës amtare, siç është përdorimi dhe shpërdorimi i Ë-së,* Asdreni konstaton mire për atë kohë, por që vlen pjesërisht edhe për kohën tone, se në shqipen... kemi katër farësh përdorimi të Ë-së, si:

**E para**, një Ë e plotë, e cila në të gjithë dialektet (e të folmet) është e tillë, pa kurrfarë ndryshimi, por për këtë nuk jep shembuj ilustrues. Si duket e ka fjalën, apo jo, për rastet, si: *në shtëpi, shkëlqim, n(d)ërmjet, bëltajë, bërllok andërr, vepër* etj.?!

**E dyta**, një Ë gjysmake, e cila e ka vendin e pacenuarshëm në gramatikë në çdo fjalë që ka përdorimin të rregullshëm, p.sh.: *punë, bukë, drasë, vajzë* etj., pastaj përmend shembuj të tjerë dualizmash paralelë, si: *lehtësi /letsi, butësi/butsi, thjeshtësi thjeshtsi, tundës /tunds, ku autori rekomandon trajtën e pare, sepse, sipas tij, në këto raste Ë-ja assesi nuk mundet që të zhduket në shkrim.*

**E treta**, një Ë hundore, e cila duke qenë hundore, në dialektin geg ndrohet në **A**, kurse në atë tosk është Ë (e theksuar). *Këtë A gegët e përdorjnë të theksuar me hundëzën A (d.m.th. me theks hundor) gjithmonë, por shpesh here e dytëshojnë (në shqiptim e shkrim n.v.), p.sh. aa, për ta shquar si hundore, por në toskët ka marrë një udhë të ngatërruarshme, nga që nuk ia venë fillin (theksin n.v.) aspak, duke bërë një gabim të madh me mos përdorur shënjë për ta shquar, p.sh. hengra /hangra, bera/ bana, terë /tanë, gjerë /gjanë, është /ashtë, me mirë /ma mirë, me s’ më duhet /ma s’ më duhet.*

**E katërta**, një –Ë të zhdukshme. Këtu, puna ndron se kjo ë mundet të zhduket nga shkrimi me që shpesh here edhe në mos shkruhet nuk ndjehet mungesa e saj, p.sh. *djematë/djemat, punëratë/punërat, shkruarë/shkruar, behetë/bëhet, të bukuratë/të bukurat. Po kjo mund të zhduket edhe në mes të fjalëve shumë here, b.f., kupëtohet/ kuptohet, shqipëtarët/*

*shqiptarët, ndërohet/ ndrohet etj. Gjithashtu kjo Ë mund të shfaqet e zhdukshme si në vjershë si në prozë, kështu, me t'a hequr – doemos ku lypset hequr – nuk i hiqet hijeshia as harmonia gjuhës, përveç kur do që të bësh një liri vjershërore (d.m.th. ta përdorësh për liri poetike a për harmonizim rrokjesh etj, n.v.)*

Jo vetëm kaq. Në vijim Asdreni e sforcon, me të drejtë, mendimin e tij, lidhur me pikën e dytë, duke dhënë shembuj nga shtypi, të cilët, vërtet, jo vetëm dëmtojnë kuptimin, por edhe iritojnë lexuesin, si b.f.

Në vend **në Durrës** paska dale në shtyp pa kujtim trajta **n' Durrc!, të mbulojmë / t' mlojm, Perëndi / Perni...** në vend **Një darkë Mbretnore** paska dalë: **Një Dark mretnor!** (dark, derk – dërrkuc!!) etj., madje cek shembuj kur Ë-ja përdoret edhe atje ku nuk duhet, si p.sh. në vend **plak –u**, në një shkrim paska pasë dalë: Vito Mëhilli **një plakë(!)** u martua me një grua!!! etj.

dhe kështu sipas tij :

*në qoftë se do t'i bijem pas gjithmonë rregullit e të mos e shkruajmë pa u menduar, se gjuha duhet shkruar si e do karakteri i saj dhe jo p.sh: **fjal, pun, buk, rrug, rrog** është një shëmtim aq i keq sa edhe për ne shqiptarët vetë është rëndë për të nxjerrë nga goja frazat pa zantoret tek vendi i tyre ... S' ka punë më e shëmtuar për një gjuhë, së cilës **duke i munguar zentoret, të mbetet vetëm me të pazëshmet, bëhet e ashpër, e humbet harmoniën, muzikalitetin dhe hijeshiën, I ngjet njëj rrugës së pa sheshuar mjeshtërisht, e cila tue qenë ashtu kudo që të shkelësh do të pengohesh nga cepat e gurrëve dhe poplave të dala q'i takon nëpër këmbë.***

Sipas autorit assesi s' duhen lejuar lëshime të tilla, sidomos nga toskërishtshkruesit, të cilët për hir të hipergegizmit (sepse atëherë ishte në fuqi letrarishtja mbi bazë të gegnishtes) bënin gafe e teprime të tilla të panevojshme e të neveritshme. Ja si e shpreh mendimin e tij lidhur me këtë autori:

*Pra shpërdorimi i Ë-së bëhet edhe nga ana e Gegëve, të cilët e zhdukin me t'a ngrënë fare dhe ku duhet, edhe nga ana e Toskëve, të cilët e zgjatin tepër, edhe ku s' duhet, ashtu që lypset gjetur një rrugë e mesme, që kjo Ë aq e dënuar të marrë vendin e saj ku duhet dhe të zhduket atje ku nuk duhet, doemos për në shkrim... Tani më së fundi kanë nisur edhe toskët t'i imitojnë në shkrim gegët, edhe këta toskët vall' a sikur duan të diftojnë se e mësuat krejt dalektin geg, edhe me ta shkruar gjuhën kësaj mënyre, duke thënë se i sjellin një shërbim, kanë rënë keq në pellg të turbullt me orthografiën, sa po thuaj gjuha ka harrijtë aq e shkëptë sa i duhen paterica për t'ecur më këmbë! **Kurrkush nuk është kundërshtim me një formë të përzjerë f.v. hangri, bani, apo ramje/rënje, vumje vënjë etj., çështja është vetëm të dish si të shkruash...***

Dhe në fund Asdreni përfundon me këto fjalë:

*Këto radhë në i shkrojta, e bëra me qëllim duke shpresuar se po të vihet në vend, e të caktohet në shkrim përdorimi i letrës Ë, nuk do të jetë aspak i vështirë për të dy dialektet që të bashkohen e të kuptohen më lehtë, **pët të mrritur në një gjuhë të përbashkme dhe të njëjshme shkrimi.***

Me që në këtë artikull ka edhe gjëra të tjera që zgjojnë interes, na u duk e arsyeshme që të japim më poshtë disa sqarime.

### c) Sqarime të nevojshme

Vetëm sa për dijeni, po theksojmë se si pika të diskutueshme drejtshkrimore lidhur me artikullin e mësipërm për të cilat lypset sqaruar janë këto dy çështje: 1) dy rregulla sot t;ë pavlera dhe 2) katër konstatime

#### Dy rregulla të pavlëra

Shikuar nga gjendja e sotme, si rregullave të pavlera që ceken në punimin e Asdrenit janë:

**E para**, emrat me –O fundore nga vokativi si **djalo** (djalë+O), autori mendon se duhet shkruar *djal'o*, d.m.th.me apostrof dhe

**E dyta**, shkrimi **A-së** hundore që në gegnishtes shënohej me theks siç rekomandon Asdreni, edhe barasvlerësi i saj **Ë** në toskërisht i duhet të shënohet po me theksin hundor, përkatësisht–**E**- po me theks hundor si A-ja?!.

Siç dihet, këto dy propozime, nëse I kam kuptuar drejt, si rregulla që kryesisht i ndeshim të realizuara në veprat origjinale të Asdrenit në drejtshkrimin pas LDB nuk praktikohen fare, ngase u tregua se janë jo të domosdoshme. Por si dëshmi që paska pasë ekzistuar një rregull i tillë, përveç Asdrenit, morëm vesh edhe nga një konstatim i prof. Arshi Pipës, i cili e përmend si rast, që atbotë edhe ky rregull i dallonte në gjuhën e shkrimit gegnishten nga toskërishtja. Si dëshmi tjetër është vetë ortografia e veorave të Asdrenit, sepse me rastin e ribotimit të veprave të tij (botimi 1987) rastet e tilla, si me thënë, janë korrigjuar, ngase ”teknikisht” ishte e pamundur dhe normativisht fare e panevojshme të shënohej **Ë**-ja apo **E**-ja me theks hundor. Si rrjedhojë kanë mbetur pa u korrigjuar shumë trajta të –**E**-së në –**Ë**. Fundja, mbase si pasojë e një dukurie të tillë ka mbetur, apo jo, në normën e sotme fjala **e gjerë (shqiptimi tosk. e gjërë)** në krahasim me trajtën geqe: **e gjanë** (gjansisht / gjerësisht), nuk mund ta dime.

#### 2. Katër konstatime me interes

Po përmendim lidhur me këtë edhe nja katër konstatime, sepse edhe sot paraqesin interes në raportin drejtshkrimor ndër-dialektor dhe përgjithësisht:

**E para**, mund të themi se vërejtja e Asdrenit rreth zhdukjes së –**Ë**-së nga praktika gjuhësore vlen edhe sot, ngase edhe sot disa *aventurierë* gegërishtshkrues po e zhdukin **Ë**-në në gjuhën e shkrimit pa kriter ose **E**-në nga diftongu **UE** ose **YE** po e kthejnë në –**Ë** ose po e zhdukin fare, duke mos e respektuar parimin morfologjik, dhe kështu po e gjymtojnë normën e djeshme dhe të sotme të stabilizuar, siç është rasti i shënuar nga Asdreni **Durrc!** Në vend Durrës, **mcus!** për mësues etj. . apo po shënohet folja e gjymtuar **me msu** në vend **me mësue** ose **me shkelqy** në vend **me shkëlqye** (**Ë**-ja ngatërrohet me **E**) etj

**E dyta**, është interesant që një mendim i atëhershëm i Asdrenit përkon me propozimin e disa standardistë të sotëm gegë, të cilët nuk janë kundër trajtave të *perziera*, por kërkojnë që a-ja me dalë parësore ndaj –**ë**-së, si te rastet: nanë/nënë, shtatzanë/shtatzënë hangra /hëngra, ngranë /ngrënë, ramje/ rënie, kanë/këngë, maz/mëz etj.

**E treta**, lexuesi i vëmendshëm mund të këtë vënë re se Asdreni kërkon rregulla drejtshkrimore vetëm **për gjuhën e shkrimit (gjuhën zyrtare)**, dhe jo për *ligjërimin e lirë*, dhe as për *gjuhën poetike*, të cilën sipas tij e mbron **liria vjershërore**, sajësë e Asdrenit për *litentia poetica*, apo jo.

**E katërta**, një gjë dihet se Asdreni ishte *për sforcimin e gjuhës me përzijim*, as plotësisht gegnisht as plotësisht toskërisht, por siç shihet ai megjithatë anonte kah ruajtja e bazës toskërishte. Kjo shihet edhe te shembujt më sipër, kur së pari i shënon trajtat toskërisht pastaj gegnisht dhe pikërisht ky qëndrim mund të quhet, apo jo, kontribut i konceptit të Asdrenit për shqipen e **njëjshme** letrare kombëtare që u miratua në Kongresin e Drejtshkrimit 1972 tash mbi bazë të toskërishte, në të cilin u kështu u veprua pas 64 vjetësh nga Kongresi i Elbasanit ose pas 42 vjetësh nga vërejtja e Asdrenit.

Sido që të jetë, Asdreni ishte për një gjuhë të *njëjshme letrare zyrtare shqipe me përzijim*, por pa i lënë anash vlerat karakteristike të asnjërit dialekt. Meqë atëherë ishte në fuqi shqipja letrare mbi bazë të gegërishtes, Asdreni anon nga baza toskërishte të cilën e begaton, siç do ta shohim në kapitullin në vijim, me gegizma, përkatësisht edhe me paskajoren geqe.

### **3) Koncepti i Asdrenit rreth gjuhës dhe funksionit të saj në dy veprat e fundit të tij**

Sidoqoftë, të shohim më poshtë se si zbulohet koncepti i Asdrenit për gjuhën e funksionin e saj në dy veprat e tij të fundit *Psalmë murgu* (1930) dhe *Kambana e Krujës*, e cila u botua pas vajtjes së shpirtit të tij në amshim. Që të dyja këto vepra, i përkasin Periudhës së Pavarësisë.

#### **a) Nga Psalmë murgu**

Asdreni në **Psalmë murgu** nuk ka shkruar parathënie, por në vend të saj ka vënë vjershën me titull **“Vjershave të mija”**, e cila në të vërtetë është parathënie funksionale dhe që në fillim zbulohet përpjekjen e autorit që të jetë i mishëruar në gjuhën e poezisë:

Nër këngë dhembjes barin ia kam gjetur  
Më 'to trishtimin munda që ta shterr,  
Qysh zeri-i i njëj vjolije tingëll-fjetur  
Çdo brengë si me dorë ta merr.

Trashëgimia e gjuhës poetike përmendej edhe më përpara nga Asdreni, por tash shtysat janë të tjera, ngase tashti, nuk kemi të bëjmë më me gjuhën shqipe si cilësi e vetme kombëtare të trashëguar, por më tepër kemi të bëjmë po me atë gjuhë shqipe, me funksione komplekse e gërshetuar me detyrim e nevojë për të kryer një sfond të gjerë funksionesh semantike e stilistike. Ai këtë rast parësorisht cek funksionin estetiko-letrare të saj, si vazhdimësi e stilit poetik të sprovuar në dy veprat e para. Pra, në strofën e mësipërme, siç e pamë, bëhej fjalë për diferencimin e vetë gjuhës si gjuhë poetike, e veçuar, sadokudo, nga gjuha zyrtare administrative, fakt ky që flet për ngritjen e kastës intelektuale të shqiptarëve në profilimin e poetikës shqiptare. Dhe Asdreni në këtë kontekst është i vetëdijshëm dhe na jep për të kuptuar

se ai ka punuar poetikisht që gjuhën e tij ta "**lë peng**" ose ose e lë të mbetet si trashëgim në kurorën e gjuhës poetike shqiptare:

Jo kurr' o vjersha s'kam për t'ju harruar  
Se jush ka dalë tingulli - i zerit tem,  
Dëshirë e zemrës sime dhempshuar;  
Nër ju q'e le si peng kur të mos jem!

Edhe më mirë këtë qëllim të lartë e shpreh dhe e precizon në vjershën pasuese GJUHA SHQIPE, ku poeti pasi bekon "ata të lumët" që brez pas brezi nuk pushuan, por e folën këtë gjuhë, përkundër të tjerëve që nuk i donin gjallërimin e saj, përruron, po tash dallon edhe më mire gjuhën poetike:

Si zonjë e madhe mbaju kryelartë;  
Bej të gjemojë zer-i yt hyjnor  
Nër vepra fryme mendje më së naltë  
T'ia thonë zanat këngës mbi Tomor!

Pra, gjuha poetike duhet të jetë e natyrës shqiptare, me cilësinë e shpirtit që merr jehonë e shëlbim nga "Zana e Tomorrit", simbol ky i njohur i shqiptarësisë: i Shqipërisë lashtë-historike dhe i shqiptarëve të sotëm.

Tash më kjo gjuhë popullore, siç del nga shprehja e Asdrenit, s'ka pse të brengoset, sepse tani më asaj nuk i kanoset rreziku i zhdukjes a i assimilimit, por megjithatë ajo edhe tash duhet të mësohet e kultivohet, të perfeksionohet vazhdimisht dhe kështu t'u mbetet brezave si trashëgimi gjithnjë e përherë më e dlirtë dhe më e begatë, jo vetëm si standard zyrtar, por edhe si gjuhë poetike. Në të vërtetë, Asdreni, asgjë nuk e shihte të kryer e të përkryer lidhur me çështjen shqiptare, prandaj thërret "djemt", brezin e ri, të nderojnë dhe të mbrojnë **flamur dhe atdhe**, sepse trevat e popullit shqiptar nuk ishin të bashkuara, madje edhe më keq, tokës shqiptare ende i kanosej rreziku i copëtimit, prandaj e shihte të asyeshme të përkujtohen brezat, që assesi tash e mbrapa të mos punojnë për të huajt:

Se mjaft i dham ndihmë çdo rrugtarit  
Mjaft vehten tonë e lamë në mjerim.

Jo vetëm kaq. kur të lexohen më me kujdes e të përjetohen me shpirt e zemër vjershat si **Maleve tanë, Adriatikut** etj. atëherë do të bindemi edhe më mire për sendërtimin e pa realizuar të programit të tij poetik –patriotik që i shtroi vetes në veprën **ËNDRRA E LOTË**, por që tash e shpiente më tej, duke kërkuar përgjigje në pronën e Nanës së Atdheut, në gjirin e fushave dhe maleve të saj:

Në gjinjt' e juaj male fshehni  
Atdheja çdo që ka të shtrenjtë,  
Ju këngë trimërie kreni  
Të bijën fli për trollin e shenjtë...

Pra brezat e rinj duhet të dijnë e të mos harrojnë, se:

Na rrugën e mbajtmë gjith me ndjesë  
të tretur shumë herë nga trishtimi;  
Por mjalt krejt na dukej hidhërimi  
Kur shihnim se fjala jonë se ze besë!

Dhe në të njëjtën vjershë lë si testament duke shprehur optimizmin për veprën e krijuar nga brezi i tij:

Ne shkojmë o shokë - po s'na shuhet shpresa  
Se fjalën që ju lamë si pasqyrë  
Gjithmonë do ta keni shëmbëlltyrë.

Dhe, me të vërtetë, brezi ynë dhe ata që do të vijnë pas nesh, kanë se çfarë të përjetojnë e mësojnë nga fjala (vepra) e shëmbëlltyra e veteranëve tanë të fjalës së bukur, siç ishte edhe Asdreni, të cilët jo vetëm nuk duhet të harrohen sot, por duhet të përmenden me nderim edhe në të ardhmen. Veprat e tilla nuk do t'i anashkalojë kurrë historia e kulturës sonë në përgjithësi dhe kultura letrare-artistike shqipe, për jetë e mot.

#### **b) Nga Kambana e Krujës**

Janë me interes të dhënat lidhur me gjuhën e funksionin e saj që i ndeshim të shprehura në veprën e tij të katërt KAMBANA E KRUIJËS. Ç'është e vërteta që në vjershën që i dha titullin veprës pasi flet për të kaluarën e KAMBANËS, e cila me zërin e saj mistik rrëfen për lindje e deri në vdekjen e Mbretit Skënderbe, që është në vazhden e vijës së Rilindjes, kah fundi i poezisë spikat:

Sot gjuha jote, po, kambanë  
Më s'mund të flasë si dikur,  
Të na tregojë çdo rrethanë  
Çdo ngjarje jete pas q'u thur!

Edhe tek të tjerët, ashtu edhe te Asdreni, kishin depërtuar dromca romantizmi me njëfarë doze pesimizmi nga idetë e Shlegelit mbi stadin e lartë të gjuhës në të kaluarën dhe me përshkallëzim uljeje në gjendjen vijuese.. Kështu kujtohej kjo e kaluar e lavdishme historike që për shqiptarët e ndërlidhej edhe me gjuhën kambanës që gjente mbështetje suksesive që nga periudhat më të lashta: e deri te ditët tona, si: periudha pellazgo-ilire, dardano–arbërore - shqiptare, sidomos, për momentin, kujtohet si më e lavdishmja **epoka skënderbejane**, e cila edhe duhet himnizuar e lumturuar me vargjet poetike në vazhdimësi.

Ç'është e vërteta, përveç asaj që u tha më sipër, në dhjetëvjetëshin e 30 të shekullit XX, Asdreni nuk ishte i kënaqur jo vetëm me zhvillimin e gjuhës, por nuk ishte i kënaqur as edhe me zhvillimin e përgjithshëm shoqëror shqiptar. Ishte koha kur bëheshin “biseda t'ashpra dhe të mfyryta” edhe rreth gjuhës letrare, kur kishin qitur krye me të madhe shumë mosmarrëshje

të natyrshme edhe aso divergjente rreth njësimi të gjuhës zyrtare, madje kishte edhe paqartësi lidhur me kuptimin e rreth ndarjes së normës letrare poetike, nga ajo zyrtare administrative, por sidoqoftë në këtë kontekst edhe nismat e mbara nuk mungonin. Mirëpo pikërisht atëherë kishte shenja se përgatitë shkelja e lirisë kombëtare nga Italia fashiste, kur edhe në Kosovë zullumi kishte arritur kulmin kundër shqiptarëve, ku ishte intensifikuar përshkallëzimi i shtypjes me qëllim asimilimi, të pjesshëm ose shpërngulj të plotë në Turqi ose në Shqipëri, gjithsesi me qëllim të shfarosjes shpirtërore e fizike të popullit shqiptar të kësaj treve. Me fjalë të tjera, gjithsesi merreshin masa për të zbrazurit e këtyre viseve nga shqiptarët, pa përfunduar çfarëdo mase. Pikërisht, në këtë kohë të gllabërimit moral e material të popullit shqiptar, kur poeti e shkroi edhe poezi kushtuar Kosovës, **Kambana e Krujës**, simboli i qenies kombëtare shqiptare, nuk duhej mbetur "*ballë unjur*", pa përfillje. Andaj poeti sërish e sheh të arsyeshme që të rifreskojë përkujtesën për të kaluarën e lavdishme historike që të dijnë të rinjtë tanë dhe të respektojnë virtytet pozitive të të parëve tanë, të cilët:

Nderim sillnin nënës e babës  
Për ta si bij të lindur plot kujdes  
Dhe flitnin gjuhën e shkabës;  
një trashëgim i mbetur për çdo bres!

Pra, sipas tij, brezi i ri nuk guxon të harrojë veçorinë më karakteristike të kombit, respektin ndaj prindërve, ndaj gjuhës dhe atdheut - assesit ndaj kombit. Është koha, kur populli shqiptar nuk guxonte me i harrue **të parët e tij atdhetarë** dhe këtë kërkesë e thekson edhe më qartë e më me forcë në vjershën *Gjaku stërgjyshëve*, sepse:

Për ta çdo fjalë që një fjalë bese,  
në shënjtësi zbatonin çdo zakon,  
Fajtori i kapun s'kishte rrugë ndjese  
Nër ta padrejtësia s'gjente fron!

Në vjersha të tjera patriotike nuk e përmend gjuhën, por në ato satirike po, ku diapazoni i të shprehurit lidhur me këtë çështje del shumë më i gjerë dhe me mundësi më të mëdha shprehjësore. Këtë rast dallojmë dy poezi dhe një prozë poetike ku trajtohet kjo çështje, siç janë:

- *Republika shqiptare*, shkruar më 1925,
- *Trashëgimi*, e shkruar dhjetë vjetë më vonë, më 1935 si dhe
- *Unë Flamuri po ju flas*, prozë poetike si apoteozë kombëtare, shkruar më 1937, në kujtim të 25 vjetorit të **28 Nëntorit - Ditës së flamurit**.

#### a) Nga "Republika shqiptare"

Në poezinë **Republika shqiptare** poeti i sheh gjërat me sytë e realitetit relativ dhe e brengos fakti se, edhe pse, tashmë kishim shtet shqiptar (kombëtar), punët nuk po shkonin ashtu siç i pati paramenduar ai në kohën e ekzaltimeve rilindëse, romantike. Ashtu siç i parti ëndërruar poeti, duke pasur në mendje vendet më të përparura të botës. Në këtë rrëfim në

vargje Adreni sheh dhe prek tërë kompleksitetin e obligimeve shtetërore, pa harruar edhe bazën ekonomike, çështjen e diturive, lëmenjtë e ndryshëm të jetës shoqërore e politike, gjithsesi lëmin e kulturës dhe me një dozë herë-herë të lehtë ironie e here-herë me sarkazmë përkujton pikat e përdëshiruara lidhur me gjuhën, kur në të vërtetë i dukej se çalonte veprimtaria e tillë e idealizuar në stilet e ndryshme funksionale e letrare, përkujdesje kjo, të cilën tashti duhet ta kishte **Republika**, përkatësisht organizmat e institucionet e saj shtetërore e shoqërore:

Shkrime shtypen ditë për ditë  
me një rregull mjeshtërie  
Nër volume madhësije  
Janë hapur dituritë  
Dhe çdo degë letërsije!

Dhe vazhdon

Shqipja shkruhet e kulluar  
me një formë krejt letrare!  
Nër fletore sheh zyrtare  
Më një rythm të stërholluar  
Qysh flet Zana Shqypetare...

Dhe në vazhdim pothuajse poeti do t'ua kujtojë me gishtin dëftues pushtetmbajtësve dhe kreatorëve të politikës shtetërore si dhe institucioneve kulturore ironikisht se veç tjerash çfarë veprimesh duhen ndërmarrë për t'i kryer detyrimet e ngarkuara nga pozita që bartnin. Nuk është çështja vetëm të shpallej republika, por përparimi kultural e arsimor të masave duhej bërë me plan, në mënyrë të organizuar, duke aluduar për një shtet të përparuar të shqiptarëve, siç e patën ëndërruar rilindësit si Samiu, Konica e ndonjë tjetër qysh herët. Tashti Asdreni si një shkollar bashkëkohës ato kërkesa ia përkujton, pra, shtetit të ri:

Në çdo fshat Biblioteka,  
Në qytet Akademira  
Dhe me mijëra bukurira,  
Mendja jonë që s'e prekka:  
Që na duken si çudira!

Këto mbase as që i fliste apo i imagjinonte kush në shoqërinë e atëhershme nga kompetentët e qeverisë së atëherhme, të cilët, fundi i fundit, as që kishin kushte për masivim aq të madh të kulturës, por sipas Asdrenit edhe ato kushte që i kishin nuk i shfrytëzonin sa e si duhet, madje as mësimin e gjuhës, andaj Asdreni përfundon satirën kështu:

U tund deti, briti toka:  
Shqipëria Republikë!  
Punë e bukur, thom pa frikë,



Veç zyrtarët që nga koka  
S'dinë shqip as gramatikë!

A meritonin zyrtarët e atëheshëm dhe këta të sotmit një etiketim të tillë, apo jo, le të vlerësohet.

### b) Nga “Trashëgimi”

Në vitet '30 edhe më parë, tashmë kur partikularizimi arriti kulmin në shumë sfera të jetës, madje edhe lidhur me gjuhën letrare, ngase u lancuan edhe teori nihiliste. Asdreni e sheh qartë prapavinë politike, andaj në poezinë *Trashëgimi* trajton disa çështje kyçe edhe lidhur me qeverisje dhe mbarëvajtjen ekonomike e kulturore, por edhe gjuhësore. Ai e njeh realitetin e hidhur kur "*kalorës të Cervantes mbajnë kapistallë, e të hurit dhe të litarit të jenë prijës - në ballë të kombit*"?! Kështu Asdreni e shihte gjendjen, duke menduar se një ndër shkaqet e së keqes që e kishte katandisur vendin ishte në radhë të parë qeverisja jo e denjë dhe se në aparatit e shtetit kombëtar ishin infiltruar ata që, sipas tij, nuk meritonin. Ja se si i portretion Asdreni ata që kishin për detyrë dhe kompetencë të merreshin me përparimin e kulturës shqiptare, por:

Me fjalë i sheh se merren, me gjepura pa kripë  
Me frymën mendjësije në lak për ta shtytur,  
Biseda pakuptime, të thëna sa për cipë;  
Themeli i kalbur fare, mendim krejt i mbytur.

Shpesh ironia e Asdrenit kalon në sulm të rëndë:

Nj'aty ku letërsia është gjellë që s'ka shije  
Edhe arti fjal'e thatë q'aspak s'i dihet fara,  
Ar derdhet pamëshirë për sende kotësije,  
Kur libra s'ke për shkolla, një çap të bësh përpara.

Në këtë kohë kur kujdesi ndaj gjuhës dhe pastërtisë së gjuhës mungonte dhe kur barbarizmat kishin vërshuar e depërtuar pa kriter me të madhe, ashtu si edhe shprehjet e huaja në jetën e përditshme të shtetit shqiptar, Asdreni do të reagojë:

Prej gjuhës sonë t'aftë me tinguj harmonije  
Që shkruhej më një kohë që s'ish zyrtare  
Me fraza të kthjellta, me fjalë që kish hije,  
Sot zyrat po na ngjeshin me lëng pa shije fare.

Kështu Asdreni fshikulloi veç stilit poetik edhe gjuhën e administrates, e cila duhej kristalizuar në bazë të shprehjeve shqipe e jo të bëhen kopjime ose kalkëzime të vrazhda nga gjuhët e huaja. Autori mendon se sa i përket çështjes së gjuhës në krahasim me punën e rilindësve u bë kthim prapa, sepse:

Prej nusës bukur nisur si vajzë trupkërthinjtë  
të sotmit na stolisin një plakë me shallvare;  
në shkollat ner katundet tek faqas lozin minjtë,  
Plevica kemi ndrequr në vend të ngrehim alltare.

Dhe rolin e arsimitarëve e prek me të drejtë poeti:

Mësonjës t'arsimit me shpirt të ndryshme - e gjyqe  
Që vet fund s'i japin një gjuhë lakrash çorbë  
me ndërlikime fjalësh a'u bëhet mentë qyqe.  
Mos presin zell mësimi nga çunat korbë.

Është e vërtetë se mësues e profesorë deri vonë përdornin secili drejtshkrimin e vet, ose nuk e zotëronin fare atë, andaj, kuptohet sa vështirë ishte edhe për nxënësit e dashamirët e shkrimit shqip. Mjerisht një dukuri e tillë sidomos te ne vazhdon edhe sot.

Sido që të jetë, duke i trajtuar problemet e gjuhës e të arsimit Asdreni nxjerr konkluzionin se në radhë të parë duhet kushtuar kujdes mësimi të gjuhës amtare, madje që në shkollat e para. Kështu cek një fakt me shumë rëndësi dhe aktual edhe për ne sot, kur cek faktin se edhe kuadro që duhen dërguar për studime e specializime në botën e jashtme, duhet përzgjedhur, në radhë të parë ata që më parë të kenë zotëruar mirë gjuhën amtare:

Të rinj përjashta çohen, po rrallë e me zelltari  
Nër shkolla dijenaltë, për t'aftë dijetarë.  
Por shqipen kur s'e dijnë se ç'duhet pikësepari  
Kot shteti derdh të hollat, kot farë hedhet nd'arë.

Edhe sot kemi raste që shumë specializantë tanë më mire po e njohin gjuhën përkatëse të huaj se gjuhën vet, që fundi i fundit e kanë detyrim ta mbëltojnë dijen që e sjellin në këtë gjuhë (shqipe) jo në gjuhën e huaj.

Së këtejmi, edhe roli i shtypit që i përket zhvillimit e aplikimit të gjuhës është padyshim tejet i madh, Asdreni lidhur me këtë vëren:

Hith sytë mbi botimet e javës e të ditës  
Në dhjetë fjalë shkruar nuk di gjen dy shqipe,  
Kalorës të pendës si t'aftë kryengritës  
Me shkelm i biejn mëmës, o flakin nëpër çipe.

Krijuesit e rinj posa dilnin në skenë nxitonin të përvetësonin fjalë e shprehje *mode* nga gjuhët e huaja dhe kjo e brengos poetin, i cili reagon:

Një kohë do t'arrijmë, që tash afrojmë po thuaj,  
Mos njohim çfarë gjuhe del frymës sonë gjallë,  
Se trupi n'është i yni, po shpirti krejt i huaj  
Mos qahemi se s'kemi të shquar papagallë!

Andaj edhe shprehja edhe përmbajtja duhet të jenë të frymës shqiptare e jo siç bënin ata politikanë, intelektualë naivë e poetë papagallë që imitonin formën e përmbajtjen e letërsive të huaja, duke përbuzur traditën e vet dhe mbaheshin mendjemëdhenj, duke u shtirë si shkollarë të zot(!):

Më hundën gjith përpjetë dhe ndjenjat të përqarta  
Me mburrje mendjelarti dhe sjellje "urt e butë",  
Si pemët e paarrjta në tul e lëng të tharta,  
Nj'ashtu siç ç'e duam vetë q'i "dashka mushka drutë".

Pra, ashtu si u deshka interesi personal a i kastës sunduese e jo interesi i shqiptarisë, i kulturës së përgjithshme të saj.

Asdreni prek edhe një çështje tjetër, shqiptarët duhet të kenë kujdes se çka po krijojnë, ngase bota e qendrave të kulturuara i vlerëson vetëm në saje të krijimeve të niveluara në çdo fushë të jetës e të dijes, sepse:

Të huaj vënë vesh ku shohin çka pjellë mendja  
Ç'del trurit e shëndoshtë, n'është ajk apo shëllirë,  
Për ndryshe s'të përfillin sido q'e prurtë gjendja  
Kur ke mungesë dije, kur s'ke gjuhë të dliërë.

Dhe kështu Asdreni edhe krijon, tërheq vërejtje e kritikon, krijon, mësimon edhe këshillon, duke drejtuar gishtin në plagët dhe të metat shoqërore e qeveritare të kohës me qëllim të zhvillimit të përgjithshëm kulturor e gjuhësor të shqiptarëve. Më një fjalë ai nuk ishte i kënaqur me zhvillimin e ngjarjeve, madje dhe sa i përket krijimtarisë artistike në ato faza, por me këto fjalë kishte për synim, siç u tha, të tregonte rrugën e mundshme që do t'i shpinte shqiptarët drejt përparimit drejt botës së civilizuar europiane e botërore. Në të vërtetë, shqetësimi i Asdrenit ishte brengë e mbarë popullit shqiptar në atë kohë, madje mund të themi se të njëjtat plagë shoqërore, po ky popull, në një fare dore, është duke i përjetuar edhe aktualisht, apo jo?!

### c) Nga “Unë Flamuri po ju flas”

Asdreni, duke parë se ndjenja patriotike te rinia shqiptare si frymëzim nuk ishte e gjallë si përpara, e sheh të arsyeshme që në **25 Vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë, pra Ditën e Flamurit** t'u drejtohet shqiptarëve po në emër e me gojën të FLAMURIT, dhe këtë e bën në artikullin “**Unë flamuri po ju flas**”, që ka elemente të një proze poetike:

*Aty në Vlorë, u gëzova bashkë me ju, qava bashkë me ju me lot ngazëllimi, lojta valle me ju, valle shqiptare të vërteta, një popull i tërë më priti me brohoritje kur më pa ...më njohu dhe bota e lire se unë jam Mrojtësi dhe Shpëtimtari i juaj i të gjithëve.*

dhe

*...Me syrin depërtonjës jam i zoti të hyj në zemrën tuaj, me ndjenjat e juaja që janë akoma të mpijta... se dhe pas 25 vjet nuk dijnë mirë se kush jam unë Flamuri juaj!... edhe nxënësit e shkollave fort të pakët janë ata që më dijnë dhe se duhet të më nderojnë... duhet të jenë të bindur edhe të më bëjnë nder si njëj shenjë e kombit që jam!... Por kanë të drejtë se nuk më dijnë, nuk më japin rëndësinë e duhur, se as s'ka kush t'ua shpjegojë me mënyrë dhembshurije kombëtare...*

Kjo është ankesë e përkujtesë dhe njëherit akuzë me vend kundër ideve antikombëtare ose ekstrauniversale që ishin infiltruar edhe në shkollat e atëhershme, përkatësisht tek disa kuadro e të rij, sidomos nga propagandat e huaja, fashiste, nacionalshoveniste, fanatikofetare fundamentale, komuniste e të tjera ekstremizma antokombëtarë, që mjerisht elemente të tilla shfaqen jo pak edhe në kohën tonë.

## Sipërfundim

Asdreni nuk pushoi së shkruari në asnjë moment dhe përherë në shkrimet e veta pati për qëllim të kontribuonte për të mirën e kauzës kombëtare shqiptare. Shkroi ashtu si i ndjente ngjarjet politike të kohës. Më 1944 u shpreh edhe kundër luftës pa kuptim, ngase nga lufta vëllavrasëse që "me gjak u mbyt Mësimi dhe Arti" , mirëpo shpëton nga inferioriteti a zhgënjimi, kur sheh se mbi gërmadhat e së vjetrës po lind një botë e re, andaj, më 1945 përshëndet fitoren e Çlirimit me vjershën DIELL'I RI:

Sot u liruan fytit kaq shtrënguar  
Dhe në të shohin jetë pa vrer...

Asdreni edhe pse nuk ishte i pranishëm në ngjarjet në Shqipëri, ai do të përshëndesë larine ose paqen pas LDB-së me gjuhën e tij të ëmbël:

Këngë gazi, derdhje vallesh  
Sot ushtojnë malet tona,  
Brtime zemre - a shprehje malle  
Po kumbojnë plot jehona.

Asdreni pra veç tjerash edhe pse nuk qe një punëtor gjuhësor, linguist me profesion ai kishte mjaft njohuri të gjera të përgjithshme e të veçanta edhe nga kjo fushë. Madje kishte një shije sens për gjuhën, ligjërimet e stilet e saj dhe me anë të vargjeve të tij e të shkrimeve të tjera kontribuoi për përparimin e gjuhës shqipe. Vargjet e tij edhe pse paraqiten me një drejtshkrim jouniform, pasqyrë e kohës, mbeten përherë të freskëta për lexuesit verior e jugor, ngase shquhen për nga përmbajtja e stili poetik dhe sidomos për spektrin e frymëzimeve, fushë kjo, cila sipas prof. R. Qosjes *“është jashtëzakonisht i gjerë dhe në këtë pikëpamje gjer më sot asnjë poet shqiptar nuk i është afruar”*. (Vepr. e cit. f. 26.)

### III. DISA NGA VEÇORITË DREJTSHKRIMORE, FONETIKE E GRAMATIKORE NË VEPRAT E ASDRENIT

Përkundër dëshirës e përpjekjeve për një gjuhë të normuar e të unifikuar rilindësit tanë, por edhe pasuesit e tyre, edhe pse idejisht ishin të orientuar mire e mbarë, jo vetëm për shkak të ndarjen ndërdilaktore nga realiteti i trashëguar i shqipes, por edhe për shkak të rrethanave të pavolitshme politike e shoqërore, sigurisht edhe për mungesë të shkollës e të administratës së unifikuar kombëtare shqipe etj., nuk mundën me arritë qëllimin që synonin – gjuhën e përbashkët letrare kombëtare shqipe. Kuptohet, edhe Asdreni, trashëgoi një ortografi të tillë, të themi, të çrregullt si dhe një gjuhë të palëruar në përgjithësi dhe të asaj letrare në veçanti, andaj ai në vazhdimësi shqetësohej për gjendjen e pavolitshme të gjuhës së shkruar shqipe, të cilës i mungonte deri drejshtrimi unik, megjithatë, kjo nuk do të thotë se ata, rilindësit dhe pasuesit e tyre, para Asdrenit e gjatë kohës së tij nuk mund të komunikonin, madje edhe të krijonin vepra të suksesshme në gjuhën shqipe, duke respektuar normën e shqipes globale si dhe normën e situatës.

Së këtejmi, për të pasur një pasqyrë më të qartë të ortografisë, përkatësisht të gjuhës së Asdrenit hetuam disa nga veçoritë më karakteristike drejtshkrimore, fonetike e gramatikore nga veprat e tij në mënyrë që në këtë komtext të nxjerrim konkluzionin real sa ishte kontributi i Asdrenit si veprim spontan e sa si nismë e vetëdijshme lidhur me kristalizimin ndërkohë të formave ortografike dhe kështu të njihet sadopak përpjekja e tij lidhur me këto shtigje mjaft të vështira, kur nuk kishte as doracak të plotë orientues për ortografinë shqipe.

Këtu, në këtë punim veçoritë drejtshkrimore, inkunsekuencat përkatëse i kemi shënuar sipas konsultimit që u bëmë fillimisht katër veprave të Asdrenit të botuara nën përkujdesjen e prof. Rexhep Qosjes, duke bërë krahasim me ortografinë e sotme kryesisht, por pa harruar edhe normën praktike të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegnishtes, që ishte në fuqi kur u shkruan ato vepra, por me që dolen dore konsultuam po ato vepra të botuara nën përkujdesjen e prof. Koço Bihikut.

E përmendëm normën letrare mbi bazë të gegërishtes, ngase Asdreni ishte i ndikuar, dhe i ballafaquar me një fakt të tillë. Është e vërtetë se shqipja në bazë të trashëgimisë dokumentuese kishte një normë globale mjaft heterogjene të trashëguar me të folme të pastudiuara në dy koinetë e njohura: gegnisht e toskërisht. Ndërkohë, si shqipe letrare me synim të përbashkët vetëm sa ishte piketuar sipas parimit gjeografik, orientuar drejt të folmes së Shqipërisë së Mesme, zonë kjo që simbolizohej me qytetin e Elbasanit që ndodhej “*në kërthizë të Shqipërisë*”, që kishte edhe njëfarë tradite shkrimore në shqipe, por si nëndialekt nuk ishte i pajisur sa duhet me shtyllat e domosdoshme të asnjërës koine që të mund ta përfaqësonte bile njërin koine si duhet. Atëbotë traditë më të dalluar shkrimore kishte zona jugore e këtij qyteti, por që kalonte në koinenë e toskërishtes nga njëra anë dhe nga ana tjetër kishte traditë edhe shkodranishtja që i takonte koinesë së gegnishtes, por fizikisht ishte nëndialekt anësor ndaj Elbasanit, ngase kishin në mes të folmet e Matit e të Lumës që kishin traditë të ligjërimit popullor paksa ndryshe të artikullimit dhe nuk kishin aq traditë shkrimore. Megjithatë, meqë **Elbasani** me Shkumbinin ndërlidhnin këto dy diekte sipas gjuhësisë gjeografike pragmatikisht e logjikisht kësaj të folmeje i takoi siç u tha dhe iu dha roli i

ndërmjetësit për harmonizimin e të dy koineve për formimin e një gjuhe letrare të përbashkët shqipe që ishin: **gegnishtja shkodrane** dhe **toskërishteja verilindore** (Korçë-Permet-Berat) me të cilën Elbasani ishte më në afërsi fizike se me Shkodrën. Është interesant se Asdreni, si me thënë, ka shenja piketues që ndër të parët e përqafoi simbolikisht idenë që si qendër orientuese drejt letrarishtes së shqipes të përbashkët të jetë **elbasanishtja**, e cila mund të përforcohej me vlerat e dy koineve. Kur themi *elbasanshtja*, kuptohet, pra, gjuha e Shqipërisë së Mesme. Si vërtetim të atij pikëtimi dëshmojnë vargjet e shënuara në ballinën e veprës së tij të parë:

S' ka punë m'e *shijnjnumun*  
për **atdhen'** kur lufton,  
Si dhe për t'*lulëzumun*  
**gjuhën** që kuvendon...

ku mbizotërojnë trajtat e elbasanishtes së atëhershme *shejtnumun*, *lulzumun* etj. Këtë fakt e ricekëm, sepse siç dihet elbasanishtja për këtë funksion ndërmjetësues ishte përmendur më përpara, por si propozim kishte dale, 4 vjet pas botimit veprës së parë të Adrenit *Rreze Djelli*, në prag të Kongresit të Manastirit (1908) dhe pothuaj u zyrtarizua një vit më vonë në Kongresin e Elbasanit 1909, por gjithashtu ishte ripropozuar dhe njëherazi vendosur dhe pajisur me disa rregulla jo aq të plota por shumë të vlera në Komisinë Letrare të Shkodrës 1917, dhe si e tillë u përkrah institucionalisht në Kongresin e Lushnjës 1920, u *fuqizua* me vendim të Qeverisë shqiptare 1923 dhe ky vendim si rekomandim zyrtar vazhdoi të ishte në fuqi deri në vitin 1945 e nën hije ligjërish edhe disa vite më vonë. Te ne faktikisht deri në KONSULTËN e Prishtinës (1968). Mirëpo duhet thënë e vërteta se në atë periudhë, kur shkroi Asdreni, kjo gjuhë letrare nuk ishte e pajisur si duhet plotësisht me asnjërin nga bazat themelore serioze që duhet të kishte një gjuhë standarde, siç janë: *drejtshkrimi me ilustrim shembujsh si shtojcë*, *gramatika normative* dhe *fjalori përkatës normativ*, duke përthithur të gjitha vlerat që ka gjuha globale, edhe pse nuk duhet mohuar përpjekjet e sukseshme në drejtim të konsolidimit të gjuhës administrative dhe në atë periudhë. Këtu e lyp vendi të njihemi me mendimin e Adrenit të shprehur një intervistë të vitit 1938 (sipas XH. Lloshit), ku Asdreni qenka shprehur kështu:

*Aq sa na lejonte nevoja jonë dhe mjetet e gjuhës së papunuar, ahëre na hapëm një rrugë jo vetëm të shtruar e të zbukuruar mire, si e don rregulli dhe rryma e sotshme.*

Sidoqoftë, kontributi i Adrenit në këtë kontekst si pararendës, qoftë edhe si piketim orientues I një rruge të mbarë është për t'u vlerësuar, ngase ai që në fillim paraqitet me *përzijim* (sajesë e tij) që nënkupton gjuhë të përzier me trajta e fjalë ndërdialektore toske e geqe. Megjithatë ne duke u mbështetur në gjendjen e atëhershme të asaj norme dhe normës së sotme do të përpiqemi të vëmë në pah në kapituj të veçantë çështjen e atij *përzijim* të gjuhës së Adrenit, por tash do të vëzhgojmë: së pari, disa veçori fonetike dhe së dyti, disa veçori morfologjike që hetuam në gjuhën e veprave të tij, të cilat nuk mund të vlerësohen si rregulla mbizotëruese, ngase përcillen me shumë luhatje.

## (I). RRETH DISA VEÇORIVE FONETIKE

### A) ALTERNIMI I ZANOREVE

Alternimi i vokaleve si në disa të folme të gjuhës popullore, u reflektua edhe në gjuhën e Asdrenit. Sidoqoftë, këtu mbetet të konstatohet alternimi i tillë në veprat e Asdrenit, dukuri kjo që si e tillë ishte e pranishme edhe në gjuhën e ashtuquajtur letrare shqipe të pakonsoliduar të asaj periudhe. Po fillojmë me paraqitjen e disa rasteve nga alternimi i zanoreve sipas veprave të konsultuara:

**Sqarim.-** Në vijim veprat janë shënuar me inicialet, si vijon: Rreze dielli – RD, Ëndrra e lotë – ËL, Psalme murgu – PM dhe Kambana e Krujës – KK dhe në disa raste pranë shembujve që kryesisht janë vjelë nga veprat e botuara më 1971 është shënuar edhe numri i faqeve

#### a) A-ja

-Në një numër fjalësh, përdorimi i A-së së patheksuar ka luhetje, sepse, edhe pse s'kemi të bëjmë me correspondence hundore, në disa raste ka pësuar reduktim në cilësi dhe është kthyer në Ë. P.sh.

RD: Lavdin 106, lavdërim 142 ndaj: lëvdoj 192, 237, 239 etj. Dhe në veprat tjera del herë më A e herë me Ë, si p.sh: ËL lëvdatë 41, 126, 590, lavd 181, lavdimn' 22, 16, 35; PM lëvdatë 49, 71, lavd 21, hymn lavdije 31, KK lavdërim 27, levdata 9, lavd 9 levdata 119, lëvdarak 134, si dhe folje lëvdojnë 119. Edhe në gjuhën letrare të sotme lejohen të trajtat *lëvdoj* edhe *lavdëroj*.

-Kemi disa raste kur Ë-ja përdoret në vend të A-së: kësollë RD 144, 145 (e që në rastet tjera del me a), dëllëndyshe 168, pëllas 190 e pellas, peshkëtar për peshkatar, përdoret 4 herë në një vjershën po me këtë titull (208). Edhe në ËL kemi *redhe* 87 e 147 në vend të fjalës *radhë*, po ashtu edhe zëmbaku 156 dhe zambaku 159 që haset po në këtë vepër.

-Po përmendim edhe trajtën dialektore kur në vend se të përdoret A-ja përdoret E-ja:

RD *ardhi* 91, 91, 129 etj. për *erdhi*, siç është kodifikuar në letrarishten e sotme.

-Kemi një dy raste ku për hir të rimës është sakrifikuar A-ja, në këto fjalë paroksitone:

PM s'pat ardhur/s'pat erdhur / për t'u derdhur 43; i mverdhur/t'i erdhur 101. Ndeshim vetëm një rast, (alternimi a/i) te fjala *kafshitë* për kafshatë.

-Ndodh edhe e kundërta kur A-ja përdoret për E-në:

PM atrit 46 për etrit, pastaj: shangullor (për shungulluar), gjarpërinj /gjerpërij e gjerpërinj etj.

#### b) I-ja

- Në veprën e tij të parë RD kemi shkrimin e I-së për J-në:,P.sh.:

Viosë 88, lulia (lulja)116, 111, kio 99, violca 157, riethë 177 pastaj miekra, rieth, miaft, qyqia, vojtie, laithitë, rriedhni, nënqeshie, - por ka raste kur J përdoret në vend të i-s; si djelli, mjelli ose ku j-ja nuk shënohet fare, si: u kriua, hia, që në veprat e tjera trajtat dalin si në normën e sotme, por megjithatë, në PM ndeshëm violccë (780) dhe palloit në vend pallojit, ndërsa në KK zjente, ciapi, ziarr në vend *ziente*, *cjapi*, *zjarr*.

- Edhe i-ja ngadonjëherë ndodh të reduktohet në Ë, si :

shëkoj, qëroj, arqëruar etj., por që në veprën e tretë PM del edhe si i p.sh. shikoj 138 e shiqoj (geg.), pastaj diftoj që në veprat tjera del më Ë si dëftesë, shëkoj etj. Ndeshim edhe palatalizmin e Ë-së në I: dishprim (RD 139, 146), por e ndeshim edhe dëshpërim 218, xhixhillon dhe te ËL xixillon (xixëllon) 40, pastaj te PM qindresë 36. Që nga vepra e dytë, ËL, ndeshim trajtën *sicili* 88, PM 126, sicilit (KK) 63, 126.

- Edhe pse kemi të bëjmë me rimim bie në sy një krahinarizëm i vrazhdë kur vetori ti shkruhet TY, d.m.th. shkruhet Y për I: P.sh. RD 205 te ty, ËL te ty 22 dhe PM tek ty 148. Ky korçarizëm përdoret edhe nga Th. Mitko .

**Shënim.**- Fjalët ndërkombëtare me origjinë greke përgjithësisht Asdreni i shënon me y e jo me i: Rythmi 111, mystik 16, mythik 16, Nymfë 16, symbol e ndonjë tjetër.

### c) U-ja

- Lidhur me U-në që ka prirje të reduktohet në Ë në disa të folme, konstatojmë se kjo dukuri reflektohet kështu edhe në veprën e Asdrenit, megjithëse është mjaft e qëndrueshme te fjalët, si:

luftoj, luftim etj., mirepo ka raste me alternim si te fjalët: shëmbëll e tingëll, por edhe: *tingull, tingllit, tinglloj* edhe *tingullor*.

- Tek Asdreni ndeshim asimilimin në distancë, si:

murmuris, mumuris, fluturisht, mirëpo te RD kemi *lumtësi* që del trajtë mbizotëruese ndaj *lumëri* etj.

- Ndeshim raste kur U-ja përdoret në vend të Ë-së apo të zanores së eliduar, si:

RD: djelmuri, lavduron dhe te PM djelmuria. Është i njohur palatalizmi i U-së në Y, për shkak të tingujve palatalë. ky fenomen del në nja dy fjalë (korçarizma) që tingëllon në mënyrë jo të zakonshme për gjuhën e sotme letrare: flytyr-a dhe gjyrmë-a P.sh. RD flytyruar 23, 163, 191, si folje pastaj si emër: flytyrat 102, 168 dhe flytyrëza /bukuroshe/219. Por tek ËL del edhe fluturo, ashtu si edhe te PM fluturat 9, por ende tek EL mbetet trajta gjyrma 43, 141, 48, 89, 172, pastaj edhe folja gjyrmojnë 66, 67, mirëpo ndeshim edhe gjurmë po në këtë vepër. Edhe te PM kemi të dy trajtat: gjyrmë 33, 81, 83 dhe gjyrmon 82, por edhe gjurma 133, 29, si dhe flytyrova 73. Te KK vlen të konstatohet se ka raste që dalin si në normën e sotme.

- Po konstatojmë se si emri ashtu edhe mbiemri participor:

i dëftuar (i dëftueshëm) shkruhet me YE: RD i padëftyer 157, i dëftyer EL 45, PM i padëftyer 110, PM, për të dëftyer 99. Hasim raste kur U-ja ka kaluar në O: p.sh. vollkan 104, 166, por që te PM del vullkan 26, 181; ruzollim 135, 136 dhe te KK rruzollim po edhe rruzullim 83, ashtu siç është në normën e sotme. Këtu mbizotëron fjalë-rrënja rruzë-a. Norma e sotme: rruazë, por rruzullim.

- Pos shembujve të pikës së mëparshme ndeshim raste kur O-ja reduktohet në U në këto dy fjalë ndërkombëtare: ËL methudhë (për metodë) dhe avuketër (për avokatë) KK 53.

Edhe te Hilë Mosi ndeshëm rruzullim 22 (III).

### d) E-ja

E--ja e reduktuar në shqiptim që pothuajse nuk dallohet nga Ë-ja paraqet problem



drejtshkrimor edhe në ortografinë e Asdrenit. Mund të thuhet se në pozicion para bashkëtingëlloreve hundore E-ja ruhet në të shkruar, si:

*vend, zemër, ergjent, kuvent, ment, kend etj.*, por nuk mungojnë rastet madje në të gjitha veprat vëhet Ë-ja në vend të E-së, mirëpo rastet me E vende-vende mbizotërojnë.

- Fjala argjend përdoret nga Asdreni në të gjitha veprat me E në ballë të fjalës ergjend, por vetëm në KK del si në normë: t'argjendta 16, 117.
- Ndeshim raste kur E-ja përdoret në vend të Ë-së si p.sh.  
KK ligjerata 37, dhe në disa shëmbuj të tjerë, ku ndoshta do të ketë ndikuar drejtshkrimi i Komisionit Letrare të Shkodrës<sup>5</sup>), e cila toleronte një shkrim të tillë, ose nuk ishte i qortueshëm zëvendësimi i këtyre shkronjave në gjuhën e shkrimit.
- Edhe disa raste të tjera, te RD: *dekes, qendron, ne* për në;  
ËL: *reza, fare, çdefrenj, rembe, me* për më; PM: *agjeron, sheron, se* për së, te për të, të pelcase, lozesh, pastaj nje, KK: *kashte, thellim, rrugen, shkelqen, permente* etj.

**Shënim:** Siç dihet Asdreni respekton rregullën e propozuar prej tij se të gjitha A-të hundore të gegnishtes në toskërishte do të shënohen me Ë- të theksuar (me theksin hundor), por me që theksi hundor paraqitet me vështirë *teknike* në të shënuar, madje në normën e sotme asnjë theks nuk shënohet fare, atëherë rastet e tilla në ri/botime janë korrigjuar sipas rregullit në Ë të theksuar, kuptohet pa shënim theksi, por mund të ketë mbetur edhe ndonjë trajtë me -E. (Shih edhe te PM f. 340 (II))

#### **dh) Zanorja Ë**

-Zanorja –Ë si tingull i reduktuar e që edhe në toskërishte filloi të mos shqiptohet në disa raste në dy shekujt e fundit nuk shënohet në shumë pozicione edhe nga Asdreni. Megjithatë, këtu po cekim, pa koment, vetën dy ekstremet:

e para, shënohet në fjalët që ishte veçori e ortografisë së vjetër, por vetëm në disa raste të vetmuara: p.sh. RD m'bukurë 205, të ftohëtë 89, të ngrohëtë 134 dhe krahunë 89 (por krahun 204), pastaj për rimim: ç'thonë/zakonë 91. Ndërkaq të vihet re se që në veprën tjetër heq dorë nga një ortografi e tillë dhe kjo vërtetohet edhe në artikullin *Vërejtje mbi –Ë*, botuar më 1930;

e dyta, si ekstremi tjetër konstatohet fakti sikur kjo zanore nuk e shënohet fare, edhe pse në normën e sotme kërkohet, si: *lirin/trimërin, të msoni* etj. PM qytetrim etj. Një ortografi e tillë me luhajtje e ndeshim edhe te Hilë Mosi, Risto Siliqi e të tjerë, sidomos në shkrimet e gegëve, madje edhe në ortografitë e Prishtinës.

Po e përmendim edhe ratsin ËL qërtimë (për qortimë).

Siç mund të shihet nga shëmbujt e mësipërm lëshimet drejtshkrimore a luhajtjet nuk janë aq me peshë, sot për sot, kur të merrret për bazë tërësia e shkrimit të Asdrenit, andaj tiparet themelore të drejtshkrimit të tij prireshin drejt drejtshkrimit që u normëzua më vonë, në gjuhën e sotme letrare shqipe.

## **B. DYZANORET**

Diftongjet që në të folme të gjuhës shqipe paraqesin variacione të ndryshme në veprën e

Asdrenit dalin të plota me ndonjë ndryshim. Së këtejmi, lidhur me këtë arritëm në këto konstatime:

a) Dyzanoreshi IE (\*Ij/\*Ej)

Ky dyzanoresh shënohet dyformësh IE dhe JE: P.sh. djelli, qjelli si dhe qielli, dielli, rieth etj., mirëpo mbizotëron trajta JE në veprat e para.

b) Dyzanoreshi gegë UE/U, tosk UA (\*On)

Dyzanorëshi UE, nga Asdreni, në vjershat e shkruara gegërisht, herë shkruhet i plotë UE e herë U, ndërsa dyzanorëshi UA shkruhet rregullisht, madje ka prirje që dyzanorshi i fjalës përkatëse më **ue** (gegnisht) ose **ua** (toskërisht) të kalojë në O, si të foljet ashtu edhe tek emrat foljorë, P.sh.RD; lonin vajtje ËL 67, 68, vajtur/rojtur 84, rojtur/shojtur, shkrojtur 31, PM të thosh 21, gjojtur 28, lot, los/farros.

c) Dyzanorshi YE (\*Yn / \*E-n) që në të folme shqipe reflektohet here i plotë here i reduktuar, qoftë në Y ose –E, ashtu del edhe në shkrimet e Asdrenit. Krahaso emrin krye /krej edhe folja \*krej **kreni** që Asdreni e përdor mjaft dendur. Së këtejmi, folja *krej kren* presim ta trajtojnë specialistët, megjithatë, mendoj se kjo trajtë ka mbështetje të folja kryej (me krye), përkatësisht emri krye, Krahaso edhe foljen me krenue, emrat: krenar-i, krenari-a, krentë (e fiseve) etj.

ç) Në veprën e Asdrenit ndeshet jo në shumë raste fenomeni i shkrimit të Ë-së pranë zanores së gjatë I, U, Y, të diftongut: IË, UË, YË, në vend të dyzanoreshit të plotë përkatës IE, UE. YE, si në poezi edhe në prozë, si:

RD qetësië/bukurië 173; ËL hyjnyëshme 53, të shkëlqyëshme 42, asht dërguë 53, KK bukuriës 95, pastaj liriës etj. Një ortografi e tillë ndeshet edhe te Hilë Mosi, A.Xhuvani e të tjerë.

## C. KËMBIME KONSONANTESH

Këtu do të përmendim vetëm disa këmbime konsonantesh që bien në sy më tepër në veprën e Asdrenit, por që nuk janë, në të vërtetë, vetëm veçori të *drejshkrimit* të tij.

### 1. C/S, C/X, C/Ç

-Në disa fjalë kemi fenomenin e përdorimit të C-së për S:

RD amëlcue, cmironte 192, kurçyer 192, 204 dhe te ËL cmirë 93, ckuqi 74, 103, PM cmirit 73. Në KK, nuk kemi vërejtur raste të tilla.

-Pastaj këmbimin e C-së me X:

te RD kapërxen 234, 225, KK kapëxente 90 II dhe të C-së me Ç (norma S): te ËL çmirit 145, 173.

### 2. G/K, G/GJ

- G-ja e fillimit që në disa të folme korçare shurdhohet në K, është prezente dhe në veprën e Asdrenit, si:

RD kuxojnë 238, ËL kuximtare 117, PM kuxim 35, 107, dhe KK 11, 17, 55, trunk,

- G-ja kalon në GJ te fjala gisht p.sh. RD gjisht 214 dhe ËL 120, por këto raste mbeten të vetmuara.

- Po përmendim shfaqjen kur K-ja kalon në korresponduesen e zëshme G (lidhur me pikën 2.) si:

te fjala flakë-a: ËL: flagë 63, 100, 119, por e ndeshim edhe flakë 79, pastaj fjala hargu 120. Te PM dalin të dy trajtat me K dhe me G, shumësi *hargje* edhe te KK: lagë, hargu. Një fenomen të tillë e hasim edhe te Noli e të tjerë.

### 3. H/zero

H-ja që në mjaft të folme të toskërishtes ose në të folmet e disa qyteteve të Jugut, madje edhe të Veriut, nuk dëgjohet, sidomos në pozicione intervokalike dhe fundore, kështuz po kjo nuk del e qëndrueshme as në shkrimet e Asdrenit.

Në të vërtetë, tek Asdreni janë prezente dy deri katër ekstreme, si:

*e para*, H-ja është eliduar, si: RD mfshenin,, ngrove; PM argje 19, Istorinë, ËL 71, thyet/kryet PM 35;

*e dyta*, H-ja shtohet në disa raste kur norma nuk e pranon, si: RD: qeh 153, reht 159, rehtë 179, EL: ta harrijë 137, rehtë pastaj harrushe 183, 83, KK: hoborit 9, 102, shtrihur 125, PM 19, por edhe rastet e lejueshme hyll, Hyjëlidëse 30, hyjësije 15 ose shënohet për hir të rimës, si ËL ‘ohin/njohin 126 dhe KK 168;

*e treta*, përmendim rastet kur nuk elidohet edhe pse e kërkon rima, gjë që na jep për të konstatuar se Asdreni vetë nuk e ndjente qartë këtë tingull në shqiptim, sepse siç shohin nga shembujt rima do të pëlqente edhe më mirë pa shënimin (shqiptimin!) e këtij tingulli, si:

RD: 112, , e ndjen/ e nxehn 206, 208, ngrohn/kërkon 222, ngrehu/Atdheu 109, vërtetë/nxehtë etj. Tek EL: mprehtë/e qetë 33, përpjetë/ rehtë 65, tha/krah 77, s'njeh/atje 93, msheh/s'ke/re 97, ne/ngreh 128, rrufe/sheh 133,etj. PM: fre/njeh, re/mpreh 11, ritur/shtrihur 19, je/njeh 51, shëro/njoh 81, ngrohn/drejton 138, krah/tra 151, mprehta/jeta 160 etj.

Ky fenomen është prezent edhe në KK edhe pse rastet janë më të rralla: të mprehtë/jetë 31, ndritur/shtrihur, por edhe ç'ka/gjah , t'shoh/shiko le/sheh 222,152 etj.

### 4. LL/L

Edhe te Asdreni si në disa të folme, LL-ja shqiptohet L dhe anasjelltas, ky fenomen është i pranishëm edhe në veprën e Asdrenit, si:

- te disa fjalë, emra e terme të huaj:

Pllaton, Helladhë etj, pastaj, mellakonllie, mellodi, fillozofi, stallaktite, dukuri që shkon prej veprës në vepër;

-edhe te disa fjalë të tjera, si:

ËL filluska 146, PM diplomati, kapellës, 32, llahuta 60 si dhe rasti i foljes dal: RD dualtë 141, Ël dolli 162, 173 dhe PM fillozofër, parlament, dolli 125, 141; etj.

- po përmendim ndonjë shembull, kur në vend të LL-së shënohet L:

RD, engjel, EL: shembël, vulkani, PM ishul 34.

Një dukuri të tillë e ndeshim edhe te Çajupi, sidomos.

### 5. RR/R

Përgjithësisht te toskërishtja e qyteteve karakterizohet prirja që tingullin RR të shqipton R. Dhe një dukuri të tillë e ndeshim edhe në veprën e Asdrenit, mirëpo kemi raste të kundërta kur

përdoret jashtë normës RR-ja, si b.f. *burrimi*. Shembuj të tillë luhatjesh ndeshim:

Së pari, në veprën e tij të parë RD rastet: *reze, zjari, ndë zjart*, pastaj: *të rojë, erësirë, erësi, rembat, thëret, marësira, nuk ri, rebtësi* etj, gjë që përsëritet edhe në veprën tjetër ËL mirëpo këtu kemi raste luhatjeje, **r/rr**, për të njëjtën fjalë p.sh. erësirë 49, 45, 58, 68 edhe errësirë 122 dhe *ndë errësi* 56, zjarr, reze e rreze, rotull e rrotull, mirëpo del e përdorur drejt te disa fjalë, si: tmerr, ferr, çjerr, tjerr etj. Edhe në PM këmi përdorimin e R-së për RR, si rethuar 97, rezonte, reshqitnin 133, arijnë, rafsh, ndërsa në fjalë të tjera e përdor RR-në, si.: rrushkat 17, ëndërronj etj. Ndërkaq në veprën KK shihet njëfarë stabilizimi që priret kah norma e sotme, si p.sh. rreze 7, n'errësirë 7, të errët 22, rrezike 17, rrjedhjes 18, urrejtje 22, të merrtë 31, shkatrrimtare 84 etj.

Së dyti, ndeshim raste, kur përdoret shumësi me një sinkopë, r+r –RR, si p.sh.: ËL rruferra 166, RD gjërra 190, ËL 35, PM zërrash 122, zërrat 144, Ël barra (barëra).-171; Pastaj nga prapavënia si përreth (për rreth) 85 etj.

Së treti, kemi raste kur shënohet RR-ja në vend të R-së, dukuri kjo që është e pranishme edhe te Naimi, Noli etj.: ËL: arrij, arrinj 188 (për ari-u/arij/të), mburronjë dhe te PM; burrimi 113, KK: gyrrin, t'u thurrim, 11, vrrul 11, bora s'rreshte, terror, rra në dorë 22, rra të flerë 125, qeverritje 59, vërrur, vërrejtje etj.

## 6. S/Z/X

Fjalët që në gjuhën e sotme letrare shënohen me korresponduesen e zëshme Z, në veprën e Asdrenit del me S, si:

RD: lëvis 10, lëvisni 10, por lëvizin 179, me gast'e tu 105, shpesët 180;EL: njerës 172, sbardhëllon 87; PM: shpesë 182, leviste 102, sgjohet 129 PM marrësi (116 II),, mirëpo del edhe me shkronjën Z, si: lozin 129. Kjo dukuri e përdorimit të S-së është e pranishme në veprën e fundit KK: risbukurimi 112, sgërbonjë 113, sborth 19, smadhoje 20, 65, dhe fjalët Asije 106, museum, por muzera 53.

Në vend të tingullit Z, në veprën Asdreni ndodh me dalë X, në ndonjë rast, si:

RD xvar 88. Po kjo X ndodh të përdoret në vend të C-së te shembulli kapërxen RD; KK kucofshi për gucofshi, pastaj XH për X xhixhillon për xixllon.

Dukuri të tilla më tepër ndeshim në veprën e tij të parë RD.

## 7. SH/S/ZH

Në vend të S-së në disa fjalë Asdreni shënon Sh-në si:

ËL shtatoj 74, PM shprovojë, shtatujë 25, madje shkëterrë, RD 178 (por edhe shkëterrë 49, tek ËL skëterra, PM sketërë 61), EL Fatosh 37, 162 (dhe te PM fatosat 13).

Ka raste ndërkëmbimi edhe sh/zh si:

PM shduket 182 (II), u shduk 10 (II). Pastaj folja shprovoj që tash në normë është sprovoj, ashtu edhe emri fatosh e fatos.

Fatos edhe fatosh dalin edhe te H.Mosi e Risto Siliqi.

## 8. Ç/SH

-Alternim i Sh-së në Ç, dukuri kjo jo vetëm në prapashtesa është prezent edhe në veprën e Asdrenit, si:

RD të çkëlqyera 5, çquan 35, EL puço, çpuar 162, çkëputet 162, çkoqnë 182, çporni 28, 28, çkëlqime etj., mirëpo në këtë vepër ndeshim edhe trajta me SH, si në normën e sotme: shkëlqim 95, 159, 160, i shkëlqyer 74, 160, pastaj si folje shkëlqejnë 117 dhe kjo fjalë vazhdon me SH-në nistore dhe te PM: shkëlqen 15 dhe shkëlqim 71. Megjithatë edhe te PM dalin fjalët me Ç nistore, si : çkulim, çpallim (por edhe shpall 155), pastaj çqep 94, çkëputa 139, 138 etj.

-Mund të përmendim fjalët neologjizma:

e shgjeshur, shndërryer, çrudhoret si dhe drejtshkrimin e fjalës shfaq, e cila te RD del tfaq 211 (sikurse te Naimi e Fishta), por në veprën ËL del me Ç: çfaqet 79, 149 dhe te PM çfaqet 15, por edhe tfaqet 77, 129.

**Shënim.**- Asdreni lidhur me këtë nuk ka kriter të qartë, prandaj shkëmben tingujt Ç/SH/ZH kjo shihet dhe nga këta shëmbuj: ËL çdukësia 118, PM shdukej 79, shduken 152 152, e shdukur 110, shdukesh 131. Dhe te KK çrudhoret 88, por shpërridhet 19, u shduk 58, shduket 68, 113, shdukur 34, shdukje 83, por dhe zhdukur 115.

#### 9. TH/F/T:

KK throne 193, për fron a frone, në të njëjtën vepër: 7, 21, KK bibliotekë 102 II.

#### 10. B/P:

Këtu e kemi fjalën jo për ndërkëmbimin e furndores së fjalës përkatëse, por për shpërndërrimin e tyre brenda fjalës përkatëse, si:

PM: dhemp, dhempshuruar, mprojë, pshtillet, mpronjëtor, pastaj shbërthente. KK balaço (palaço).

Ndeshim edhe raste të tjera të veçuara kur një shkronjë konsonante a vokale që në veprën e Asdrenit shënohet ndryshe nga norma e sotme, por ne po mjaftohemi me shembujt që sollëm më sipër.

### C. GRUPET KONSONANTIKE DHE SHURDHIMI I BASHKËTINGËLLOREVE TË ZËSHME

#### 1. Veçori e përgjithshme

Dihet se dialekti i jugut karakterizohet me shurdhimin e konsonanteve të zëshme në pozicion fundor. Ky fenomen është i përhapur pjesërisht (në raste) edhe në ndonjë të folme të veriut. Kjo dukuri vërehet edhe te vepra e K.Kristoforidhi, e Sami e Naim Frashërit e të tjerë dhe po këtë rrugë të shurdhimit e ndjek në drejtshkrimin e tij edhe Asdreni, madje këtë e bën edhe në shkrimet gegërisht. Mirëpo, në veprat e fundit, aty-këtu ndeshim raste të mosshurdhimit të këtyre bashkëtingëlloreve. Sidoqoftë, këtë dukuri të shurdhimit po e ilustruam më ndonjë shembull, si:

RD: mblith, breth, mbleth etj.; ËL i math, vent/tent, funt/katunt, njerës, shkëmp, vith etj.; PM përmbledh, djek, munt etj.; KK: mentsh, sbarth etj.

Megjithatë edhe raste të veçanta të mosshurdhimit vërehen që në veprën e parë, si:

RD: qind 87, por mbetet rast i vetmuar dhe pastaj mosshurdhimi paraqitet te PM: vend/kuvend 38, mund 55 e pafundme 89, fund/kurrkund 89, gjësend 114, send 114, 180, 185, gazmend 150, dhe tënd/sënd 139. Madje në veprën KK kemi një raport në të mirë të dukurisë së mosshurdhimit, si: ndez 18, rrebta 21, kënd 21, vend 23, 115, 82, vend/kuvend 25, gjësende 35, fund 126, 129, asgjëkund 129, pafund/gjëkund 24, ergjend etj.

## 2. Asimilimi dhe reflektimi i grupeve konsonantike

Siç e pamë në ndonjë shembull më sipër ndeshim raste të shurdhimit të shkronjës së dytë të grupit konsonantik, mirëpo ne më poshtë me sqarime, për ilustrim po shënojmë edhe ndonjë shembull,

- 1) Alternimet historike si palatalizmi etj. nuk u trajtuan.
- 2) Grupi SHT që në stilin e bisedimit te disa të folme toske kalon në SH, reflektohet dhe te Asdreni: RD tashi (tashti) 209, 139, 193 dhe tek ËL tashi.
- 3) Grupi TSH që në stilin bisedor shkrihet në Ç e që disa kalime tashmë janë pranuar dhe në gjuhë e normuar te Asdreni është i pranishëm:  
RD vjetësh (vjeç) 22, por ndenjçi 126, pastaj te ËL mos patëshin (paçim) 172, PM rënc 69, KK mijvjetshare 5, 18, vjetësh 111, 112, 113, por të veçëm 36.
- 4) Po përmendim kalimthi edhe fjalën shbërthen 89, ku në vend të SHP është shënuar grupi konsonantik SHB.
- 5) Grupi ND, MB asimilohet por jo në të gjitha rastet. Po shënoj vetëm disa shëmbuj të asimilimit:  
RD: nonjë 207 (për *ndonjë*), ËL nër (*ndër*), 124, 101, 160 PM: mi (*mbi*), 34, 34, 64, 112 nër (*ndër*) 37, 144 dhe te KK mi (*mbi*) 115, 117, 119.
- 6) Grupi NT që në gjuhën gjuhën e bisedimit asimilohet në të zëshmen ND reflektohet edhe në veprën e Asdrenit, p.sh.:  
PM mendarë, fandastike 141 150 dhe diamande 141 e që të dy fjalët e para përsëriten edhe te KK: mendarë 21 dhe fandastike 26.

## (II). RRETH DISA VEÇORIVE MORFOLOGJIKE

Pasqyrë edhe më e qartë e ortografisë së Asdrenit fitohet kur merren në vështrim edhe disa nga veçoritë morfologjike që i hetuam në veprën e tij dhe po i paraqitim më poshtë. Në të vërtetë, në këtë nënkapitull janë trajtuar vetëm disa çështje të drejtshkrimit e të përdorimit të trajtave të disa fjalëve të sistemit eptimor (emra a folje kryesisht) që janë më karakteristike për gjuhën e Asdrenit.

### (1) EMRI

#### 1. Gjinia

Në veprat e Asdrenit ndeshim luhatje në të tri gjinitë e emrit

##### a) Gjinia asnjane

Dihet se kategoria e gjinisë asnjane të emrit joparanyjësor në gjuhën e sotme shqipe thuhet se ka karakter mbeturinor të theksuar. Emrat asnjane të paparanyjësuar, të cilët ende janë ruajtur edhe sot, në disa vise më shunë e në disa më pak në të dyja koinetë, në kohën e Asdrenit mbase ndiheshin më shumë se sot, andaj në veprën e tij na dalin të tillët që tregojnë lëndë si *leshhtë, rushtë, ballë* etj., por ndonjëri prej tyre në veprën e Asdrenit, del në gjininë femërore që është veçori e të folmes së Korçës. Dihet se emrat e kësaj gjinie në gjuhën e sotme letrare më së shumti kanë kaluar në gjininë mashkullore.

##### b) Gjinia mashkullore

Gjithashtu te KK ndeshim ballët 10 (por ballit 17).

Edhe te Hilë Mosi e të tjerë ndeshim raste të tilla.

##### c) Gjinia femërore

Ashtu e kemi edhe në veprën e Asdrenit, po siç thamë e ndeshim në disa raste si në të folmen e Korçës. P.sh. RD dylla, uja 159, ujën 241, por te ËL kemi uji 114. Po aty ndeshim dylla si dhe RD djellë 133, 151, ËL djellë 27, 73, PM 155, KK 87, por shikuar në tërësi mbizotëron trajta dielli, përkatësisht djelli në gjininë mashkullore. Kjo vlen edhe për fjalën qielli (qjelli), por e kemi një rast në gjininë femërore te RD qiella 146: EL lajmë leshkat !!155, lajmes (PM) 131, atdheja 164, 19, edhe te KK 11

Luhatje apo mospërputhje me normën e sotme hetohen edhe në disa fjalë tjera sa i përket gjinisë gramatikore.

#### 2. Shumësi dhe shquarsia e emrave

Dihet se luhatjet në drejtshkrimin e shumësit të emrave janë shkak i shumëllojshmërisë së mjeteve për shumësim si dhe për shkak të mungesës së një kufiri të qartë midis temave, shkaktuar edhe nga ndërveprimi i dialekteve në procesin e kristalizimit të gjuhës letrare. Kjo është arsyeja që krahas normës zotëruese janë paraqitur edhe raste dubletash edhe në veprën e Asdrenit.

Në të vërtetë, këtu po i shënojmë vetëm disa shembuj me ortografi problemore, duke u ndalur në tri mbaresat më kryesore të shumësit të emrave të dy gjinive.

**a) Shumësi me mbaresën –A**

**1) Gjinia mashkullore:** RD: shata, tempulla, luana 88, por tek ËL del luanë, djema, por që tek ËL kemi djemtë 32, PM djem si dhe te KK.. Po te KK del uja 159 (për ujra); tek ËL: shumësi bën pyllat 53 dhe pyllet 110, shekullat 55, ndërkaq te KK del shekuj 19 etj.; te KK, kapsollat, rrashtat, qenat 47, ndërsa tek ËL ishte qentë, bulevarda 55, pensiona 54,

**2) Gjinia femërore:** RD, plagat, rrugat, gjëllat, valat, pushkat 88 dhe te ËL 51, por më nuk del në këtë trajtë. Ndeshim një rast emrin *shata* 91 dhe asnjëherë tjetër, pastaj shpesat 133 (por edhe shpesët si dhe te EL 177, rugat e rrugat 177 dhe tek ËL djersat 27, PM dërsa t41, djersa-t 84, gjurmat 71, shekullat, leshkat 155. bjeshkat 19, 145:valat, botat,, kokallat, dallgat, stinat, buzat 82,. KK: bjeshkat, jargat, palat, dallgat, valat, stinat, robot 24, skelat 56, zyrrat 53. ministrijat 54.

**b) Shumësi me mbaresën -E**

Me këtë mbaresë dalin këta emra në shumës që nuk perkojnë me normën e sotme letrare:

**1) Gjinia mashkullore:** RD lotet si dhe në veprat tjera: EL 47, 106, 149, PM 7, 54, 59, 112, flamuret 127, EL 71, 55, PM 161. ËL qarket, vjetet dhe te PM vjetsh 7, kandile 23, 110, 119, shqëlme 51, riete 121, shpirtet 27, 93, pastaj floke (të bardha) 82, he(j)te, PM qarke, djepet 47, kandile 35, 46, 133, 135 dhe te KK gardhet, pyllet.

**2) Gjinia femërore:** netet 36 PM nete 42, 50, PM: vëthe 24.

Këtu mund të jetë përvjedhur ndonjë trajtë e rasës vendore.

**c) Shumësi me mbaresën -Ë**

**1) Gjinia mashkullore:** RD bilbilët (tek ËL bilbilat 93), tronafilët, korbët (edhe tek ËL 77) mikrobët

**2) Gjinia femërore:** majët, por maja-t edhe majet (edhe te PM majët) pastaj kurorët, shpellët dhe në PM *në arët* për edhe *në arat*, si në normën e sotme.

**Shënim:** Në bazë të një hulumtimi që kemi bërë shumësi i emrave me këto tri mbaresë të thjeshta mund të thjeshtohet, duke u mbështetur edhe në prirjen si më poshtë që spontanisht del edhe te shembujt e Asdrenit, kështu:

1. Shumësi i emrave mashkullore që tregojnë frymorë me marrë një-mbaresën Ë, si p.sh. si *luanët* edhe *bilbilët, korbët, mikrobët*;
2. Shumësi i emrave mashkullore e femërorë që tregojnë gjë-sende konkrete me marrë një-mbaresën –A, si p.sh. gjinia mashkullore: **djepat, trëndafilat, kandilat, ligjat** etj, madje edhe ata të gjinsë femërore: **pushkat, stinat, skelat, valat, dallgat, bjeshkat, gjurmat**, edhe pse sipas normës së sotme mund të jenë të rekomandueshëm shumësi i tyre me mbaresën tjetër Ë ose E dhe
3. Mbaresë –E të jetë e rezervuar për shumësin e të gjithë emrave femërore që në njesin e pashquar marrin fundoren –E si dhe për emrat mashkullore që tregojnë nocione abstrakte ose në raste edhe emërvende, si: mendime, bulevarde, hotele etj.



Gjithsesi normëvënësit e sotëm duhet të kenë parasysh prirjen e tillë e cila paraqitet mjaft transparente si zgjidhje e mundshme dhe gjithsesi më e lehtë për mba mbamendje sesa zgjidhjet e rekomanduara në shqipen e sotme letrare.

#### **ç) Shumësi më -O**

Në veprat e tij të fundit për të parën herë del shumësi me -O si p.sh. teatro 55, verando 56. që për mendimin tone më mire është që shumësin ta bëjnë me njërën nga mbaresat e thjeshta të shqipes sipas nënfushës semantike që mbulojnë. teatra, veranda

#### **d) Shumësi me -ËR**

Në grup emrash kryesisht frymorë që në të folmen e Korçës bëjnë shumësin me -ËR e që në gjuhën e sotme letrare kanë hyrë me ngarkesë stilistike a figurative, trajta që i ndeshim të përdorura edhe nga Asdreni, si:

*ujqër, ujqer 41 (ËL), të zotrit, robër, grekrit, gjyshrit, atërve etj., si dhe ashketër, shenjtër, deshër, kryezotër, fillozofër etj., që për mendimin tone lypset rishikuar.*

#### **dh) Shumësi me -RA**

Edhe tipi i emrave të gjinisë femërore që e bëjnë shumësin me mbaresën -RA e përdoren rëndom me një ngarkesë stilistike , por edhe me ngarkesë neutrale ndeshet në gjuhën e Asdrenit, si:

RD: bimrat 102, punra 177, punëra 179, 175, 194, 195. EL: rufëra 164, PM majrave 126, stolira 161, 67, kohërat 83, 11, çudira 45. KK: akademira, bukurira, frymra, fletra, sostira etj.

Kështu e bëjnë shumësinë edhe disa emra asnjans që tregojnë lloje të një lënde e që tash në gjuhën e sotme letrare dalin më fort në gjininë mashkullore si: ujrata, fshatrat, drithrat si dhe fjala detrat. Po përmendim edhe fjalën *të qarët* EL etj., ku kjo formë e asnjansit shndërrohet në kuptimin e shfaqjes konkrete të veprimit. Edhe kjo formë shumësi lypset rishikuar.

#### **e) Shumësi me mbaresën -NJ**

Lidhur me këtë mbetet për të konstatuar se drejtshkrimi i Asdrenit përkon me rregullat e gjuhës së sotme letrare, d.m.th. emrat që mbarojnë me një zanore të theksuar në njëjës, në shumë marrin mbaresën -NJ. Mirëpo janë nja dy raste që nuk përkojnë me normën: Tek ËL është një rast *arrij* (për arinj), dhe te PM Perëndinjtë 18 (që duhet perënditë). Edhe kjo mënyrë e shumësit ka mundësi thjeshtëzimi, duke marrë mbaresë zero ose vetëm mbaresën -J.

### **3. KONSTATIME LIDHUR ME RASAT**

Këtu kemi përfshirë vetëm disa shembuj nga teksti i veprave të Asdrenit që nuk përkojnë me normën e sotme dhe që tani konsiderohen si shembuj të vetmuar, edhe pse ndonjëri mund të ketë përhapje relative edhe aktualisht.

#### **a) Emërorja**

- Shkrimi i J-së ndërzanore te format e emrave me -I të theksuar si bagëtija, ministrija,

bukurija, mendesija- norma e sotme nuk e qas.

-Ndeshim nja tri raste, kur në emërore marrin një E të theksuar në trajtën e shquar:

P.sh.: RD: dallëndysheja 168, manushaqeja 219 dhe tek ËL lulekuqeja që në normën e sotme kjo E fundore me rastin e shquarsisë elidohet: dallëndyshe dallëndyshja e kështu me radhë. Raste të tilla ndeshim edhe te Naimi e autorë të tjerë jugorë.

- Po ashtu (si te Naimi) është një rast kur emri i gjinisë mashkullore qiri-u, merr mbaresë-shtesën -RI për analogji si te fjala (emri) mulli-ri. P.sh. PM qirir-i 173, ËL 445 (sipas autogramit nga Vepra, Tr. 1976).

Edhe në artikull kushtuar Naimit Asdreni shkruan: "u tret si qiriri" KK 19, që do të thotë se këtë emër e përdor në këtë trajtë nën ndikimin e shkrimit të Naimit. Me këtë cilësi e ndeshim edhe te Lasgushi, e sidomos te Enver Gjergjeku.

## b) Gjinatorja

Gjinatorja e shqipes karakterizohet me nyjën e përparme, mirëpo kjo nyjë në veprën e Asdrenit nuk është e qëndrueshme gjithmonë. Ndeshim jo pak raste të tilla në të gjitha veprat e tij, që në kllapa po e shënojmë nyjën që mungom, si:

RD: Krijetarit (*të*) gjithësisë 134, Ti je engëll (*i*) jetës sime 213. ËL: Magji e prallës (*së*) patreguar 141. PM: Për trollin (*e*) shenjt ku kemi le 13, I çdo dëshirës (*së*) gjallë 19, prej gazit (*të*) madh që ndjeva paduruar 16, Shpres i japin (*të*) zezës rrojtje 113 etj., KK: Faqet (*e*) verdha.faqet (*e*) bardha 91, Për t'i treguar botës pushtetin (*e*) plot' qi e kanë 63, Ndjej qysh rryma (*e*) gjakut prëndverak 133.

-Mund të përmendim një këmbim të gjinorës me rrjedhoren a anasjelltas, ku mund të shihet qartë se në atë fjali, respektivisht para emrit mund të vëhet nyja apo parafjala gjegjëse e rrjedhores, p.sh.:

PM: Qytet kujtimesh (*të*) shekujve të shkuar 25; KK: Druesh doresh mizorije etj.

Shihet gjithashtu edhe një prirje që mos të shënohet nyja e thjeshtë para nyjës përcaktuese numërore apo si pjesëzës prkatëse: P.sh.

PM: Sa kini përkujdesjet e një kreshniku 8, Mos mbetet gjurmës këmbës njëj barbari 13, Kujtimet të tmertë njëj qyqare 53. KK: Shtet në det me vrushkuj (*të*) njëj vullkani 19, Ay që zë vendin njëj shenjtorit 28, këtu po kalben eshtrat e njëj tradhëtorit 28, Sheh jeta si mvaret në majet njëj shpate 30, Të shëmben themelet njëj bote së zezë 117 etj.

-Nga shembujt e mëparshëm dhe të tjerë mund të vërejmë se nyja e prapme apo mbaresa rasore ndikon që të mos përsëritet nyja rasore si p.sh.

PM: këmbës (*së*) njëj barbarit 13, dëshirës (*së*) gjallë 19, mallit (*të*) tij 41. Zbrita pa lavdi prej fronit (*të*) naltë tim 62... KK: Të drodha para syvet mij 139 dhe Se syvet mij ti... 169 etj.

## c) Kallëzorja

-Asdreni përdor trajtën e kallëzores së shquar njëjës të gjinisë mashkullore sipas tipit të vjetër duke i ngjitur temës mbarësën -N(Ë). P.sh.:

RD: atdhenë 88, 89, 142 etj.; ËL 22, 26, 45 etj. Skëndërbenë RD 92, 96, madje plaknë 193, ushëtimn' 108; përendimn' 108. ËL: mbretn' 20, shpëtimnë tuaj 129, lavdimn' 15, gjakn' 50, edhe te KK: me gjakn' e saj 11., PM: zen' (për zërin), pastaj Egjyptiën, Arabien, Libien 55...

- Mirëpo krahas këtyre trajtave kemi edhe trajtat si në drejtshkrimin e sotëm, madje kjo dukuri ndeshet në të gjitha veprat, si p.sh.:

pallën RD 91, kordhën 91, Ël armikun/gjakun 55, me flamurin 49, qëllimin 21, afshin, varrin .

-Po përmendim edhe trajtën e pashquar të këtyre emrave në rasën kallëzore, përkatësisht të emërores së pashquar, pra të tipit përkatës, si vijon:

ËL: ndë zemrë 31, veprë 63 (por edhe vepër 68); PM: Letrë 23, motrë 45, zemrë 59, 60, 67, veprë 87, veglë 174; KK: veprë 8, 47, lodrë 30, 57, vatrë 46, 60, letrë(sije) 53 etj.

Një drejtshkrim të tillë e lejonte Komisia Letrare e Shkodrës, Ndërkaq në veprën e Asdrenit mbizotëron trajta si në drejtshkrimin e sotëm.

### ç) Rasa vendore

Në të folmen e toskërishtes veriore, që është edhe veçorfi e gjuhës së Asdrenit, është prezente trajta e rasës vendore, të cilën Shaban Demiraj<sup>8</sup>) e quan kallëzore të shquar, e cila paraprihet gjithmonë me parafjalët: në (ndë), më (mbë), mbi, përmbi, me - por si rasë nuk është pranuar në gjuhën e sotme letrare, sepse kuptimi i saj fare lehtë shprehet me anën e kallëzores me parafjalë ose me anë të rrjedhores pa parafjalë.

Parafjala e tillë në variantet përkatëse është përdorur mjaft dendur nga Asdreni në të gjitha veprat, si:

RD: *ndë* dhet 218, ndë majët 166, ndë dasmët, ndë qëliet 166 ndë zjarrr, ndë vart 175; RD *mi* (mbi) dhet 159; ËL: *mi* bart, *mbi* dhet 128 *mi* dhet 62, përmi qivurt 91; PM: *në* zemërt 31, në vesht 48, në hapësit, në luftët, në magjet, në ballët 50, në magjet 177; KK: në gjit, në dhet, në vatret 32. në luftët; më ballët 10 etj.

Formantet e kësaj rase ndeshen të përdorura dendur në veprat e shkruara para kohës së Asdrenit, mirëpo norma e tashme nuk e lejon, ngase konstatohet se edhe në të folme është kufizuar.

### d) Rrjedhorja pa parafjalë

Asdreni *Ka një parapëlqim të tepruar për rrjedhoren pa parafjalë*, thotë prof. E Lafe dhe vërtet kjo është një, *veçori e sintaksës së tij*, madje më sa *pamë* intensiteti i përdorimit të kësaj trajte vjen duke u shtuar prej vepre në vepër. Kështu, ndërsa në veprën e parë kemi hetuar një rast, në veprën e dytë nja 5 raste, në të tretën PM 30 dhe në të fundit KK mbi 30 raste. Një shtim i tillë duket edhe më i madh, kur marrim për bazë numrin e rreshtave prej veprës në vepër. Lidhur me këtë duke pasur për bazë gjendjen e gjuhës së sotme, po japim për ilustrim disa shembujt, ku mungesa e parafjalës PREJ shihet qartë:

*dorës sime shkruar, zjarrit tretej ndenjuri shtratit; Shkoj dimri kohra gjumit zgjohen 99, Gjith avull dheut ngrihet, hapet 107. PM: ...dorës sime shkruar 7, Ju rojta si dhe vehten çdo rreziku 8, Ju na largoni çdo mjerim 19, Mi bar mëndafshit jemi shtruar 19, Dorës zotit e gatuar 34, Të dytën gojës kurr s'e largojnë 117, U tundnë britjesh lartësitë qiellore 161 etj.*

Ja një strofë nga KK:

Si zë trumbetet rradhësh ushtetore.  
Që tundet ajri zërit shangullor,  
Si fantazma hijesh tinëzore  
Na shkundnin trupin gjumit qetësor.(14)

Ja edhe disa shëmbuj të tjerë:

*Më s'ngopet syri pamjesh dëfrimtare 23, dëshirash lakmimtare 64, plagash plumbi 64, druesh dore mizore (prej dorës) 96 etj.*

Lidhur me këtë pririje prof. Shaban Demiraj 9) konstaton me të drejtë se ndërtimi i tillë i sintagmave mbetet arkaik dhe se plotësit ndjafoljorë në rrjedhoren e pashquar në shqipen e sotme letrare domosdo duhet të marrin parafjalën përkatëse PREJ.

- Në përgjithësi mund të konstatohet se poeti duke u vënë theksin fjalëve kryesore, fjalët ndihmëse, pjesëzat, parafjalët, nyjet i kursen në të shkruar.

- Asdreni nuk e përdor parafjalën sinonimike të rasës emërore NGA, e cila në kohën tonë u bë mbizotëruese, duke e marrë mbi vete funksionin që kishte rrjedhorja me parafjalën PREJ, në shumë raste.

Sidoqoftë, vërejtja është me vend se Asdreni e përdor me tepri rrjedhoren pa parafjalë dhe kjo mbetet veçori e stilit të tij.

Siç dëshmohet në folklorin tone edhe shkrimtarët e vjetër gegë e përdornin mjaft shpesh rrjedhoren pa parafjalë.

## (2) FOLJA

### 1. Aoristi

Lidhur me kategorinë e foljes janë marrë në shqyrtim vetëm disa çështje problemore të aoristit. Siç është cekur më përpara në përdorimin e të kryerës së thjeshtë Asdreni ka luhatur në këto raporte:

a) E përdor zakonisht trajtën e vjetër: të fundores së shumësit: –ËM/MË –NË/ËN shkelmë /shkelëm, mbajtnë / mbajën shkelnjë shkelën etj.

b) Ashtu si në të folmen ed Korçës e përdor aoristin në dy forma: **kuptova** dhe **kuptoja**, ndërkaq në veten e tretë njëjës del tri formash: (ai) *kuptojti, kuptovi dhe ai kuptoj*, që në letrarishten e sotme del: **kuptoi**.

Me sa u tha për pikëm b) po japin për ilustrim disa shembujt:

*E para*, Asdreni duke ndjekur ortografinë e Naimit e të Samiut dhe të tjerëve, veten e tretë njëjës të aoristit e shënon me –J, si: RD: flytyroj (ai) 93, shpëtoj 126, dërgoj 99 etj.; ËL: e këndoj (ai) 41, shkoj (dimri) 88 etj., te PM: s'u pushoj 11, i dërmoj (ai) 100 etj.; KK: pikoj 14, filloj (t'i zbardhë) 7 etj.

*E dyta*, ndjek rrugën analogjike si në veten e parë e të dytë dhe në veten e tretë përdor -V-në antihiazituese, e cila mbetet si trajtë dialektore. Kështu te foljet e tipit *shkova/shkove*

*shkoi ose shëmbëlleva shëmbëlleve shëmbelleu* në veten e tretë shënon fundoren –vi, për të dyja rastet, si: PM: *shëmbëllevi/thevi 102, e ndjevi 126, dhe te KK shtrivi 20, shkovi 60 dhe shkavi 125.*

*E treta*, Asdreni në nja dy raste në vend të -H- e përdor përdor V-në, si: *msheva* dhe e *ngrova*, që i përdoret kështu edhe nga Çajupi.

*E katërta*, po përmendim gjithashtu edhe dukurinë se Asdreni në disa raste e përdor aoristin sigmatik: *u lashë, u ndashë, u vrashë* (për u vrava) dhe *u zushë* (për u zura) etj.

*E pesta*, po cekim edhe rastet *u shojta* (për u shova) e *njofta ose e njofta* (për e njoha), shembuj këta që si duket janë shfrytëzuar për rimim.

*E gjashta*, vetat e shumësit të aoristit pasiv që në normën dalin me mbresat vetore të tri vetat e shumësit në shumës dalin me -ËM, -ËT, përkatësisht-ËN, tek Asdreni dalin në formën arkaike me –**më, –në** fundore, si: RD: e gjetnë 238, ËL: e ropnë, e prishnë 13, e thëthinjë (v.II.sh.) e njojnë, ju ndohtë 50 derthmë etj.; përdoret edhe në veprën PM, si: e shpallnë 17, mbetnë 17 etj., edhe te KK: përballnë 46, u përleshnë 75, u shkelnë 75.

Ndërkaq në veprën e fundit dalin edhe trajtat si në normën e sotme, si: u përballën 14, mbetëm 14. Kështu edhe në këtë pikë hetojmë prirje pozitive në ortografinë e Asdrenit, i cili përqafon trajtën e cila do të bëhet mbizotëruese, madje edhe do të kodifikohet në kohën tonë.

## 2. Foljet me –NJ/-J fundore

Konstatojmë se ka luhatje në përdorimin e bashkëtingëllores **nj/j**, por mbizotërojnë trajtat e formuara me -NJ. Ja disa shembuj:

1) E tashmja e dëftores:

RD: luanj, ngjyronj, rronj, rrethonj, dëftenj etj

ËL: përshkonj, pushtonj, çdëfrenj,

PM: ënërronj, vështronj

KK: besonj, shtrëngonj etj.

2) E pakryera e dëftores:

RD: lulzonje, lartsonja, mposhtonja, shkelnja, ndjenja, ngjtnja, shëtitnja, mfshehnja, bënja

ËL: shihnja, mirrnja, fluturonja, ngjeronja, mejtonja, vëshronja, rronja

PM: besonja, rronja, vështronja,

KK: shtrythnja, këndoja, qëndroja, fluturonja etj.

3) Lidhorja

RD: të luftonja, të ndritnjë, të rronj, të kuptonj, të dërgonj, të kujtonj, të punonjë, të mbulonjë, të lëvdonjë, të qanjë, të vështronjë, të shkrettonjë, të rronjë

ËL: të shuanj, të adhuronj, të rronj

PM: të adhuronj, të rronj,

KK: të shkonj, të shikonj etj.

Me sa pamë në RD, ka më shumë raste përdorimi të trajtave të pakryeres se në 3 veprat e tjera.

### 3. Folje me I të theksuar, përforcuar me J

Te format e së pakryerës së zgjedhimit vokalik me **i** ose edhe o të theksuar (ndikimi i F. Konicës) Asdreni shton një j përforcuese, si

i bijin, dij, doj dojin RD: s'guxojin, ËL: ndrijnë, harrijnë, s' lij të shpijen, PM: vejin e vijnin, lëvrijin, prisjin, bijin, prijin, shkojin, vij, të rrejnin të ndrijën, shtijzë KK: flij, shkrijtët, ushtijnë, ndrijnë, shtijzë

**4. Format pësore vetvetore** të vetës së dytë shumës i formon me mbaresën I, si: mundohi, ngrihi, tundi, (norma e sotme: mundohuni, ngrihuni, tunduni).

**5. Forma e pashtjelluar mohore** nga Asdreni e ndërtohet me dy fjalëza mohuese: **pa mos**, si: pa mos dashur, pa mos shkelur. (Edhe te P. Begdanit hasim një dukuri të tillë.)

Ç'është e vërteta, Asdreni ka edhe një formë tjetër mohore në formë lidhore: *pa të shohë gjë, pa të njohë veten, pa të mos u vijë ku të doni*. (Prof. E.Lafe, mendon se një dukuri e tillë mund të jetë refleks nën ndikimin e rumanishtes.)

**6. Formën e urdhërores, veta II**, tek Asdreni e ndeshim duke e vendosur një **-E** pas mbaresës, si: bënie, mbushnie, shtinie etj. - në vend –JE: merrnie, rrëmbejeni etj.

### Përmbyllje

Nga veçoritë fonetike dhe morfologjike që u shtruan në këtë kapitull si dhe nga vështrimi i tërësishëm i sistemit drejtshkrimor, shikur nga aspekti diakronik mund të nxjerrim si përfundim se luhatjet në drejtshkrimin e Asdrenit nuk janë lëshime të rënda dhe se ato janë në të vërtetë, pasqyrë e gjendjes jo të rregullt të drejtshkrimit që mbretëronte në ato periudha të gjëllimit të shkrimit shqip në të dyja koinetë: gegërisht e toskërisht..

Me paraqitjen më të shkruar të trajtave të ndryshme drejtshkrimore, qofshin ato edhe raste të vetmuara mud të nxjerrim edhe një dozë pozitive, se duke pasur dorë të lirë në përdorimin e dy apo të tri trajtave të një fjale ai jep mundësinë që të hetohen të gjitha trajtat dhe kështu të bashkëjetojnë ato për koncepte të ndryshme sinonimike ose të zgjidhet trajta më e përshtatshme edhe ajo të përgjithësohet. dhe pikërisht një qëndrim i tillë ka bërë që ai të thyejë kriterin dialektor dhe në disa pika iu afrua prirjes drejt formave që u përlligjësuan më vonë në gjuhën e sotme letrare.

Gjuha e Asdrenit që nga fillimi, d.m.th. që nga paraqitja e tij e parë si gjuhë shkrimi tërhoqi vëmendjen e lexuesve, sepse njëherazi edhe ushtroi ndikim, por edhe gjatë fazave të zhvillimit të shkrimit shqip shënoi rritje që vetëkuptohet, si në prag të Pavarësisë, ashtu edhe sidomos gjatë Periudhës së Pavarësisë, por që vazhdoi edhe në Periudhën e pas LDB. Së paku ajo pati ndikim edhe në mënyrë emotive, kuptohet, jo vetëm me himnin e me poezi të tjera antologjike patriotike, por edhe ato që u kompozuan si këngë dashurie e sociale.

Ç'është e vërteta, edhe pse shikuar nga aspekti i sotëm i zhvillimit a evoluimit të gjuhës, gjuha e Asdrenit paraqitet pak a shumë me trajta të papranueshme momentalisht, ajo megjithatë nuk është e pakuptueshme dhe me vlerën e saj ideo-artistike që ka vazhdon e do të

vazhdojë të ketë ndikim edhe sa i përket përmirësimit e perfeksionimit të gjuhës letrare kombëtare. Kontributi i Asdrenit me idetë e tij lidhur me drejtshkrimin e saj në këtë drejtim kurrësi s'mund të mohohet.

Asdreni kishte koncept të qartë rreth dallimit të gjuhës së folur ligjërimore dhe të lirisë së vjershërimit në njërin anë dhe në anën tjetër ndaj gjuhës letrare zyrtare.





#### IV. PËRZIJIMI TOSKËRISHT/GEGNISHT – VEÇORI E GJUHËS SË ASDRENIT

##### **Konstatim paraprak**

Pothuajse në gjuhën e të gjithë shkrimtarët toskë ndeshim fjalë e trajta ndërdialektore, ndërkaq sa i përket çështjes së përdorimit të gegizmade, Asdreni, edhe pse nuk është një ndër të parët, është një ndër më të dalluarit. Ç'është e vërteta, ky ka vazhduar punën e rilindësve toskë, para, gjatë dhe pas brezit të tij. Edhe ky si të tjerët eci drejt motos së ashtuquajtur gjuhë letrare e **përzier** (Sami Frashëri) ose gjuha e përbashkme e **përzijet** (Faik Konica), por e veçanta qëndron se ky vetë për këtë nocion e sajoi termin **perzijim** ose shprehjen: **shqipe e njëjshme me perzijim** d.m.th. gjuhë e përbashkët letrare ndërdialektore (gege-toske/toske-gege). Siç dihet, edhe më herët, që në shkrimet e Naum Veçilharxhit, përkatësisht që nga **Kanonizma e Shoqërisë së Stambollit**, në shkrimet e Naimit, J. Vretos, Çajupit, F. Konicës, M. Gramenos si dhe të ndonjë tjetri edhe pse ishin toskë të lindur ndeshim gegizma të përdorur me vetëdije dhe në anën tjetër ndeshim toskizma në shkrimet e bashk;koh;ve t; Asdrenit, **Luigj Gurakuqit, Filip Shirokës dhe të tjerëve**, edhe pse këta i takonin arealit gegë. Gjithsesi shembuj edhe më transparent, pa hyrë në hollësi të tjera ndeshim te K. Kristoforidhi, i cili b.f. te tregimi *Gjahu i malësorëve*, **version gegnisht**, Prishtinë 1968, përdori trajtat: *atie, tyj, erthtë, sbarth, bek, mbëlithni, plump* (por edhe plumb), ndërsa te **versioni toskërisht**: *gjyshat, djelli, tashi, beg, kanë ardhë* etj.

Fundja, një fenomen të tillë e ndihmon edhe vetë fakti se këto dy areale i takonin të njëjtës gurrë: shqipes *nanë*, fakt ky i padiskutueshëm, sepse më shumë elemente bazë i kishin, siç i kanë edhe sot, të përbashkëta, ndaj atyre ndarëse, dhe këto ndarëset kishin mundësi të zbuteshin ose të bashkëjetonin në konkurrencë lojale, duke respektuar diversitetet e natyrshme të trashëguara që mund të ketë çdo gjuhë, por mbi të gjitha te krjuesit tanë ishte koncepti i vetëdijësimit të formëzimit të kombit shqiptar mbi bazë të shqipes globale, gjithnjë me synim: për përbashkimin e elementeve të saj si një mjet që në vetvete paraqiste armën shpirtërore kryesore për çlirim dhe për mëvetësi të Shqipërisë. Në të vërtetë, shikuar historikisht, gegë e toskë, kanë pasur lidhje të përbashkëta organike të shumëllojshme jetike etnike-psikologjike, gjeografike e historike edhe më përpara, madje ideja për bashkimin e popullit arbror ndër shqipfolësit me elemente vetëdijësimi shtetësie ka ekzistuar edhe para Rilindjes sonë kombëtare. Pa mëdyshje edhe para vetë shtetit të parë të **Arbnit** (shek. XII-XIII), kur në të vërtetë gjatë këtij formacioni u përforcua ai gjallim, pa përmendur Ilirinë, sepse faktet tregojnë se ekzistenca e popullit dhe origjina e shqipes ishte shumë më e hershme në këto troje, madje që nga parahistoria ose gjithsesi në ashtuquajturën periudhë *parashtetërore kombëtare*, kur jo vetëm vazhdohej të flitej shqip, por kishte sadokudo edhe norma të definuara në marrëdhënie organizuese, si të themi pushtetore, ndërfamiljare, pastaj raporte ndërfisnore e ndërkrainore dhe në vazhdimësi, kuptohet edhe mes principatash, sanxhaqesh etj., gjë që dëshmohet edhe me elemente të trashëguara, siç është vetë gjuha shqipe që nuk diskutohet, por edhe faktet e tjera, ngase sipas ligjeve të shqipes globale, shpjegohen jo vetëm emërtime vendesh, mitesh e profesionesh, por edhe disa koncepte nga *gjuha juridike e pleqnive*, të ndarjes së të drejtës sipas *Kanunit të të Urtëve*, terminologji kjo si **besë, besëpaqe, pleqni, plak, stërplak, be e**

**besim, betim, Zot e përzot, Hyll e Hyji, Perëndi, Zotynë** etj., që ka arritur deri në ditët e sotme. Madje vende-vende kjo dukuri e ndarjes **në emën** të së drejtës së tillë, në realitetin tone gjuhësor, pra, me institucionin **e Pleqnisë** ka arritur deri në ditët e sotme, jo vetëm si koncept, por edhe si dukuri reale aktive bashkë me fjalë-termat përkatës funksionalë. Sidoqoftë, këtë trashëgimi atëbotë e shfrytëzuan mençurisht rilindësit tanë dhe e bënë bazë themelore të Platformës të tyre, gjithsesi duke i dhënë vlerë me cilësi të lartë, ashtu siç e impononte koha, për përlindjen e etnisë dhe të kombit shqiptar me një koncept të ri. Pra, pikërisht duke sforcuar jo fenë që ndan po gjuhën shqipe që afron e bashkon, e cila, veç tjerash, tashti shërbente, si arma më e fortë e zgjimit dhe e formëzimit kombëtar pa dallim feje, krahine e ideje, ngase vetëm në këtë mënyrë arrihej shpëtimi i shqiptarëve nga asimilimi dhe kthjellimi nga obskurantizmi i mëtejshëm i përhapur nga klerikët e kishave dhe të xhamive të huaja. Njëherazi krejt kjo ndërlidhej me kërkesë-idealën si koncept e si trasim rruge për përkufizimin dhe mëkëmbjen e shtetit të natyrshëm shqiptar brenda kufijve gjeografikë gjuhësorë, deri atje: **ku i thonë: bukës bukë dhe ujit ujë**. Andaj edhe në kohën e Asdrenit respektoheshin dialektet kryesore gegë e toskë, edhe pse të folmet ishin jo të njohura sa duhet, ngase ishin të pastudiuara, qofte në rrafshin sinkronik, ashtu edhe në atë diakronik. Por ekzistonte e vërteta se respektohej toskërishtja nga gegët dhe po ashtu respektohej gegnishtja nga toskët. Koine këto që kishin shtrirje mjaft të gjerë gjeografike, madje kishte dokumenta të shkruar në të dyja këto areale, si me thënë, nga epoka pararilindëse, siç janë shkrimtarët e vjetër gegë: GJ. Buzuku, P. Bardhi, P. Budi, P. Bogdani etj, veprat e të cilëve, sapo kishin nisur me u zbulue, ashtu respektoheshin edhe veprat e shkrimtarëve jugorë, si: V. Meksi, E. Vithkuqari, Voskopojarët etj., pa përmendur shkrimet e arbëreshëve (Itali), të cilat madje atbotë ishin më të njohura në fushën shkencore. Kështu që të gjitha ato vepra adhuroheshin, pa marrë parasysh përmbajtjen e tyre kryesisht fetare dialektore katolike, ortodokse ose edhe muslimane (bejtexhinjtë etj.).

Mirëpo kur është fjala të baza orientuese e gjuhës së përbashkë, ç'është e vërteta, që nga rilindësit e parë, por edhe tani në kohë të Asdrenit të ri e të burrëruar, vazhduan të shtroheshin ide dhe teori me vlerë rreth kësaj çështjeje. Së pari, u imponua njëzimi i alfabetit dhe njëherazi u shtrua edhe çështja e gjuhës së përbashkët shkrimore si mbëhi. Dimë për mendimin e Naum Veçilharxhit, madje mbi punën praktike të Konstantin Kristoforidhit, Vaso Pashës, Naim e Sami Frashërit, madje mendimet e shfaqura nga veprimtarët e brezit të Asdrenit siç ishin: F. Konica, L. Gurakuqi, A. Xhuvani, A. Z. Çajupi e të tjerë, ku, si me thënë, në këtë parapërgatitje, kërkohej si zgjidhje në të shkruarit të jetë **ai mesi i artë gjuhësor**, duke u mbështetur, pra, në realitetin relievor të Shqipërisë. Pra edhe Asdreni ishte përfshirë në kuadër të suazave të atyre përpjekjeve. Siç dihet, Asdreni toskërishten e kishte gjuhë të *leme, dhuratë hyjnore*, por ai futi në përdorim që në shkrimet e tij të para edhe disa trajta jo të pakta të gegnishtes që e kishte, si me thënë, gjuhë të *bleme, dhuratë ditunore*, d.m.th të mësuar vullnetshëm dhe synimi i tij ishte fisnik: *që t'i shkrijë vlerat e ligjërimin ekzistues me përzijim*, barabarësisht të dy dialektet t'i bëjë *si dy faqet e një lire*, që vetëm ashtu të **pandame** sajojnë **vlerën e vërtetë** ose *si dy lisa rrënjëgjitur, rritur në një diell*, siç do të shprehej disi kështu *ai* në vargje të tij. Pra sipas tij:

Gegë burra të vërtetë,  
Dhe ju toskë, burra të pavdirë,

Hidhuni bashkë si shigjetë  
Dhe bëne atdheun të lirë...

Kështu i mendonte Asdreni gegë e toskë dhe gjuhën letrare të tyre ta kenë të përbashkët, gjithsesi të pandarë. Dhe ai vërtet, u përpoq me forcën e pendës e të mendjes, duke bërë **përzijime** fjalësh e trajta fjalësh, që këto dy dialekte të bashkëjetonin harmonishëm si në veprat e tij. Pra, ai me vetëdije futi në përdorim, edhe elemente të gegnishtes, madje dhe të të folmeve të ndryshme. Dhe si rrjedhojë në gjuhën e tij gërshetohen jo pa sukses elemente të tilla ndërdialektore në të gjitha shkrimet e tij, por gjithnjë duke e mbajtur anën e së *lemes*, d.m.th. bazën **toskërishte**, pa i harruar **të përbashkëtën** dhe **vlerat nga gegnishtja**. Ky anim nga toskërishtja shihet fare qartë, kur të krahasohet numri i titujve, respektivisht i vargjeve (rreshtave) në raport të të dy dialekteve. Në këtë kontekst del se paraqitja në dialektin gegë është fare e vogël, mirëpo zgjon interes gjuha e tij se për të parën herë në mënyrë të vetëdijshme një "toskë" **shkruan** vjersha, si të themi plotësisht "gegërisht", por jo në një gegërishte të "pastër" separate, por në një gegnishte me **përzijim** e sipër me toskërishten, ngase siç i sqaron vetë Asdreni redaktorit, të cilit i dërgon për botim poezinë **Nata e mrame e Skënderbegut**:

*Vjershë gegënisht; u përpoqa ta sjell sa më tepër t'ngjasë gegënishtes, po megjithkëto kanë shkarë edhe toskënishtes, e kjo s'prish gjë, po në qoftë munt t'i ndreqësh, në beson se i vijnë.*

Pra, i **janë shkarë** (trajta) *toskërishte* brenda *gegënishtes*, po **kjo s'prish gjë**, - thotë autori. Nga kjo nënkuptohet se ai veproi kështu me vetëdije të lartë, ngase kishte pikësynim të vënët e bazës rreth formimit të *gjuhës së përbashkuar shqipe me përzijim*, ngase ashtu si në vjershat e shkruara gegnisht edhe në ato të shkruara toskërisht *i janë shkarë* trajta e fjalë geqe ose anasjelltas toske dhe kjo, sipas tij, **nuk prishka punë**, apo jo?!

Ç'është e vërteta, kështu kuptohet krejt gjuha e Asdrenit, sepse, pothuaj, në asnjërën poezi, shqipja e tij, nuk del as thjesht toske as thjesht geqe, po del një gjuhë **shqipe**, pra, **me përzijim**. U pëmend se atëherë shqipja kishte dialekte të emërtuara *toskë* e *gegë*, por nuk kishte normë të emërtuar institucionalisht as njëdialektore as ndërdialektore, sidomos kjo vlen për kohën kur u shkruan dhe u botuan dy veprat e para të tij.

Në të vërtetë, mund të thuhet se gjuha e Asdrenit është paksa e veçantë, ajo ka elemente por nuk është as si gjuha toskërishte e Kristoforidhit as si ajo e Faik Konicës, madje gegnishtja e tij nuk është si gjuha e shkodranëve as e elbasano-dibranëve edhe pse ky përdori trajta të shkodranishtes, madje edhe trajta, *edhe pse të pa përpunuara të elbasanishtes*, kosovarishtes në njërën anë, por jo thjesht as të toskërishtes naimjane në anën tjetër, sepse, ishte nën ndikimin e të gjitha veprave të botuara në atë periudhë. Shkurt me thënë, Asdreni ishte nën ndikimin e specifikës së normës së shqipes globale ende të pakonsoliduar normativisht dhe varësisht nga tema që trajtonte, përpiquej të përshtatte edhe mjetet gjuhësore.

Sidoqoftë, më poshtë po japim disa shembujt konkretë të përdorimit të gegizimave ose edhe të toskizimave brenda tekstit toskërisht ose gegnisht, natyrisht, duke tërhequr vëmendjen e lexuesit në rastet e ndryshimeve kryesore dialektore, siç janë: pjesorja geqe (në cilësi ose jo

të paskajores), dukuria e rotacizmit ose e jorotacizmit, dyzanorshi -UE/-UA, trajtat shkrimore të fjalëve përkatëse paralele ose si idioma të veçanta, shurdhimi ose jo i konsonanteve të zëshme etj.

## 1. Disa nga gegizmat ose toskizmat e përzijuar në veprat e Asdrenit

Më poshtë po i shënojmë (*dalluar me shkronja italike*) disa nga gegizmat, por edhe toskizmat, në vjershat shkruar *gegnisht*, ashtu, siç i ndeshim në burimet përkatëse të Asdrenit.

### 1) Nga Rreze dielli

Në veprën e parë të Asdrenit **Rreze dielli**, prej 86 titujve që ka përmbledhja, vetëm tri janë janë shkruar, si me thënë, gegnisht dhe ato janë përfshirë në ciklin "Vjersha atdhësie", por gegizma, si të themi, të inkorporuar brenda vargjeve ndeshim pothuajse në gjitha poezitë e Asdrenit shkruar në *toskërishten* e tij. Pra, përveç elementeve të përbashkëta të shqipes globale gjuha e tij karakterizohet me elemente të *përziera*: *gege* /*toske*.

Ja disa fjalë-gegizma të shkëputura të përdorura nga vjershat shkruar kryesisht toskërisht që i ndeshëm në RD:

*O lemje, ky gjumë... në vdekje i ka çu, kudo lavdim, shpresë fare nuk ki, u ngoptë me të rema, o djem, këndon me zë të naltë, prëndverë, bujku i gazmushmë, një mbret qi me fuqin' e tij urdhënonte, gazmend, argjent, e çkëlqyeshme, zotëni, më rreh zemra.. s'mund të më shtjerë, zburon/ nalton, mbeti me barrë, do të vij, bamiri etj.;*

Përdor edhe pjesoren e shkurtë (*gege*): *na ka gjet', / ka mbet' etj.*

Më poshtë, po japim disa shembuj, ku lexuesi përveç përmbajtjes mund të vërejë lehtë *përzijimin* ndër-dialektor:

- a) Nga **Nata e mrame e Skanderbegut** e shkruar gegnisht,

Shqypnarë! Or' e funit afroi,  
Diell për *mua* s'ka ma me shënrít'  
Ndjej tash si vdekja më ka nër thoj  
E s'më le ma fjalët për me i qít'  
Shqypnin' deri sot unë e kam neru,  
Por *që* sot e tutje kete barrë e kini ju!  
.....  
Kokën e *ul*, *mjekra* po i *zbarth*,  
Edhe shkoi trimi që prap' s' ka me *arth!*  
.....  
*Sot* s'ka kush atë kordh' m'e *tunt*  
*Sot* s'ka anmiqt' kush me i dëbue,  
Oh! E shkretë ditë, pse i *dhe funt*  
Se nata q' *ardh* Shqypnin' e ka mulue...

b) Nga vjersha **Për Shqypninë** shkëputëm këtë strofë:

Nana e jon' e mjera  
që në mjerim *gjëmon*,  
Ajo na *thërret* për hera  
t'i japim ç'i mungon...

c) Nga poezia **Për atdhenë** po shënojmë strofën e pare:

Atdheu prej anmiqsh ish rrethue,  
Kur nana tuj përcjell', birin e vet  
E përshshëndosh gjith' tuj bekue  
*Nga lufta* për me u kthye me shnet;

I uron nga zemra prep(!) për me ardh'  
Burrnisht me luftu, armët me i zbardh'...

Në vijim po i paraqit nga kjo vepër edhe një shembuj shtesë ku vjersha e tërë, edhe pse e shkruar gegërisht, nuk del artificiale edhe aq më tepër e pakuptueshme apo e rëndë për lexuesin, si atëherë, si sot, sepse elementet e përbashkëta të shqipes mbizotërojnë:

Prëndverë për me ardh',  
me dit të gazmu(e)me,  
Fushën me na zbardh'  
me lule t'beku(e)me.

Eja pra o lule,  
që *ritesh* ndë vesë,  
Që nga qielli u sule  
për me na pru shpresë.

## 2) Nga **Ëndrra e lote**

Në veprën **Ëndrra e lotë** ndeshim nja katër poezi që në tituj janë shënuar në gegnisht: *Zani i lahutës*, *Armët e Skanderbegut*, *Ngjatjetimi i nxansave* dhe *Të tana janë gëzu*, por edhe te poezitë *Ballashi* dhe *Dimri*, mbizotërojnë elemente të gegnishtes. Shembuj të shkëputur nga këta tituj do t'i japim më poshtë pasi t'i cekim disa gegizma që i ndeshim brenda vargjeve, si të thuash, shkruar toskërisht, si:

*Përment papra me gojë, e shporrni, të vumë, djema/të rrema, lavdim, habim, dashamir, zjarmi i atdhesisë, thom e them, gjindja, shtyllë është dija, ka mbet' bekim i qiellit, për dhenë sa të duash, rreziku thom, armët e Skënderbegut, i qëndrove kryes, shqyptar jemi, prej një nane jemi lerë, një të game/ një zemër të pandame, drojë, erdhi koha, pamje e kandëshme, me këngë malli trimënore, sy të flaktë./dritëpaktë, dheut tem/do t'ia them, mçel, jeta është veç një ushtimë/lumtësia një tingllim', qielli i*

*kjartë/ylli i zjarrtë, malli i em, mallin tem të shkretë, të rroj/rronj për jetë, të shoh të rremat...,shpirti i em, lemëni, kryet unjur, nepnae sot, ngjatjetim i nxanësve, mëngjezi/mezi, shtat të naltë, sy të gjallë, ... në katunt, ramjet e këmbanës, të kjartë, ylli jem, sy të zinj/ zij/vij (4 herë), më të ri/rri, tunden/krunden etj.*

Siç e paracekëm, tani për secilin titull të poezive të sipërcekura po shkëpusim për ilustrim, disa vargje:

a) Nga poezia **Zani i Lahutës**:

Ay za q'e ban shum' herë  
Zemrën tone me lotu;  
Dhe na lotet tuj i nxjerrë  
Ndjemë shpirtin të lehtsu...

.....  
Që prej Shkodre e gjer Janinë  
Që prej Shkupi e Manastir,  
Ku lahuta e ka kufinë ...  
Zani i saj asht tuj na thirr':

Nana *Tuaj*, nana e ngratë,  
Që me kangë ju ka rrit'  
Djem, prej jush dit' edhe natë  
Ah! Nji **kang**' po asht tuj prit'!

b) Poezia **Armët e Skanderbegut** vetëm titullin e ka gegnisht, por jo tërësisht tekstin. Ja, vargjet e fundit:

O pallë edhe ti helme(të) e Skënderbeut  
Prej *qindra* vjetsh që mbani zi *paprerë*,  
*Arth* dita, Shqipërisë edhe një here  
Me fame t'i shkëlqeni përsëri.

c) Edhe te poezia **Ngjatjetimi i nxansavet** vetëm titulli del gegnisht, ndërsa teksti pasqyron shprehje të përbashkëta. Ja një strofë për ilustrim:

Mësonjesve të ndershme  
Urojmë ngjatjetime  
Me gjithë zemër sot  
Për punët aq të vlefshme  
Këshilla dhe mësimë  
Që nuk' harrohen *dot* ...

ç) Në poezinë **Të tana janë gëzu...** mbizotërojnë gegizmat. Ja dy strofa sa për ilustrim:

Qiellit hanëza baloshe  
Qindroi vendit kur të pa

E prej *cmirit* si vogloshe  
Ajo *zuri* e me qa.

.....  
Po kur bashk' na jena hasun  
Me mallim tuj u qafu,  
Dhe me buzt' tuj u përqasun  
At'her': T'tana jan' gëzu.

d) Në vijim po japim për ilustrim strofën e 6-të e poezisë "BALLASHIT, për të parë se si janë inkorporuar natyrshëm paskajoret gege brenda tekstit toskërisht:

"Sepse *armikun ka me bë hi*  
Atje lule *ka me mbi*,  
Trëndafili *ka me u çel'*;  
Kurr bari *s'ka m'u mverth'*.

dh) Në vjershën **Dimri**, titulli del toskërisht ndërkaq mbizotërojnë fjalët e trajtat gege:

*Hëna* nuk *shëndrit*  
Se ret' e kanë' mbulu,  
Veç *ngaherë* rrezet *i qit*  
Porsi vash' e turpnu.

e) Për përmbajtjen që kanë po i shtojmë edhe këto vargje nga KANGA E BASHKIMIT(83)

Gegë e Toskë *vllazën* jemi  
Te dy bashkë një nënë e kemi  
Dhe një fat në këtë botë  
*Shqyptar'* jemi, fjala thotë

Prej një nëne jemi lerë  
Muslimanë e të krishterë  
Me një diell jemi rritur  
Si dy lisa pranë ngjitur

Te dy kemi një dëshirë  
Se një sisë kemi pirë,  
Një të qeshur, një *të qame*  
E një zemër *të pandame ...*

ose:

Tërë bota ka me ditur  
Se na s'jena për t'shitur. (84)

dhe:

Të gjithë *kena m'u përpykun*;  
Për Shqipninë sot *me vdekun!* (84)

ë) Edhe nga vjersha **Cilët jemi** theksojmë variantin:

Me emrin Geg e Tosk ç'kuptojmë,  
Sa here njëri tjetrin e kujtojmë:  
Një fis dëften se jemi, një farë  
Një shpirt si dy vëllezër të pa ndarë  
Sepse një mëm' e madhe na ka pjellë  
Porsi dy lisa rritur në një diellë.(87)

Në shembujt e mësipërm dallojmë këto pjesore (ose paskajore) gege:

*turpnue, mbulue, me bë (me ba /bë/rë), çelë, përçasë, qafue, hasë, gëzue, qa, pritë, rritë, thirrë, lehtsue, lotue*

**Shënim.-** Siç dihet, deri në fillim të viteve '20 nuk kishte shqipe letrare të përcaktuar as mbi bazë gegnishte as mbi bazë toskërishte, andaj jo të gjitha gegizmat e Asdrenit u pranuan si gjuhë letrare mbi bazë të gegërishtes, të emnuar ashtu pas vendimeve të Komisionit Letrare të Shkodrës 1917, ashtu si nuk u inkorporuan edhe disa toskizma në letrarishten e sotme (pas vitit 1972).

### 3) Nga Psalme murgu

Në veprën PM, botuar 13 vjet pas Komisionit Letrare të Shkodrës, asnjë vjershë tërësisht (më vete) nuk del në gegërisht por edhe në këtë vepër ndeshim jo pak trajta e fjalë gege, si:

*drras', prej katundit tem, siç tek na(2), vajza shtatkrenare, mendarë, shoqi-shokun, njashu, kam trokit' / kam fut', jam gdhi/ kanë vra, kam la, nj'ashtu, simbas, syri i em, vështrimi i em, njëri-tjetrin rren papra, jam ul', e thom, s'ia kam heq, grushtit tem, fuqisë seme, me pandehme, të rit' e mia, të qofsha fal', pa pra, rreh, dashnorë, shpirti i em, thundrës seme, thom, q'aty, syt' i rrejin pa dobi, me mall dashnori, shoqi-shokun, e qenura ! malli i em, them, dashnorëve, i shkundnë, nj'ashtu, grihemi (na grinte), për punë feje, re të tmerrta, por na sot, për na që rodhi, atdheja, ka le/për atdhe, kish mbet' veç shpresa, lypset, jam gdhi, kam la, kam fut', kam fal' s'jam tut', dashnor' e vjeshëtarë, le t' i laj (nj), kombit tem, nër hovet plot burrnie si një dëshmor/ plot burrni e drojë aspak, koha jote luleshtru(r)/sykullua(r), qielli sykullua(r), f.246, shkaba mali, papërlyme/të papërlyme, një shpirtrob/mikrob, pa pra s't'u nda, mirëdashjen letër prej katundit tem, terror!, pamje, trandafili, ngjallja jonë, me ty gjalloj një komb, mendje më së nalta, nalt lirin' i kanë tjerr(ë), krahnori i djelmurisë, prej drojës unjen manushaqet, hove burrnie, tek na me zell punojnë vajza shtatkrenare, dijes së tyre, hymn lavdije, rren/gjen, plot andje, me pandehme, ta thom, mahen shqerrat, pa pra që lëviz rrotullim, tokës arbnore, andje verore, syt' i rren, një dashnor, ç'dreq kish, e papërlyme etj.*

Në të vërtetë, siç thuhet në *Shënime* për poezinë *Hymn kombëtar* f.297-298 në autografin e lënë nga Asdreni (pika 6) gjenden 6 strofa shkruar gegnisht, përkatësisht 8 strofa me refren (pika. 8), po ashtu shkruar gegnisht, por që kanë mbetur pa u përfshi në PM (1930), gjë që dëshmon se Asdreni ka vazhduar me shkruar gegnisht.



Sidoqoftë nga poezia **Hymn kombëtar**, e botuar në PM f. 17, ku mbizotërojnë elementet toskërishte, ne, gjithnjë me qëllim të tërheqjes së vëmendjes në për përmbajtjen dhe përzijimin, po shkëpusin strofën e fundit:

O bij, t'atdheut, o bij të Shqipërisë,  
Shqiponja mali mveshur trimëri,  
Si burrat e palodhur të lirisë  
Nër lufta t'ashpra, luftë për liri,  
Tregonin se *krahnor* i djelmurisë  
**Mburonjë qe dhe mbetet përsëri.**

Madje, sipas titujve asociacionojnë në gegnishte këto poezi: *Letër prej karundit tem 28*, *Luftari Lypës 56* dhe *Andje verore 155*. Po i ilustruam me shembuj:

a) Në poezinë *Letër prej katundit tem*, mbizotërojnë trajtat e përbashkëta, megjithatë në raste hasim trajta të gegnishtes, si:

*N'avlëmend*, punuar dit'e natë  
Siç tek *na* me zell punojnë gratë.

.....  
Në çdo *send të vete* të shtëpisë  
Duket dora, mjeshtri i bukurisë.

.....  
Tek ju presin – jo më pak bujare  
Zonja si dhe vajza *shtatkrenare!*

b) Në poezinë *Luftari lypës* nuk kemi tekst me mbizotërim të trajtave geqe, por siç do të shohim përdorimi i pjesores së shkurtër që është veçori e dialektit gegë del evident. Ja disa shembuj:

Armikut s'i *jam tut'*  
Në ballë i *kam dal'*,  
Shpesh dërmën ia *kam fut'*  
Dhe hovin ia *kam ndal'*.

.....  
Të tjerë më shpirtliq  
Që prap na *kanë vra*,  
Sot bëhen miq për fiq,  
Sikur më s'janë ata.

c) Nga *Andje verore* përzgjedhëm këta dy strofa:

Këngë e valle pa pushim  
Gjith në dasmë je *pa pra*,  
Bukuria s'ka mbarim  
Pa ty bota shije s'ka.

.....  
Pyll, të lutem, kur të shkoj

Hape gjirin e më merr,  
Se si *foshnjë* t'ëndërroj  
Kur kujtimi yt më *therr*.

ç) Nga poezia **Burri i dheut** (variant) 252, shkëputëm vargjet:

Gjuha jonë kaq e bukur  
Që në krye t'ishte shkruar  
Botën kishim ne (*/me!*) pushtuar...  
Po në vend të pendës vogël  
Q'është' më e fortë se një shpatë  
Ne përdorëm pushk' e thikë  
Pastaj mbetëm duarthatë.

Trimëritë ne që bëjtëm  
Për çdo *komb* e për çdo farë  
Gjë s'u shkrojt' në *gjuhën tonë*  
Andaj s'dijmë se çka ngjarë;

Se çdo burrë i math në dolli  
Që kaloi mbi male e dete  
I mbet emri për të huaj  
Asgjësendi s'la për vete!

Në këto vargje ndeshëm këto pjesore gege: *trokitë, futë, ndalë, tutë, gdhi, vra, la, heqë, falë, le, mbetë, therrë*.

#### 4) Nga Kambana e Krujës

Gjithnjë me qëllim për të vënë në pah përmbajtjen dhe gegizmat në veprës KK, këtij angazhimi, po i qasemi nga këto tri pika:

- Disa gegizma inkorporuar brenda poezive përkatëse me elemente mbizotëruese toskërishte
- Shembuj nga disa poezi me theks përmbvajtja dhe përzijimi ndërdialektor, sa për ilustrim dhe
- Rreth dy poezive kushtuar Kosovës.

##### 1. Disa nga gegizmat

Në kuadër të KK-së, ndër të tjera ndeshim edhe këta gegizma:

*ka fik', dashamiri, mendje më së naltë, hyjnor, kemi le/të mprojmë flamur e atdhe, flamur nalt', pa pra, krahnor i djelmurisë, pshtjell sot kryet, kombit tem/plot burrnie, krahnorin, kambana, bëmat, të ardhme ka, ka pas qenë, një pamje sysh, si ngjalë,*

*thom, doktoresha /hyllesha!/, godina të nalta, shkaba dykrenore, thom pa frikë, vogloma mjerimin, duk' na shqy, me frymën kryenaltë, e kotme, çka don vetë, të stërpiku, shigjeta majëramta/të famta, më të largme, trashëgimi 56, së përditme, një të pritme, shkolla dijenaltë, mëngjezi, mendjen teme, trini vëllaznore, tynzotit, dera arbnore, kryezoti, hirin tënd hyjnor, ushtarët mbetshin! pa bari (122) rrethanë, stërgjyshët, nderim mëmës e babës, feja/preja, të pamend/të pa vend, pamje katundare, gojëdhana, ia shtrëgote!137, me një vashë/ u nis prralla, them e thashë, nderë dhe lavdime /shkabës trime, zëhyjnor, bekim hyjnor, qenin tem, shkaba dykrenore, arratinë teme, mundi i em, truesëll, papra un' e kam ndje këtë dëshirë, vendlermi 263, papra shëndris, krenj! dhurata, qesim /shprenim (h)/ tines ligjërime, 271, bukurisë e pavdekshme (e amëshuarshme) (272), trualli /trolli i tyre (279) krahnorin vutë, ndë gjith tem326, fshani i zemrës, kryet ku pshtet...etj.*

## **2. Shembuj nga disa poezi me theks përmbajtja dhe përzijimi ndërdialektor**

Veç vjershës me titull **Shokëve të dashtun, djemve të Shqypnisë** shkruar gegnisht (në vitet e para të krijimtarisë së tij), me elemente gege ndeshim edhe disa tituj, si: *Vojsava, Dora d'Istria, Trashëgimi, Gjaku i stërgjyshëve, Trazime shpirtërore, Lulja ngjushëllimi*. Ja shembuj nga titujt e sapocekur

a) Vjershën **Shokëve të dashtun, djemve të Shqypnisë** pasi është e shkurtër dhe e vetmja e shkruar gegnisht po e shënojmë të tërën:

Shokëve të dashtun, djemve të Shqypnisë  
Që prej s' lergu s'pushoni gjith' me na çu  
T'fala prej zembresë, të fala të dashtnisë  
Vllaznin' q'na bashkon tuj diftu...  
Dhe na s'këtejmi këtë për me provu  
Se ma mir' si shqyptart e kan' zakonë,  
S'mundim, pra, gja tjetër m'u dërgu  
Përveçse at' që kemi: - **zemrën tone!**

b) Nga poezia **Vojsava – besa shqiptare** shkëputëm dy strofat e fundit:

Me vrullin e vrapit shqiponje gjahtare,  
Me kordhë nër sulme dërmonjëse rrëfeje,  
Bir, vepra pa vdekje nër shekuj prej teje  
Për nderin e *lavdin* e tokës *amtare*.

Jo kurrë mik bese me farat barbare!  
Ti ruaj zakonet dhe *fenë prindore*,  
Se *lavd* e kurorë dafinash verore:  
Stolia më e bukur është **Besa Shqiptare!**

c) Nga **Dora d'Istria**, shkëputa:

S' la vend e qytet më të shënuar,  
Pa mos ia njohur çdo që kish në art;  
Zakone e gjuhë *dij me t'ia përshkruar*;  
Në syt' e botës, gjë që e ngriti lart.

ç) Nga poezia **Trashëgimi** prej mbi 200 vargjesh shkëputëm këta rreshta:

Fytyra prej shqiptari, por zemra krejt e huaj  
E trupin e tyre faqas, kur shpirti u breth përjashta  
Të dijs se ç'kanë brenda lëkurën pak ua kruaj  
Shenjtor' s' *ke me i gjetun*, po djaj me mish e rrashta...  
.....  
Të rinj përjashta çohen – po rrall' e më zelltari  
Nër shkolla *dijenaltë*, për t' aftë dijetarë,  
Por shqipen ku s' i dijnë si ç' duhet piksëpari,  
Kot shteti derth të hollat, kot fara hidhet nd'arë.

d) Nga **Gjaku i stërgjyshëve** shkëputëm, si vijon:

Për ta çdo fjalë qe një fjalë bese,  
Me shenjtëri zbatonin çdo zakon;  
Fajtori i kapur s' kish rrugë ndjese;  
Ndër ta, padrejtësia s' gjente fron!  
.....  
U vramë për të tjerë kot së koti,  
Treguam trimëria pa dobi,  
Për vete s' na pikoi askurrë loti:  
Sa *mbetëm* veç një dorë për habi!

Të verbër nga padija dhe feja  
Dëshirë kemi sendesh të *pavend*;  
*S' mendojmë* se prap ne do të jemi *preja*,  
Kujt zgjatim dorën, *lypës të pamend*!

Pyes vetveten, a kemi ndër krenë edhe sot lypës të pamend, apo jo?!

dh) Për relaksim shpirti, për fund, po I sjell këta dy strofa nga poezia **Lulja ngushëllimi**:

Lule e badhë, lule e kuqe,  
Mos vono, të qofsha falë,  
Çfaq plot ato *bubuqe*  
Dufi i zemrës të më dalë!

dhe:

Lule fushe lule zalli  
Çeli gjinjet ngjyra-ngjyra  
Të më ndizet rishtas malli  
Të më qeshet prap' fytyra!

### 3.Dy poezi kushtuar Kosovës së robëruar

Asdreni robërimin e Kosovës ashtu si Gj. Fishta e tjerë e ndjeu shumë rëndë dhe këtë dhimbje e shpreh shumë fuqishën në dy poezi të angazhuara: **Lote robërie** dhe **Kosovës**. Mirëpo para se t'i qasemi më afër dhe të themi dy fjalë për këto dy poezi, bëjmë me dije lexuesin e nderuar se me termin Kosovë e kosovarë atëherë kuptoheshin të gjitha viset shqiptare që ranë në sundimin e egër serb pas Luftës I Botërore, duke përfshirë tërë Maqedonia Perëndimore, Kosovën, pastaj Plavë e Guci e vise të tjera deri edhe Ulqinin.

#### a) **Lote robërie**

Që poezia **Lote robërie**, botuar në KK (f. 29), i është kushtuar Kosovës së robëruar nuk mësojmë vetëm nga përmbajtja, por edhe nga komentimi e sqarimet lidhur me këtë:

Së pari, në f.. 265), edhe pse pa kontekst shkrimor me këto dy vargje, sa sqaron se ka tze bëjë me Kosovën e kosovarët, aq më shumë përkujton dhe nxit:

O burrani, ju djem ju trima kosovarë,

Përpara pra, ju burra djem të mbarë!

Së dyti, faqe 295 sipas autogramit bëhet me dije se kjo poezi (Lote robërie) fillimisht e paska pasur titullin **Lote kosovare**. Pra, përkushtimi i tillë as që mund të diskutohet.

Sidoqoftë, rrëfimin për vuajtjet në robëri, poeti e vë në gojën e të vuajturve (kosovarëve), të cilët duke treguar për historinë e vet tregojnë hjekitë kalvare që janë duke përjetuar nga sundimi barbar serbojugosllav, regjim ky që dhunën , gënjeshtren, dinakrinë e kishte masë legale për çrrënjosjen e çdo gjëje shqiptare, duke mohuar edhe të vërtetën e autoktonisë, e cila, sipas gojës së fakteve nuk mund të mohohej dot, sepse:

Kudo që mbin një lule, shelig a bar,  
Atje mund të ndodh një'eshtrë apo një varr!  
Aty ku trollit brazda çel parmenda  
Kokallat tona gjërë janë mbjellë  
Pa pra të rrahura në shi dhe djellë  
Me lot e gjak përzjerë tokës brenda!...

Ndërsa:

Sot dorë e huaj thonjtë na i ka futur  
As gjuhën s'mund ta flasim ne të mjerët  
As kënga më s'gjëmon te bjeshk' e mblerët  
As për të qarë, as për të lutur...

Sepse

Pa nder, si kafsha marrë nëpër këmbë  
Nën thundër zotërsh pa një pik'ndërgjegje  
Kurrkujt ata pa i dhën' asnjë përgjegje  
Na thithin gjakun duk' na shqy me dhëmbë.

Dhe në ato raste kur Europa nuk reagonte ndaj asaj fatkeqësie që vetë e kishte bekuar ndaj popullit tone, poeti u lëshon mallkim:

Mallkuar qoftë ky *qytetërimi*

Mallkuar qofshin sa që ka në krye  
Q' u bënë shkaktarë e njëj krimi  
Ky kombi i ynë copra sot q'u thye.  
Dhe së fundi poeti (kosovari) klith e gëlthet:  
Oh, lernani të rrojmë o shpirtmizorë..  
Ku lote kanë derdhur aq dëshmorë...  
...Mjaft ujqër, buka jonë vrer e hidhur  
Për Zotin, mjaft me gojë e duar lidhur...

Dhe kështu rrëfimi i tij mbyllet pa rrugëdalje, por plotësohet, si me then, me ato dy vargjet e pa përfshira që u cekën më sipër, por edhe më gjerësisht të vetmën zgjidhje e shpreh me poezinë që paksa po e trajtojmë në vinim.

### b. Poezia “Kosovës”

Poezia *Kosovës*, nuk është përfshirë në asnjërin nga dy kompletet që i patëm në dorë, por atë kemi pasur rast ta lexonim si fletë volante në ilegalitet. Ajo tashme gjendet e botuar në internet. Poezia përbehet prej 12 strofash ,11 gjashtë reshtash, nsdërkaq vetëm strofa r ka katër rreshta, pra gjithsej poezia ka 70 rreshta. Si duket edhe kjo si *Vaje robërie* ose *Vaje Kosove* është shkruar (mbase) më herët ose më von kur u shkrua ose u përpunua *Vaje kosovare* në fillimvitet e 30-ta të shekullit të kaluar, kur vërtet Kosova përjetonte kalvar robërie. Sidoqoftë, ndërsa në *Vaje kosovare* (Vaje robërie) poeti pasinuk'mund të gjendte zgjidhje tjetër përfundonte me mallkim ndaj barbarit dhe me klithje viktime, para gojës së *ujqërve*, ndërkaq në poezinë **Kosovës** është shumë më i hapur dhe nujk kërkon zgjidhje vetëm me kllithje e mallkim, por kërkon zgjidhje me sakrificë, me kushtrim.

Në të vërtetë, para se jape kushtrimin fillimisht hymnizon në dy rreshtat e parë të strofës së parë::

Kosovë, o vend i famshëm i trimnis,  
Kosovë, o lule e bukur e Shqipnis...

Apostrfofë përdor edhe në dy rreshtat e parë të strofës së dytë:

Kosovë, o atdhe i labduem I trimnis,  
T I ke pas kjenë mbretnesha e Rumelis...

Dhe po këtë e përsëritë në strufën e pesrtë:

Kosov ë, o terimnesghë luzlwe e rrallë  
Detyrën tin' e ke mal sot në ballë!

Siç e rsyeton

Ti të çohesh përsëri  
N'luftë të mbarë peer liri

Ose

Përpara burra rrokni ghut' e shpatë  
Prej zis, pështonie Kosovën e ngratë

Natyrisht është edhe më I qartë

Shyptarë, mos kujtoni bes e fe  
Po nanën juj kujtoni që u ka le

Ngase:

Sot ora mrrini dita e bekueme  
Dhe e përfundon kushtrimin jo vetëm për trima kosovarë, por mbarë shqiptarët:  
Shqiptarë, çoni-u, vllazën ora mbrini,  
Si Geg' e Tosk nalt Flamurin ngrini!  
Një Manastir, Shkup, Shkodër e Janinë  
Një trup bani an'emb'anë Shqypninë  
Siç trimit mirë i prek:  
Me nder n'luftë me dek'

Mund të konstatojmë se përmbajtja e tërë poezisë **Kosovës** pa hyrë në aspektin politik, kombëtarisht qëndronte e mbështetur. Ashtu edhe u veprua në Luftën e fundit.

Por, sidoqoftë, lexuesi i nderuar mund të ketë vërejtur se gjuhësisht te **Vaje robërie** mbizotëron toskërishtja, ndërsa te poezia **Kosovës**, mbizotëron gegnishtja. Edhe kjo e ka simbolikën e vet.

Nga sa më lartë, mund të nxjerrim si përfundim se edhe në KK Asdreni përdor *përzijime*, ai jo vetëm nuk i korrigjoi gegizmat nga krjimet e mëhershme të pabotuara, të cilat gjetën dritë botimi në këtë vepër, por ai përdori gegiyma edhe në shkrime të reja. Kështu nga të gjithë shembujt e mësipërm të vjelë nga KK ndeshim këto pjesore (pa ose si paskajore me **me**) gege: *fikë, pshtetë, ndje, prekë, dekë, gjetë, shqy, mbushë, përtri*,

### **Sipërfundim**

Për sa u analizua më sipër mund të përfundojmë se edhe pse numri i gegizmave në veprat e tij është edhe më i madh, ne po mjaftohemi me shembujt e mësipërm si dhe me përygjedhjen e disa nga vargjet poetike të tij, ngase besojmë se çdo lexues, tashmë e ka të qartë nocionin e sajësës së Asdrenit **përzijimi i gjuhës së njëjshme shqipe**, d.m.th. me të cilën mbulohen koncepte me përzierje trajtash e fjalësh ndërdialektore toske/gege ose gege/toske, varësisht nga tema që trajtohej.

Ndërkaq para se të kalojmë në trajtimin e paskajoren gege (me + pjesore) në veprat e Asdrenit, po risjellim në kujtesë të vërtetën se Asdreni, nuk ishte i vetmuar në këtë punë përzierjeje, ngase ç'është vërteta, gegizma, pa përmendur të tjerë, ndeshim, me dhjeta veç në Kanonizmën e Shoqërisë së Shkronjave Shqip të Stambollit, e madje edhe tek autorët, si: Naum Veçilharxhi: *dashun, pa dije, i vet*; Sami Frashëri: *emën, i krishtenë, anëmik*, Naimi: *meni, zotnisë*; Th. Mitko: *tue puthun, ja dhashtë, anëmiqët*; J. Vreto: *pamësit, të këputunë*, madje te shkrimet e këtij të fundit kemi vërejtur afro 10 raste të përdorimit të paskajores me +pjesore.

## **2. Numri dhe trajtëshkrimi i paskajores me+pjesore sipas veprave të Asdrenit**

### **Sqarim paraprak**

Infinitivi ose paskajorja në gjuhët e pajisura me këtë formë qëndron si fjalëformë përfaqësuese

e foljes, e cila shërben për të emërtuar një veprim si proces, pa iu referuar një vete të caktuar. Siç dihet, në kohën e Asdrenit paskajorja e tipit **me punue**, ishte trajtë normëzuese, ndërsa në kohën tonë ajo si veçori (gjoja vetëm) e gegërishtes mbeti jashtë normëzimit, pasi letrarishtja e sotme mbështetet mbi bazë të sistemit foljor të toskërishtes, e cila mundka të funksionojë pa të dhe se njëjësi I vtes së parë të dëftores mundka ta përfaqësojë tërë sistemin foljor të gjuhës shqipe, apo jo?! Në të vërtetë, letrarishtja e sotme njih si paskajore trajtën e tipit **për të punuar** si paskajore të dytë jo atë të mirëfilltën **me punue**, e cila funksionalisht e mbulon një nocion të tillë, andaj edhe quhet: *paskajore e mirëfilltë* ose *paskajore e pavarur e gjuhës shqipe*. Së këtëjmi, integrimi i paskajores mbetet çështje e shqipes standard/

Kur është fjala te gjuha e Asdrenit konstatohet se ai përdori të dy tipat e paskajores, ashtu siç i ka gjuha globale shqipe, por më tepër e fut në pëdorim **paskajoren e mirëfilltë** me +pjesore për arsye të forta, jo vetëm pse ashtu e kërkonte kuptimi a shprehja e kontekstit, por edhe për arsye fisnike, thjesht patriotike me qëllim të bashkimit ose të barazpeshës së dy kryedialekteve të shqipes. Dhe kjo është e kuptueshme, kur dihet se Asdreni ... "duke punuar me dashuri të veçantë dhe këmbëngulëse arriti të përsosë gjuhën e vet dhe të çlirojë atë nga të gjitha pengesat, që ia kufizonin forcën shprehëse të saj". U përmend më sipër se Asdreni shfrytëzonte fjalë e forma fjalësh të të folmeve të dy dialekteve, andaj kuptohet se ai po ashtu e përdori edhe paskajoren e mirëfilltë me + pjesore (gege) në disa trajta, madje edhe me pjesore të toskëzuar, sepse ashtu ndeshet atëherë, siç, në të vërtetë, ndeshet edhe sot, në realitetin tonë gjuhësor. Pikërisht rreth kësaj teme, d.m.th. rreth llojllojshmërisë së trajtave të pjesores së paskajores së mirëfilltë të pëdorur nga Asdreni do të bëjmë fjalë në vijim, Për të qenë më të qartë këtë trajtim e kemi ndarë në këto tri pika:

së pari, do të paraqitim shembujt me paskajore me + pjesore sipas titujve të poezive që i ndeshim në veprat e caktuara,

së dyti, japim pasqyrën e plotë të trajtëformave të tipit të pjesoreve të paskajores dhe së treti, disa vënerime ose sqarime lidhur me pasqyrën rreth trajtëformave përkatëse.

### **a. Titujt e poezive sipas veprave dhe shembujt me paskajore (me+pjesore)**

#### **1) RD**

Në veprën e parë RD paskajorja gege në gjuhën e Asdrenit ka shtrirje përdorimi mjaft të gjerë. Kështu sipas titujve të poezive ndeshim këto raste:

a) **Për Shqypninë**, shkruar gegnisht. ndeshim:

*për me i dhan' dituni, sa me munt, nga terri për me qitun, nga gjumi për m'e shkunt; Shqypnin' me neru, duhet me çporr', as me hy me të... – 7 raste.*

b) **Nata e mrame e Skandebegut** ndeshim këto paskajore:

*për me ardhë pran' / me ia nigju zan', s'e linte me u shue/ pa iu këshillue; mos m'e len' me ngordhë/ mos m'e coptu; për me mujt' m'u fol' 110, për me iu dhan', jetën me ma shkurtu, fjalët për me i qit', për me i dhanë atdheut lirin', në lufta kini me vajt', për me kqyrë, prap s'ka me arth!, për me pa mretin, ka me ra n'zi /ka me qa krahun e tij 111, kush me i dëbue/ me zhdrivillue/atdheun m'e lirue!, ka me metë evorfnunmun250 – gjithsej 22 raste.*



c) **Për atdhenë**, ndeshim:

*për me u kthye me shnet/ prep me ardh'/ burrnisht me luftu, armët me i zbardh'; anmikun m'e prit'/kryet m'i qit', s'ka' m'u pamun/damun, për me shpëtumun/tuj luftumun, , kishin luftue për me i njekun/, me i numurue,/për me çporr'! për m'e përqaftue/pleqinë për me ia amëlcue/ me e shtrëngue edhe një here; punën (me ) ia dëftye/me i than' n'ven t'luftës kish met' /për me shkue n'qetësi/ ke me hjekun/ me ranun, ma mir'asht me rrnue - gjithsej **20 raste**.*

ç) **Dimri**: nëpër lule me qëndru/ka pushtu, për me kërkue ushqim 159, për me na pru shpresë 160. – **3 raste**.

d) **Një ëndërr**: s' ke me pa 163 -**1 rast**.

dh) **Shqypnija**: ka (me) me t' vorfnumun.250, me ia amblcue - **2 raste**.

Gjithsej në RD si raste ndeshim **55 paskajore me + pjesore** (7+22+20+3+1+2).

## 2) ËL

Në këtë vepër paskajore geqe ndeshen në këta tituj të poezive:

a) **Balashi**: për me shkel', ka me mbi, ka m'u çel', s'ka m' e mverth – gjithsej **4 raste**.

b) **Zani i lahutës**: me kang' ven' me punu , **1 rast**.

c) **Kënga e bashkimit**,.., kena m'u përpkjekun/ sot me vdekun, **2 raste**.

ç) **Të tana janë gëzu**: zuri me qa/kur të pa, **1 rast**.

d) **Për gjah**: me ha'(!) dhe me pi (!). për me shkel', tërë bota ka me ditur//s'jemi (jena) për t'u shitur 252, për me shtypun, **5 raste**.

dh) **Dëshmorëve të kombit**: me shkëlqyer dielli, **1 rast**.

e) **Lutje zanës**: me luftuar , me i rrëmbyer , bota ka me ditur, Tërë bota ka me ditun 212 , **4 raste**.

ë) **Dimri**: lule me qëndru, me kërkue ushqim, për me ardh', me na zbardh', me na pru shpresë, **5 raste**.

f) **Nga letra**: për me u shtypun f. 211 – **1 rast**

Gjithsej në ËL, ndeshim: **24 paskajore me +pjesore** (4+1+2+1+5 +1+4+5+1).

## 3) PM

Asdreni infinitivin gegë e ka përdorur në ndonjë rast edhe në veprën PM. Atë e ndeshim te këta tituj:

a) **Dëshira pagane**, vuan me pa birin tend - **1 rast**,

b) **Luftari lypës**: fati i em m'u pa, 57, - **1 rast**,

c) **Burri i dheut**: syt' e zemrës me t'i çpuar 51, - **1 rast**,

ç) **Sqythia ...**: ka me u drit' gjer tej Tanais ... (55), **1 rast**

d) **Një udhëtim**: mendja ime me t'kërkuar, pa pra me ta vëzhguar largimin148, me t'u tallur ! 149, - **3 raste**

dh) **Mendjeshkurtët**: me u ndërruar!, - **1 rast**.

e) **Vlorës**: Me pa draper...(204) – **1 rast**.

Kështu në këtë vepër ndeshim gjithsej **9** paskajore me + pjesore. (1+1+ 1+ 1+ 3+ 1+ 1).

**Sqarim.-** Edhe pse ndonjë rast mund të jetë i diskutueshëm, ngase mund të ngatërrohet me formën e pashtjelluar të tipit: *me të ardhur, me të kërkuar, me t'u arritur* etj, forma këto që zbërthehen: që në momentin e të kërkuarit, të daljes, të arritjes etj., megjithatë ne i cilësuam si paskajore të mirëfillta ndonjë rast, ngase ashtu impononte koncepti i dalë nga konteksti.

#### **4) KK**

Në KK, ku u përfshi edhe peozia *Kosovës* autori e përdor paskajores geqe në disa tituj. Për arsye qartësie poezinë *Kosovës* po e analzojmë si pike më vete:

##### **a) Paskajorja në KK pa poezinë *Kosovës*:**

- a. **Flamuri arbënor:** ka me ndritur djelli 51, dhe për me na mbajtur peng në skllavëri 69, - **2 raste**;
- b. **Trashëgimi** (*variant*: shenjtor' s' ke me i gjetur 281. - **1 rast**).
- c. **Shokëve të dashtun, djemve të Shqypnisë:** me na çu/tuj diftu/ për me provu/m'u dërgu73 gja tjetër m'e dërgu 319, - **4 raste**.
- ç. **Trazira shpirtërore:** s'e lënë me u përtri 141, zu m'u mbush' me re 142, - **2 raste**
- d. **Diell i ri:** për me na mbajtur peng 151, - **1 rast**,
- dh. **Dora d'Istria:** dij me me t'ia përshkruar 134, - **1 rast**.

Gjithsej paskajores me + pjesore në këtë vepër **11 paskajore me+pjesore (2+1+4+2+1+1)**.

##### **b) Paskajoret në poezinë *Kosovës***

Ndërkaq vetëm në poezinë **Kosovës** (që unë e kam shfrytëzuar në fillim si *fletë volante* ndërsa tashti edhe nga internet,i ndeshim 16 raste të përdorimit të paskajores:

*për me shpëtue, din m' i ba, me dekun, ke me dal', për me u mprue, me dëbue,, me durue, me t' rrzue, për me t' shkel', për me t' ba, duen me thanë, me kjenë, , me iu shnderue, me shkëlzy, me rrnue, me dek'.*

Gjithsej pakajore me + pjesore në këtë poezi: **16 raste**.

Pra gjithsej në KK, ndajbathur edhe me rezultatin nga poezia **Kosovës** ndeshim **27 paskajore me +pjesore (11+16)**.

Ndërkaq, totali i numrit të paskajoreve me + pjesore sipas veprave të konsultuara del kështu:

**RD 55, ËL 24, PM 9, KK 27 (11+16), gjithsej 115 raste.**

Pra, në gjuhën e veprave të Asdrenit, në të gjitha versionet, ndeshëm **115** raste të përdorimit të paskajores me + pjesore. Por meqë forma e pjesores së paskajores së tillë ndyrshonte në realitetin guhësor, ai ndryshim sadokudo refleктоhej edhe në veptën e A sd renit, prandaj në

vijim do të bëjmë fjalë pikërisht për këtë dukuri.

### **b. Pasqyra e numrit të paskajores me + pjesore sipas tipit të pjesores**

Sipas tipit të pjesoreve të paskajores së mirëfilltë të regjistruar në burimet përkatëse shembujt i ndajmë në katër grupe, si vijon:

#### **1) Tipi paskajore me + pjesore e shkurtër**

a) mbi temë konsonante, nëntipi: me ardhë, me dhanë: RD 22, ËL 6, PM 1, KK 6 ,gjithsej **35 raste;**

b) mbi temë vokalike, nëntipi: me pa, me pru, me përtri: RD 6, ËL 5, PM 4, KK, 3, gjithsej **18 raste;**

c) mbi temë diftongu, nëntipi: me luftue, me kthye: RD 12, ËL -, PM -, KK 7, gjithsej **19 raste.**

Totali mbi temë të pjesores së shkurtër: **72 (35+18+19) raste.**

2) Tipi me pjesore gege **mbi temë me diftong të cunguar**, tipi me coptu, me shkëlzy; RD 8, ËL 3, PM -, KK 5, gjithsej **16 raste (8+3+5).**

#### **3) Tipi me pjesore të zgjeruar gege, tipi:**

a) me -UN fundore, nëntipi: me qitun: RD 3, ËL 5, PM -, KK 1, gjithsej **9 raste;**

b) me -NUN fundore, nëntipi: me ranun: RD 1, ËL- PM -, KK -, gjithsej **1 rast;**

c) me -MUN fundore, nëntipi: me shpëtumun: RD 3, ËL -, PM -, KK-, gjithsej **3 raste, gjithsej: 13 raste (9+1+3).**

#### **4) Tipi me pjesore të toskëzuar:**

a) me -UR: nëntipi: me ditur, me gjetur, me mbajtur: RD -, ËL 2, PM 1 KK 4, gjithsej **7 raste**

b) me -UAR/YER, nëntipi: me shkëlqyer, me kërkuar, RD -, ËL 2, PM 4, KK 1 gjithsej **7 raste - gjithsej 14 raste (7+7).**

**Totali i numrit të përgjithshëm të paskajoreve me + pjesore në veprat e Asdrenit arrin shifrën 115 raste (72+16+13+14).**

### **c. Vënerime rreth pasqyres së mësipërme**

Nga pasqyra e mësipërme nxjerrim të dhëna me interes ditunor, qoftë për letrarishten e atëhershme, qoftë për normëzimin e sotëm, por edhe atë të ardhshëm, material ky i mirëseardhur sot, për Këshillin Ndërkademi, i cili mesa dime e ka në tryezë shqyrtimin e integritit të paskajores së mirefilltë në standardin e sotëm, apo jo?! Unë për këtë çështje, rreth domosdosë së integrimi të tillë këtu nuk do të zgjatem shumë, mirëpo meqë paskajorja e tillë, deshtëm s' deshtëm me pranue, është duke u përdorur jo vetëm në gjuhën e folur, por gjithnjë e më tepër edhe në atë të shkruar, duke e pasur parasysht edhe rezultatin nga *Pasqyra e mësipërme* si fakt bëjmë me dije opinionin dhe anëtarët e atij Këshilli se Asdreni si toskë i

lindur sipas tipave të pjesores e ka përdorur paskajoren gege si vijon:

- paskajore të mirëfillta (gege) me + pjesore e shkurtër në 72 raste,
- paskajore me pjesore gege të cinguar (vetëm te foljet me diftong) 16 raste dhe
- paskajore me pjesoren gege të zgjeruar (tri varianteshe) vetëm 13 raste,

atëherë e shohim të nevojshme t'ua tërheq vëmendjen lexueve të nderuar e opinionit të gjerë dhe sidomos përdoruesve të sotëm të kësaj forme si më poshtë:

**E para** specialistët si dhe Këshilli Ndërkademi si formë përdorimi **mbi pjesoren gege** si paskajore të re në standard (A. Omari), apo jo(!), duhet ta rekomandojnë si më poshtë:

**Po**, vetëm trajtave me pjesore të shkurtër: **me mësue, me shkëlqye, me folë etj.**

ndërkaq

- a) **Jo**, trajtave me pjesore të cinguar, si: *me mësua* a *msu*; *me shkëlqy*, *me fol* etj.
- b) **Jo**, trajtave me pjesore të zgjeruar, si: *me msuem*, *me msuemun*, *me mësuen*, *me mësuenen*, *me mësunun*; *me shkëlqyen*, *me shkëlqyemun*, *me shkëlqymun*; *me folun*, *me folen*, *me folun* etj.
- c) **Jo**, trajtave me diftong të ndryshuar -UË ose YË, si: *me mësueë*, *me shkëlqyë*, andaj nuk rekomandohen trajtat *me mësueë*, *me pëlqyëë*, që në mjaft raste mund t'i ndeshim në shkrime të kohës së Asdrenit, por edhe në ndonjë shkrim të sotëm.
- ç) **Jo**, trajtave si: *me mësua*, që në kohën tone propozohen nga ndonjë autor, mbase me qëllim fisnik, duke menduar se kështu gjendet, gjoja ai mesi i artë pajtues (gegnisht UE/UA/r toskërisht), sepse ashtu edhe u përdorka në ndonjë trevë të Malësisë së Gegnisë (!).

**Sqarim.**- Lidhur me rastin e fundit (pika ç) mendoj se një qëllim i tillë, edhe pse mbase fisnik, sipas traditës dhe gjendjes së sotme (*si bidat i ri!*) nuk qëndron, andaj nuk duhet përkrahur, sepse, tash flas për të dyja rastet, ato të pikës c) dhe ç): **me mësueë, me mësua**, ngase si të tilla më shumë i sjellin vështirësi e mbështjellim se lehtësim normës, kur kemi parasysh faktin sepse: edhe ish letrarishtja jonë mbi bazë gegnishte, ashtu si kjo e sotmja mbi bazë toskërishte e njeh pjesoren e tipit të shkurtër: **mësue: mësues, mësuesi, mësueshmëri, i mësuet, mësuekam**, pra jo mësua as mësueë! etj. ashtu njëhej dhe njihet edhe forma: **shkëlqye, shkëlqyes, i shkëlqyeshëm, i shkëlqyer, shkëlqyekam**, pra jo shkëlqyëë, shkëlqyëës shkëlqys, shkëlqyakam etj., prandaj nuk ka kurrfarë vështirësie që paskajorja **me mësue, me shkëlqye, me folë**, me u bekue ose me u rikthye në trajtën e pranueshme të pjesores nga norma e sotme. Është tjetër gjë nëse kemi të bëjmë me ndonjë frazeologjizëm, idiomë ose ndonjë rast të jashtëzakonshëm.

Sidoqoftë, lexuesin ose krijuesin e papërvojë nuk duhet ta shqetësojë aspak, madje as ta hutojë fakti kur ndonjë rast të pjesores së paskajores përkatëse e ndesh në trajta të ndryshme, si b.f. në veprat e Fishtes, Asdrenit, Poradecit, M. Krujës ose të ndonjë poeti të ri, e ku ta dime, ngase trajtat përkatëse të fjalëve nga veprat poetike rrallë mund të shërbejnë si gjedhe drejtshkrimore për shqipen standarde.

**E dyta**, ndërkaq kur kemi të bëjmë me raste **mbi pjesoren e normëzuar (toske)** te tipi i paskajores me **me** (*me +pjesore të toskëzuar*), tipi **me mësuar, me shkëlqyer, me folur**, që ndeshim vetëm 14 shembujt te Asdreni, por edhe nga të tjerë është e lejueshme me u përdorë

ashtu apo jo? Para se të jepet përgjigjigjia lidhur me këtë, duhet pasur parasysh këto tri fakte:

së pari, dihet se një formë të tillë të paskajores e ndeshim të trashëguar. E ndeshim edhe në shkrimet më të hershme nga autorë toskë si: *D. Rada, Th. Mitko mos me prishurë, mos me na shti fit,, me e lenë me na marrë, Loni Logori, ka me mbetur, Naim Frashëri e të tjerë, si, mos me prishurë, me ditur etj.*,).

së dyti, pohohet se edhe një pjesë e toskërishtfolësve e përdorin atë trajtë të paskajores, qoftë edhe në zona të ndërmjetme nën Shkumbin, e ku ta dime dhe

së treti, duke respektuar autoritetin e letrarishtes së sotme, e cila pjesoren e tillë e ka të sforcuar në sistemin foljor të kohës së përbëra, si **kam mësuar, kam shkëlqyer, kisha folur, pata folur** etj. në njërin anë dhe nevojën e domosdoshme të përdorimit të paskajores që po ndjehet për ditë e më shumë në realitetin tone gjuhësor, madje e përfutur për analogji edhe të ndonjë gegërishtfolës.

Andaj duke pasur parasysh këto tri fakte, ne kemi pasë shprehim mendimin se trajta e tillë, paskajorja me pjesore të toskëzuar, nuk mund të jetë e qortueshme, në raste të veçanta, në konkurrencë të lire me trajtën e shkurtër të gegnishtes, nëse ashtu e kanë në përdorim toskët (!), sepse kjo është e drejtë e toskërishtfolësve të caktuar, mirëpo. është tjetër gjë, nëse vetë ata ose studiuesit përkatës (që e mohojnë praninë e kësaj forme në sistemin e tyre ligjërimor) për hir unifikimi pajtohen me u përdorë kryesisht vetëm paskajorja me + pjesore të shkurtër, si paaskajore të natyrshme shqipe, siç është, edhe kjo është e drejtë e tyre.

**E treta**, kur është fjala të foljet e tipit **bëj bërë** (me ba) që momentalisht paskajoren e ndeshim të përdorur edhe të Asdreni, në trajtat **me bë (me bërë), me lënë, ose me ba bana/bëra** (jo zakonisht: me bamë, me bamun, me banen), **me lanë** etj. mendoj se për normën e sotme, është më e lehtë me u pranue, siç është propozuar (B. Bokshi), siç e përdor edhe Asdreni në ndonjë rast) trajta **me bë, me lënë**, kur kemi parasysh zgjidhjet ekzistuese në normën e sotme: **bëkam, bëmë-a, i bëshëm, bëzaj; bëzanje, bëzhigoj** (M.Elezi), **lënkam, lënkësh**, e kështu me radhë.

Pra, sido që të jetë, po e përsërisim faktin se **propozim-sugjerimi** ynë mbështetur edhe nga Pasqyra e mësipërme, ku mund të thuhet se edhe Asdreni faktikisht respektonte parësisht trajtën e shkurtër të pjesores së paskajores gege (72 raste) ndaj pjesores së cunguar (raporti 72 me 16) si dhe ndaj pjesores e zgjeruar (72 me 11), ndërkaq edhe pjesoren e toskëzuar të paskajores e ka futur në përdorim vetëm në 14 raste dhe kjo, duke filluar vetëm nga vepra e dytë ËL 4 raste (2+2), PM 5 raste(?) (1+4) dhe KK 5 raste (4+1). Është interesant se në poezinë **Kosovës**, asnjë rast nuk del as me pjesore të cunguar, as me pjesore të toskëzuar. Ndërkaq prej 16 rastesh, përjashtim nga pjesorja e shkurtër bën vetëm rasti *me vdekun*.

Këtë rast po shtojmë se në Komisinë Letrare të Shkodrës, pothuaj del e për zgjedhur trajta e shkurtër e pjesores në kuadër të paskajores së mirëfilltë. Së këndejmi, po e rikujtojmë edhe një fakt tjetër se edhe në gjuhën poetike jo vetëm në atë administrative qëndronte i fuqizuar përdorimi i paskajores me +pjesore të shkurtër. Po sjellim vetëm një strofë nga poezia *I dbuemi* të A. Gj. Fishtës, i cili **Bjeshkëve të Shqiptarisë** u drejtohet kështu:

Oh, ju Bjeshkët e shqiptarisë,  
Ku ma mire ndrit dielli e hana  
E ku asht logu i bujarisë,

E ku rriten djem si zana:  
*Unë ju kurr s'kam me u harrue*  
*Der sa t'm' jet' gjykue me u endë*  
*Der sa t'muj me ligjërue*  
*Ju gjithmonë kam me (j)u përmendë....,*

Mendojmë se duke respektuar trajtën e tillë si Fishta si Asdreni paraprakisht respektonin prirjen e normës së natyrshme globale të shqipes, madje këtë e bënin para se të rekomandohej kjo rregull faktikisht nga Komisia Letrare e Shkodrës (1916-1918), e cila fuqizonte, siç u tha, përdorimin e pjesores së shkurtër në normën e atëhershme të gjuhës shqipe mbi bazë të gegnishtes (jo aq të elbasanishtes për këtë pikë), standard ky që me paskajoren e mirëfilltë ka shërbyer si gjuhë zyrtare me dhjeta e dhjeta vite, sidomos te ne (deri më 1968), andaj sot e mot kërkohet që për hir të balancimit të koineve ekzistuese në normëzimin e sotëm menjëhershmerisht, pa kurrfarë zvarritjeje të integrohet paskajorja e mirëfilltë, e cila vetëm sa e sforcom standardin e sotëm, ngase paskajorja e mirëfilltë i ka fushat e veta të lira për manovrim, të cilat janë të pambuluara plotësisht me elementet e letrarishtes së sotme. Fundi i fundit, edhe Asdreni po këtë e dëshmon në poezinë **Trazim shpirtëror**, shkruar më 1940, prej nga shkëputëm me qëllim këta dy strofa:

Në shpirtin tem shpëthejnë papandehur  
Furtuna dhe shtërngata plot furi  
Si do lëkundje trupi krejt të nxehur  
Ofshama që s'e lane **me u përtri!**  
.....  
Dikur në palcë ndjenja drithmat gazi  
Nga dejt e mi vërshonte jet' e re  
Por fati kur dhurata gjijsh m'i zbraz  
Çdo ditë e bardhë **zu m'u mbushë** me re...

Pra, siç po shihet Asdreni e përdor natyrshëm këto dy paskajore **me u përtri** dhe **me u mbushë**, ku si duket na jep për të kuptuar se ai tashmë paskajoren e tillë, si rast të veçantë pa paradigmata përkatëse gege, e kishte të pëvetësuar natyrshëm në sistemin e vet ligjërimor dhe e përdor vetëm në raste të veçanta kur i nivojitej qoftë edhe si sinonim, për të përmbushur po ashtu nevojat e veçanta.

Sidoqoftë, edhe unë bashkohem me ata që mendojnë e veprojnë se gjithsesi është më i drejtë e më me mend integrimi i paskajores, jo në trajta të tjera, por pikërisht në trajtën e pjesores së shkurtër të tipit: **me mësue, me shkëlqye, me folë, me bë, me lënë**. dhe me këtë zgjidhje që e propozojmë edhe ne bashkë me të tjerë i mundësohet frymëmarrje e re zhvillimit të shqipes standarde mbi bazë të pasurisë dhe vlerave që ka brendapërbrenda vetëvetes, truallit gjuhsor që ka shqipja e natyrshme pa ia prishur komoditetin standardit gjuhësor të sotëm, tashmë të përqaftuar kombëtarisht dhe njëherazi nuk u zihet fryma diskutimeve konstruktive për përsosjen e mëtejshëm të standardit ekzistues.

## **Përfundim**

Në fund të këtij kreu po ritheksojmë se siç u dëshmuar në pjesën e parë të këtij kapitulli gjuha e veprave të Asdrenit karakterizohet me **përzijime** trajtash e fjalësh të shqipes globale, përkatësisht të të gjitha të folmeve të të dy dialekteve. Edhe pse ai si tosk i lindur dhe i rritur pati bazë dialektin e vet, kur filloi të shkruajë në moshë 30 vjeçare përdori gjuhën *me përzijim* fjalësh e trajtash jo të pakta të dialektit tjetër, megjithatë gjuha e tij, duke qëndruar përgjithësisht mbi bazë të dialektit të vet nuk doli artificiale edhe aq më pak e pakuptueshme apo e rëndë, qoftë për shqipfolësit veriorë, qoftë për ata jugorë. Ai me vetëdije, përveç toskërishtes që e kishte gjuhë *të leme*, futi në gjuhën e tij edhe fjalë e trajta gegnishte, të cilën, si me thënë, e kishte gjuhë *të bleme*, në kuptim të *të mësuarit*. Pra, merita e Asdrenit qëndron në faktin se ai e përdori shqipen me **përzijim dialektesh** me synim që të arrihet në një shqipe të përbashkët dhe këtë përzijim sidomos e praktikoj në dy dhjetëvjetëshat e parë të shekullit XX, kur nuk kishte gjuhë të konsoliduar normëzuese as gegërishte as toskërishte, por e vazhdoi edhe në periudhën e Pavarësisë, kur ekzistonte si rekomandim letrarishja mbi bazë të gegnishtes. nga e cila e përvetësoi, si të themi, kryesisht vetëm paskajoren me+pjesore të shkurtër, duke e ruajtur përgjithësisht dialektin e vet toskërisht.

Sidoqoftë, shumica e poezive të tij u shkruan në toskërisht *me përzijim gegizmesh*, ndërsa disa, jo shumë, i shkroi në gegërisht, por edhe këto *me përzijim toskizmesh* dhe që të gjitha këto poezi përbajtësisht, gjuhësisht e stlistikisht, i qëndruan kohës me sukses, duke zënë vend të merituar në libra leximi për filloristë dhe në antologjitë e letërsisë shqipe.

Nga krejt kjo që u shtrua në këtë krye e sidomos në pjesën e dytë, nxjerrim si konkluzion se paskajorja me + pjesore si gegizëm i dalluar gjente përdorim të gjerë në veprën e Asdrenit, madje siç del nga analiza, kjo formë pa paradigmën e veçanta geqe u bë më në fund si një fjalëformë e përvetësuar në sutemin ligfjërëtor të tij. Kur kemi parasysh shumësin e trajtave të pjesores së tillë (të paskajores) në gegnishte mund të thuhet se Asdreni, e përvetësoi formën më të pranueshme të thjeshtësuar: atë me paskajore të shkurtë. Kështu edhe sot kërkohet integrimi i paskajores me +pjesore të shkurtët në në normën e sotme, pra në trajtën përkatëse, e cila edhe është e pranishme në formën e tillë, si p.sh. **mësue** (me mësue), mësues mësuesi, mësuekam, **shkëlqye** (me shkëlqye), shkëlqyekam, shkëlqyeshëm, **folë** (me folë) folje, folkam etj. Ndërkaq **të gjitha trajtat e tjera të pjesores së paskajores së mirëfilltë**, qoftë ato të cinguarat, si: *me mësu*, *me shkëlqy*, *me fol*, qoftë ato me pjesore të zgjeruara: *me mësuen*, *me me mësuemun*, *me mësuenen*; *me shkëlqyem* *me shkëlqyen*, *me shkëlqyemun*, *me shkëlqyenun*; *me folun*, *me folen*, qoftë në ndonjë trajtë me diftong të ndryshuar si *mësuË* (*me mësuë*), *mësua* (*me mësua*), **dalin të panevojshme**. Në të vërtetë përdorimi i trajtave të tilla, si sot si në të ardhmen, me përjashtim të ndonjë idiome a shprehjeje lapidare, besojmë se mund të konsiderohen si mish i egër për normëzimin e shqipes standarde. Për gegërishtfolësit nuk del e natyrshme assesi as trajta e pjesores së letrarishtes së sotme, si mësuar (me mësuar), shkëlqyer (me shkëlqyer) folur (me folur), po nëse toskërishtfolësit e ndjejnë më natyrshëm atë trajtë ose ndonjë trajtë tjetër për të shprehur nocionin e paskajores së mirëfilltë, atëherë ajo është e drejtë e tyre dhe si e tillë mund të dalë e lejueshme, por në konkurrencë lojale.

Pra, jo vetëm unë që për këtë çështje, bashkë me gjuhëtarë të tjerë kemi shprehur dhe arsyetuar mendimin mjaft gjerësisht në punime të tjera rreth dosmosë së integrimimit të paskajores së mirëfilltë me +pjesore të shkurtë në shqipen standarde, por ashtu patën menduar

dhe qenë shprehur shumë para nesh, kur u është dhënë rasti edhe shkrimtarë e gjuhëtarë me emër. Këtu po e përmend vetëm mendimin e prof. Aleksandër Xhuvanit, i cili në një bisedë intime me prof. Selman Rizën, qenka rrëfyer, se paska pasur presione nga individët për ndryshimin e bazës së standardit (nga gegrishtgje në torkërishte), të cilët i ka refuzuar, por presionit plus nga “Kadiu”, ky s’ka mundur të rezistojë, por në mendje I paska shkuar:

**“Po të vihet edhe paskajorja me kohë mund të arrihet edhe në formimin e një gjuhe të përbashkët. (Shih: gazeta Shekulli, Tiranë, 22.11.2011.)**

Prandaj, sot është dita që menjëhershëmrisht Këshilli Ndërkademi i zbatojë legalisht dhe unanimisht dëshirë-këkesën e prof. A. Xhuvanit dhe të xhuvanëve, sheperëve, çabejve e rizëve, por edhe të kostallarëve të rinj, që pa zvarritje paskajoren me + pjesore të shkurtër ta integrojnë në standardin e shqipes së sotme për koncepte të caktuara, dhe kështu, vërtet, nuk e them vetëm unë, por edhe shumë e shumë të tjerë, **normëzimi** do të ketë kompetencë të plotë për me e përfaqësue si duhet strukturën foljore të shqipes, jo të një dialekti, por të **gjuhës së natyrshme shqipe** me të gjitha vlerat kryesore të saj që ka. Nuk është fjala për shartim e arnica, por për plotësim *vakuumi*, shkaktuar për mungesë koncepti, ngase kjo çështje nuk ishte studiuar në hollësi në aspektin sinkronik.



## V. DISA VEÇORI FJALËFORMUESE E LEKSIKORE NGA GJUHA E VEPRËS POETIKE TË ASDRENIT

Në këtë kapitull do të përpiqemi të vëmë në spikamë fjalët që na janë dukur më karakteristike në gjuhën e Asdrenit, qoftë të përzgjedhura ose të krijuara, gjithsesi të përdorura nga autori me anë të ndajshesave fjalëformuese: parashtesave e prapashtesave dhe me anë të kompozimit, si tipe më produktive në fjalëformimin e gjuhës sonë (pa përjashtuar koinenë veriore ose jugore), por në këtë kontekst është prekur dhe ndonjë çështje lidhur përputhshmërinë ose jo me fjalëformimin ose me drejtshkrimin e përbashkët të sotëm .

### A. PARASHTESIMI

Parashtesat më të përdorura nga Asdreni janë: Ç- (SH-, ZH-), M-, N-, PA-, PER-, S- (Z-, C-) dhe STËR-.

#### 1. Parashtesa Ç- (-SH-, ZH-)

Parashtesa Ç- përdoret në shumë fjalë nga Asdreni, madje në vend të simotrave sinonimike SH- e ZH-. Një këmbim i tillë i këtyre parashtesave ka vazhduar deri në ditët tona, përkatësisht derisa kjo çështje u kodifikua në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe (1974). Ja, disa nga fjalët që i ndeshim në veprën e Asdrenit me këtë parashtesë:

a) çnderoj, çlodh, çmend, çmallet, çmallim etj. Në KK çrudhoset 88 dhe çlironjës 28.

b) ç-ja përdoret për SH-në ballore: çfaq, (tfaqet), çfrim, çfrehet, çpërlarë, çpërblimi, çpërthehet, çkulloj, çfytyron, çprovuar etj.

c) ç-ja përdoret për ZH-në: çvendos, çvishte, çvillim, çgryer çbëjmë etj..

**Shënim.-** Mirëpo në veprat e fundit dalin shembuj me SH-në ballore (nistore), si shgjesur (zh): shpërndaj, shquajnë, shkëmbejnë; Si krijime karakteristike a neologjizma muned të konsiderohen këto fjalë: *çbëjmë, çkullojmë, çfytyron, çprovuar, çrudhoset* dhe fjalët: *shpërkënditej, shmbyllje* – e ndonjë tjetër.

#### 2. Parashtesa M-

Në toskërishtën lindore të anëve të Korçës, konstatojnë A. Xhuvani dhe E. Çabej: *M-ja është krejt fonetike*, dhe nga ky dialekt, shtojnë ata, *kanë hyrë në përdorim të gjuhës shumë fjalë*, si mvehtësi, pamvarësi etj. (...) Pra edhe vepra e Asdrenit është e stërmbushur me shembuj të formuar me këtë parashtesë. P.sh. *mpirë, mvar, mposhtonte (mposht) mpronte, mveshur, mveshje, mfsheh, mvrejtjet, mfryhet; mvrojtur, mbirë*; pastaj emri *mburimi* si dhe folje *mburoj* si dhe *mburrje, mplakur, mbërthyer, mvodhi* etj.

Lidhur me këtë parashtesë mund të japim këto konstatime:

-Intensiteti i përdorimit të kësaj parashtese vjen duke u zvogëluar prej veprës në vepër dhe ka raste kur nuk shënohet fare. Kështu Asdreni edhe në këtë pikë i afrohet normës së sotme, si p.sh. PM *mvodhi* dhe në të njëjtën faqe (104) *vjedhur*, pastaj emri *mburimi* në PM del *burimi* pa M-në nistore etj.

-Asdreni zakonisht në vend të grupit konsonantik MB përdor MP, si: mpronjës ËL 125 (për mbrojtës), mprojmë, mpshtetur, mpshtjellë, mprapste (ËL 20), mprim (ËL 125) etj.

-Fjalën MBLËTA që e shënon me M-në nistore ndofta e shkroi duke u bazar në MBLËTËN e THIMI MITKOS apo të Dodanit. Ashtu e shënonin edhe Naimi, Çajupi e ndokush tjetër.

-Zgjon interes formimi i këtyre si: i mverdhur RD 233, ËL mprapstë 20, ËL mbërthe (38, 78, 188, 136), ËL mçel 94, mfytyroj (ËL 148), mpronjës, mprim (ËL).

-Sa për kërshërie po përmend faktin e fjalët (emra) që fillojnë me M-në nistore sa i përket numrit në veprën RD u prijnë atyre me shkronja tjera. Kështu me M- nistore janë 50 emra, me P- 45, me V- 39, me B- 38, me SH- 35 etj. Edhe kompozitat me M nistore, janë në numër më të madh (47) në krahasim me shkronjat e tjera nistore.

### 3. Parashtesa N-

Parashtesa N- nuk është produktive se M-ja. Mirëpo edhe fjalët me këtë parashtesë kanë shtrirje të konsiderueshme: ndritin, ndritmë, ngjallnë, e ngjallme, nqasen, ngazëllim, ngjëronj, ngjasin, ndëpagesatë (ËL 175); Te PM: ngjizur dhe KK ngjizej, nguronin (141) Dhe po në këtë vepër (KK) del fjala ndreri (148), ndryshkur 29, ndëpagesatë, e cila ka nevojë të sqarohet. Në RD161 ndeshëm rastet: *i gadaltë* dhe *shpërdaj*, ku nuk del e shënuar shkronja **n**.

### 4. Parashtesa PA-

Kjo parashtesë, e cila u shtohet sidomos emrave abstraktë të cilësisë edhe të emrave prejfoljorë të veprimit që u jep një kuptim të kundërt, është shumë prodhimore tek Asdreni. Numri i fjalëve me këtë parashtesë shtohet prej veprës në vepër. Pasqyra e përdorimit duket kështu:

RD: 8 raste, d.m.th. një në 458 rreshta;

ËL: 16 " 1 " 242;

PM 28 " " 1 " 142 " dhe

KK 40 1 në 96 rreshta.

Asdreni nuk njihë sinonimet e kësaj parashtese MOS- ose JO- që në kohën tonë janë bërë mjaft prodhimore. Sigurisht për shkak të një mospërdorimi të tillë parafjala PA- pati një përdorim gjithnjë e më të dendur. Po dallojmë disa nga shembujt më karakteristikë: *të pashteruar, të pavidrë, pafundje, të pazbutur, i papëlqyer, i pangarë 26, panjoftime, të patrandur (KK 19) dhe gjithashtu KK 55 të patundur, të palëkundur.*

Veçojmë krijimet: *paukunguar* (PM 108), ku edhe *pjesëza* ngjizet bashkë me parashtesën dhe fjalën kryesore, dhe fjalët *panjoftime* (ËL 140) dhe te KK *me pametë* (53).

### 5. Parashtesa PËR-

Parashtesa PËR-, e cila shpreh kuptim përforcues e ndonjëherë edhe krahasues ka mbetur pak prodhimore në kohën tonë sa i përket ndërtimit të mbiemrave prejfoljorë e të tjerë, nga Asdreni përdoret mjaft dendur. Është më e përdorura në krahasim me parashtesat e tjera. Në se cilën vepër ndeshim, përafërsisht nga 40 shembuj me këtë parashtesë. Po përmend vetëm disa nga fjalët e tilla:

*RD: përgëzonin, përndaj (shpërndaj KK 112); ËL: përgjithërisht 7, të përbashkuar 22, përshtëllqimi 65, përlindje 42, 74, përmendore 72, përrurime 128, PM: përkul, përflak, përball, përshkuar etj. si dhe përrushtohet 142, përvujtësisht 116 (dhe KK: përvujtje 30, 37); KK: përfillje 10, (përfill 67 si folje), u përleshnë 75, përminjeri 121,*

*përgjunjur 125, përbuzje 119, përbri, përmbush, përshesh etj.*  
Edhe nga këta pak shembuj, mund të vërejmë krijime cilësore.

## **6. Parashtesa STËR-**

Me parashtesën e mirëfilltë STËR- me të cilën shprehet nuancë e zmadhimit a të teprisë krijohen disa fjalë farefisnie a origjine që i gjejmë edhe te Asdreni si p.sh.: stërgjyshërit a stërgjyshët, (trollit) stërgjyshor; stërnipër. Përveç tyre në veprën e Asdrenit me këtë parashtesë ndeshim krijime me të cilat shprehet një intenzitet lashtësor kohor a përforcues të veprimit me një ngjyrim të kuptimit, pa u larguar nga strumbullari:

P.sh. *stërvjetër (PM 19) si dhe te KK: stërfundje 14, stërpiku 15, stërpiqu (në prush) 120, stërmagjie 50, 116, stërhollë, stërhollësi 65 etj.*

## **7. Parashtesa të tjera**

Në dy veprat e fundit Asdreni shtiu në përdorim disa parashtesa, me origjinë parafjalore që nuk i kishte përdorur më parë, të cilat, edhe pse me shtrirje të kufizuar, gjejnë përdorim sot e kësaj dite, si

NËNË: nënëkëmbim (PM 55), nënëkëmbësi (KK 122), nënëdheshme (KK 66),

MBI: PM mishkrim dhe KK mbishkrim 44,

NDËR: ndërgjegje (KK 63 dhe 66),

RI: ringjallje (PM 37), risbukurimi (112 PM), me të cilën parashtesë emërohet një veprim që kryhet sërish;

PARA: paragjykim (46 PM), parahistorik (KK 14);

TEJ: tejpertej (KK 121);

TËR: KK tërhiqet 114, tërhidhem 111.

Kështu në veprat e fundit kemi edhe shumësi parashtesash, të cilat bijnë në sy, si krijime mjaft cilësore.

## **B. PRAPASHTESIMI**

Prapashtesimi është mënyra më prodhmtar i ndajshesimit në gjuhën shqipe. Gjuha ghupe ka tri herë më shumëprapashtesa se parashtesat (Xhuvani – Çabej) dhe kuptimet e tyre fjalëformuese janë më të shumta e më të larmishme se kuptimet e parashtesave, prandaj edhe fjalët me prapashtesa zënë vendin kryesor në fondin e leksikut të shfrytëzuar, të krijuar ose të përdorur nga Asdreni.

Edhe në këtë nënkapitull kemi cekur vetëm disa nga krijimet që na u dukën më karakteristike Dhe këtë e bëmë me qëllim që të fitohet së paku njëfarë ideje mbi kontributin e Asdrenit në përzgjedhjen, sjelljen a krijimin e fjalëve të reja dhe të vihet re fjala gjejeje, e cila si pronë e leksikut ka gjetur jetë në kontekstin e ligjërimit poetik të Asdrenit..

### **1. Prapashtesa -AK (-ARAK)**

Me këtë prapashtesë janë krijuar disa emra a mbiemra banorësh si dhe fjalë mbiemra a emra me kuptim përkatësor apo keqësues. Kështu dalin edhe tek Asdreni fjalët e formuara me këtë prapashtesë.

Kështu në veprën e parë RD kemi vetëm dy fjalë : fshatarak e fusharak. Në ËL nuk kemi asnjë rast, ndërsa te PM tri raste: varfanjak, gjysmak e vërcak. Në veprën KK kemi 12 shembuj: dredharak, varfanjak, burracak, vërcak, rencak, çpifanak?, lëvdarak, prendverak, dredhak, dinak, rosak, vjedharak.

Edhe L. Pogradeci krijoi fjalë me këtë prapashtesë: vraparake, brumake, lotak, varfanjak.

## 2. Prapashtesa -AR, -TAR

Me prapashtesën -AR, (-TAR) formohen kryesisht emra profesioni prej temash emërore, përkatësisht emra (prej emrash) që tregojnë njerëz të karakterizuar sipas veprimi që kryejnë. Një prapashtesë e tillë duket shumë aktive dhe pati një përdorim gjithnjë e më të madh në veprat poetike të Asdrenit. Në veprën e parë RD janë 13 fjalë, në ËL 30, PM 38 dhe KK 69 fjalë. Po përmendim disa nga krijimet duke i tërhequr vëmendjen lexuesit në nuancimet apo efektet stilistike që jepet paksa nga vetë fjala përkatëse, forma e saj:

Në veprën RD ndeshim fjalët: *atdhetar, shqiptar, kombëtar, kordhëtar, mendimtar, gënjeshtar* etj. Pastaj: *detëtar, peshkëtar, ushtëtar*, mirëpo që në veprën ËL heq dorë nga ortografia e tillë naimjane me *-tëtar*, tash e shënon trajtën me -AR: *ushtar*, ndërsa *detëtar* e vazhdon, aty f. 23, por ndeshim edhe trajtat: *detërak*, kështu, si me thënë, anon drejt trajtave që sot janë më të përgjithësuara, të cilat edhe priren të nguliten në normën letrare. Asdreni e krijoi fjalën *vetar* për murg, por edhe *vetar* RD 166 për të burgosurin në qeli (birucë). Tek ËL, ndër të tjera dalluam këto krijime: *qeshëtare, lirimtare, dheshkrimtare, mundëtare, mpronjëtar*, nuancimi kuptimor e stilistik i shembujve të tillë duket se nuk mund të zëvendësohet me sinonimet përkatëse si p.sh. qeshëse, çliruese (liruese), gjeografike(!), mundëse (ngadhnyese), mbrojtëse etj. Në këtë vepër kemi mbiemrin *shkollar* (vitin shkollar ËL 128) për *vitin shkollor*, siç është përvehtësuar në normën e sotme. Në veprën PM na ranë në sy krijimet *rrugëtori* (për kalimtarin a okupatorin), *mendar(ë)* (me kuptimin dijetar apo shkencëtar), pastaj *besëtar* (besnik), *amatar* (çun mamake, qaraman!), *shkreptimtar*. Po në këtë vepër kemi për të parën here, me sa pamë fjalën *letrare* 53 (gjuha letrare), si dhe fjalën *milënar* që te KK del mijëvjetshar (18, 50). Edhe në veprën KK ndeshim krijime të tilla, si: *vegimtar(e), flijimtare, lakmimtare, dëfrimtare, shkëlqimtare, mëshirtare, vrapimtare, lodërtare* etj.

Edhe këto krijime ndoshta janë aq në numër të konsiderueshëm, pasi Asdreni nuk ka krijuar fjalë me prapashtesën -(UE)S, d.m.th. nga pjesorja geqe, sinonime këto që nuk mund të zëvendësojnë ngjyrimin stilistik dhe kjo mbetet veçori e stilit asdrenian. Në këtë vepër për të parën herë në poezi gjejmë fjalët e stilit libror: *zyrtare, mesjetar, grunare* (për hambar, drithnik) etj.

Krijime të këtij tipi ndeshim edhe në veprën e L. Poradecit: *vetëtimtar, thëthimtar*, si dhe te Çajupi: *lodërtare, motëmoçare*, e H. Mosi: *dëshimtar* (për martir dëshmor).

## 3. Prapashtesa -I,(-Ë)RI (-NI), -SI

Me anë të prapashtesave -I, -(Ë)RI (-NI), edhe -(Ë)SI formohen emra abstraktë, përkatësisht me kuptim cilësie të gjinisë femërore, dhe për hir të specifiikës së krijimit të fjalëve të tipit të tillë, duke u bazuar në veprën e Asdrenit po shënojmë njëherë disa nga fjalët me prapashtesën -I edhe -(Ë)RI dhe pastaj ato me prapashtesën -(Ë)SI.

**a. Prapashtesa -I** u bashkohet kryesisht temave të emrave e të mbiemrave për të krijuar fjalë a emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë të tyre si dhe emërtime të degëve të ekonomisë a të profesioneve. Edhe prapashtesa -(Ë)RI u shtohet fjalëve për të formuar një numër emrash me kuptim abstrakt ose përmbledhës. Vërejmë një numër të konsiderueshëm shembujsh me këtë prapashtesë që gjenden në veprat e Asdrenit, si: RD: *liri, trimëri, djelmuri, vëllazëri, dituri, dinakëri, lumtëri, vorfni, pleqni(!)*, etj si dhe fjalën *shtyrani* (fatkeqësi, dështim); ËL: *lumëri* (krh. lumtëri), *antikëri, tregëti, djallëzi, madhëri, madhështi, filozofi* etj. PM: *siguri, pleqëri, mituri* etj. KK: *shoqëri, dhempshuri, therori, rini, shpejti* (105) etj. Pasqyra e numrit e këtij tipi fjalëformues sipas veprave del kështu:

**Tabela e numrit të shembujve sipas veprave**

Vepra	Numri i fjalëve	Numri i rreshtave	Përqindja	Një fjalë në rreshta
RD	25	3631	0,68 %	145
ËL	23	3879	0,59 %	164
PM	32	3959	0.80 %	124
KK	40	2890	13%	72

Siç po shihet nga tabela në veprën e fundit kemi një shtim numri, gjë që tregon prodhimtarinë e këtij tipi fjalëformues në atë fazë. Mirëpo tipi që tash është aktiv dhe produktiv kryesisht për formimin e emrave abstraktë kur temave të mbiemrave të nyjshëm me prapashtesën–SHËM u shtohet prapashtesa -(Ë)RI, tipi *vazhdueshmëri, ligjshmëri*. Pasi nga Asdreni nuk përdoren fare shembujt e tillë, supozojmë se krijimet me këtë prapashtesë (-shmëri), janë më të mëvonshme.

**b) Prapashtesa -(Ë)SI**, e cila u shtohet kryesisht temave të atyre mbiemrave që mbarojnë me zanoren –Ë të patheksuar, siç janë grupet tingullore –ËR, –ËL si dhe të disa mbiemrave dhe emrave që mbarojnë me bashkëtingëllore të tjera dhe që shqiptohen në përgjithësi në rrokjen e fundit, zgjojnë kërkshërinë e lexuesit, sepse paraqet një specifikë në fjalëformimin e këtij tipi të emrave në veprën e Asdrenit. Në të vërtetë, është i vetmi tip i fjalëformimit që numri i shembujve zvogëlohet në veprat vijuese në krahasim me veprën e pare RD, siç shihet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela e emrave me -SI**

Vepra	Numri i fjalëve	Numri i rreshtave	Përqindja	Një fjalë në __ rreshta
RD	28	3631	0,77%	130
ËL	17	3879	0,46%	228
PM	22	2890	0. 55%	180
KK	17	2890	0,57%	170

Siç po shihete në veprën e dytë ËL kemi rënie sa i përket shumësisë së përdorimit të këtij tipi fjalësh, ndërsa në veprën e tretë e të katërt shihet njëfarë shumimi numrash, por aktivizimi nuk është si në veprën e parë RD. Ja disa nga fjalët e këtij tipi: RD: *ndrysi, vobësi, gjaksi, tradhësi, harbutësi, vjershësi, vrapësi, unjësi, mbrësi* etj. Disa prej tyre përsëriten edhe në vepra të tjera. por shembujt: *kënaqësi, atdhësi, lumtësi*, nuk përsëriten në dy veprat e fundit. Po ashtu ndeshim shembujt: *urtësi, ëmëlsi, fatbardhësi, mirësi, madhësi, paturpësi, kombësi (kjo vetëm në PM nuk përdoret), ligësi, qetësi* etj. ËL: *paqtësi, mundësi, mjekësi, fatkeqësi, malësi* si dhe fjala *risi* (e cila del edhe te PM). Në të vërtetë në PM, për të parën here dalin këto fjalë: *paudhësi, kaltërsi, butësi, zemërligësi, miqësi, kthjelltësi, pavdekësi, bashkësi, përjetësi, gjerësi, cilësi, lartësi, shenjësi si dhe hyjësi, dorëplotësi* e ndonjë tjetër. Dhe të gjithë këta shembuj sot janë fjalë aktive në fondin themelor të fjalësit të gjuhës shqipe. Edhe te KK nënvizojmë këto fjalë të këtij tipi: *letrësi, ndritësi, stërhollësi, vjetërsi, vështirësi, kotësi, mendësi, padrejtësi, shenjtësi, zotësi* etj., që, me sa pamë, dalin në përdorim për të parën herë.

Kështu Asdreni krijoi ose vazhdoi me shfrytëzimin e krijimeve të këtij tipi, tip ky që ishte i pranishëm edhe te shqipshkruesit para dhe gjatë kohës së tij. Në të vërtetë, atëherë u krijuan shumë fjalë të këtij tipi që disa u përfshinë e disa jo në fondin themelor të fjalorit e gjuhës sonë letrare. P.sh.: Naimi: *mjerësi, Gurakuqi: 5* (vend) *shkretësije*, Mosi: po fjalës *vjershësi* që e përdor dendur, përdor edhe fjalën *këngësi, pastaj flagësi* etj., Siliqi: *ndjekësi (kryengritja)*, Poradeci: *pastërsi, vegëlsi, përbrendësi, erë-fshehtësi, dlirtësi* si dhe *ndryshmësi* etj.

#### 4. Prapashtesa -IM

Prapashtesa -IM bashkohet me temën pjësore të shkurtër e në raste edhe me trajtën e kohës së tashme të foljeve që mbarojnë me -OJ dhe EJ (pjesërisht) dhe formon emra abstraktë që pos kuptimit të veprimit, mund ta kenë edhe kuptimin e rezultatit të veprimit.

Ky tip fjalëformimi është popullor dhe gjeti përdorim të madh në veprat e Asdrenit. Në RD janë 75, ËL 108, PM 99 dhe në KK janë 75 fjalë të këtij tipi. Ja disa nga fjalët e këtij tipi, sipas veprave:

- RD: *lirim (për çlirim), nderim, lakmim, tradhëtim, fillërim (166), qetim (për qetësim), ëmbëlsim, përfytyrim, kuxim (për guxim)* etj.
- ËL: *mjaftim, robërim, habim, përshkëlqim (128), ngjatjetim (65), përrurim (128), mbrim (për të arriturit) 110, mprim 126 (mbrojtje), mallim 145 (mallëngjim), derptim, premtim, shtërrim, bekim* etj.
- PM: *amëshim, arësim, bërtim (112), buçim, dërmim, fullim, dorëshkrim, kobim, kremtim 11, dhe kremtërim 160, lavdërim 142 dhe lavdim 163 dhe lavd-i KK 11.15, 72, panjoftim, qytetërim, shugurim, mishkrim* etj.
- KK: *botim, drithtërim, egërsim, frushkullim, frymëzim, fjalim, paragjykim, përkujtim, kërsënim, ligjërim, mohim, mbretërim, përmallim, ngashërim, ngadhënim, përparim, paçmim, shpagim, shpartallim, shërbim, veprim, vendim, vëllim, zbukurim e risbukurim* etj.

Dhe nga shembujt e tillë mund të konstatojmë jo vetëm pasurimin e fjalorit shprehës të

Asdrenit, por shohim sadokudo edhe pasqyrën e zhvillimit të gjuhës sonë që në ato faza, por njëherazi paraqesin interes, ku mund të vërehet cilësia e fjalëve të reja që zgjodhi ose krjoi Asdreni për veprën e vet.

Edhe H. Mosi është i stërmbushur me emra të këtij tipi: mallvajim, dëshrim (dëshirë), dashunim, trathitim, flatrim, shpresim, flladim/heshtim. Gurakuqi: dishrim, Siliqi: vegim (pamje fantastike) etj.

### 5. Prapashtesa -JE

Emrat prejfoljorë të veprimit me prapashtesën -JE formohen nga të gjitha pjesoret e foljeve konsonantike, po jo zakonisht nga foljet me -OJ dhe -EJ, të cilat, si u tha, marrin zakonisht prapashtesën -IM. Edhe ky tip fjalëformimi prej veprës në vepër ka ardhur duke e shtuar numrin e shembujve si dhe dendurinë e përdorimit: RD 13, ËL 35, PM 54 dhe KK 74. Pra shumësia prej veprës në vepër del e shtuar për 20 fjalë.

Në veprën RD nënvizuar fjalët: *vërejtje, mirëdashje*. Tek ËL: *fundje, pafundje, përkujdesje* (dhe te PM 8), *pritmje, përlindje, nënëqeshje, symbyllje* 155, etj. Te PM: *msytje, lusje* (=lutje) *fryjtje, vdirje, mirë veshje, përqsasje, buzëqeshje, mirë - ritje, zë-ringjallje* etj. Te KK: *përfillje, stërfundje, mirëqenie, mirënjohje, nqasje, mbledhje, përvujtje, mirëbërje, mirërroitje, mirëprimitje, kryengritje, vetëdije, ndërgjegje, mbarëvajtje, përbuzje*, etj.

Edhe R.Siliqi përdor: padukje; H. Mosi: ardhje (për ardhmëri, e ardhme).

### Prapashtesa -ESË

Me prapashtesën -ESË janë formuar nga tema foljesh të zgjedhimit të parë, emra sendesh e veglash në kohën tonë, por nga Asdreni nuk kemi raste të tilla të shumta, pos ndonjë shembulli, si *ndërtesë, fortesë, shtresë*.

Kjo prapashtesë u shtohet kryesisht temave të foljeve që mbarojnë me -OJ, sikurse mbaresa -IM dhe shumica e këtyre emrave me prapashtesën -ESË shprehin rezultatin e veprimit, gjithsesi pasqyrojnë kuptime konkrete, Ndërkaq emrat paralelë të formura mbi të njëjtën temë prodhuese formuar me -IM ruajnë zakonisht kuptimin abstrakt të veprimit, si p.sh. ankim - ankesë. vonim - vonesë etj.

Në veprën e parë RD kemi fjalët: *fillesë, shtresë, ngatresë*. Tek ËL: *shërbesë, pagesë, krijesë, /krh. ndëpagesatë 175/*. Në veprën PM: përsëritet fjala *fillesë* (nga RD), *krijesë* (si te ËL), pastaj *shpërblesë* (5 herë), *shtresë, qindresë* dhe KK *qendresë*, pastaj po te KK *shpërblesë, krijesë, mbikrijesë, martesë, mungesë, ndërtesë*. Vetëm fjala *shtresë* përsëritet në të katër veprat. Lazgushi: shëmbëllesë.

### 7. Prapashtesa -(Ë)S

Me prapashtesën -(Ë)S formohen emra njerëzish të karakterizuar sipas veprimit që kryejnë apo profesionit a punës që bëjnë. Numri i fjalëve në veprat poetike të Asdrenit me këtë prapashtesë nuk është i madh: RD 1, ËL 3, PM 9 dhe KK 17 fjalë, qofshin emra apo mbiemra. Në RD hasim fjalën: *mësonjës*, tek ËL *mundës, gjykatës, mpronjës (mbrojtës)*, te PM: *arritës, mirëpritës, kryengritës, jetëprusës, mundonjës, mohonjës, depërtonjës, përdhes, presë* 152 (nën presë pallo). Edhe te KK: *paslindës, lajmëronjës, pushtonjës, vezhgonjës, kalorës, ngadhënonjës, depërtonjës, kryengritës, lëfronjës, krijonjës, mësonjës, kryeprijës, mundës, endërronjës, largtingëllonjës, Hyjlindës, mjekës* 82 (që nuk është krijim për rimim).

Asdreni nuk përdori asnjë emër a mbiemër të tipit *dëgjues*, që prapashtesa -S t'i jetë shtuar pjesores geqe të foljeve me -UE, trajtë kjo që ka hyrë në gjuhën e sotme letrare dhe ka një traditë përdorimi të gjerë dhe në shumë raste i ka mënjanuar në gjuhën e sotme letrare trajtat paralele të tipit më -onjës që përdor Asdreni, të cilat janë krijuar nga trajta dialektore e dialektit jugor të së tashmës së foljes . Krahaso: *mësues/mësonjës*.

Edhe Siliqi përdor: ndjekës (për kryengritës), Noli kalorës, çlironjës, gjakpirës, Gurakuqi: presë (=pritje), H. Mosi: largtës; Lazgushi: vetëditës, therorës.

## 8. Prapashtesa -OR, -TOR, -SOR

Kjo prapashtesë, në shqipen e sotme letrare, është prodhimtare, sidomos në formimin e mbiemrave, por në veprën e Asdrenit del prodhimtare edhe në formim emrash banorësh. Madje kjo prapashtesë prej veprës në vepër, ka shumësi të konsiderueshme. Krahaso: RD 5, ËL 23, PM 51 dhe KK 67.

- Te RD veç shembujve: *punëtor, tradhëtor e shërbëtor* që kanë kuptimësi neutrale, pa ndonjë ngarkesë stilistike, kemi edhe nja dy raste (vjersha) *fushore*, si mbiemër dhe *madhështorisht*, si mbiemër i formuar me prapashtesë ndajfoljore ka kaluar në ndajfolje.

- Tek ËL fjala *madhështor* përdoret 4 herë, te PM 11 herë dhe te KK 12 herë, pastaj po përmendim edhe disa shembuj: *gjelbërore, faltore, mpronjëtorë (mbrojtës), kafshore, përmendore, këngëtare, muzikore, qiellore, engjëllore, hyjnore, dashurore, trimënore, shekullore, vjershëtor, gjator* etj.

- Te PM: *dykrenore (dhe dykrenare), mjeshtërore, syverore, hijësore, hyjnore, zëhyjnore* etj. Kemi edhe mbiemrin edhe me nyje të përparme edhe me prapashtesën: *i çmendur*, që nuk është krijim për rimim, si krijim rasti që mbetet i vetmuar (ndoshta për i çmendur).

- Edhe te KK dalluam këta mbiemra, epitete të qëlluara: *qumështore, shembullor, princërore, malësore, krishtërore, kujtimore, shkumbore* etj.

Po përmendim edhe ndajfoljen: *terthori* (për terthorazi). Dhe pothuajse shumica e fjalëve të këtij tipi të përdorura nga Asdreni kanë përdorim të natyrshëm, pos disave, por që mbeten si epitete shumë të qëlluara që ia ngrejne vlerën poetike veprës dhe vlerësohen si veçori e stilit poetik.

Ja edhe disa fjalë të këtij tipi të krijuara apo të përdorura nga shkrimtarët tjerë: H. Mosi: *dashnore/fatbardhësore, vjershmiksore/përmallore*; Noli: *vdekurore*; Gurakuqi: *flatutore* etj.; Lazgushi: *paqtore, helmori, vajzërore, gjeratore, pikëlore, botor, vrerore, vjeshtore*.

## 9. Prapashtesa -OSH

Prapashtesa -OSH shërben për të formuar mbiemra cilësues të drejtpërdrejtë përkatësor, Mbiemrat e drejtpërdrejtë ose kanë kuptim keqësues ose përkdhelës. Mbiemra a emra me këtë prapashtesë në veprat e Asdrenit nuk zënë numër të madh, por zgjojnë interes ata me kuptim përkdhelës.

- Në RD: *bukuroshe, (syçkat) bukuroshe, vogëlushe, bardhoshe dhe përshëndosh*.

- Tek ËL: (duart) *vogëlosh, (vasha) bukuroshe, O bukurosh 37 dhe fatosh (37m, 162 , t*

- Te PM *Fatos 13*). Po përmend edhe fjalën *Balash*, që afrohet me krijimin popullor: *balë, balosh*. PM: *pikaloshe, bardhoshe, lavroshe* (krahëshpejtë), pastaj *Bukuroshi (143)* si emër i përvetshëm.

- Në KK kemi fjalët: *djalosh, pastaj vogëlosh, bukuroshe, bardhëlosh, syzioshe*.



Edhe te R. Siliqi edhe H. Mosi ndeshim fjalët *fatos* edhe *fatosh*, si dy fjalë. Noli e ka *trimosh*, ndërs Lazgushi *fatos*, *finosh*, *vogëlosh*, *turpëroshe*, *përvëlosh*, *zbukurosh*, *fatmiroshe*.

### 10. Prapashtesa -(I)SHT, -ISHTE, -ISHTË

Me këtë prapashtesë formohen ndajfolje dhe kjo është mjaft prodhimtare dhe në veprat e Asdrenit ka gjetur përdorim. P.sh. RD: *madhështorisht*, *burrërisht*, *turqisht*, *arabisht*, *greqisht*; ËL: *trimërisht*, *shqiptarisht*, *burrërisht*, *përgjithërisht* (në prozë); PM: *dhëndërishte*, *pleqërishte*, *dhelpërisht*, *përvujtësisht*, *djallëzisht*; KK: *shoqërisht*, *shkëlqimisht*, *zakonisht*, *trimërisht*, *verbërisht*, *fluturisht*.

Lazgushi: *dhemshurisht*, *pleqërisht*, *murisht*, *çmendurisht*, *stëgjyshërisht*, *tmerrisht e tmerrësisht*, *madhërisht*, *llaftarisht*, *gjeratorisht*, *lirisht*, *shakërishte*, *armiqërisht*, *blatisht*, *varrisht*, *miturisht*.

Dhe me këtë rast vëmë re cilësinë kuptimore të ndajfoljeve përkatëse brenda kontekstit. Mirëpo me që ra fjala lidhur me ndajfoljet po cekim kalimthi edhe disa krijime pa këtë prapashtesë që mund të zgjojnë interesim, si: RD: *mbrëmanet*, *pakëz*, *njërësh* (për njëherit). ËL: *asgjekundi* (si përemër i pakufishëm), *ngaditë* (për ditëpërditë); PM: *sadopak*, *mrëmësore*, *ndaj natë herë*; KK: *papritmas*, *fluturimthi*, *dorëhaptas*, *mbatanë*, *sa më lartas*, (*rreze*) *zjarrtas* etj. Parafjala *pakës* përsëritet edhe te PM edhe KK.

### 11. Prapashtesa -SHËM

Kjo prapashtesë është shumë prodhimtare, sidomos në shqipen e sotme dhe shërben për formimin e mbiemrave të nyjshëm prej temash foljore, emërore dhe ndajfoljore. Nënvizojmë disa shembuj nga veprat e Asdrenit:

*ËL: të perëndishmë, e mallënyjëshme, të mallëshm, PM: e shijshme, KK: e pashme, e famëshme, i nënëdheshmë (66) etj. Ndërkaq, në veprën PM dalin krijimet pa këtë prapashtesë: në t'ardhmen, i paqm, etj. dhe te KK: e pritme, e përditme, i fundmi,*

të cilat po kështu, shumica kanë gjetur përdorim në gjuhën e sotme letrare. Por sa i përket drejtshkrimit të këtij tipi me -SHËM konstatojmë se në të shumtën e rasteve Asdreni i shkruan në mënyrën arkaike me -SHMË fundore. Mirëpo, në veprat e fundit përdor trajtat me SHËM fundore. Kjo kishte të bënte me gjininë mashkullore, ndërsa mbiemrat e gjinisë femërore të këtij tipi Asdreni, i përdor ashtu siç u normëzuan në drejtshkrimin e sotëm.

12. Mbiemrat prejfoljorë janë përdorur dendur nga Asdreni, madje mund të konstatojmë se tipi me mbaresën e pjesores së tipit -UAR (-UE) përdoret më dendur, edhe në vend të tipit me -SHEM. Kështu, Asdreni, në të vërtetë, nuk njih nuancimin e kuptimit të këtyre mbiemrave sinonimikë. Ja disa nga shembujt:

- RD të pavdirë (= të pavdekshëm), i pajuar (= i pajisur), i pasteruar (= I pashterrshëm dhe trajtat si: i çmenue (= i çmendur) të vrapuara, i qetuar (i qetësuar).

- ËL: i përbashkuar (i bashkuar, unik), i krahëshkuar = me krahë të shkruar.

- PM: i paqm', e pafundme (= e pafund); e pakufire (e pakufi, e pakufishme a e pakufizuar).

- KK: t'armatuer (= të armatosur), i ashpëruar (i ashpër, i ashpërsuar), të nemosur (të nemur), PM i gatuat (= i gatshëm).

Edhe këto formime gjejnë analogji me klasat e ndryshme të fjalëformimit dhe si rrjedhojë janë të kuptueshme, mirëpo jeta e mëvonshme gjallërimin e mënyrës së tillë fjalëformimi nuk e pranoi si model të mbështetur prodhimitarisht.

Nuk i trajtuam fjalër me –IMË, por po konstatojmë, se Asdreni përdori edhe krijime të tilla.

### PASQYRA E NUMRIT TË FJALËVE ME PRAPASHTESA SIPAS VEPRAVE

Nr. rendor	Pr a p a s h t e s a	V e p r a			Gjithsej	
		RD	ËL	PM		KK
1.	–AK(-ARAK)	8	-	3	12	23
2.	–AR (-TAR)	13	30	38	69	150
3.	–I (RI/NI)	25	23	32	40	120
4.	–SI	28	17	22	17	84
5.	–IM	73	108	99	75	365
6.	–JE	13	35	64	74	186
7.	–ESË	3	4	5	8	20
8.	–(Ë)S	1	3	9	16	29
9.	–OR /TOR,-SOR/	5	25	51	67	148
10.	–OSH	5	3	3	6	17
11.	–(I)SHT, ISHTË, ISHTE	4	4	5	14	27
12.	–SHËM	7	16	7	14	28

Siç po shihet nga tabela, vetëm prapashtesa -SI nuk pati zhvillim progresiv. Madje, u përdor në numër 67më të vogël në veprat e botuara në Periudhën e Pavarësisë. Prapashtesa -IM, pothuajse u përdor në një numër të njëjtë fjalësh duke pasur parasysh numrin e rreshtave të secilës vepër veç e veç. Të gjitha prapashtesat e tjera, pos ndonjë rasti përjashtues, patëm shumësi përdorimi.

### 13. Rreth krijimit të disa foljeve me prapashtesën -O(J) e të tjera

Prapashtesa -O- pa zgjerim dhe ato, O me zgjerim, -RO, -TO, -SO, -ZO, -JO-, është tipi më produktiv dhe aktiv në gjuhën shqipe. Ne jemi ndalur në trajtimin e disa foljeve që janë krijuar nga Asdreni, në bazë të analogjisë dhe janë krijime të frymës popullore, por nuk kanë gjetur përdorim në atë trajtë në gjuhën tonë të shkruar. Madje, disa krijime të këtij tipi ka mundësi, veç stilit neutral, tash e në të ardhmen të aktivizohen në gjuhën poetike, si:

*RD: ngjyroj* (që tashti është: ngjyros), *kqyroj* (këqyr), *fillëron*, *qetohem*, *mvrejtton* përzijim (përzijoj!);

*ËL: borëton* (tash mbetet shprehja: bie borë).

Dhe në këtë vepër del folja *ngjyroj* (por që është e pranuar në gjuhën e sotme letrare si dhe folja ngjyros). Përmendim foljet: *duk'e mpruar/fare të dobtuar* (për mbrojtur dhe dobësuar),

*fryjtim (fryjtoj), ndrijon, mposhtoj, gjallëson;*

PM: mposhtoj, kam fajtuar, d.m.th. *fajtoj* që sot përdoret: fajësoj. ndritoj, vranoj, pajon, Pastaj folja *namatis* për: nëm, lëshoj, nëmë.

KK *armatuar armatoj, vogloj, flakroj, pshtjelloj, ngjitoj ngjitim, stërpiku, kaptoj, mësyjt, mbështuall/mbuall kryqos, shpërdridhet, të shterojnë,*

Mirëpo krijime të tilla me -O(J) e që nuk përkojnë me normën gjejmë edhe te shkrimtarët tjerë: R. Siliqi: tundoj (për tund, trondit), dhimbësoj, fatoj (uroj), kushtrimoj, çapova (bëra hapa), tokojti (toka luajti vendit) çapriti (eci), etj. Gurakuqi: zbutohet, Lazgushi: djellëson, qjellëson, botëson; H. Mosi: filladoj, lutoj (lus), shmallohem (shmallem), ndirësoj 119.

### C. KOMPOZIMI

Kompozimi është mënyrë shumë frytdhënëse në fjalëformimin e gjuhës sonë. Me anë të kompozimit formohen kryesisht emra e mbiemra dhe një numër i kufizuar foljesh e ndajfoljesh që kanë në përbërjen e tyre dy a më shumë tema motivuese.

Në veprën e Asdrenit ndeshim disa lloje kompozitash dhe kjo mund të quhet si veçori e stilit poetik asdrenian. Nga numri i tërësishëm i kompozitave përcaktore e në raport nënrenditës në veprat e Asdrenit si tipe më të njohur kompozitash dallojmë:

1. Kompozita të krijuara nga pranëvënia, si: RD: gjëkafshë; ËL: dashamir; PM: ballafaqe, gjëkundi, gjësend, që dalin edhe te KK, pastaj: grek - dhija, flamur kuq - zi; ËL: jongo-bobota; PM: djelë-zogë, detimbret Adriatik, pushka-lule, lule-dashuri, lulja-mbret; KK: fytyrë-shenjtorë, Fron-Shkëlqimi e ndonjë tjetër.

2. Emra të përbërë të formuar nga dy tema emërore (emër + emër prejfoljor i vepruesit) me prapashtesën -(Ë)S: ËL: *verëshitës, hyjlindës*; PM: *bukëprurës, jetëprues, fatrëfenjës, kryengritës, udhëheqës*; KK: *gjakderdhës, femohonjës, kryeprijës, hyjnor kombonjës, ligjvënës, mbretër-prijës, keqbërës* etj.

3. Kompozita emër + emër prejfoljor veprimi i formuar me prapashtesën -JE apo -IM që e tregojnë veprime abstrakte:

a. Me -JE: ËL: *vetëdije*; PM: *mirëdashje, mirërritje, mirënjohje, mirësjellje, marrëveshje, vetëvrasje*; KK: *kryengritje, mirënjohje, mirërritje, mirëpritje, mirëbërje, mbarëvatjtje*.

b. Me -IM: ËL: *dheshkrim(tare)*, PM *dorëshkrim, falenderim*; KK: *gjak-trazimi, lulja-ngushëllimi*.

4. Kompozita në përbërje emër + emër çfarëdo: RD: *atdhe* (që përsëritet në të gjitha veprat), *atdhesi* (dhe te ËL e KK), *atdhetar, atdhetari, dritë-ari, fatbardhësi* (edhe te PM), *kryelartësi*, ËL: *fatkeqësi, mendje arti, vendlermi*, PM: *burrë-lufte, burrëmali, burrëtrim, ballë areopagu, bujë lajmëtari, dorëplotësi, gojëtagare, frymënëmë, dhempallë, symëshqerrë, sylugate, sygjarpush, trupqen, ujë-ergjend, lundërthyeri*; KK: *degë-ulliri, gojëdhënë, gjeldeti, kukuvaje, kurorë-ylberor, kurorë-lavdije (qjellore), mendjedlirti, mendjelarti, symëshqerre, shpirtflori, shtatselvije, shkumb-ergjendi, shpirtmurtajë, shpirtvogëlinë, trupkërthinjtë, vajguri*.

5. Mbiemra (a emra) të përbërë të formuar nga tema emërore + tema mbiemërore (ndajfoljore), si:

ËL: lulekuqaja; KK: buzëkuqura, trupmadhi; RD: ditëshkurtër, dritëpaktë, degëgjelbër, degëgjjerë, zemërmirë (edhe tek ËL); ËL: fatbardhë, fuqimadh, faqezbehta, faqebardhë, fletëgjelbër, faqekuqe, fatmirë, majëmprehtë, mustaqezi, mendjelartër, menjdeshkurtër (edhe te PM), syëmbël, symadh, zemërdlirë, zemërmath. PM: buzëthartë, gushëbardhë, filedlirë, fatbardhë, fatkeqe, faqezi, krahëshpejtë, këmbëdrejtë, jetngratë (edhe te KK), fytyrëtharë, mendjelehtë (edhe te KK), mjekërmprehtë (edhe KK), ngjyrëbukur, ngjyrëverdhe (edhe KK, ngjyrëzverdhe), syshtrembër (edhe KK), systrembur, sygjallë, zemërzi, zemërluk, kokëtrashë. KK: barkthatë, famëmadhe, faqekthjellta, flatragjerë, fatbardhë, fatlume, shkallëartër, zemërgjerë, mes-hollë, mendjeshkretë, syziosh, zemërbardha, kokëthinjët, fytyrëthartë, faqebardhë, llërëbardhë, mustaqegjatë, majëramta, mendjeshkurtë, mendjehollë dhe zemërmadhi etj. Pastaj: RD: plotfuqishmë; PM: magjiplot (edhe te KK), hirplot, dritëplot, dorëplot, degëplot, fuqiplot (edhe te KK); KK: fatlum, dorëhaptas, shumëngjyrta.

6. Prefiksoid (përemër a numëror) + emër: ËL: vetëdijë, vetëvrasje, PM: ytbir, KK shumëherë, shpeshherë, tetëkëmbës (edhe te PM). Këtu janë përfshirë edhe kompozitat me prefiksoidin KRYE-: RD: kryelartësi, ËL: kryelartër, kryelartë, kryengritës, PM: kryemadhështor, kryenaltë (kryelartër, kryelartë), kryetatëpjetë, kryevepër, kryeverë. KK: kryezot (kryezotër), kryeprijës, kryembret, kryevend, kryelartë, kryetrim, kryengritje, kryeqytet, kryevepra,

7) Emër + pjesore. RD: buzëqeshur (që është përhapur në të gjitha veprat), krahëshkruar; ËL: vetullmvrenjtur (edhe te KK), zemërthyer, zemërdjegur, zëheshtur, zemërpikur, kryeunjur, shpirtndritun, sykulluar, synxehur; PM: dritëmveshur, dyerçelur, gojëhapur, faqeshuar, fismallkuar, fytyrëngrysur, këpucëngrysur, shpirthelmuar, shpinëthyer, faqejenjtur, luleshkruar, systrembur, syshtrembër, sykulluar, symvrenjtur, vetullmvrenjtur, sypërgjakur, pamjeçelur;

KK: kryepshtetur, faqendritur, luleshtruar, mesprerë, majëprehur, shpesëdashur, shpirtkulluar, shpirtbekuar, mirëshkruar.

Kështu duke trajtuar kompozitat në veprën e Asdrenit mësojmë sadopak mbi llojllojshmërinë leksikore që përdor Asdreni dhe nxjerrim konkluzionin mbi modelet ekzistuese të formimit të kompozitave që njëherazi pasqyrojnë jo vetëm prirjen, por edhe pjekurinë gjuhësore të poetit në kohëhapësirën përkatëse.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë lidhur me shtimin e kompozitave prej veprës në vepër po japim tabelën e mëposhtme:

**Tabela e numrit të kompozitave sipas veprave të Asdrenit**

Vepra	Numri I Kompozitave	Numri I rreshtave	Përqindja	Një kompozitë në rreshta
RD	17	3.663	0,47%	214

ËL	61	3.879	0,56%	64
PM	122	3.959	3.08 “	32
KK	130	2.890	4.49%	22

---

Krahas me zhvillimin sasior duhet theksuar edhe krijimet cilësore të kompozitave si epitete të qëlluara efektive.

Kompozitat janë mjaft të llojlojshme, vend të dukshëm zënë përftimet nën ndikimin e gjuhës së krijimeve popullore. P.sh. Shumica e kompozitave si temë të parë kanë fjalët nga pjesët e trupit (të fytyrës): sy\_\_(21), zemër\_\_(22), faqe\_\_(13), krye\_\_(18), buzë\_\_(6), dorë\_\_(8), gojë\_\_(6), krahë\_\_(6), pastaj ballë, bark, fytyrë, dhëmp(b), shtat, mustaqe, llërë, trup, vetull etj., si dhe kompozitat me fjalën (temën) përkatëse, si gjymtarë të pare, si shpirt\_\_(14), fat\_\_(10) etj.

Edhe pse nuk mund të themi se ishim shterues, nga lënda që u trajtua në këtë kapitull kemi bindjen se të fitohet përshtypja për modelet më karakteristike të fjalëformimit që i shfrytëzoi Asdreni në krijimtarinë e tij. Pra njëherazi sadokudo mësojmë edhe për veçoritë e fjalëformimit të gjuhës sonë në ato faza të caktuara kohore që i shfrytëzoi autori, por edhe për krijimet vetjake të tij si veçori specifike autoriale e poetit.

Nga fjalëformimi vetvetiu del interesimi për lëksikun e veçoritë stilistike që po I trajtojmë në vijim.



## VI. DISA NGA VEÇORITË LEKSIKORE E STILISTIKE TË GJUHËS SË VEPRAVE TË ASDRENIT

Edhe në kapitujt e mëparshëm u njohëm deridiku me disa nga veçoritë leksikore, por edhe për ato nën hije me elemente stilistike të veprës poetike të Asdrenit dhe siç pamë pos ca lëshimeve periferike dhe krijimeve të natyrshme specifike të gjuhës së shkrimtarit, u konstatua se leksiku i Asdrenit praktikisht mund të cilësohet si fjalor themelor në kuadër të gjuhës shqipe të periudhës përkatëse kohore. Është konstatuar, pra, me të drejtë se Asdreni është vijues drejt gjuhës letrare të kodifikuar parimisht duke e shpënë më tej konvergjencën ndër-dialektore, pra, duke qëndruar në toskërishten si bazë, dialekt të cilit i takonte organikisht, mirëpo ai nuk mbeti i mbyllur brenda kornizës së atij ngase ai nuk e rrudhi dorën në prurjen dhe përdorimin e fjalëve ose të trajtave të gegërishtes. Siç mësojmë nga biografia e tij Asdreni si gjuhë shkolle fillimisht pati greqishten, pastaj si gjuhë shkolle e buke pati rumanishten, ndërsa si gjuhë kulture (lingua franka) pati frëngjishten, por ai për fat të shqiptarisë si gjuhë shpirti zgjodhi dhe e ruajti ligjërimin shqip, të cilin e barti nga vendlindja, por duke e brumosur e pasuar atë jo vetëm me fjalë, por edhe me idetë e rilindësve, të cilin do ta mësojë e perfeksionojë jo vetëm si gjuhë marrëveshjeje me bashkëkombasit në Rumani e në vendlindje, por edhe si gjuhë të *lartuar* me të cilën do të shkruajë vepra të pavdeshme shqiptarie, Në të vërtetë, Asdreni duke qenë, si të themi, nxënës i veprave të Naimit, ai eci në vazhdë të asaj gjuhe, por edhe ky si Naimi, bile shumë më tepër se ai, duke synuar një gjuhë shkrimi të përbashkët futi në gjuhën e tij gegizma, të cilat do t'i ketë mësuar duke konsultuar shkrime në atë dialekt që botoheshin në publikime të ndyrshme, siç ishin publikimet shqipe në Rumani, Sofje, Egjypt etj, por aq më tepër do ta mësojë shqipen nga zëmadhja **Albania** e Faik Konicës, me të cilën bashkëpunoi, ashtu si edhe Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, A. Xhuvani e të tjerë. Kjo çështje rreth konstatimit të veçorive të gjuhës së Asdrenit deri më sot nuk është trajtuar mjaftueshëm ose hollësisht siç e meriton, prandaj në këtë kapitull do të përpiqemi që nga veprat e Asdrenit të hetojmë paksa, si qëndron:

- së pari, raporti rreth dialektore e kombëtares
- së dyti, raporti i fjalëve të huaja dhe ndërkombëtarizmave,
- së treti, denduria të përdorimit të disa fjalëve dhe sjellja e risimeve,
- së katërti, konstatim rreth prekjes së fjalëve për shkak rimimi dhe
- së pesti, do të paraqesim një fjalorth me disa fjalë karakteristike me interes që na imponohen nga veprat e tij.

### 1. Dialektorja dhe kombëtarja në leksikon e veprave të Asdrenit

Nga analiza që bëmë në kapitullin përkatës pamë konkretisht shembujt që përkojnë e që nuk përkojnë me normën drejtshkrimore në krahasim me letrarishten e sotme, dhe kjo është krejt normale, kur dihet e vërteta se Asdreni ishte nën ndikimin e të formeve dialektore, madje edhe të atyre që atëherë ishin të papërpunuara, por ndër to pati edhe elemente koenizimi, sido mos pas Komisië Letrare të Shkodrës, ku sadokudo u vijhëzua një normë mbi bazë të gegnishtes,

andaj disa trajta e fjalë enë të pranueshme nga ajo normë, por nuk mingojnë së pranuari as në normën e mëvonshme të sotme letrare. Sidoqoftë po përmendim më poshtë disa raste dialektizmash:

Së pari, në gjuhën e tij vërejmë, si të themi, koinenë korçare, të cilën ai e barti me vete, të cilat si korçarizma nuk ishin të qortueshme në atë kohë, ngase ato i ndeshim edhe te Naimi e të tjerë, si: *arth, shkovi, lusje, rohtë, djerset, ujat, ty (për ti), e tija, luanj, ndryshonja, të tregonja, mbuallnë (mbollën)* etj., por mund t'i ketë përvetësuar dëgjimisht nga kolonia ose edhe nga rrethi ku jetoi në Bukuresht e Konstancë, ku kishte të mërguar në numër të konsiderueshëm, pikërisht bashkëvendës, nga treva e Korçës. Nuk përjashtohet te ai edhe ndikimi i folklorit, të cilin ai e lexoi me andje madje edhe e studio aq mire sa që qe në gjendje të mbajë ligjëratë rreth kësaj teme.

Së dyti, përdori ose kopjoi ndonjë shkrodranizëm, si **Shqypni, papra** (pandërpre), **nanë, zotni** etj., ngase konsiderohej se dialekti shkrodran ka pasur pak a shumë strukturë më të formëzuar në histori se sa edhe elbasanishtja madje edhe se vetë toskërishtja në përgjithësi

Së treti, përdori elbasanizma, të cilat në parim edhe rekomandoheshin se gjoja janë të përbashkëta toske /gege, edhe pse koha vërtetoi se ato nuk ishin krejt ashtu siç dëshmon edhe evoluimi jo i rregullt njëtrajtësor i pjesores etj., siç ishte edhe rasti i ballinës së veprës së së tij parë të trajtave: *shejtnumun lulzumun..*

Sidoqoftë ne nuk do të ndalemi në përimtime të tilla, ngase nuk e shohim edhe shumë të rëndësishëm këtë fakt, sepse dihet e vërteta, se të gjithë shkrimtarët rilindës në radhë të parë reflektuan veçoritë e të folmeve të vendlindjes a të trevës prej kah rridhnin me synim si të themi , si një grumbullimi material, i cili do të përpunohej ndërkohë. Duke nxjerrë në shesh thesarin e asaj pasurie, qoftë si fjalë, qoftë si trajta mme të cilën do të manipulohej në gjuhën e shkrimit të veprave, andaj në këtë plan edhe puna e Asdreni nuk përjashtohet nga ky kontekst, Mirëpo, megjithatë mund të thuhet sot se Asdreni me gjuhën e tij doli pararendës drejt gjuhës letrare të kodifikuar pas LDB, ngase ai që në ato dy periudha, duke ndenjtur në bazë të dialektit toskë por me *përzijime gege* ndihmoi konvergjençën ndër-dialektore pa nënçmuar asnjërin dialekt, parim ky që u ruajt në normën mbi bazë të gegërishtes, por edhe mbi bazë letrarishtes së sotme. Po të shikojmë mire na del e vërteta shsazi se Asdreni që në fillim të shkrimeve të tij, nuk ishte rob i asnjëres së folme a dialekti. Prandaj, mund të thuhet se ai nuk është imitues i vërbër i asnjërit dialekti, por ishte nxënës i dinjitetshëm i veprave të rilindësve tanë, si të Naimit, të Samiut, të Faik Koncës, por edhe i gegërishtshkrueve përkatës, veprat e të cilëve pati mundësi t'i konsultonte.

E shohim të nevojshëm të përsërisim faktin se ne kemi bindjen se Asdreni leksikonet e para mbi gjuhën i mësoi dhe i servoi pikërisht në qorthullin patriotik të Bukureshtit. Ku qenë botuar veprat e bartësve të kulturës gjuhësore poetike të rilindësve tanë prijatarë, veprat e Naimit, të Samiut, të Vretos dhe shkrimet tjera, ku qarkullonin apo gjendeshin më me lehtësi publikimet e kohës se kudo gjetiu. Së këtejmi Asdreni pati fat t'i ketë dhe t'i lexojë dhe të pajiset me veshën gjuhësore e poetike të tyre dhe kështu edhe vetë të japë në këtë drejtim kontributin e tij dhe jo aq modest.

Pra sipas kushteve të tilla del se Asdreni fillimisht u pajis me elementet e dialektit jugor, resp. të të folmeve të Dangëllisë: Përmetit, Beratit e Korçës dhe gjithashtu thithi fjalë a shprehje nga dialekti ose të folmet gege që pati mundësi t'i mësojë parësisht nga shkrimet e



ditës, jo vetëm nga revista *Albania* e Faik Konicës, por edhe nga botimet e shkodranëve, elbasanasve e të tjerëve.

Si përfundim mund të thuhet se Asdreni u indikua fillimisht nga stili libror-publicistik, por edhe nga folklori i botuar në gjuhën shqipe, por shumë shprehje i përvetësoi edhe nga gjuhët e huaja, të cilat i shfrytëzoi për të përkryer profesionin e vet poetik, por edhe duke bërë përkthime e adaptime të qëlluara shumë të sukseshme, ky ndihmoi dhe gjuhën e prozodinë poetike të shqipes. Shikuar në tërësi gjuha e Asdreni del gjuhë që i takon normës globale shqipe gjithëkombëtare e më pak asaj thjesht njëdialektore, gjithsesi gjuha nga kjo pikëpamje (shqipes globale) del më e gjerë, më gjithpërfishëre, jo vetëm se noma mbi bazë të gegnishtes (1917), por edhe se norma e shqipes së sotme (1972).

## 2. Fjalët e huaja dhe ndërkombëtarizmat

Rilindësit bën punë të madhe dhe të mbarë sa i përket pastrimit të gjuhës së shkruar shqipe nga barbarizmat, sidomos turqizmat, por edhe nga greqizmat, sidomos ato që nuk kishin zënë rrënjë në gjuhën tone dhe heqja të cilave nuk prishte kuptimin themelor të ligjëritimit shqip. Shumë koncepte të fjalëve të huaja u zëvendësuan me fjalë të gurrës shqiptare, qoftë me fjalë e shprehje të veçanta vendëse, qoftë me kalkëzime, gjithnjë duke u mbështetur përgjithësisht në shtrukturën e gjuhës shqipe. Pothuajse shumica e krijimeve të tilla gjetën vend edhe fjalësin e krjuesve letrarë, madje edhe në stilin e administratës, kur u imponua një nevojëë tillë dhe kështu mbeten si fjalë aktive në ligjërimin shqip, duke zënë vend edhe në fjalorët normativë që u hartuan më vonë. Në këtë kontekst po përmendim faktin se Asdreni në RD për fjalën **autor** përdor fjalën **bërësi**, ndërsa në ËL **auktori** Ndërkaq për ndërkombëtarizmen **etimologji** në RD e sajoi kompozitën **antikofjalëtorie**. Siç dihet përpjekje për heqjen e fjalëve të tilla të huaja vazhdoi edhe më vonë, madje vazhdon edhe sot, por megjithatë në veprat e Asdrenit mbeten disa fjalë të huaja, si:

RD: (era e *lipës* 160 sll, për blirin), ËL: bosh (zbrazët)132 (turc.), meprizoj (fr.)PM: avlli (oborr) dhe porta (derë)22 (më) udob (përshtatje) 90 stërvinë (kërmë) stapin (shkop), (sll.), nakar (mëni) (turq. kurmi levarash etj.

por disa nga fjalët e tilla sllave përdorëshin edhe nga N.Mjeda e të tjerë. Por më dorëilirë, si me thënë në përdorimin e sllavizmave ishte Risto Siliqi, në veprën e të cilit ndeshëm sllavizmat: *samokresë, tresje, mashtë, tugë, stërvinë, kollutë, zhallogë, llozinka, truba, sadfe, me zhigatë, zharrishte, pollaba, me piskatë* etj., andaj ato fjalë te Asdreni nuk mund të cilësohen si barbarizma me kuptim të vrazhdë të fjalës. Lidhur me këtë vlen për t'u theksuar se në fazën e dytë të krijimtarisë së tij e sidomos në veprat e tij të fundit Asdreni në vjershat e veta futi në përdorim bukur shumë fjalë e terme të stilit shkencor-kulturor, që ndonjëra pej tyre përdorej edhe në veprat e para, si:

RD: *kalimera* 115, *aristokrat* 115, maqjavelike, që të trija me ngarkesë stilistike.

ËL: *auktor*, *Metudhë* 58 (për metodë), *fantoma* 119 (për fantazmë-a).

PM: *egoist*, *harmonim*, *gama*, *verbi*, *symboli*, *symfoni*, *magjistar*, *hypokrezi*, *myster* (dëshirë) *pagane*, *nymfë*, *historianë*, *violije*, *mythik*, *verbi fanatik*, *vandalë*, *kritikë*, *gramatikë* etj.

KK *avuketër*, *opera*, *akademira*, *muzera*, *institute*, *primadona*, *parlamenti*, *opozita e guverna*, *politikanë*, *ministre*, *diktoresha*, *pastaj bulevarda*, *teatro*, *nadile*, *evari* etj.

Siç mund të vërehet, sidmos në 2 veprat e fundit janë future në përdorim mjaft fjalë ndërkombëtare nga lëmi i kulturës. Një dukuri e tillë ishte e theksuar sidmos në vitet e '30-a

Në të vërtetë, fjalë të shkencës vërshuan edhe tek shkrimtarët e tjerë. Ato lindën edhe si nevojë që shtronte koha. Madje në këtë kohë edhe kriteri lidhur me përdorime të tilla filloi të zbutet.

Po e përmendim edhe një veçori tjetër. Në fillet e shkrimeve të dhjetëvjetshit të parë të shekullit tonë poetët shqiptarë kishin praktikuar që të vënë moto dedikimi, madje në gjuhë të huaja para veprave apo vjershave të veta. kështu veproi edhe Asdreni. Ai në veprën e parë RD ka një moto (latinisht) mbi Skënderbeun, të cilit ia kushton tërë veprën. Në veprën e dytë ËL kemi nja katër moto e disa citate në gjuhë të huaja, pa i përkthyer në gjuhën shqipe, por të gjitha këto me ngarkesë stilistike, si p.sh. Zonjën Durhan e quan "*alma mater*", të cilës edhe ia kushton veprën. Në veprën PM kemi një rast (moto), kurse në veprën KK asnjë citat a moto në gjuhë të huaja, mirëpo siç pamë, kemi shumë fjalë ndërkombëtare.

Pa marrë parasysh sa më sipër mund të thuhet se Asdreni u ruajt nga barbarizmat, madje në shkrimet e para edhe nga fjalët ndërkombëtare dhe kështu me të vërtetë gjuha e tij del e dliurur nga barbarizmat, por në fazën e pjekurisë intelektuale e fizike shtiu në përdorim shumë fjalë e terma kulture e shkence.

### **3. Denduria e përdorimit të disa fjalëve dhe sjellja ose risime me polisematizëm**

Fondi themelor i fjalësit të gjuhës së Asdrenit përkon me natyrën e thurjes së temave dhe shtjellimit të ideve që trajtonte. Ai përdori fondin aktiv të gjuhës së pastër popullore dhe në fjalorin e spastruar të rilindësve, të cilët e patën harrë sadokuso gjuhën nga barbarizmat dhe e patën vënë në binarë të drejtë, të mbarë.

Fjalori i Asdrenit është i pranishëm edhe sot në të folmet e përditshme, me përjashtim të atyre trajtave arkaike ose tejet dialektore, të cilave u ka ikur koha. Pra, shikuar në tërësi pothuajse i tërë leksiku i Asdrenit mund të përdoret edhe sot kur kemi parasysh llojet e ndryshme të stileve shprehëse funksionale.

Siç dihet pati batica e zbatica në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, por mund të konstatohet se në përgjithësi zhvillimi i shqipes pati ecuri të mbarë pozitive, andaj edhe gjuha dhe jeta e fjalëve në veprat e Asdrenit vijimisht erdhi duke u begatuar dhe është njëfarë pasqyre simbolike e realitetit të rritës gjuhësore të shoqërisë shqiptare në ato periudha të caktuara historike.

Sa ishte entuziast në veprën e tij të parë për t'u shërbyer temave aktuale të kohës tregon kjo pasqyrë krasimtare e dendurisë së përdorimit të disa fjalëve (emrave) sipas katër veprave të tij:

**Tabela**  
**e dendurisë së përdorimit të këtyre fjalëve**

Fjala	Denduria e përdorimit sipas veprave				Gjithsej
	RD	ËL	PM	KK	
-----					

Shqipëri	54	25	13	6	98 herë
Atdhe	31	17	7	6	61
Skënderbe	18	13	-	2	33
Shqiptar	18	13	2	5	38
Mbret	15	1	1	2	19
Zjarr	24	10	14	8	58
Zemër	30	32 (8+5)	39 (31+8)	10 (8+2)	111
Dashuri	23	4	4	3	24

Sqarim.- Fjalët *shqiptar*, sidomos *zemër* në veprat e fundit dalin edhe si gjymtyrë përbërëse të kompozitave.

Denduria më e pakët e përdorimit të këtyre fjalëve nuk do të thotë se Asdreni nuk trajton tema të tilla apo tash këto fjalë janë terme periferike, përkundrazi kjo tregon se Asdreni tash posedon një fjalor më të gjerë të leksikut dhe sa i përket kësaj mjafton të kujtojmë kapitullin përkatës lidhur me krijimin e fjalëve prej veprave në veprë se sa fjalë të reja na dalin, sidomos të kujtojmë kompozitat që u trajtuan më parë, por diçka do të ripërmendet më poshtë.

#### 4. Konstatime rreth prekjes së fjalëve për shkak rimimi

Kritika ka konstatuar me të drejtë se shumë fjalë Asdreni i krijoi ose i ndryshoi për hir rimimi. Lidhur me rimimin mund të bëjmë këto tri vërejtje: cungimi i fjalëve, përdhunime e krijime trajtash për hir të rimës që disa prej tyre mund të cilësohen të përligjura e disa jo.

Sidoqoftë, të shohim sipas veprave, disa shembuj cungimi, përdhunime edhe përshtatje për shkak rimimi:

##### 1. RD

Raste cungimi për hir të rimës kemi në veprën e tij të parë RD *Shkumb* /*plumb* 83 (për Shkumbinin), *prej engjell/shembëll* (123), ku mungon mbaresa rasore, *si akull/një mërakull* (192).), kemi nja dy raste të cungimit: *u jap këshillë/si prifti Ungjillë* (32) - më e natyrshme: Ungjillin), *q'i japin/t'u kllasin drap'in* (60)-për draprin. Pastaj: *trumpetat/pushkat të pametat* (88); *ndrit/i qit, tradhësi/(Shqipëri), tradhëtim/lirim, vullnesë/të pabesë, keqfate/(shkoj e vate), me nerue/nji i çmenue (i çmendur), fillërim/hidhërim, vjershësi / lumtësi, vrapësi /qetësi, i pavdirë/mirë*

Siç shihet nga shembujt cungimi bëhet dhe fare nuk vëhet apostrofi.

Edhe te Siliqi: *Shkumbi si drap)/me vrap* 101 (është fjala për drapër e jo për drap, dajak.

##### 2. ËL

Edhe tevepra e dytë ndeshim përshtatje të tilla, si: *të qohin/njohin* (126); *me verë rush-zi/ me ha e me pi* (188); *udhë/metudhë* (50); *e mermerta/të tmerta* (28); *të shkreta/ të mprehta (thonj)* (28) Pastaj: *vrapim/gjallim, habim/kerkim, (ujqër) të urëtuar/e paftuar, qeshëtare/udhëtare, fatosh/bukurosh, lirimtare/shqiptare, të pavdirur/për t'u thirrur, lirimtare/shqiptare, të pavdirur/për t'u thirrur, trimi/përshkëlqimi, lavdim/shkëlqim, pasje/rasje, të bashkuar/shpirtndrituar, fryjtim/adhurim, fillërin/ndëprin (mbrojtje), agimi/qetimi/mburimi, rini/përsëri, përrurime/fitime, ngjatjetime/mësim, baloshe/vogëlushe*

etj.

### 3. PM:

Nga vepra e tretë volëm këta shembuj: *zerit tem/ kur të mos jem (8) - ku kemi le / flamur e atdhe (13. Pastaj: ngadhënore/përmendore, luftar/milënar, të lumit/për tej shumit, rrugtarit/shqiptarit/të parit, shkomëzore/pjellore, kombit tem / të pruri qem, kobimi/shkëlqimi, besëtar/mburtar, engjëllush/djallush, jetëprusës i njëj provoji/kroji, shkreptimtare/fare, ikonollast/ në çast, me pandehne/ jetën teme, kurmi lavarash / batën që të çash, bukëprurës / n'ujt'e gurrës, prej thellimit / cingarimit, më çik/mik, qamatar/margaritar, hyjësose/qiellore)* etj.

### 4. KK:

Edhe në veprën e lënë në dorëshkrim ndeshim shembuj të tillë: *syt' e ndritur / me të shtrihur (125), bohem/shpirtin tem (132) mburonjë / si mpronjë (63) – mpron. Pastaj: dërgata/dhurata, shenjtore/krishtërore, levdata/nata, trimoshe/bukuroshe, pleqësishte/miqësishte, babës/shkabës, ngadhënore/tingëllore, pamje shkreptimtare/stërfundje vegimtare, ushtetore / tinëzore, shangullor/qetësor, kuajsh të flakruar/të pushtuar, shigjeta majeramta/emëra të famta, flijimtare/mijvjetshare, një kalor / sygazmor, madhëri/përsëri, gjëmitare/dëfrimtare, smirtarët/të parët, shpagimin/trimin, grunare/kombëtare, metale/fëmijët e çdo lale, madhështore/lulëzore, Gjinokastra/ngastra (si Sami Frashëri. për provinca), bardhëlloshë/bukuroshe, i ashpëruar/ për të kërkuar, sgerbonjë/shkabonjë, pranverore/dhempshurore, anije të tmerrta/mbetn të shtërta, kujtimesh/frushkullimesh, Përendimi/risbukurimi, resë / presë etj.*

Një dukuri të tillë e shfrytëzuan edhe të tjerë si b.f, H. Mosi, nga vepra e të cilit shënuam: *zjarrmuer/ndërduer, mejdana/nana, bukurushë/vejushë, Shqypni/tretni,dritësue/për mue, miksose/përmallore, tingllueshme/ dëshprueshme, dashtnimin/mërgimin etj.*

Dhe nga këta shembuj e tillë shihet se, pa përjashtuar ndonjë përdhunim, vende-vende bëhern zgjidhje me zhdërvjelltësi, sidomos në veprat e fundit të Asdrenit, qoftë në sjelljen e fjalëve të reja apo të ndërthyerjes së trajtave për rimim. Trajtat jo të rëndomta për sot nuk janë të parëndësishme, ngase, edhe pse krijime të imponuara me motiv rimimi, ndonjëra prej tyre mund t'i qëndrojnë kritikës, fundja edhe kështu jepet kontribut në lëmin e fjalëformimit.

## 4. Fjalorth i disa fjalëve të karakterit inspirues

Është i drejtë konstatimi se Asdreni "nuk kursente mundin që fjalën e vet poetike ta bëjë sa më të bukur e kuptimplotë" prandaj kjo vlen edhe për zgjedhjen e fjalëve, krijimin apo sjelljen e tyre në gjuhën e shkrimit. Për pasurimin e gjuhës, Asdreni krijoi edhe neologjizma, veç atyre që u përmendën kalimthi më lartë, këtu do të ndalemi paksa:

**së pari**, rreth disa shembujve për të cilët nuk mund të polemizohet në aspektin e gjuhës poetike të autorit, por fgjithsesi në kuptimin neutral rreth shtrirjes së tyre për fusha e nënfusha të tjera semantike. Si fjalë të tilla që dallohen ose inspirojnë me karakteristikën e tyre për shtrirje në stilet përkatëse po përmendim këtu disa shembuj:

a) Me parashtesën **Ç** (tash SH-: *çrudhoset* (88), *çkulloj* - që e shterr për pikë, me fund; *çbëjmë* (180) – prishim; *çfytyroj çfytyron*), por *çprovuar* - tash *sprovuar* etj.

b) Me parashtesën **PËR**: *përndaj*, *përshtëndosh*, *përfytyroj*, *përgëzoj*, *të përbashkuar* - kjo fjalë tashmë është duke u përdorur me kuptim përforcues, siç e përdori edhe autori; *përshkëlqim*, *përlindje*, *përpushtoj*, *përkujdesje*, *përmendore*, *përfillje*, *përqasje*, *përshtëndosh* etj.

c) me parashtesën **M**- *mfytyroj*, *mprim* (mproj/mbroj) *mbrojtje-a*; *mpronjës* - mbrojtës; *mpruar* (42) - mbrojtur; *i mposhtuar* -i mposhtur etj.

ç) Përdorime **me prapashtesa** të ndryshme si: *fatkeqësi*, *dështim*, *vettar* - *vetmitar* (në qeli); *madhështorisht lumtësi* (që përdoret vetëm në dy veprat e para *fryjtim* - *freski-a*, *veprimi* i të fryerit të erës; *fillërim* (128), i vetëm, *fill*, *robërim* (28) – *robëri*, *fatosh* – *fatos*, *lirimtare* - për çlirimtare *paqtësi* - me nuancim kuptimor, *mundës* - *ngadhnyes*; *shkreptimtar* ,*pamje shkreptimtare* -*vegimtare kaltërsi* –*përjetësi*; *bardhoshe* *ebardhëllosh*, *hyjësore* - që ka të bëjë me *yje*, *hyjnore*, *risi* etj.

d) Fjalë ndërtimesh **të ndryshme** si: *mirëdashje zhdrivilloj*, *dërptonte* – *trondiste*; *shpërkënditoj* – *shpërndahej*, *pafundje* (177) - gjen përdorim më të gjerë te PM; *ndëpagesatë*, *dojë-a* - *dashje*, *dëshirë*; *besëtar* - nuancim ndaj fjalës *besnik*; *ringjallje*, *shpërblejë* ; *qindresë* - *qëndresë*; *palla* - *shpata*; *shprovojë* - *sprovojë*, *çik- prek lehtë*, *stërpiku*, *stërkulluar*, *risbukurimi*, *rushkullimë*, *kredh*, *krrye*, *vetëdije* –*ndërgjegje* etj.

Shembujt e sipërshënuar edhe nëse nuk janë krijime të autorit, vetvetiu prania e tyre në gjuhën e tij tregon aftësinë e poetit për përzgjedhjes, sjelljen dhe përdorimin me vend të fjalëve të rralla. Me fjasë të tjera, Asdreni shprehej "i pakënaqur me pasurinë e fjalëve të deriatëhershme të shqipës", ai u gjind mrekullueshëm me gjetjen e fjalëve të veçanta për të shprehur vegimet e ndjenjat që i përjetonte me të gjitha stërhollësinë e tyre.

**Së dyti**, kritika letrare ka konstatuar me vend se Asdreni i solli risi letërsisë shqipe jo vetëm me vjershat patriotike, por edhe me lirikën e dashurisë, me atë të natyrës, si dhe në lëmin e poezisë meditative, madje ai vlerësohet edhe për faktin se e pasuroi letërsinë shqipe edhe me motive të letërsisë europiane e botërore, Me fjalë të tjera, duke e pasuruar thesarin vet fjalësor ai e pasuroi njëherazi dhe atë të gjuhës shqipe me xhevahire të çmueshme, me fjalë e mënyra shprehjësore të reja "delikate e stërmagjike". Pa hyrë në hollësi të tjera, siç është cekur më përpara në veprën e Asdrenit vërejmë veçori foljeformuese ose emërformuese mbi bazë prejfoljore, jo vetëm mbi prapashtesat –Oj , si qetoj (qet+Oj), fulloj (full+Oj) por edhe me kuptim përshkallëzimi nga tema e njëjtë, si: përktdhel - përkëdheloh, këqyr – kqyroj, por edhe ato me –O të zgjeruar, siç janë shembujt: gojëzoj (gojë+ZOj), thrimoj (thri+MOj) fërmoj (fër+MOj), fillëroj (fill+ëROj), dëmnon (dëm+NOn), çkombësoj (ç+komb+ëSOj), fryjtoj (fryj+TOj), kremtoj – kremtëroj (kremtë+ROj), drithëroj e drithtëroj (dridhë+ROj) , pësenjëzoj (pësenjë+ZOj) etj Dhe së këtejmi analog sikurse flijoj (fli+JOj, magjijoj

(magji+JOj) u përftua edhe përzijoj (përzi+JOj), përkatësisht prejfoljori **përzijim**, qoftë nga pjesorja (me) përzi, qoftë nga prejfoljori pandajshesor përzijë-a, sikurse dojë-a etj.

Një prirje e tillë foljeformuese, ashtu si edhe përftimi i disa kompozitave, edhe në qoftë se dikuj i duken jo aq të pranueshme, shikuar nga struktura fjalëformuese e shqipes së sotme, krijimet e tilla asesesi nuk mund të jenë të qortueshme në gjuhën poetike. Andaj përpjekja e tillë e Asdrenit duhet vlerësuar drejt. Kjo duhet vlerësuar pra si veçori e gjuhës poetike autoriale. Sidoqoftë, vetë përpjekja ose metoda e punës së Asdrenit në këtë drejtim ka rëndësinë jo të vogël që ndikoi jo vetëm për periudhën kur veproi, por edhe për kohën tonë e të ardhmen e gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të asaj poetike në veçanti.

Po e përmbyll këtë paraqitje me një strofë të poetit shkëputur nga poezia me titull **Trazira shpirtërore**, shkruar më 1940, ku shihet gjuha e përkryer me përzijim e poetit që duket si me na lënë amanet paskajoren me + pjesore të shkurtër me këta dy shembuj: **me u përtri** dhe **me u mbushë**, duke na cytur që kjo çështje të studiohet dhe të zgjidhet, madje bashkë me ndonjë çështje tjetër gjatë rishikimit të rregullave të shqipes së sotme letrare kombëtare:

Në shpirtin tem shpërthejnë papandehur  
Furtuna dhe shtërngata plot furi,  
Si do lëkundje trupi krejt të nxehur  
Ofshama që **s'e lanë me u përtri**.

Dikur në palcë ndjeja drithmat gazi  
Nga dejt e mi vërshonte jetë e re  
Por fati kur dhuratat gjijsh m'i zbraz  
Çdo ditë e bardhë **zu m'u mbushë** me re!

Siç po shihet në këta dy strofa (nga katër rreshta) janë shkrirë mrekullisht ndjesitë me përmbajtjen me përbashkim elementesh të gjuhës së zemrës e të mendjes me vlera gjuhësore të shqipes globale (toskërishte e gegnishte).

## VII. KONKLuzionet e Përgjithshme dhe të veçanta - Përfundimet

Kur m'u ofrua tema: **“Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe”** nga prof. Androkli Kostallari, si punim magjistrature, e pranova me kënaqësi, pa menduar shumë për ndërlikueshmërinë që sillte trajtimi i një teme të tillë, sidomos për një fillestar që për të parën herë ballafaqohej me një punë të tillë serioze shkencore. Meqë ambicia dhe vullneti dhe koha nuk më mungonin veprat e Asdrenit i rilexova më me përkushtim dhe mbi bazë të *skicës ideore* të paradhënë, duke ditur se Asdreni veproi në dy periudha të historisë sonë kombëtare, në etapë të Rilindjes shqiptare (1900-1912 dhe në atë të Pvarësisë (1912-1945) e konceptova projektin që duhesha realizuar:

Së pari, cilat ishin tiparët që i mori, i përvetësoi dhe i mishëroi Asdreni nga Platforma e Rilindjes sonë Kombëtare edhe në fushën e gjuhës.

Së dyti, si e kupton Asdreni si patriot e si poet konceptin e gjuhës dhe si e shpreh atë në këto dy periudha.

Së treti, cilat janë veçoritë drejtshkrimore fonetike e morfologjike të gjuhës së Adrenit në ato dy etapa.

Së katërti, si qëndron gjuha e Adrenit në ballafaqim me dy koinetë ekzistuese toske e gege, sidomos me gegizmat e në mënyrë të veçantë me paskajoren, para dhe pas Komisionit Letrare të Shkodrës (1917) kur ende nuk kishte gjuhë të konsoliduar e njësishtme letrare.

Së pesti, çfarë niveli zë gjuha e Asdrenit në ato faza në raport me zhvillimin leksikor dhe fjalëformimin, dhe

Së gjashti, cilat janë veçoritë leksiko-stilistike të gjuhës së Asdrenit dhe në veçanti të asaj poetike dhe

Së shtati, cilat janë konkluzionet e përgjithshme dhe ato të veçanta që mund të veçohen nga analiza e kësaj teme, të cilat sipas kapitujve përkatës do të përpiqemi me i paraqitë, pra, tash fill, në këtë kapitull.

1

### **1.Rreth formimit intelektual, patriotik e gjuhësor të Asdrenit në frymën e Rilindjes Kombëtare**

Asdreni provoi të shkruajë, përkatësisht të botojë vjersha e punime tjera jo që nga mosha e re, e njomë, por aty nga vitet 30-a të jetës, pasi të jetë pajisur me njohuri intelektuale, patriotike e gjuhësore, së pari ai e mësoi shqipen nga stili bisedor i vendlindjes e pastaj më fort nga ai i klubeve patriotike ku bënte pjesë edhe ai, por aq më tepër u formëzua gjuhësisht nga gjuha librore e publicistëve dhe e poetëve tanë veteranë rilindës toskë e Naimit e Samiut, e Vretos dhe e të tjerëve, veprat e të cilëve qenë botuar në Bukuresht, por ai e mësoi shqipen edhe nga gjuha dydialektore e Konstatintin Kristofridhit dhe nga revista Albania e Faik Konicës që e praktikonte dy koinetë, pa ndërhyrje në gjuhën autoriale të bashkëpunorëve gegë, por Asdreni e mësoi edhe drejtpëdrejtë nga gjuha e shkrimtarëve dhe e publicistëve gegë., prandaj që në

fillim poeti paraqitet si njohës solid i dy dialekteve. K jo vetëm bëri përzijim fjalësh e trajtash ndër-dialektore, sidomos geqe në vjershat toskërisht, por edhe në të vërtetë provoi të shkruajë jo aq pa sukses vjersha vetëm në gegnishte. Në të vërtetë, Asdreni nga tetë pikat e Platformës gjuhësore të Rilindjes sonë Kombëtare të cekura prej nesh, mund të themi se i përqafoi të gjitha, por më kuptimplote ose më gjithpëfshirëse na duket, pika e parë: gjuha shqipe si armë për zgjimin dhe qenien shqiptare dhe kjo vëretohet nga një lutje që i drejtohet Zotit, prej nga shkëputëm këtë strofë:

Ashtu, ju, o Zot, gjuhën tone  
Ta bëni sot të përparonjë,  
Se veç me atë përgjithmonë  
Shqipëria mundet që të ronjë! (RD f. 95)

Kështu edhe Asdreni si ilumistët tanë patriotë rilindës përpjekjen për ngjalljen, përlindjen dhe pasurimin e gjuhës e ndjente si luftë për të ndihmuar e çliruar atdheun e tij të vuajtur dhe këtë ide poeti e kishte të pranishme deri në frymën e fundit të krijimtarisë së tij. Mirëpo ai edhe pse ankohej vazhdimisht do të mësojë e perfeksionojë gjuhën, qoftë nga shkrimtarët bashkëkohës, qoftë nën ndikimin e poezisë popullore shqiptare, që kishte mundësi të shfrytëzonte, qoftë edhe nën ndikimin e poezive të gjuhëve të huaja frënge e rumune, por asnjë herë pa iu larguar parimisht natyrës së gurrës shqiptare. Bashkëpunoi, pra me revistën Albania dhe të tjera, simpatizoi dhe qe anëtar i shoqërisë Bashkimi të Shkodrës, me alfabetin e së cilës botoi veprën e parë të tij, pastaj bashkëpunoi edhe me shoqërinë e Manastirit, e përqafoi alfabetin e ri të atij Kongresi, dhe e kritikoi faktin pse u lejua edhe lafabetin binjak, të cilin e sulmoi pa mëshirë dhe kështu dha kontributin e tij në drejtim të konsolidimit të gjuhës së shkrimit në atë periudhë, kur s'kishte gjuhë të unifikuar letrare (standard). Atbotë, lufta për gjuhën identifikohet si lufta për çlirim kombëtar, gjë që ashtu kërkonte nevoja. Asdreni nuk ngel në një konstatim aq të përgjithësuar, madje që nga fillimi, dallon gjuhën e folur nga fgjuha e shkrimit si dhe nga gjuha poetike. Mirëpo ai nuk ngel në një vend, ngase shkon gjithnjë e më tepër duke e thelluar duke e zgjeruar konceptin mbi gjuhën: rolin politik e shoqërorë të saj, por edhe gjuhën si art. Pra, ai me shqipen jo vetëm nuk joshi zemratshqiptare, por edhe kritikoi veset shoqërore e sidomos në etapën fundit, tërhoqi vërejtje deri edhe i sulmoi me fjalë të rënda edhe organizmat shtetërorë, lidhur me mbarëvajtjen e gjuhës dhe të kultures në përgjithësi..

## **2. Koncepti i Asdrenit për gjuhën, rolin dhe dallimet funksionale të saj**

Sipas analizës së këtij kapitulli merita e Adrenit qëndron në këto katër fakte:

Së pari mësimi i gjuhës jonjëdialektore e shqipes, së dyti, zgjedhja e alfabetit thjesht latin, së treti, diferencimi i stileve gjuhësore, së katërti, koncepti i tij shprehur me vargje për gjuhën në funksion praktik të saj në dy periudha ajo e rilindjes sonë kombëtare dhe periudha e Pavarësisë së shtetit shqiptar, edhe këtu do të përmendim ndonjë konkluzion që u arrit në punim nga trajtimi I veprës së Asdrenit sipas këtyre periudhave.

**Së pari**, veçoritë e veprimtarisë së Asdrenit në periudhën e Rilindjes sonë lidhur me gjuhën e rikujtojmë në këto tri pika:



a) Edhe pse respekton të folmen e vendlindjes Korçës, d.m.th. ka për bazë dialektin toskë.; mirëpo ai që në shkrimet e para bën përzijime me të folmet geqe, , kjo është veçori e gjuhës së tij, sidomos ky përzijim më tepër shihet në veprën e tij të parë Reze djelli, por që do ta vazhdojë edhe në veprën e dytë Ëndra e Lote, po thuhet do të heqë dorë në shkrimet e hartuara thjesht gegnisht në periudhën e Pavarësisë, por edhe tashti vazhdon që në gjuhën e tij të përdor gegizma jo të paktë, madje fitohet përshtypja se disa fjalë shprehje e forma të gegërishtes i ka bërë tashmë pjesë përbërëse të fjalësit të tij ligjërimit poetik, si@ç është pjesorja e shkurtër dhe paskajorja e mirëfilltë

b) Asdreni ka meritë se si me thënë pati parashikim të drejtë edhe në zgjedhjen e alfabetit. Ky hoqi do të nga alfabeti I Nikolla Naços, (ndikim I rumanishtes), hoqi dorë edhe nga alfabeti I Stambollit, të cilin e çmon lart, por tekniksist kishte vështirësi përhapja e tij për arsye të sh kronjave jo të zhjesht latibne dhe përkrahu alfabetin e Bashkimit (të Shkodrës, thjesht latin, me të cilin e botoi dhe veprën e tij të parë. Përkatësisht e përqafoi alfabetin thjesht latin të Kongresit të Manastirit. Madje duke e kritikuar binjakun e lejuar në atë Kongres që kishte përhapje në viset jugore, ky ndihmoi në njëzimin e alfabetit të shqipërisë që e kemi në sot. Kritika e Asdrenit mund të thuhet se u opranua mirë dhe vetvetiu ai alfabet që kishte përdorim më tepër në toskëri doli jashtë përdorimit duke ia lënë vendin alfabetit që e kemi sot.

Andaj mendimi teorik apo kontributi i tij I Asdrenit lidhur me çështjen e alfabetit të paraqitur publikisht konkretisht nuk bën të mohohet ose të heshtet

c) Meritë e tij është se që në fillim të veprimtarisë së tij krijuese dallon gjuhën si thjeshtligjërimit nga gjuha e shkrimit, madje edhe në kuadertë gjuhës shkrimit dallon gjuhën poetike në këtë kontekst dhe këtë dallim do ta bëjë gjithnjë e më të qartë edhe dhe do ta zbatojë prej veprës në vepër

Gjithashtu është meritë teorike konceptore e Asdrenit që për të parën herë kërkon edhe provon diferencimin e stileve gjuhësore, si ai stili politik (propagandistik), administrativ, shkollor-libror dhe sidomos, asiq u cek, stili artistik (poetik). Çështjen e formimit apo të zhdrivillimit të gjuhës letrare unike e shtron drejt autori dhe kjo është anë pozitive e tij. Përzijimin e fjalëve të dialekteve dhe të të folmeve Asdreni e bëri me paramendim, me qëllim të afrimit të këtyre dialekteve, mirëpo një përjekje të tillë nuk e bëri vetëm Asdreni, por në të vërtetë kjo është veçori më dalluese se ky se të tjerët. Siç dihet njësimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe u zgjidh disi po ashtu me përzierjen (bashkëjetimin) më të natyrshme se siç bëri Asdreni, mirëpo është meritë e tij se nuk nënvlerësoi asnjërin dialekt, andaj baza e gjuhës së tij është më e gjerë se kriteri që pati për gjuhë letrare Komisi Letrare e Shkodrës mbi bazë të gegnishtes, po ashtu më i gjerë edhe se Letrarishtja e sotme mbi bazë Kongresit të Drejtshkrimit (1972). Asdreni ka meritë se çështja e gjuhës nuk e trajton vetëm njëherë nga ai por vazhdimisht e në evolucion, krahas zhvillimit të vetë shoqërisë.

**Së dyti**, edhe në Periudhën e Pavarësisë Asdreni e trajton gjuhën dhe si në veprat e para edhe në periudhë e vlerëson drejt rolin dhe funksionin e saj, por tash më tepër rolin shoqëror e edukativ të saj, natyrisht duke mos e lënë anash as rolin mësimor. Madje e zgjeron konceptin e gjuhës prej veprës në vepër. Por pasi tashmë Shqipëria ishte bërë shtet i pavarur poeti poeti tërhe vërejtjen se tashti duhet punuar në mënyrë të organizuar edhe për zhvillimin e gjuhës e kultivimin e pasurimin dhe zbatimin e saj. Dhe këtë kontekst zhvillimi duhet bërë në bazë të ligjeve sistimore të brendshme të ligjërimit të natyrshëm e jo të merren fjalë a shprehje

të huaja pa ndonjë kriter që shkojnë në dëm të shprehjes shqipe, ngase fjalët e shprehjet e zvetnojnë gjuhën e dliërë shqipe. Në këtë kapitull u analizua edhe një artikull gjuhësor I Asdrenit me titull *Disa vlërejtje përmi –Ë-në*, në të cilin rrah çështje që edhe sot janë aktuale. Ky artikull është analizuar prej më në hollësi se kudo deri tash. Aty Asdreni kërkon që të respektohen të dy dialektet. Tërheq vëmendjen për katër mënyrë të përdorimit ose të shpërdorimit të shkronjës –Ë. Gjithsesi kërkon nga kompetentët të punojnë për konsolidimin e standardit të njëzuar. Në të vërtetë ai në veprën PM përmend gjuhën poetike edhe për përdorimin e shqipes në stilet funksionale Gjithsesi kërkon nga kompetentët që të ndikojnë në zhvillimin e gjuhës e të letërsisë, përkatësisht të mundësojnë krijimin e kushteve të volitshme që gjuha shqipe në mënyrë të natyrshme si gjuhë kulturore e shtetërore të mund t'i plotësojë nevojat e kohës. Në të vërtetë në KK në ë mënyrë satirike duke përmend me vend faktorët më të rëndësishëm të cilët duhen përkujdesur për gjuhën e dhe sendërtimin e saj në jetë, në fushat përkatëse që atëherë ishin ëndrra të përdëshiruara, sidoqoftë ai përkujtonte:

- shkolla, e shtrirë dhe në çdo fashat, e pajisur me godina e me inventarin përkatës deri edhe me biblioteka
- mësuesit të jenë të kualifikuar me fjalën e tyre të gjallë e me plot emocion,
- nëpunësit e në përgjithësi ta mbajnë në nivel administratën përkatëse,
- organet e përgjegjëse të jenë të pajisur me kulturë e me njohuri shkencore kombëtare,
- zhvillimi ekonomik e politik i vendit, ngritja e formimi i kuadrove të profileve të ndryshme profesionale të jetë të planifikuar etj.,
- lidhjet ndër-gjuhësore e kulturore për studime e specializime, por që ata më parë të jenë të pajisur me njohuri e kulturë solide në gjuhë amtare etj. etj.
- si çështje me shumë rëndësi që shtrihet nga Asdreni është edhe gjuha letrare, e cila pak a shumë duhet të jetë e ndarë nga gjuha e poezisë, e cila bashkë me krijimet tjera duhet të jenë në nivel të lartë,
- shkrimet shkencore të vlerësohen jo vetëm me kriterin kombëtar, d.m.th. sa e si i shërbejnë kombit të vet, por edhe t'u bëjnë ballë edhe kritereve nga bota e jashtme, në të vërtetë me kualitetin e lartë artistik e shkencor, respektivisht me fuqinë shprehëse të mahnisin a të zgjojnë interesin edhe tek të huajt, sepse kështu vepra përfaqëson popullin ndaj kombeve tjera, dhe në këtë mënyrë edhe kultura shqiptare të bëhet një ndër kulturat integrale të popujve të kulturuar të Evropës dhe të botës së qytetëruar. Kur të lëxojnë të huajt krijimet shkencore apo letrare artistike ata duhet të binden për kulturën autoktone shqiptare dhe kështu të vlerësohet drejt kultura jonë si dhe pjekuria intelektuale që vjen e shprehet me anë të veprave të tilla. Kështu Asdreni apelon që me punën intelektuale të depërtohet në botën e jashtme dhe të bëhet integrimi me kulturat tjera pozitive, gjë që është arritur njëfarë suksesi në kohën tonë dhe një hap i tillë po përshëndetet nga kritika evropiane e botërore.

Sipërfundim, pra, nga pikat e shtruara më lartë mund të konkludojmë se koncepti i Asdrenit lidhur me gjuhën, "e cila është një nga objektet mrekullisht të përshtatshme për hulumtime interdisiplinore apo "intitucionin shoqëror gjithnjë vjen duke u zgjeruar dhe kompletuar, por Asdreni duke iu kthye realitetit shpreh shqetësim, andaj këkon që sidomos të rinjve duhet t'u flitet edhe më me emocione për çështjen kombëtare.

### 3. Çështje drejtshkrimore fonetike e eptimore morfologjike në veprën e Asdrenit

Në kapitullin e tretë, vepra e Asdrenit u analizua nga pikëpamja e veçorve drejtshkrimore, fonetike e morfologjike, ku Asdrenit del më fort si grumbullues material, prej nga del i qartë gjendja e gjuhës sonë në ato etapa të caktuara zhvillimore. Pra në periudhën e parë kur shkroi dhe botoi Asdreni nuk ekzistonte një ortografi stabile, por, megjithatë respektohej si me thënë norma globale e natyrshme që kishte shqipja e papërpunuar në të dyja koinetë., edhe pse nuk mungonin tradita pozitive të shkrimit të shqipes si tradita pozitive drejtshkrimore të Naimit dhe të Samiut, të cilën do ta ndjekë Asdreni, por ai e tejkaloi atë, ngase provoi të shkruante edhe gegnisht, sipas koinesë dialektorte të Shkodrës, porpaksia edhe traditën gege elbasanase dhe që të dyja këto koine i praktikonte edhe revista famëmadhe *Albania* e Faik Konicës si dhe disa organe të tjera që vazhduan ose filluan të botoheshin shqip (gegnisht e toskërisht) anembanë rruzullit ku gjallonin shqiptarë, tash edhe në SHBA e gjetkë. Nga punimi si vërejtje të përgjithshme lidhur me ortografinë e tij dalin:

#### 1) Në fushën e fonetikës

##### a) Ndërrimet vokalike

-Në veprën e tij janë prezente dubletat, madje edhe më shumë forma për drejtshkrimin e një fjale, si p.sh. lavd, lëvdatë, levdate, dëftoj, diftoj; qindresë, qëndresë, qendresë, qëndroj etj.  
-Vetëm në veprën e tij të parë RD kemi trajtat: kio, Viosë etj., që në veprat tjera dalin me J.  
-Edhe nga palatalizimi i tepruar Asdreni heq dorë në veprat e fundit, pra tash nuk e përdor më gjurmë, flytyr, por gjurmë-a, fluturë-a.

Konstatim i njëjtë mund të bëhet edhe për fjalët si: vollkan, ergjent (përvullkan, argjent) etj.

-Në veprën e tij RD kemi shembuj të përdorimit më ekstrem të Ë-së, p.sh.: bukurë, ftohëtë etj., ndërsa në veprat e fundit ka raste kur nuk e shënon Ë-në: lirin, trimërin, etj., si dhe ndonjë elizion tjetër që nuk lejohet në bazë të letrarishtës së sotme, por dorë të tillë të lirë lidhur me këtë pati edhe Komisia Letrare e Shkodrës.

-Përndryshe edhe në shkrimet e periudhës së dytë Asdreni E-në para bashkëtingëlloreve të zëshme zakonisht nuk e shurdhon në Ë, ashtu siç preferon gjuha e sotme letrare.

-Dyzanorin IE Asdreni zakonisht e shënon JE, mirëpo është prezente edhe trajta IE, mirëpo mbizotëron trajta me JE.

-Në shkrimet e Asdrenit është prezente prirja që dyzanorin UE (UA) ta shënojë me O, kështu prirë një zgjidhje e mesme për të dy dialektet: vajtje, rrojtje, losnin etj.

##### b) Ndërrimet konsonantike

-Edhe sa i përket këmbimit të konsonanteve ka raste që përkojnë me normën e sotme, por ka edhe raste që nuk përkojnë.

-Po përmendim ekstremet lidhur me përdorimin a mospërdorimin e H-së, R-së e të L-së: P.sh. rehtë, hyjt, hoborit, llahuta, erësirë (rr), marësi (rr) etj.

-Shurdhimi i bashkëtingëlloreve është trajtë mbizotëruese, por në veprat e fundit priret të mos

bëhet shurdhimi ashtu siç ishte në normën e Komisië Letrare (1917), ashtu siç është në normën e sotme letrare.

- Dhe sa i përket përdorimit të R-së, H-së dhe L-së kemi njëfar stabilizimi në veprat e fundit.

## 2) Në fushën e gramatikës

### a) sistemi emëror

Sa u përket trajtave morfologjike mbizotëron norma, megjithatë mund të përmendim disa veçori që mbeten si karakteristikë e gjuhës së tij, apo si raste të veçuara:

-Gjinia asnjë e tipit paparanyjësor që sot është mbeturinore është prezente në të gjitha veprat e Asdrenit.

-Shumësi i emrave sa i përket drejtshkrimit mbeten problematikë në ortografinë e tij. Asdreni bën shumësin pa ndonjë kriter të caktuar, në forma të ndryshme duke mos pasur një dorë, megjithatë prirert që shumësin e emrave të sendeve konkrete<sup>4</sup> mashkullorë we femërore ta bjë me bnyjëmbaresë -A.

-Kemi nja dy-tri raste të vetmuara kur në rasën emërore të shquar ruhet E-ja që ajo bjen kur shquhet emri si p.sh.: lulekuqeja, dallëndysheja, manushaqeja ... Po kjo nuk përgjithësohet.

-Nyja e gjinore shpesh nuk qëndror. Dhe lidhur me këtë ndikon mbaresa rasore: dëshirës gjallë mallit tij, etj.

-Kallëzoren e shquar e karakterizon trajta arkaike e drejtshkrimit -NË, në vend të trajtës -IN, -UN: mbretinë (mbretin), atdhenë (atdheun) etj. Por nuk mungojnë rastet, si normën e sotme.

-Është prezente trajta e emërores a e kallëzores së pashquar si: motrë, letrë, zemrë etj. që një ortografi e tillë lejohej edhe nga Komisia Letrare e Shkodrës, mirëpo drejtshkrimi i sotëm nuk e lejon.

-Edhe rasa vendore është prezente në veprën e Asdreni.

-Rrjedhja pa parafjalë mbetet veçori dalluese e stilit gjuhësor të Asdrenit. Numerikisht kjo trajtë apo ky fenomen ka rritje progresive si vijon: RD 1 rast, ËL 5, ndërsa PM dhe KK ka mbi 30 raste për secilën vepër.

### b) Sistemi foljor

Edhe sa u përket foljeve kemi një mori trajtash që nuk përkojnë me normën dhe që në veprën e Asdrenit paraqiten si refleksë i të folmeve dialektore a si fjalë e trajta të marra nga veprat e ndryshme të botuara, nga forma e të cilave ishte ndikuar Asdreni.

Sa i përket aoristit konstatuam se në veprën e Asdrenit në të shumtën e rasteve reflektohet në trajtën shkoi dhe në disa shembuj dhe shkoVi e shkojti. Kështu përmenda vetëm veten e tretë njëjës që paraqitet si karakteristikë sa i përket drejtshkrimit. Asdreni këtu ndoqi ortografinë e Naimit, veten e tretë të aoristit e shënon rregullisht me J e jo me I në fund si në normën e sotme, ndoshta për të dalluar me kohën e tashme të tipit të foljeve SHKOJ që ai e shënon SHKONJ me NJ (por edhe shkonja, të shkonja). Mirëpo ai përdori edhe trajtën nëndialektore si: shëmbëlleVi, theVi, në vend: shëmbëlleu, theu etj.

Shumësin e kësaj kohe (të aoristit pasiv) e përdor me mbresën arkaike -NË, si p.sh. e gjetnë, e njojtënë etj., por në raste del edhe si në normën e sotme.

-Si veçori e stilit asdrenian është toskëzimi i paskajores gege. Raste të tilla dalin që nga vepra e tij e dytë ËL, katër raste, por del edhe në veprat tjera të mëvonshme, por jo në numër të madh

rastesh.

Një veçori e tillë pati pasues. Edhe para Asdrenit pati raste të një përdorimi të tillë, gjë që është karakteristike e të folmeve kalimtare.

#### 4. Çështja e përzijimit ndërdialektor të gjuhës së Asdrenit

Nga ideja për bashkimin e të gjitha viseve shqiptare (sidomos Veriut e Jugut), doli edhe domosdoja e përzierjes së dialekteve a të të folmeve në një shqipe letrare të përbashkët. Siç dihet shqiptarët e të gjitha viseve mund të komunikonin shqip e të merreshin vesh ngaase kishin më shumë elemente të përbashkëta se sa aso ndarëse, megjithatë në gjuhën e shkrimit në kohën kur filloi së shkruari Asdreni ishin të formësuara më mire të emnuara, por jo aq të konsoliduara dy koine ajo gege dhe ajo toske. Asdreni i takonte koinesë jugore toske, andaj në ortografinë ose gjuhën e tij, siç e pamë më sipër, mbizotërojnë elemente të fonetikës e të gramatikës të asaj koineje, mirëpo ai që në shkrimet e para futi edhe elemente të koinesë tjetër, madje edhe provoi të shkruante jo pa sukses poezi në dialektin gegë. Pikërisht përfshirjes së gegizmave ose rreth përzijimit të gjuhës së Asdrenit me fjalë e trajta ndërdialektore (gege – toske) iu kushtua kapitulli IV, ku::

**Së pari**, janë identifikuar disa nga gegizmat sipas veprave poetike të Asdrenit, ose toskizmat në vjershat e shkruara gegnishte sipas veprave të tij, Ja disa nga gegizmat që tashmë duken se heqja e tyre nga fondi themelor i gjuhës sonë do të ishte i pamundur, p.sh.: krye, dashnor, pamje, krahnor, hyjnor, dro-ja, katundi, grunare, (me) kqyrë etj. etj., por ka trajta e forma që nuk i qas norma e shqipes së sotme, siç është edhe paskajorja me +pjesore.

**Së dyti**, pikërisht çështja e përdorimit të paskajores me +pjesore nga Asdreni si numri i tyre sipas titujve të poezive në kuadër të 4 veprave të Asdrenit dhe njëherazi është trajtua në hollësi, ku, veç tjerash është bërë edhe ndarja e tyre sipas tipit të pjesores përkatëse dhe rezultati i numrit të paskajoreve me + pjesore sipas veprave të konsultuara doli kështu: **RD 55, ËL 24, PM 9, KK 27 (11+16), gjithsej 115 raste.** Pra, në gjuhën e veprave të Asdrenit, në të gjitha versionet, ndeshëm **115 raste** të përdorimit të paskajores me + pjesore. Ndsërkaq sipas tipit të pjesoreve të paskajores së mirëfilltë të regjistruar në burimet përkatëse shembujt të ndarë në katër grupe dhanë këto rezultate:

##### 1) Tipi paskajore me + pjesore e shkurtër

a) mbi temë konsonante, nëntipi: me ardhë, me dhanë: RD 22, ËL 6, PM 1, KK 6 ,gjithsej **35 raste;**

b) mbi temë vokalike, nëntipi: me pa, me pru, me përtri: RD 6, ËL 5, PM 4, KK, 3, gjithsej **18 raste;**

c) mbi temë diftongu, nëntipi: me luftue, me kthye: RD 12, ËL -, PM -, KK 7, gjithsej **19 raste.**

Totali mbi temë të pjesores së shkurtër: **72 (35+18+19) raste.**

2) Tipi me pjesore gege **mbi temë me diftong të cunguar**, tipi me coptu, me shkëlzy; RD 8, ËL 3, PM -, KK 5, gjithsej **16 raste (8+3+5).**

3) Tipi **me pjesore të zgjeruar gege**, tipi:

a) me -UN fundore, nëntipi: me qitun: RD 3, ËL 5, PM -, KK 1, gjithsej **9 raste;**

b) me -NUN fundore, nëntipi: me ranun: RD 1, ËL- PM -, KK -, gjithsej **1 raste**;  
c) me -MUN fundore, nëntipi: me shpëtumun: RD 3, ËL -, PM -, KK-, gjithsej **3 raste**, gjithsej: **13 raste (9+1+3)**.

4) Tipi **me pjesore të toskëzuar**:

a) me -UR: nëntipi: me ditur, me gjetur, me mbajtur: RD -, ËL 2, PM 1 KK 4, gjithsej **7 raste**

b) me -UAR/YER, nëntipi: me shkëlqyer, me kërkuar, RD -, ËL 2, PM 4, KK 1 gjithsej **7 raste - gjithsej 14 raste (7+7)**.

**Totali i numrit të përgjithshëm të paskajoreve me + pjesore në veprat e Asdrenit arrin shifrën 115 raste (72+16+13+14).**

Së këtejmi meqë paskajorja geqe është duke u përdorur gjithnjë e më shumë edhe nga autorët që e respektojnë normën e sotme propozohet që si rregull përdorimi me qenë paskajorja me + pjesore të shkurtër.

## 5. Veçoritë leksore e fjalëformuese të gjuhës së Asdrenit

Fondi i leksikut të Asdrenit prej veprave në vepër vjen gjithnjë duke u rritur, duke u begatuar. Fjalët e reja të sjella a të krijuara me parashtesa, prapashtesa ose me kompozim freskojnë dhe dhe me nuancimet shprehëse kuptimore gjuhën e tij poetike e ngrejne gjithnjë e më të lartë.

### A.Parashtesimi

Parashtesat më të përdorura nga Asdreni janë ato me Ç- (që e përdor më tepër se simotrat sinonimike SH- e ZH-) e pastaj vijnë arashtesat etjera, si: M-, N-, PA-, PËR- e STËR-.

-Po përmendim si kuriozitet se në veprën e tij të parë prijnë fjalët me parashtesën M-. Dhe kjo është nën ndikimin e dialektit të Korçës, ku M-ja është krejt fonetike. Ka fjalë me këtë parashtesë që nuk mbeten në gjuhën e sotme: si mburimi, mbleta etj.

-Parashtesa PA- përdoret dendur nga Asdreni, sidomos në krijimin e fjalëve të reja, ngase Asdreni nuk njih fjalë me parashtesat MOS- dhe JO-, të cilat në kohën tonë kanë shtrirje përdorimi më të gjerë.

-Parashtes PËR- shfrytëzohet mjaft nga Asdreni, sidomos për të krijuar fjalë me kuptim përforcim veprimi. Me këtë parashtesë u krijuan fjalët si: *përbashkuar*, *përshkëlqim*, *përndarje* etj., të cilat janë mirëpritura për stilet e ndryshme të gjuhës së sotme, sidomos të veprave poetike apo të fjalorit ekonomik.

-Në veprat e fundit aktivizohen edhe parashtesat: MBI-, NËN-, NDËR, TËR-, TEJ-, RI-, por në një numër të vogël fjalësh.

### B.Prapashtesimi

Prapashtesimi si mënyrë më produktive e fjalëformimit zë vendin kryesor fjalëformues dhe në veprën e Asdrenit. Fjalët me prapashtesa kanë ardhur duke u shtuar numerikisht prej veprës në vepër. Madje edhe vetë krijimet kanë rëndësi sa i përket shprehjes kuptimore si dhe ngarkesës stilistike që bartin. Dhe ky është një fakt i ngritjes cilësore të krijimtarisë poetike të Asdrenit.

Nga pasqyra e dendurisë së përdorimit shihet qartë rritja progresive e fjalëve me prapashtesat përkatëse.

-Shumësim më të madh kanë fjalët me prapashtesat -AR (TAR) që në RD janë 13, ndërsa në ËL 30, PM 38 dhe KK 69, pra ndryshimi është mjaft i dukshëm, por edhe më i dukshëm është ndryshimi tek fjalët me prapashtesën -OR(-TOR, -SOR): RD vetëm 5 fjalë, Ël 25, PM 51 dhe KK 67 fjalë, që do të thotë mbi 60 fjalë më tepër.

-Fjalët me prapashtesën -IM pothuajse janë përdorur me një tempo të njëjtë në të gjitha veprat. -Shtim progresiv kemi edhe te fjalët me prapashtesën -I (-RI, /-NI): 25, 23, 32 dhe në veprën e fundit KK 40 fjalë, por fjalët simotrën e tyre -SI kanë njëfarë zvogëlimi në tempon e përdorimit: RD 28, Ël 17, PM 22 dhe KK 17, pra vetëm sa i përket përdorimit të fjalëve. Shumë fjalë përdoren vetëm në veprën e tij të parë RD, si: vobësi, tradhësi, vrapësi, vjershësi etj., si edhe fjalën lumtësi, e cila përdoret edhe në ËL.

-Madje kemi edhe krijime si disa nga këto që më nuk janë aq të parapëlqyeshme si p.sh. fundje, ardhmje, pritnje, fryjtje etj.

### **C. Kompozimi**

Edhe kompozitat prej veprës në vepër kanë ardhur duke u shtuar, nëse si kriter i vlerësimit të cilësisë poetike merret kompozimi, atëherë ndryshimi sa i përket kësaj është i madh. Ndërsa në veprën e parë kemi 17 kompozita, në ËL 61, në PM 122 dhe KK 130 sosh, prandaj rritja kap shumë mbi 120 kompozita më shumë në veprën e fundit në krahasim me veprën e parë.

Kompozitat janë mjaft të llojllojshme, shihet ndikimi i stilit libror, por edhe krijimet në frymën e krijimtarisë popullore.

## **6 . Veçoritë leksikore e stilistike të gjuhës së Asdrenit**

Ndërsa shumësia e përdorimit të fjalëve me prapashtesa, parashtesa dhe kompozita është prezente prej veprës në vepër denduria e fjalëve të caktuara nuk është e tillë. Ka fjalë që përdoren shumë në veprën e parë në të tjerat fare pak apo as që përmenden fare, edhe pse janë fjalë të fjalorit aktiv e themelor të shqipes. Po përmend vetëm fjalën ATDHE, e cila në veprat e fundit përdoret në numër të vogël në krahasim me përdorimin e saj në veprat e para: RD 31 herë, Ël 17, PM 7 herë dhe KK 6 herë.

Asdreni zgjodhi fjalë dhe krijoi vetë aso fjalësh, në mënyrë që shprehja e tij të jetë sa më me efekt të madh ideor e artistik dhe njëherit që pati pikësynim që fjala e tij të mbetet shëmbëlltë për brezat e ardhshëm.

Barbarizmat janë fare simbolike në veprën e Asdrenit, madje disa sosh përligjen se tregojnë ngjyrimë stilistike apo kanë zënë rrënjë në gjuhën e popullit dhe janë bërë pjesë e leksikut të shqipe.

Internacionalizmat a fjalët e kulturës e të shkencës gjetën vend në veprat e tij të fundit dhe ato me ngarkesë stilistike dhe më duket se nuk ia ulin vlerën artistike e ideore veprës së tij apo temës që trajtohet nga ai..

Kombëtarja zë vendin thelbësor në veprën e Asdrenit, mirëpo edhe dialektizmat nuk

mungojnë. Edhe pse ndoshta do të prisnim stërmbytyje në provincializma duke pasur parasysht rrethanas nën të cilat u zhvillua dhe gjëlloi gjuha jonë kombëtare. Asdreni gjeti një gjuhë të sheshuar sa i përket perspektivës krejt formimit të gjuhës sonë kombëtare dhe në këtë drejtim ai eci rrugës së drejtë duke pasur bazë gjuhën e rilindësve si të Naimit, Samiut e të Konicës, d.m.th. të dialektit të vet, mirëpo ky, madje më tepër se të tjerët mori fjalë e shprehje nga dialekti i Veriut dhe kështu e begatoi gjuhën dhe te zgjeroi të shprehurit mbi bazë të shqipes globale.

Ndikimi i stilit libror në veprën e tij është evident. Ca nga gegizmat që përdori ai mbeten në gjuhën e sotme letrare, edhe pse në një farë dore ekzistojnë terma a trajta në toskërishten.

Padyshim gjithato fjalë të prejardhura e të përbëra në veprën e tij shërbejnë sigurrë e mirë shkollë mësimi e frymëzimi për vazhdimësinë e përdorimit të fondit themelor të shqipes letrare, mirëpo edhe krijimi i ca neologjizmave apo sjellja e fjalëve të rralla zgjojnë interesim dhe ato mund të jenë të mirëpritura për të gjetur jetë në stilet e ndryshme të kohës. Tashmë shumë sosh duken si krijime të përditshme dhe disa të krijuara në bazë të natyrës së shqipes mund të gjejnë përdorim si p.sh. përzijim, të përbashkuar (unji a unik), përlindja, përpushtoj, përshtëqimi, hyjësose, stërpiku, etj etj.

Vepra e Asdrenit u çmua lart edhe sa i përket gjuhës publicistike e sidmos asaj poetike. Po përmend vetëm vlerësimin që i bëri A. Gj. Fishta veprës së tij të dytë ËL më 1914, duke e përfill atë si një vepër "*me dinjitet që e pasunoi letërsinë shqipe me poezi të përshkueme nga një fllad i ambël freskie dhe hieshie fort të kandëshme, shton, mas mendimit tem, ky libër tfaqë ma së mirit shka ka hieshëm në vetveti djalekti i Tosknis*" 3).

Së këtejmi del edhe kontributi i Asdrenit për formimin e gjuhës letrare kombëtare, e cila u kurorëzua duke pasur njëfarë mbështetje edhe në gjuhën e tij, e cila në të vërtetë kur kemi parasysht paskajoren e disa elemente të tejsa të gegnishtes ka bazë më të gjerë se letrarishtja e sotme, andaj në këtë drejtim vepra e Asdrenit mund të shërbejë si gjedhë që edhe letrarishtja e sotme të integrojë edhe atë *përzijim*, të pajiset me ato lamente të domnosdoshme që nuk i ka.

## Përmbyllje

Misteri i popullaritetit të veprës së tij edhe pas L2B në Shqipëri qëndron në faktin se Asdreni si vazhdues i rilindësve me idetë e tij demokratike dhe me gjuhën e përdorur si mjet shprehës u bazua pikërisht në frymën e masës së gjerë dhe në temat që trajtoi preku interesat vitale të kombit shqiptar.

Që nga botimi i vargjeve të tij te para emri i Asdrenit u bë i dashur për çdo shqiptar që atëherë ndjente dhe kishte nevojë shpirtërore të ushqehet me zjarrin e dashurisë për atdhe dhe për një art që ndihmonte sendërtimin e idelave të shenjta të rilindëve, për një liri të gjithmbarshme kombëtare, Jehona e veprës së tij erdhi gjithnjë duke u shtuar, ajo ndjehet e gjallë edhe sot, sepse "me ato poezi të zjarrta, me ato marshe dhe hymne Asdreni arrin drejtpërdrejtë në zemrat e lexuesve, i prek, i ndez shpejt dhe bëhet poeti i tyre nga më të dashurit" (HLSH f.582). 4)

Vetë popullariteti i veprës së Asdrenit flet se ai shkroi për popullin, për masën e gjerë fusharakë e malësorë dhe se në këtë pikëpamje del se pati kujdes në sjelljen e fjalëve popullore, ngase trajtoi edhe temat që kanë të bëjnë me këto masa. Po në gjuhën popullore pati



pikëmbështetjen kryesore për krijimin e fjalëve që mbeten si neologjizma, mirëpo Asdreni që i ndikuar edhe nga shprehjet e gjuhëve të huaja dhe kështu e pasuroi gjuhën tone me motive univesale.

Asdreni si rilindës nuk u mbyl në barbarizmat e fjalët e huaja që ishin karakteristikë e kohës, mirëpo ai sidomos në veprat e fundit pati qëndrim të drejtë ndaj fjalëve a termeve të kulturës e të shkencës dhe këto i përdori në veprat poetike, duke u dhënë ngarkesë stilistike. Dhe në këtë pikë Asdreni i lufton idetë e depërtuara të "civilizimit" që përfaqësoheshin nga të "qytetëruarit" e qyteteve apo të bartësve të administratës së huaj apo që ishin relikte të dhunës së të huajve dhe se kështu e sillnin dem gjuhës e shprehjes shqipe.

Është thënë me të drejtë se "gjuha e Asdrenit është një toskërishte e pastër dhe se poeti bën vazhdimisht përpjekje për pasurimin e saj" dhe lidhur me këtë është e vërtetë se Asdreni u inkadrua në gjuhën letrare toske, e cila u paraqit më unike në krahasim me gegërishten letrare, ngase dhe të folmet e toskërishtes veriore dhe të mesme ishin më të afërta në mes veti dhe se ky dialekt u kultivua nga shkrimtarët veteranë të gjuhës e të letërsisë sonë: Kristoforidhi, Naimi, Samiu, Vreto e të tjerë. Andaj në vargun e shkrimtarëve që kontribuan lidhur me këtë bërthamë të shëndoshë të gjuhës letrare bën pjesë edhe Asdreni, i cili duke përqaftuar atë gjuhë, duke e përpunuar dhe duke e formuar edhe duke krijuar fjalë me fytyrë drejt gegërishtes, madje duke marrë nga ajo fjalë e trajta dhe duke i përdorë mjaft natyrshëm ato në veprën e tij dha kontribut të çmuar në afrimin a bashkëjetimin e konvergencën ndërmjet dy dialekteve kryesore të shqipes që ishte në të vërtetë rruga dialektike e drejt formimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe. Andaj kontributi i Asdrenit është i madh se pikërisht ajo gjuhë toske me një zhvillim e lulëzim të natyrshëm me ndonjë *përzijim* (term i asdrenit) është në të vërtetë gjuha e sotme letrare e mbarë popullit tonë.

Kështu mund të rezultohet në mënyrë implicite se edhe Asdreni me artin e tij letrar, me mësimet e tij didaktike e patriotike si dhe kontributin teorik bëri një punë jo të vogël në kultivimin e gjuhës letrare kombëtare, sepse nektari i veprës së tij u thith nga çdo shqipfolës që nga vegjëlja e në moshat madhore, që nga mosha shkollore e në shkollat më të larta dhe nga pjesëtarët e të gjitha shtresave shoqërore dhe ajo me të vërtetë, bashkë me himnin kombëtar, u fut në shpirtin e popullit, u rrit me të, ndikoi po ashtu në mënyrë të qetë me forcën e vet artistike e didaktike, me shprehjen e bukur të saj në hedhjen e farës së gjuhës unike për shqiptarët pa e nënçmuar asnjërin nga dialektet dhe as të folmet, andaj respekti i brezave ndaj veprës së Asdrenit nuk mungon.

Kontributi teorik i Asdrenit qëndron në faktin se ai pati qëndrim të drejtë sa i përket çështjes së vendosjes së alfabetit të vetëm të gjuhës shqipe me fytyrë latine, pikërisht siç e kemi sot. Asdreni dha mendimin pozitiv dhe s ai përket formimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe me shkrirjen e dialekteve. Ishte i mendimit që çështja e gjuhës letrare të shqyrtohet nga ekspertët dhe ata të vendosin si kompetentë duke pasur parasysh interesin kombëtar.

Vërejtjet lidhur me ortografinë që dalin nga vetë përdorimi i tij në veprat konkrete dhe evolucioni që bën ai sa i përket drejtshkrimit, janë vërejtje me vend dhe kështu koineja e toskërishtes veriore dhe e mesme gjatë zhvillimit hoqi dorë nga shumë përdorime dhe kështu iu afrua dialektit gegë dhe kështu bëri që shumë trajta të bashkëjetojnë edhe pse që të gjitha ndoshta nuk u verifikuan me drejtshkrimin e ri të gjuhës sonë të sotme letrare.

Gegizmat në vjershat toskërisht të tij mbesin veçori e gjuhës asdreniane, por lidhur me këtë duhet cekur se shumë nga termet gegë që u përvehtësuan në gjuhën e sotme letrare janë në njëfarë dore edhe kontributi i drejtë që e dha Asdreni në këtë drejtim. Kontributi i Asdrenit është tejet i madh në afrimin dhe bashkëjetesë e dialekteve, madje edhe të varianteve të shkrimeve dialektore. Vetë zhvillimi i mëpastajmë mori rrugë të mbarë dhe bëri kristalizimet e duhura.

Padyshim popullariteti i veprës së tij që prezent dhe vazhdon të jetë gjithnjë në vazhdim në saje të forcës estetike-poetike, didaktiko-patriotike si dhe didaktike-muzikore të veprës së tij,

Vepra e tij është prezente në historinë e kulturës sonë të periudhës së Rilindjes dhe të Pavarësisë dhe vazhdon të mbetet idhull që ruan e vet për formimin dhe edukimin e brezave nëpër shekuj. Gjithashtu vepra e tij mbeti burim frymëzimi dhe përstudime të mëtejshme për të nxjerrë në dritë momente me rëndësi dhe sa i përket shkencës historike gjuhësore që sapo vjen e po përparon dita më ditë.

Fjalët e reja apo të rralla të sjella nga autori janë të mirëseardhura për t'u përdorur në stilet e ndryshme të gjuhës sonë, apo në të ardhshmen do të kenë edhe më shumë vlerë kur nevoja e nuancimeve shprehëse do të jetë edhe më e madhe.

Po përfundoj këtë punim me fjalët Koço Bihikut, i cili konstaton me të drejtë se "Sa më shumë largohet prej nesh epoka e Asdrenit aq më e afërt bëhet për njerëzit tanë patriotizmi i zjarrtë i poetit, dashuria për vegjëlinë" dhe po shtojmë se aq më vlera e tyre përmbajtësore dhe poetike po bëhet më frymëzuese jo vetëm si tekste për këngë e kompozime, por edhe për meditatorët dhe poetët aktual e të rinj dhe njëherazi edhe një sibusull për standardololgët e sotëm për të përplotësuar e përkryer standardin e gjuhës shqipe.

Pra kontributi i Asdrenit për formimin e gjuhës letrare kombëtare shqiptare duket i qartë në parim edhe nga ana gjuhësore dhe jo vetëm sa i përket kontributit letrar poetik, por edhe sa i përket normës standard. Shtë e vërtetë se ai me perzijimi e patë bazën gjuhësore më të gjerë se se ish-shqipja letrare mbi bazë të gegnishtes (1917) dhe njëherazi ishte më e gjerë, po ashtu edhe ndaj letrarishtes së sotme të Kongresit të Drejtshkrimit 1972, dhe kjo dëshkohet me fakte, siç ishte sistemi foljor i toskërishtes paksa i përçmuar sa u përket trajtave me rotacizëm etj. në standardin e mëparshëm dhe tashti anashkalimi i tërër sistemit foljor të gegnishtes, siç është edhe rasti i mungesës së paskajorja geqe, siç u përmend edhe në këtë punim.

## **Li teratura**

- 1) Ajeti, Prof. Dr Idriz, Kërkime gjuhësore, Prishtinë 1978.
- 2) Ajeti, Prof. Dr Idriz, Për ngritjen e kulturës gjuhësore, gazeta RILINDJA e dt. 11.III.1978.
- 3) Ani? Vladimir, Jezik Ante Kova?evi?a, Zagreb 1971.
- 4) Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit (red. M. Domi), Tiranë 1972.
- 5) Buda, Prof. Aleks, Historia e popullit shqiptar, Prishtinë 1969.
- 6) Bihiku, Koço, Asdren - Vepra I, Tiranë 1976.
- 7) Bala, Vehbi, Lidhjet letrare shqiptare rumune, Bul. shkencor -Shkodër nr. 1/73.
- 8) Berani, Shaqir, Fillet e revolucionit gjuhësor të shqipes -Naim Frashëri- gjuha letrare shqipe dhe kontributi i tij për pasurimin e njësimin e saj, në gaz. RILINDJA të dt. 27.V.1978, Prishtinë.
- 9) Blaku, Murat, "Albania" dhe gjuha, Fjala e dt. 15.I.1975, Prishtinë.
- 10) Blaku, Murat, "Albania" dhe alfabeti i shqipes, në gazetën RILINDJA të dt. 25.XI.1978, Prishtinë.
- 11) Çabej, Prof Eqrem, Studime gjuhësore III, V, Prishtinë 1976.
- 12) Domi - Demiraj, Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976.
- 13) Demiraj, Prof. Shaban, Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Prishtinë, 1970.
- 14) Demiraj, Prof. Shaban, Gjuha e Sami Frashërit (leksiku) BSHSH, 3/55, Tiranë, f.191-234.
- 15) Demiraj, Prof Shaban, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë, 1971.
- 16) Desnickaja, Gjuha shqipe dhe dialektet e saj, Prishtinë 1972.
- 17) Fullani, Dhimitër, Asdreni - Vepra të zgjedhura, Prishtinë 1969.
- 18) Fullani, Dhimitër, Antologji e letërsisë së Rilindjes, Tiranë 1972.
- 19) Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (kostallari, kryet i Kom. hartues), Tiranë 1976.
- 20) Gjuha letrare për të gjithë (Kostallari, kryetar i kom. hartues), Tiranë 1976.
- 21) Gjocaj, Zenun, Roli i Luigj Gurakuqit për themelimin e alfabetit të përbashkët, gazeta "Shkendija" e dt. 1.XII.1978.
- 22) Gjinari, Jorgji, Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve, Konferenca I e st. alb., Tiranë 1962.
- 23) Gjinari, Jorgji, Dialektologjia shqiptare, Prishtinë 1970.
- 24) Hamiti, Sabri, Gjuha poetike e përkushtimi, Fjala 15.VI.1976, Prishtinë.
- 25) Ismajli, Rexhep, Shqipja kontaktet dhe aplikimi i saj, në gaz. RILINDJA të dt. 24.IV.1976, Prishtinë.
- 26) Ismajli, Rexhep, Rreth koncepteve gjuhësore të L. Gurakuqit, "Përparimi" 5/78, Prishtinë.
- 27) Ismajli, Rexhep, Shenj e ide, Prishtinë 1974.
- 28) Ismajli, Rexhep, Shumësia e tekstit, Prishtinë 1977.
- 29) Jokli, Norbert, Naim Be Frashëri e pasurimi i gjuhës shqipe, Gjurm. alban. II/72 f.21-30, Prishtinë.
- 30) Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe (Idriz Ajeti red...), Prishtinë 1974.
- 31) Kadare Ismajl, Naim Frashëri e gjuha e njësuar shqipe, në gaz. RILINDJA e dt. 28,29,30 XI.1977, Prishtinë.
- 32) Kastrati, Jup, Disa konsiderata të Asdrenit për gjuhën shqipe, Bul. shkencor - Shkodër 1/73.
- 33) Kostallari, Prf Androkli, Nga punimet, ligjëratat e artikujt përkatës, sidomos po dallojmë: Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, St.mbi leks... Tiranë 1972.

Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj, SF 1/73, Tiranë.

34) Mulaku, Prof Dr Latif, Mbi disa çështje të gjuhës letrare shqipe, në gaz. RILINDJA dt. 24.IV.1976.

35) Mulaku, Prof Latif, Mbi gjuhën e vjershave të Fan Nolit, "Përparimi" 10/62, Prishtinë.

36) Martinet, Andre, Elementet e gjuhësisë së përgjithshme, Prishtinë 1974.

37) Pavloviq, Dr. Milivoje, Problemi i principi stilistike, Beograd 1969.

38) Pranjiq, Jezik i knjizevno djelo, Zagreb 1973.

39) Qosja, Dr Rexhep, Antologjia e lirikës shqipe, Prishtinë 1970.

40) Qosja, Dr Rexhep, Asdreni, jeta dhe veprat e tij, Prishtinë 1972.

41) Qosja Dr. Rexhep, Kontinuitete, Prishtinë 1972, f.104-117.

42) Qorac Dr., Jezik i stil Mihaila Lali?a, Pr 1968 -stilisti?ka istra?ivanja. Pr'74.

43) Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe (red. përgj. Kostallari) I, II, Tiranë 1972.

44) Stevanoviq Dragutin, Pesni?ki jezik i stil Vladislava Petkovi?a-Disa, Beograd 197??.

45) Stanoj???? ?ivojin, Jezik i stil Iva Andri?a, Beograd 1967.

46) Sosyr, dë Ferdinand, Kursi i gjuhësisë së përgjithshme, Prishtinë 1977.

47) Shuteriqi, Dhimitër, Historia e letërsisë shqipe II, Prishtinë.

48) Shkurtaç, Gjovalin, Naim Frashëri dhe gjuha letrare shqipe, Nendori 5/71, Tiranë f.34-50.

49) Xhuvani, Prof. Aleksandër, Studime gjuhësore, Prishtinë 1968.

\*